



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORTI VJETOR

2019

Nr. 19

Prishtinë, 2020

Përmbajtje

Fjala e Avokatit të Popullit.....	9
I. Institucioni i Avokatit të Popullit.....	11
Mandati i Avokatit të Popullit	11
Promovimi i të drejtave të njeriut.....	14
Qasja në Institucionin e Avokatit të Popullit.....	20
II. Gjendja e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës	21
Pushteti legjislativ	21
Sistemi gjyqësor	25
Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve dhe e prokurorëve.....	26
Pushteti ekzekutiv.....	29
Përgjegjësia për mjedisin jetësor	33
E drejta për qasje në dokumente publike.....	44
III. Të drejtat e fëmijëve.....	48
Gjendja e të drejtave të fëmijëve	48
Korniza ligjore dhe të drejtat e fëmijëve	48
Analizë e shkurtër e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës	49
E drejta e fëmijëve në arsim	51
Dhuna dhe gjendja e sigurisë në shkolla	52
Fëmijët me aftësi të kufizuara	53
Fëmijët në situatë rruge	54
Të rinjtë/fëmijët viktime të abuzimit me substanca narkotike	56
Të drejtat e fëmijëve në procedurat në organe gjyqësore dhe administrative	58
Mbrojtja sociale dhe shëndetësore e fëmijëve.....	58
Drejtësia për të mitur	60
Detyrimet pozitive të shtetit lidhur me të drejtën për jetë.....	62
IV. Barazia para ligjit	64
Zbatimi i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi	65
Diskriminimi në punë.....	67
Diskriminimi ndaj pensionistëve.....	73

Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	74
Strehimi social.....	76
Personat me aftësi të kufizuara.....	77
Barazia gjinore	79
Barazia gjinore ndërlidhur me çështjen e së drejtës në punë	80
Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe zbatimi i Ligjit për Barazi Gjinore	80
E drejta e pronës dhe e trashëgimisë	82
Dhuna në familje	83
Komunitetet pakicë në Kosovë.....	85
Kthimi dhe siguria	85
Regjistrimi civil dhe dokumentet e identitetit	88
Të drejtat pronësore.....	89
Arsimi	91
Përdorimi i gjuhës	94
V. Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (MKPT)	97
Raportet me rekomandime të publikuara gjatë vitit 2019	97
Bashkëpunimi me MKPT-në i institucioneve të vizituara	98
Policia e Kosovës	98
Qendrat korrektuese dhe të paraburgimit	100
Personeli, trajtimi dhe infrastruktura.....	109
Qendra për Azilkërkues.....	114
Qendra e Mbajtjes për të Huajt.....	115
Rekomandimet e MKPT-së dhe progresi i autoriteteve në zbatimin e tyre	116
Institucionet e shëndetit mendor.....	118
Shtëpitë Integruese në Bashkësi	119
Shtëpitë me Bazë në Komunitet	121
Shtëpia për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare.....	124
VI. Përmbledhje e raporteve me rekomandime, letër rekomandimeve, opinioneve, amicus curiae dhe kërkesave për masë të përkohshme	126
Raportet sipas detyrës zyrtare.....	126

Raport ex officio nr. 479/2017 lidhur me menaxhimin e papërshtatshëm të deponisë sanitare të mbeturinave në Velekincë të Gjilanit.....	126
Raport ex officio nr. 305/2019 për trajtimin e personave me HIV dhe AIDS	126
Raport ex officio nr. 514/ 2016 në lidhje me çështjen e fëmijëve në situatë rruge.....	126
Raport ex officio nr. 450/2018 përkitazi me trajtimin e pabarabartë të pensionistëve nga ana e bankave komerciale në Kosovë.....	127
Raport ex officio nr. 421/2019 për mungesën e mjeteve juridike efektive për zgjidhjen e kontesteve të punës	128
Raport ex officio nr. 340/2017 për situatën e personave me aftësi të kufizuara në komunën e Gjilanit	128
Raport ex officio nr. 346/2019 për detyrimet pozitive të shtetit përkitazi me mbrojtjen nga dhuna në familje	128
Raport ex officio nr. 567/2019 për detyrimet pozitive të shtetit në rastin e K. V.....	129
Raport ex officio nr. 468/2019 për detyrimet pozitive të shtetit në rastin e znj. Z. S.	129
Raport ex officio nr. 489/2018 për përdorimin e substancave narkotike nga fëmijët	130
Raport ex officio nr. 59/2019 për vlerësimin e sistemit të ofrimit të shërbimeve sociale.....	130
Raportet me rekomandime	130
Raport A. nr. 683/2018 në lidhje me Ligjin nr. 06/L-012 për Kryeqytetin.....	130
Raport A. nr. 119/2018 për mosvazhdimin të licencave të punës së gjeodetëve të kategorisë së dytë dhe për mos harmonizim të dispozitave të legjislacionit sekondar	131
Raport A. nr. 674/2018 në lidhje me lirinë e asociimit	131
Raport A. nr. 288/2018 në lidhje me mosaprovimin e kërkesës për kthim në listat prioritare, si dhe efektin juridik të anulimit të Vendimit nr. 2/988 të Senatit të UP-së.....	131
Raport A. nr. 18/2018, 56/2018 dhe 57/2018 lidhur me kushtëzimin për anëtarësim në Shoqatën e të Verbërve të Kosovës	132
Raport A. nr. 869/2018 për kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike	132
Raport A. nr. 542/2018 për kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike	133
Raport A. nr. 108/2019 për kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike	133
Raport A. nr. 131/2018 në lidhje me kushtëzimin e shkyçjes nga rrjeti i ngrohjes	134
Raport A. nr. 327/2018 lidhur me zvarritjen e procedurës në GjThP	134
Raport A. nr. 558/2019 lidhur me zvarritjen e procedurës në GjThP	134
Raport A. nr. 209/2018 lidhur me zvarritjen e procedurës në GjThP	135
Raport A. nr. 842/2017 për mosndërmarrjen e veprimeve adekuate në drejtim të lirimit të hapësirave publike nga Komuna e Fushë Kosovës	135

Raport A. nr. 925/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në GjThP	135
Raport A. nr. 352/2019 lidhur me moszbatimin e aktvendimit të GjThP-së nga KEDS	135
Raport A. nr. 826/2018 për kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike	136
Raport A. nr. 849/2016 në lidhje me pretendimet për statusin e “dëshmitarit të mbrojtur”	136
Raport A. nr. 662/2019 për kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike	136
Raport A. nr. 831/2018 për problemet e banorëve të lagjes “Ndre Mjeda” në Ferizaj për qasje në rrjetin e kanalizimit	137
Raport A. nr. 742/2019 për kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike	137
Raportet e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës	137
Raport i MKPT-së lidhur me vizitën në Qendrën e Mbajtjes për të Huajt në Vranidoll.....	137
Raport i MKPT-së lidhur me vizitën në Shtëpinë e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore në Shtime	138
Raport i MKPT-së për vizitën në pikën e kalimit kufitar në Aeroportin “Adem Jashari”	139
Raport i MKPT-së për vizitën në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë	139
Raport i MKPT-së për vizitën në Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan.....	139
Raport i MKPT-së lidhur me vizitën në Qendrën Korrektuese në Dubravë	140
Raport i MKPT-së lidhur me vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë	140
Raport i MKPT-së lidhur me vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prizren	140
Raport i MKPT-së lidhur me vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan	141
Raport i MKPT-së lidhur me vizitën në Qendrën Edukativo - Korrektuese në Lipjan.....	141
Raport i MKPT-së lidhur me vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë.....	142
Raport i MKPT-së lidhur me vizitën në Burgun e Sigurisë së Lartë	142
Letër rekomandimet	142
Letër rekomandimi për rastin ex officio nr. 67/2019	142
Letër rekomandimi për rastin ex officio nr. 133/2019	143
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 839/2018.....	143
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 818/2018.....	144
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 706/2018.....	144
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 522/2018.....	144
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 562/2017	145
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 888/2017.....	145
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 30/2019	145

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 245/2019	146
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 591/2018	146
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 699/2018	146
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 235/2019	147
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 29/2019	147
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 9/2019	147
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 60/2019	148
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 260/2019	148
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 265/2019	148
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 412/2019	149
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 203/2019	149
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 164/2015	150
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 290/2019	150
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 448/2019	150
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 256/2019	151
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 363/2019	151
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 275/2019	151
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 496/2019	152
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 337/2019	152
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 877/2019	153
Letër rekomandimi për vizitat nga MKPT-ja nëpër stacionet policore	153
Letër rekomandimi për vizitën e MKPT-së në Qendrën Korrektuese në Dubravë	153
Letër rekomandimi për vizitën e MKPT-së në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan	154
Letër rekomandimi për vizitën nga MKPT-ja në Qendrën e Paraburgimit në Pejë	154
Opinionet e Avokatit të Popullit	155
Opinion nr. 67/2019 lidhur me Kodin e Drejtësisë për të Mitur	155
Opinion nr.744/2019 për sigurimin e qasjes në informim për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar të dëgjimit	155
Mendimet juridike në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae)	155
Mendim Juridik në cilësinë e mikut të gjykatës lidhur me padinë e ankuesve E. Sh. dhe B. E.	155
Mendim Juridik në cilësinë e mikut të gjykatës lidhur me rastin e S. S. dhe N. D.	156
Mendim Juridik në cilësinë e mikut të gjykatës në lidhje me padinë C.nr.3381/2018	156

Mendim Juridik në cilësinë e mikut të gjykatës në lidhje me pretendimet për të drejtën për trajtim të barabartë	156
Mendim Juridik në cilësinë e mikut të gjykatës në lidhje me ankesën e E. B.	157
Kërkesat për Masë të Përkohshme	158
Kërkesë e Avokatit të Popullit drejtuar GjThP-Departamentit për Çështje Administrative, që ta shtyjë ekzekutimin e dhunshëm të Vendimit nr.01/10-01/2019A.....	158
Kërkesë e Avokatit të Popullit drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e disa paragrafëve të neneve të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë.....	158
Kërkesë e Avokatit të Popullit drejtuar Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor lidhur me çështjen e operimit të hidrocentraleve në vend	159
Kërkesë e Avokatit të Popullit drejtuar GjThP-së në lidhje me listat e kandidatëve të subjekteve politike për Zgjedhjet e Parakohshme 2019	159
Kërkesë e Avokatit të Popullit drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin dhe pezullimin e disa dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.....	160
Kërkesë e Avokatit të Popullit drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin si dhe për pezullimin e Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik	161
VII. Bashkëpunimi ndërkombëtar	162
Bashkëpunimi me homologë dhe me organizata të tjera ndërkombëtare.....	165
Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare	169
Raportimi në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë	171
VIII. Komunikimi me publikun dhe me mediat	172
Tabela 1: Rastet e hapura Ex. Officio nga raportimet e mediave.....	172
IX. Financimi.....	176
Financimi i IAP-së nga Buxheti i Republikës së Kosovës	176
Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2019.....	177
Donacioni - financimi direkt i IAP-së	178
X. Statistikat	179
Përmbledhja statistikore e ankesave dhe e rasteve për vitin 2019	179
Paraqitja grafike e statistikave 1 janar 2019 - 31 dhjetor 2019.....	186
Statistikat për treguesin 7 të Kontratës së Reformës Sektoriale për Reformën e Administratës Publike	190

Fjala e Avokatit të Popullit

Raportimi i Avokatit të Popullit në baza vjetore është standard i mbështetur ndërkombëtarisht, me të cilin synohet të krijohet ndërvarësia mes demokracisë, në njërin anë, mbrojtjes së të drejtave e të lirive të njeriut dhe sundimit të së drejtës, në anën tjetër, parime këto të përcaktuara edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Këto parime në vetvete bartin detyrimin që shteti ta garantojë demokracinë, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sundimin e së drejtës dhe ta bartin përgjegjësinë e plotë për zbatimin e tyre.

Raporti vjetor i Avokatit të Popullit, në frymën e parimeve të lartpërmendura dhe të mandatit kushtetues e ligjor, synon të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme të sfidave në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës. Me theks të veçantë në çështjet e problemeve sistematike në të tria shtyllat e pushtetit: në legjislativ, në ekzekutiv dhe në gjyqësor, duke besuar se në këtë mënyrë ky Raport do të shërbejë gjithashtu si mjet për forcimin e demokracisë në vend.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e përcakton Avokatin e Popullit si institucion të pavarur në ushtrimin e detyrave, pa ndërhyrje nga organet, nga institucionet ose nga autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtet në Republikën e Kosovës. Në përputhje me këtë të drejtë, Avokati i Popullit vazhdimisht u ka bërë thirrje institucioneve publike që t'i respektojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, të cilat janë të përcaktuara me Kushtetutë, me ligje dhe me konventa ndërkombëtare, të zbatueshme drejtpërdrejt në legjislationin vendor.

Puna e Avokatit të Popullit përgjatë vitit 2019 më së miri pasqyrohet në këtë Raport, të 19-in me radhë, i cili ndërthet në vete kompilim të informatave për veprimet e Avokatit të Popullit pikërisht për mbikëqyrjen, për mbrojtjen dhe për promovimin e të drejtave dhe të lirive themelore. Gjithashtu, në Raport është paraqitur gjendja e të drejtave të njeriut, e barazisë dhe e sundimit të ligjit.

Përmes këtij Raporti ia paraqesim Kuvendit të Republikës së Kosovës një përmbledhje gjithëpërfshirëse të gjendjes së të drejtave të njeriut në vend, si obligim që buron nga Kushtetuta. Raporti, në të njëjtën kohë, mëton tërheqjen e vëmendjes së institucioneve që respektrimin e të drejtave të njeriut të mos e lënë në mëshirën e veprimeve të lira politike, por, nëpërmjet instrumenteve ekzekutive, të sigurojnë zbatimin e tyre.

Trajtimi meritor i Raportit nga ana e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës gjithashtu ndihmon në përmirësimin e llogaridhënies nga ana e autoriteteve, të cilat kanë abuzuar apo i kanë shkelur të drejtat e njeriut, pavarësisht adresimit nga institucioni që unë e përfaqësoj. Megjithatë, dëshiroj të theksoj se, përgjatë këtyre viteve të mandatit tim, është vërejtur një ngritje shumë progresive në zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga ana e autoriteteve të nivelit qendror, ku në vitin 2015 ishte vetëm 11%, derisa gradualisht, nga viti në vit, zbatimimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga autoritetet e nivelit qendror këtë vit (2019) ka arritur në 54%. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve mbeten të pazbatuara nga ana e autoriteteve, e sidomos nga ana e autoriteteve të nivelit lokal, prej të cilëve pres një bashkëpunim më të fuqishëm dhe më të përgjegjshëm, me qëllim dhe me interes të mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive të njeriut në komunat e tyre.

Për më shumë, dëshiroj të vë në dritë se trajtimi meritor i Raportit vjetor të Avokatit të Popullit është një mundësi e përshtatshme për ta luftuar kulturën e trajtimit të të drejtave të njeriut vetëm si vlerë (e drejtë) morale, e cila nuk është e zbatueshme, por në rastin më të mirë si e drejtë për të cilën duhet ankuar, shkelja e të cilave nuk ka konsekuenca juridike, por eventualisht morale.

Të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës nuk janë koncepte abstrakte juridike, të cilat doemos duhen zbërthyer në dokumente më të përshtatshme ligjore për të qenë të zbatueshme. Ashtu siç janë garantuar në Kushtetutën e vendit, të drejtat dhe liritë përbëjnë hiç më pak se mënyrën e jetesës së qytetarëve të republikës, të cilat i garanton shteti dhe i cili mbahet përgjegjës për shkeljet e tyre.

Unë dhe bashkëpunonjësit e mi shpresojmë shumë se ky Raport do të mund të debatohet në seancë plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për dallim nga Raporti i vitit 2018, i cili nuk e arriti këtë synim aq të domosdoshëm, për shkak të zhvillimeve politike në vend.

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

I. Institucioni i Avokatit të Popullit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka përcaktuar Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) si kategori kushtetuese, përkatësisht si institucion të pavarur kushtetues.¹ Avokati i Popullit mbron, mbikëqyr dhe promovon të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.² Funksionin e tij Avokati i Popullit e ushtron në bazë të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, sipas të cilit Avokati i Popullit shërben si një mekanizëm ligjor për mbrojtjen, për mbikëqyrjen dhe për promovimin e të drejtave dhe të lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, të institucioneve dhe të personave apo të autoriteteve të tjera, të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: autoritetet publike), dhe si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të Torturës dhe të trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.³

Po ashtu, Avokati i Popullit përfaqëson mekanizmin e barazisë, i cili promovon, monitoron dhe mbështet trajtimin e barabartë, pa diskriminim në bazat e përcaktuara me Ligjin për Barazi Gjinore dhe me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.⁴

Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, IAP-ja përbëhet nga: Avokati i Popullit, pesë (5) zëvendës të Avokatit të Popullit dhe nga personeli i IAP-së.⁵

Mandati i Avokatit të Popullit

Mandati i Avokatit të Popullit është përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Avokatin e Popullit, sipas të cilëve Avokati i Popullit pranon dhe heton ankesat nga çdo person, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës, i/e cili/a pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore nga autoritetet publike në Kosovë.

Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrave dhe nuk pranon udhëzime ose ndërhyrje nga autoritetet publike, të cilat janë të detyruara t'u përgjigjen kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesin të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin.

Në kuadër të veprimtarisë së tij, Avokati i Popullit udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit⁶, si dhe ka pavarësi organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.⁷

Në kuadër të kompetencave të tij, Avokati i Popullit zhvillon hetime për ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me Kushtetutë,

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli XII, nenet 132 – 135.

² Po aty, neni 132.

³ Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 1, paragrafi 1.

⁴ Po aty, neni 1, paragrafi 2.

⁵ Po aty, neni 5.

⁶ Po aty, neni 3, paragrafi 1.

⁷ Po aty, neni 3, paragrafi 3.

me ligje, me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNj)⁸.

Avokati i Popullit mund të zhvillojë hetime edhe me iniciativën e vet (*ex-officio*) nëse dëshmitë, faktet, konstatimet ose njohuritë e fituara ofrojnë bazë për shkeljen e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, Avokati i Popullit përdor ndërmjetësimin dhe pajtimin, si dhe mund t'u ofrojë shërbime të mira edhe qytetarëve të Republikës së Kosovës që ndodhen jashtë shtetit. Shërbimet e ofruara nga Avokati i Popullit janë falas.

Nëse Avokati i Popullit gjatë kryerjes së hetimeve vëren se ka elemente të veprës penale, e informon organin kompetent për fillimin e hetimeve. Po ashtu, Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, me çështjet e barazisë dhe me mbrojtje nga diskriminimi. Avokati i Popullit nuk ndërhyt në rastet dhe në procedurat e tjera gjyqësore, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave. Por Avokati i Popullit mund të japë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Po ashtu, Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën dhe me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese⁹.

Në kuadër të Avokatit të Popullit funksionon edhe Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe të trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese (MKPT).¹⁰

Avokati i Popullit, në kuadër të përgjegjësi si MKPT, është i obliguar që t'i vizitojë rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria (duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut). Avokati i Popullit bashkëpunon me mekanizmat ndërkombëtarë dhe vendorë në fushën e parandalimit të torturës si dhe formave të tjera të trajtimit apo ndëshkimit mizor, jonjerëzor dhe poshtëruës. Gjithashtu, Avokati i Popullit mund të japë sugjerime dhe rekomandime për personat dhe për institucionet përgjegjëse ku mbahen personat e privuar nga liria, pa marrë parasysh llojin apo objektin dhe rrethanat e mbajtjes së tyre, për përmirësimin e trajtimit dhe të kushteve të tyre.

Avokati i Popullit kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, me Ligjin për Barazi Gjinore dhe me legjislacionin tjetër në fuqi; mbledh të dhëna statistikore për çështjet e diskriminimit dhe të barazisë të paraqitura te Avokati i Popullit, të cilat edhe i publikon; nxjerr raporte dhe jep rekomandime për politikat dhe për praktikatat për luftimin e diskriminimit dhe për promovimin e barazisë; bashkëpunon me partnerët socialë dhe OJQ-të që merren me çështje të barazisë dhe kundër diskriminimit si dhe me trupa të ngjashëm ndërkombëtarë me Avokatin e Popullit.¹¹

Avokati i Popullit ka edhe përgjegjësitë e theksuara ligjore: jo vetëm t'i hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit, por edhe të angazhohet për eliminimin e tyre; të

⁸ Po aty, neni 16.

⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 113, paragrafi 2, neni 135, paragrafi 4, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 10. Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, neni 29.

¹⁰ Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 17.

¹¹ Po aty, neni 16, paragrafët 13 deri 16.

hartojë dhe të miratojë procedura të veçanta për pranimin dhe për trajtimin e ankesave për fëmijët, si dhe krijimin e ekipit të specializuar për të drejtat e fëmijëve dhe të programit të përhershëm për vetëdijesimin e fëmijëve për të drejtat e tyre dhe për rolin e IAP-së për mbrojtjen e tyre; t'i bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe t'i rekomandojë qeverisë, Kuvendit dhe autoriteteve të tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe me avancimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut, të barazisë dhe të jodiskriminimit; t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta; të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve si dhe nxjerrjen apo ndryshimin dhe plotësimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës; të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut; të rekomandojë harmonizimin e legjislacionit vendor me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe për liritë e njeriut, të barazisë dhe kundër diskriminimit, dhe të kryejë hulumtime për çështjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, të barazisë dhe kundër diskriminimit; në pajtim me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi, të bashkëpunojë me të gjitha autoritetet vendore dhe ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut; ta ruajë fshehtësinë e të gjitha informatave dhe të të dhënave që i merr, duke i kushtuar kujdes të veçantë sigurisë së ankuesve, palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve, në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ankesat kundër administratës publike qytetarët mund t'i parashirojnë sipas procedurës së thjeshtë dhe pa pagesë. Ankesat e drejtuara në IAP mund t'u referohen veprimeve, mosveprimeve ose vendimeve të administratës publike, që nga ankuesit mund të konsiderohen të padrejta ose të pafavorshme. Në shqyrtimet e ankesave të tilla, veprimet e këshilltarëve të IAP-së kanë të bëjnë me ofrimin e këshillave juridike, me kërkim të të dhënave nga administrata publike, nga gjykatat dhe nga institucionet e tjera të rëndësishme, lidhur me ankesat e paraqitura, si dhe me mbikëqyrjen e procedurave të caktuara administrative dhe gjyqësore.

Në rastet që kërkojnë veprime të menjëhershme, Avokati i Popullit paraqet kërkesa për masa të përkohshme. Nëse Avokati i Popullit konsideron se duhet të merren masa të menjëhershme nga autoritetet publike, ai mund të kërkojë që organi administrativ kompetent ta ndërmarrë ose ta suspendojë një veprim të veçantë, si masë e përkohshme për ta parandaluar dëmin e papërmirësueshëm të ankuesve apo të pasurisë së tyre.

Në qoftë se kërkesat për intervenim dhe përpjekjet për ndërmjetësim nuk janë të suksesshme, Avokati i Popullit mund të nxjerrë raport, duke siguruar analiza dhe paraqitje publike për shkelje të të drejtave të njeriut ose të ligjeve të aplikueshme, së bashku me rekomandime për institucionin publik, për t'i evituar shkeljet. Raporti i drejtohet autoritetit që ka bërë shkelje, kurse kopja e raportit i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe organizatave të tjera përkatëse. Ndërsa raportin vjetor për vitin paraprak, Avokati i Popullit ia paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës deri më 31 mars të vitit vijues, i cili shqyrtohet në seancë plenare në Kuvend gjatë sesionit pranveror.¹²

¹² Po aty, neni 29.

Kompetencat e Avokatit të Popullit për t'i shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga diskriminimi në përgjithësi dhe nga diskriminimi gjinor në veçanti janë paraparë me dy ligjet e tjera bazike për të drejtat e njeriut (Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ligjin për Barazi Gjinore).

Kështu, sipas Ligjit për Barazi Gjinore, Avokati i Popullit është institucion i barazisë gjinore që trajton rastet që lidhen me diskriminimin gjinor, në përputhje me procedurat e parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit.¹³

Ndërsa, sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit bën promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin, sipas ligjit përkatës për Avokatin e Popullit.¹⁴

Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM) është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.¹⁵

Promovimi i të drejtave të njeriut

Avokati i Popullit, edhe gjatë vitit 2019, është përkushtuar në drejtim të përmbushjes së mandatit ligjor që buron nga Ligji nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit dhe përcaktimeve të standardeve ndërkombëtare për promovimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore.

Si rezultat i angazhimit dhe përkushtimit në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, Institucioni i Avokatit të Popullit vazhdon të jetë institucioni më i besuar në vend dhe më gjerë.¹⁶

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2019, i publikuar në maj të vitit 2019, ka theksuar: *“Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës ka vazhduar të avancojë mandatin e tij në promovimin, mbrojtjen dhe mbështetjen e të drejtave dhe lirive themelore për të gjithë dhe të përforcoj kapacitetin e tij në shqyrtimin e rasteve. Ky i fundit mbetet institucioni më i besuar në Kosovë.”*

Institucioni i Avokatit të Popullit, me qëllim të përmbushjes së mandatit të tij për promovimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, gjatë vitit 2019 ka vazhduar me organizimin e aktiviteteve edukative me qëllim të ngritjes së vetëdijesimit për të drejtat dhe për liritë themelore të njeriut dhe me aktivitete me karakter informues për promovimin e rolit dhe mandatit të Institucionit të Avokatit të Popullit, si institucion i vetëm kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, trajtimin të barabartë dhe pa diskriminim.

Me qëllim të ngritjes së besueshmërisë në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe promovimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, të parapara në Strategjinë dhe Planin Zhvillimor të Institucionit të Avokatit të Popullit 2017-2019, janë organizuar një varg aktivitete me karakter informues, edukues, vetëdijesues, si: trajnime, konferenca, fushata vetëdijesimi, tryeza të rrumbullakëta, punëtori etj.

¹³ Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, neni 13.

¹⁴ Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 9.

¹⁵ Po aty, neni 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2.

¹⁶ Raporti i Porgresit 2019 për Kosovën, i publikuar nga Komisioni Evropian, maj 2019, fq. 7

Po ashtu, duke marrë në konsideratë rolin dhe kontributin e rëndësishëm të mediave në promovimin e të drejtave të njeriut, Institucioni i Avokatit të Popullit ka vazhduar të jetë i pranishëm në media: radio, televizion, gazeta, portale etj.

Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe promovimi i të drejtave të njeriut

Bashkëpunimi ndërinstytucional në fushën e të drejtave të njeriut me institucione vendore, me organizata ndërkombëtare në Kosovë dhe me shoqërinë civile ka vazhduar edhe gjatë këtij viti. Institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në rreth 50 tryeza diskutimi, 20 konferenca, 35 punëtori, 24 trajnime, 28 debate publike, takime konsultative e tematike si dhe në 9 aktivitete kulturore-artistike, të organizuara nga institucionet publike, nga organizata ndërkombëtare dhe nga shoqëria civile. Gjatë këtyre aktiviteteve janë trajtuar tema të ndryshme nga fusha e të drejtave dhe e lirive themelore të njeriut, si: trajtimi pa diskriminim, barazia gjinore, të drejtat e komuniteteve joshumicë, të drejtat e gruas, të drejtat e fëmijëve, abuzimi me substanca narkotike, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të drejtat e komuniteteve të marginalizuara dhe të tjerë, e drejta për mjedis të sigurtë dhe të shëndetshëm, e drejta për qasje në dokumente publike, e drejta në arsim, të drejtat e personave të privuar nga liria, kompensimi i viktimave të krimit etj.

Ndërsa, me qëllim të përmbushjes së misionit rreth edukimit dhe vetëdijësimit të publikut për të drejtat dhe për liritë themelore të njeriut dhe promovimit të mandatit të IAP-së, gjatë vitit 2019, Avokati i Popullit ka mbajtur 10 ligjërata me studentë të universiteteve publike dhe private në Kosovë.

Në kuadër të kornizës së aktiviteteve të planifikuara, me qëllim të diskutimit për të drejtat dhe për liritë themelore të njeriut, gjatë vitit 2019 janë organizuar tryeza diskutimi dhe konferenca. Më 26 shkurt 2019, u organizua tryezë diskutimi me përfaqësuesit e Komisionin Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës në Kosovë, si dhe me katër OJQ-të e autorizuar për pranim dhe dorëzim të aplikacioneve. Në takim u diskutuan çështjet me rëndësi përkitazi me procesin e njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimave të dhunës seksuale, si: mungesa e arsytimit në vendimet e komisionit; afatet për procedimin e aplikacioneve dhe zvarritjet në procedurë për shqyrtimin e tyre; si dhe mënyra e procedimit të lëndëve në gjykatë, me rastin e inicimit të konfliktit administrativ për refuzim të njohjes së statusit të viktimës së dhunës seksuale. Avokati i Popullit, udhëzoi që vendimet të jenë në përputhje me dispozitat ligjore, me qëllim që palëve t'u garantohet e drejta për shfrytëzim efektiv të mjeteve juridike.

Më 21 mars 2019, IAP-ja, mbështetur nga ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, në bashkëpunim me Shoqërinë Kosovare për të Drejtat e Njeriut dhe Drejtësi, organizoi Tryezën e Diskutimit me temën: *“Përgjegjësia juridike e shtetit për shkeljet e të drejtave të njeriut”*. Në këtë tryezë u diskutua me palët e interesit rreth rregullimit të përgjegjësisë juridike të shtetit, si detyrim kushtetues, i cili buron nga detyrimet pozitive të shtetit, si dhe për nevojën e ndërmarrjes së nismës legjislative që do ta siguronte përgjegjësinë juridike të shtetit në shërbim të mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, si dhe të rritjes së nivelit të llogaridhënies së shtetit ndaj qytetarëve.

Avokati i Popullit, më 23 prill 2019, organizoi tryezë diskutimi me përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, nga ShSKUK-ja, nga Oda e Farmacistëve, nga AKPPM-ja, nga Autoriteti i Konkurrencës, nga Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, nga Shoqata e Farmacistëve të Kosovës dhe nga

përfaqësues të Klinikës së Onkologjisë, ku u diskutua për mungesën e barnave nga lista esenciale në QKUK. Pika kryesore e diskutimit ishte mungesa e citostatikëve në Repartin e Onkologjisë, si dhe dështimi i procedurave të tenderimit si rezultat i ofertave me çmime tejet të larta nga kompanitë me pozita monopoli. Ndër rekomandimet e dala nga ky takim ishin: fillimi i hetimit nga Autoriteti i Konkurrencës ndaj kompanive farmaceutike, për keqpërdorim të pozitës së monopolit, si dhe nevoja e revidimit të listës esenciale të barnave.

Më 16 prill 2019, u mbajt konferenca lidhur me përmbylljen e projektit “Fuqizimi i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës”, financuar nga Këshilli i Evropës, nga qeveria zvicerane dhe nga ajo norvegjeze, ku morën pjesë të gjitha institucionet relevante në Republikën e Kosovës. Në kuadër të projektit në fjalë, u organizuan trajnime intensive nga ekspertët e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës për monitorimin e të gjitha vendeve ku mbahen personat e privuar nga liria.

Vëmendje e veçantë edhe këtë vit iu kushtua diskutimit dhe adresimit të problemeve mjedisore dhe ndikimit në të drejtat e njeriut. Në kuadër të aktiviteteve për promovim të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, më 5 qershor 2019, me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Mjedisit, IAP-ja, në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit në Kosovë, organizuan tryezën me temën: “Mjedisi i sigurt dhe i shëndetshëm – e drejtë e njeriut dhe përgjegjësi kushtetuese”. Qëllimi i organizimit të tryezës ishte diskutimi për gjendjen e mjedisit në Kosovë, me qëllim të gjetjes së modaliteteve për adresim adekuat të problemeve mjedisore nga ana e institucioneve kompetente në vend. Tryeza kishte për qëllim që të vë në pah rëndësinë e bashkëpunimit të institucioneve publike me Avokatin e Popullit dhe me Auditorin e Përgjithshëm për zbatimin e rekomandimeve të adresuara institucioneve të nivelit qendror dhe të nivelit lokal, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së mjedisit në vend.

Më 26 qershor 2019, MKPT-ja, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare në Përkrahje të Viktimave të Torturës, organizoi konferencën, ku u prezantua Raporti vjetor i MKPT-së, si dhe u diskutuan sfidat në zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së adresuara tek institucionet përgjegjëse. Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin përfaqësues të institucioneve publike, përfaqësues të organeve të drejtësisë, të Policisë së Kosovës si dhe përfaqësues nga misionet diplomatike dhe nga shoqëria civile.

Më 21 nëntor 2019, u organizua konferencë me rastin e shënimit të 19-vjetorit të themelimit të IAP-së. Të pranishëm në këtë konferencë ishin përfaqësues nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, përfaqësues nga misionet diplomatike dhe nga organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare, ku u prezantuan rezultatet e IAP-së. Ndër të tjera, Avokati i Popullit theksoi: “Janë 19 vjet njohuri dhe përvojë e akumuluar në të gjithë vendin përmes reagimeve, opinioneve, rekomandimeve dhe raporteve vjetore, për t’u shndërruar në institucionin më të besuar në vend, por edhe në Ballkan, për dy vjet radhazi.” Më tej Avokati i Popullit theksoi se do të vazhdojë t’i trajtojë çështjet e të drejtave të njeriut, për të cilat e ka hartuar planin dhe strategjinë. Ngjarja u shoqërua me punëtorinë „Human Rights Cafe”, e cila kishte për qëllim realizimin e disa raudeve të bashkëbisedimeve ndërmjet pjesëmarrësve për çështjet e të drejtave të njeriut, në një atmosferë të relaksuar.

Me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit ndërinstitutional dhe fuqizimit të bashkëpunimit me shoqërinë civile, Avokati i Popullit, gjatë vitit 2019, ka nënshkruar 4 marrëveshje të bashkëpunimit.

Më 15 mars 2019, IAP-ja dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi, me qëllim që të sigurohet një kornizë për bashkëpunim në kuadër të projektit “Mbështetje për forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë”. Ky projekt është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë përmes Ambasadës Mbretërore të Norvegjisë në Kosovë, i cili synon mbështetjen e reformës në sektorin e drejtësisë, përmirësimin e qasjes në drejtësi për qytetarët, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e mbështetjes për institucionet e drejtësisë në ngritjen e efikasitetit të tyre.

Më 23 prill 2019, IAP-ja nënshkroi Marrëveshje Bashkëpunimi me Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj), me qëllim të bashkëpunimit në sferën e mbrojtjes dhe të promovimit të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore.

Më 24 prill 2019, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të IAP-së dhe Komisionit Kombëtar Zvicëran për Parandalim të Torturës, me qëllim të monitorimit të përbashkët të operacioneve të kthimit me forcë ndërmjet Zvicrës dhe Kosovës.

Më 5 nëntor 2019, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit mes Avokatit të Popullit të Kosovës, atij të Shqipërisë, të Maqedonisë së Veriut dhe Komisionerëve anti-diskriminim, me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të qytetarëve shqiptarë, dhe jo vetëm në vendet respektive.

Bashkëpunimi në fushën e të drejtave të njeriut me organizata ndërkombëtare në Kosovë, me organizata joqeveritare dhe me shoqërinë civile

Edhe në këtë vit raportues ka vazhduar bashkëpunimi dhe mbështetja e IAP-së nga organizata të ndryshme ndërkombëtare, si: Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës, OSBE, UNICEF, UNMIK, UNDP dhe nga organizata të tjera, nëpërmjet projekteve të ndryshme, me qëllim të bashkëpunimit nga fusha e të drejtave të njeriut dhe e lirive themelore.

Si ngjarje e rëndësishme për IAP-në është fillimi i implementimit të projektit “Mbështetja e Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë”, i financuar nga Bashkimi Evropian. Qëllimi i projektit është fuqizimi i kapaciteteve institucionale dhe mbështetja e IAP-së në mbrojtjen efektive dhe promovimin e të drejtave të njeriut për qytetarët e Kosovës dhe ngritja e vetëdijesimit të qytetarëve dhe të institucioneve publike. Me qëllim të prezantimit të aktiviteteve të projektit dhe përcjelljes së mesazhit për bashkëpunim, koordinim mes palëve të interesuara dhe harmonizimin e aktiviteteve në fushën e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, IAP-ja, më 27 mars 2019, me mbështetje të projektit ka organizuar një takim diskutimi mes palëve të interesit, organizatave joqeveritare në Kosovë, organizatave ndërkombëtare, misioneve diplomatike, dhe përfaqësuesve të institucioneve publike në vend.

Në kuadër të projektit “Avokimi për mbrojtjen e mjedisit dhe eficientësinë e energjisë në Kosovë”, i implementuar nga Environmentally Responsible Action (ERA) group në partneritet me BIRN Kosovë, TV Mreža dhe Bankwatch, gjatë muajit qershor 2019 janë organizuar takime me qytetarë, me gazetarë, me aktivistë të të drejtave të njeriut dhe me përfaqësues nga shoqëria civile, në disa qytete të Kosovës, si: Prishtinë, Ferizaj, Gjiilan e Gjakovë. Në këto tryeza, përfaqësuesit e IAP-së kanë prezantuar çështjet mjedisore të trajtuara nga perspektiva e IAP-së, në rastet më sistematike të

shkeljes së të drejtës në mjedis të sigurtë dhe të shëndetshëm. Po ashtu janë prezantuar edhe aktivitetet promovuese të IAP-së për të drejtën në mjedis të sigurtë dhe të shëndetshëm dhe ngritjes së vetëdijesimit të qytetarëve rreth informimit për të drejtat mjedisore si dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në proceset me ndikim në mjedis.

Në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës në baza gjinore dhe shënimit të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, OSBE-ja, në kuadër të aktivitetit “*Të Drejtat e Njeriut përmes Artit*”, ka organizuar diskutime publike me të rinjtë në Prizren, në Pejë, në Obiliq, në Gjilan dhe në Mitrovicë. Qëllimi i aktivitetit ishte diskutimi me të rinjtë për të drejtat e njeriut dhe për mekanizmat mbrojtjes. Gjatë këtyre diskutimeve, të rinjtë e grup-moshave të ndryshme u njoftuan nga Avokati i Popullit për të drejtat themelore të njeriut, me rolin dhe me mandatin e IAP-së në lidhje me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Më 10 dhjetor 2019, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, IAP-ja lansoi “Platformën për të Drejtat e Njeriut”, e cila synon të promovojë zbatimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, siç garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me aktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe me ligjet e zbatueshme në Kosovë.

Po ashtu, më 10 dhjetor 2019, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, Avokati i Popullit, në bashkëpunim me shoqërinë civile në Kosovë, organizoi për të tretin vit me radhë marshin “Çohu për të Drejtat e Njeriut”. Këtë vit kjo iniciativë kishte për qëllim dërgimin e një mesazhi për një angazhim më të shtuar, gjithëpërfshirës dhe ndërinstytucional për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me theks të veçantë për mbrojtjen e së drejtës për një mjedis të sigurtë dhe të shëndetshëm, si një nga të drejtat themelore të njeriut. Nëpërmjet marshit iu bë thirrje institucioneve të Republikës së Kosovës për ndërmarrjen e masave më efektive për mbrojtjen e ambientit dhe të së drejtës së qytetarëve për një mjedis të shëndetshëm jetësor.

Promovimi i të drejtave të fëmijëve

IAP-ja i ka kushtuar rëndësi të veçantë edukimit dhe ngritjes së vetëdijesimit të brezave të rinjë rreth të drejtave të njeriut dhe për liritë themelore dhe ka vazhduar me fushata informuese me nxënësit dhe me mësuesit e shkollave fillore dhe të mesme në rajone dhe në komuna të ndryshme të Kosovës. Gjatë vitit raportues janë organizuar rreth 68 fushata informuese me nxënësit dhe me mësuesit e shkollave fillore dhe të mesme. Në këto takime ata janë njoftuar më për së afërmi lidhur me rolin e IAP-së në promovimin dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, si dhe për mundësitë e adresimit të ankesave të tyre në IAP mbi pohimet për shkelje të të drejtave të njeriut, ndër tjerash, edhe përmes platformës online “Njihuni me të drejtat e juaja”.

Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, IAP-ja priti në takim fëmijët e grup-moshave të ndryshme nga komuna e Prishtinës. Gjatë këtyre takimeve fëmijët kishin mundësinë që të njihen më për së afërmi me mandatin e IAP-së, e gjithashtu nëpërmjet pikturave dhe vizatimeve kishin mundësinë që t’i shfaqnin mendimet e tyre për të drejtat e njeriut.

Më 21 qershor 2019, Avokati i Popullit priti në takim 20 fëmijë të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian nga komuna e Podujevës. Në këtë takim fëmijët patën mundësinë që të dëgjohen nga Avokati i Popullit, përkatësisht që t’i shprehin mendimet, qëndrimet apo shqetësimet e tyre për probleme të

ndryshme, me të cilat ata ballafaqohen çdo ditë, jo vetëm në shkollë, por edhe në rrugë e gjetiu. Në këtë takim u vërejt një interesim shumë i madh i fëmijëve për çështje të cilat janë shqetësuese për fëmijët në realitetin kosovar. Fëmijët parashtruan pyetje të shumta për çështje të ndryshme, si: rrezikimi nga qentë endacakë, sjelljet e dhunshme në shkolla, transporti etj.

Më 27 shtator 2019, Avokati i Popullit vizitoi shkollën fillore “Shtjefën Gjeçovi” në Janjevë, ku zhvillohet mësim nga nxënës të tri komuniteteve njëkohësisht (shqiptarë, kroatë dhe romë). Avokati i Popullit, gjatë kësaj vizite, i informoi më për së afërmi rreth të drejtave të fëmijëve, mbrojtjes nga diskriminimi, si dhe funksionimit të IAP-së.

Më 6 nëntor 2019, Avokati i Popullit publikoi Rregulloren për procedurat e veçanta për pranimin, trajtimin dhe adresimin e ankesave të paraqitura nga fëmijët apo ankesave që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve, e mbështetur nga Organizata Joqeveritare “Terre des hommes”. Kjo rregullore përcakton rregulla të veçanta për pranimin, trajtimin dhe adresimin e ankesave, që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve, duke garantuar dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e tyre të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet dhe me aktet e tjera, si dhe me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, veçanërisht me Konventën për të Drejtat e Fëmijës.

Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve, më 20 nëntor 2019, Avokati i Popullit organizoi ditë të hapur për fëmijët. Në këtë ditë fëmijëve iu dha mundësia që të dëgjohen nga IAP-ja, përkatësisht që t’i shprehin mendimet, qëndrimet apo shqetësimet e tyre për probleme të ndryshme me të cilat ata ballafaqohen çdo ditë.

Lansimi i Platformës për të Drejtat e Njeriut si dhe i video spoteve me karakter edukues e informues

Më 10 dhjetor 2019, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, IAP-ja lansoi “Platformën për të Drejtat e Njeriut”, e cila synon të promovojë zbatimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, siç garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me aktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe me ligjet në Kosovë. Kjo Platformë përmban dy udhëzues: “Udhëzuesin e të Drejtave të Njeriut” dhe “Udhëzuesin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ)”, të cilët do të shërbejnë për të siguruar qasje më të lehtë dhe praktike në juridiksionin vendor dhe ndërkombëtar përmes lidhjeve të strukturuar mes instrumenteve juridike, të cilat zbatohen drejtpërdrejt në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, si dhe për të demonstruar lidhjet e OZhQ-së me të drejtat dhe me liritë themelore të njeriut. Platforma është projektuar nga IAP-ja dhe është zhvilluar në bashkëpunim UNDP-në, me mbështetje financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë.

Gjatë vitit raportues, IAP-ja ka lansuar tri video spote me karakter edukues dhe informues për të drejtat e njeriut. Video spotet kanë trajtuar problematika të ndryshme nga fusha e të drejtave të njeriut, me qëllim ngritjen e vetëdijesimit dhe promovimin e të drejtës për mjedis të sigurtë dhe të shëndetshëm, mbrojtjen nga diskriminimi, duke përcjellur një mesazh tek autoritetet përgjegjëse, në mënyrë që t’i ndërmarrin masat e duhura. Këto video spote janë transmetuar në TV si dhe janë publikuar në media sociale.

Qasja në Institucionin e Avokatit të Popullit

IAP-ja, në zyrat e saj, për çdo ditë pune (nga e hëna deri në të premten) nga ora 8:00 - 16.00, pret qytetarët, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre. Ata priten nga këshilltarët ligjorë të IAP-së, të cilët i trajtojnë rastet me kujdes, me konfidencialitet dhe me profesionalizëm.

Për ta lehtësuar qasjen në IAP të qytetarëve të Kosovës, përveç Zyrës Qendrore në Prishtinë, IAP-ja ka edhe zyra rajonale: në Ferizaj, në Gjakovë, në Gjilan, në Mitrovicën Jugore, në Mitrovicën Veriore, në Pejë, në Prizren dhe në Graçanicë.

Zyrat e IAP-së përbëhen nga stafi profesional, që u shërben qytetarëve dhe përgjigjet në kërkesat dhe në ankesat e tyre, si dhe mbron të drejtat që ata konsiderojnë se u janë shkelur.

Njëra nga format e qasjes më të lehtë të qytetarëve në IAP është organizimi i Ditëve të Hapura nga Avokati i Popullit dhe nga zëvendësit e tij. Ato organizohen në Prishtinë dhe në zyrat rajonale. Zyrat rajonale i njoftojnë qytetarët e komunave përkatëse për ditët e hapura, përmes publikimit të datave nëpër këto komuna, në mediat lokale dhe në ueb-faqen zyrtare të IAP-së.

Format e tjera të qasjes së qytetarëve në IAP janë edhe qasja përmes postës, përmes telefonit dhe përmes postës elektronike, që po përdoret gjithnjë e më shumë për parashtrimin e ankesave nga qytetarët. Në Zyrën Qendrore të IAP në Prishtinë ekziston edhe linja telefonike falas për raste urgjente, por edhe për raste të tjera të zakonshme.

Zyrtarët e IAP-së bëjnë vizita të rregullta në të gjitha burgjet dhe në vendet ku mbahen personat me liri të kufizuar në Kosovë. Për të mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë me të burgosurit, në bashkëpunim me autoritetet e Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe me autoritetet përgjegjëse të burgjeve në Kosovë, IAP-ja, që nga viti 2004, në të gjitha burgjet dhe në qendrat e paraburgimit në Republikën e Kosovës, në vende të dukshme, ka vendosur kutitë postare, të cilat hapen vetëm nga përfaqësuesit e IAP-së. Kjo praktikë ka dëshmuar se kutitë e vendosura nëpër burgje, përkatësisht në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, kanë ndihmuar shumë të burgosur ose të paraburgosur ta vënë kontaktin e parë me Avokatin e Popullit. Kutitë e tilla janë vendosur edhe në Entet dhe Qendrat e Shëndetit Mendor, gjë që lehtëson qasjen e pacientëve në IAP.

II. Gjendja e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës

Pushteti legjislativ

Avokati i Popullit, në bazë të kompetencave të tij, ka përcjellë procesin legjislativ në fushën e të drejtave të njeriut. Programi Legjislativ për vitin 2019 i Qeverisë së Republikës së Kosovës është miratuar në mbledhjen e 81-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendimin Nr. 03/81¹⁷, i datës 24 dhjetor 2018. Në programin legjislativ për vitin 2019, Qeveria e Republikës së Kosovës ka paraparë shqyrtimin dhe miratimin e 78 projektligjeve (58 projektligje të reja dhe 20 projektligje për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve ekzistuese). Avokati i Popullit ka vërejtur se edhe në vitin 2019 ka vazhduar rënia e përqindjes së projektligjeve për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve ekzistuese.

Në vitin 2019, Qeveria e Republikës së Kosovës ka paraparë që t'i shqyrtojë dhe t'i miratojë 20 projektligje për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve ekzistuese, apo 26% e programit legjislativ, gjë që e dëshmon se Qeveria e Republikës së Kosovës viteve të fundit (viti 2017- 42%, viti 2018 - 31%) ka shënuar progres në këtë drejtim, duke e zvogëluar numrin e projektligjeve për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve ekzistuese, duke reflektuar kështu stabilitetin e ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve në vitin 2019, ka miratuar 29 ligje. Avokati i Popullit konsideron se numri i vogël i miratimit të ligjeve është rezultat i funksionimit jo të rregullt të Kuvendit, i cili, gjatë vitit 2019, ka mbajtur një numër relativisht të madh të seancave të jashtëzakonshme, të cilat janë konsideruar pengesë për funksionimin e mirëfilltë të Kuvendit. Gjithashtu, Avokati i Popullit ka vërejtur se në momentin e shpërndarjes së Kuvendit, më 22 gusht 2019, në proces të shqyrtimit dhe të miratimit kanë mbetur 53 projektligje. Procedimi i numrit kaq të vogël të ligjeve është tregues që Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka pasur mundësi që ta ushtrojë në mënyrë të duhur funksionin e tij kushtetues në drejtim të miratimit të ligjeve. Vlen të theksohet se, gjatë vitit raportues, asnjëri nga ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk i përket legjislacionit me interes vital.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka identifikuar raste kur Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligje, të cilat, për nga përmbajtja e tyre janë në kolizion me ligjet e tjera në fuqi. Kuvendi i Kosovës, më 17 maj 2018, ka miratuar Ligjin nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, i cili për nga kompetencat lidhur me çështjet e sigurisë publike është në kolizion me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë. Lidhur me këtë situatë, Avokati i Popullit, më 14 shkurt 2019, ka publikuar Raportin me rekomandime A.nr 683/2018 dhe i ka rekomanduar Kuvendit e Kosovës marrjen e nismës legjislative për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën, përkatësisht harmonizimin e tij me Ligjin nr. 04/L-074 për Policinë, në aspektet e sigurisë publike. Avokati i Popullit ka rekomanduar që deri në harmonizimin e këtyre ligjeve, në situatat e konfliktit të kompetencës lidhur me çështjet e sigurisë publike, përparësi të ketë Ligji nr. 04/L-074 për Policinë si ligj special.

¹⁷ Programi Legjislativ për vitin 2019 është miratuar në mbledhjen e 81-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendimin nr.03/81, i datës 24.12.2018, i plotësuar dhe i ndryshuar me Vendimin nr. 07/85, i datës 22.1.2019, dhe me Vendimin nr. 03/87, i datës 29.1.2019.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka identifikuar raste të mospërputhjes së versioneve gjuhësore të akteve normative. Lidhur me këtë çështje, gjatë hetimit të ankesave të pranuar dhe gjatë analizimit të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe të Udhëzimit Administrativ MAPL nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të Nënkryetarëve në Komuna, Avokati i Popullit ka identifikuar se ka mospërputhje ndërmjet versioneve të gjuhës shqipe me versionin e gjuhës serbe në aktet në fjalë, e që në praktikë mund të sjellë paqartësi rreth zbatimit të tyre. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit, më 31 korrik 2019, ka publikuar Letër rekomandimin A.nr 9/2019 dhe i ka rekomanduar Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që t'i ndërmarrë veprimet adekuate me qëllim të harmonizimit gjuhësor të Udhëzimit Administrativ MAPL nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të Nënkryetarëve në Komuna, e po ashtu në bashkëpunim me Kuvendin e Kosovës të ndërmarrin masa me qëllim të harmonizimit gjuhësor të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale. Lidhur me këtë çështje, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka mirëpritur rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe janë zotuar se do t'i ndërmarrin veprimet adekuate për harmonizimin gjuhësor të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të udhëzimit administrativ në fjalë.

Në raportin e vitit 2018, Avokati i Popullit kishte vlerësuar se Kuvendi i Kosovës duhet të marrë masa në drejtim të ngritjes profesionale të stafit mbështetës të komisioneve, me qëllim të aftësimit të tyre për interpretimin e ligjeve. Një vlerësim i tillë ishte bazuar në faktin se Kuvendi i Kosovës nuk po e bën interpretimin e ligjeve dhe kjo po sjell paqartësi dhe moskuptim të frymës së ligjeve nga përdoruesit e tyre.¹⁸ Avokati i Popullit vazhdon ta përsërisë qëndrimin e tij lidhur me këtë çështje, në mënyrë që Kuvendi të sigurojë ngritjen profesionale të stafit të tij, me qëllim të aftësimit të tyre në drejtim të interpretimit të ligjeve.

Në raportin e vitit të kaluar, Avokati i Popullit kishte tërhequr vëmendjen se procesi i hartimit të ligjeve është përcjellë edhe me mungesën e konsistencës gjuhësore dhe terminologjike, si pasojë edhe e mungesës së terminologjisë unike juridike. Avokati i Popullit mendon se kjo ka shkaktuar vështirësi në zbatimin përkatës të ligjeve, por edhe në interpretim gjatë zbatimit të tyre. Avokati i Popullit edhe në vitin raportues vlerëson se është e nevojshme që sa më shpejt të bëhet standardizimi i terminologjisë juridike përmes hartimit të fjalorit terminologjik juridik, i cili do të ndihmonte sponsorizuesit e ligjeve, por edhe deputetët, në procesin e hartimit dhe të miratimit të ligjeve.¹⁹

Ashtu sikurse në vitin e kaluar, Avokati i Popullit vazhdon tërheqjen e vëmendjes se është e nevojshme që qeveria ta hartojë Planin e Përafrimit Ligjor, sipas të cilit Kuvendi i Republikës së Kosovës do ta monitoronte procesin e përafrimit të legjisllacionit vendor me atë evropian. Në këtë drejtim, është e nevojshme që në këtë Plan, i cili monitorohet nga Komisioni Parlamentar për Integrim Evropian, të përfshihet edhe legjisllacioni sekondar i miratuar nga qeveria, në mënyrë që Kuvendi të jetë sa më efikas në zbatimin e këtij plani. Avokati i Popullit konsideron se qeveria dhe Kuvendi duhet të kenë një bashkëpunim të ngushtë në funksion të hartimit dhe të mbikëqyrjes së përafrimit të legjisllacionit vendor me atë evropian.²⁰ Po ashtu, Avokati i Popullit konsideron se Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të jetë më aktiv në ushtirimin e funksionit të tij në drejtim të mbikëqyrjes

¹⁸ Raporti Vjetor 2018 i Avokatit të Popullit, faqe 31.

¹⁹ Po aty, faqe 31.

²⁰ Po aty, faqe 31.

së zbatimit të ligjeve. Në këtë drejtim, me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, Kuvendi do të arrinte t'i identifikonte vështirësitë në zbatimin e ligjeve ekzistuese dhe do të mund t'i merrte masat adekuate për eliminimin e pengesave në zbatimin e ligjeve.

Avokati i Popullit e vlerëson si shumë të rëndësishëm edhe procesin e kodifikimit të ligjeve. Nëpërmjet këtij procesi do të mundësohej përmbledhja (grumbullimi) i ligjeve, të cilat e rregullojnë fushën e njëjtë apo të përafërt në një dokument. Me fjalë të tjera, kodifikimi mundëson përmbledhjen e ligjeve nga fusha e njëjtë në një dokument të vetëm. Ky proces do të siguronte që i gjithë legjislacioni i një fushe apo i një resori të gjendet në një dokument dhe po ashtu do t'ua lehtësonte zbatuesve të ligjeve identifikimin dhe qasjen në ligjet e fushës së njëjtë.

Procesi i zbatimit të ligjeve në praktikë është i ndërlidhur me qartësinë e tyre. Lidhur me këtë çështje, në raportin e vitit 2018, Avokati i Popullit e kishte vlerësuar të nevojshëm ndryshimin e teknikave për hartimin e legjislacionit, konkretisht rregullimin e procesit pas miratimit të ligjeve për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve ekzistuese. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit e kishte vlerësuar të nevojshme që qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me Kuvendin, me një ligj për aktet juridike, ta rregullonte procedurën, sipas së cilës, pas miratimit të ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit ekzistues, ato ndryshime dhe plotësime të inkorporohen në ligjin bazik dhe të ekzistojë si një ligj i vetëm. Një rregullim i tillë do ta bënte me lehtë të qasshëm dhe me të përdorshëm legjislacionin që pëson ndryshime dhe plotësime. Avokati i Popullit thekson se një veprim i tillë është i domosdoshëm me qëllim të lehtësimit të këtyre procedurave të zbatimit praktik të ligjeve.²¹

Procesi i miratimit të ligjeve dhe shpallja e tyre në Gazetën Zyrtare është proces, sipas të cilit mundësohet hyrja e ligjeve në fuqi. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit ka vërejtur se në disa raste kur ligji i cili është publikuar në Gazetën Zyrtare dhe hyn në fuqi në një periudhë të mëvonshme, i njëjti ligj e shfuqizon ligjin paraprak, mirëpo në Gazetën Zyrtare figuron që ligji paraprak shfuqizohet në momentin që ligji i ri publikohet e jo në momentin kur hyn në fuqi. Këto situata sjellin konfuzion tek zbatuesit e ligjeve, sepse, sipas Gazetës Zyrtare figuron ligj i shfuqizuar ligji i cili realisht shfuqizohet në momentin kur hyn në fuqi ligji i ri e jo në momentin kur i njëjti publikohet në Gazetën Zyrtare. Situatë e tillë është shfaqur me rastin e miratimit të Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, i cili është publikuar në Gazetën Zyrtare më 15 shkurt 2018 dhe ka hyrë në fuqi më 1 tetor 2018, ndërsa e ka shfuqizuar Ligjin nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Në këtë rast, Gazeta Zyrtare e ka vendosur mbishkrimin "I SHFUQIZUAR" për Ligjin nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme prej momentit kur ligji i ri është publikuar më 15 shkurt 2018, gjë që i bie se i ka vënë në lajthim praktikuesit e këtij ligji, sepse, në realitet Ligji 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme ka qenë në fuqi derisa ligji i ri ka hyrë në fuqi më 1 tetor 2018, që rezulton se mbishkrimi "I SHFUQIZUAR" është vendosur nga Gazeta Zyrtare shumë më herët sesa që është dashur.

Prandaj, me qëllim të shmangies së situatave të tilla, Avokati i Popullit rekomandon që përgjegjësit e Gazetës Zyrtare të jenë të kujdesshëm në këtë drejtim dhe ta identifikojnë saktë periudhën kur ligji i ri hyn në fuqi dhe vetëm atëherë të njoftojnë se ligji i vjetër është shfuqizuar.

²¹ Po aty, faqe 32.

Në kuadër të mandatit kushtetues (neni 113, paragrafi 2, i Kushtetutës) lidhur me mundësinë e ngritjes së çështjeve të përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të presidentit e të kryeministrit dhe të rregulloreve të qeverisë, me Kushtetutën, Avokati i Popullit, gjatë vitit raportues ka iniciuar në Gjykatën Kushtetuese 3 kërkesa për vlerësimin e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Përkitazi me këtë çështje, nga ankesat e pranuar nga Oda e Noterëve të Kosovës dhe nga analizat e bëra në Ligjin nr. 06/L-010 për Noterinë, me qëllim të vlerësimit të përputhshmërisë me Kushtetutën të dispozitave të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë (neni 32, 41 dhe 76), Avokati i Popullit, më 19 prill 2019, ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë dhe ka kërkuar vendosjen e masës së përkohshme deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata. Lidhur me këtë çështje, më 23 gusht 2019, Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë aktgjykim, sipas të cilit dispozitat e kontestuara nuk i cenojnë dispozitat kushtetuese.

Me qëllim të vlerësimit të përputhshmërisë me Kushtetutën të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Avokati i Popullit, më 8 nëntor 2019, ka dërguar kërkesë në Gjykatë Kushtetuese dhe ka kërkuar vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të ligjit në fjalë e po ashtu ka kërkuar vendosjen e masës së përkohshme nga gjykata deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar. Lidhur me këtë çështje, Gjykata Kushtetuese, më 26 nëntor 2019, ka publikuar vendimin me të cilin ka vendosur masë të përkohshme dhe ka pezulluar zbatimin e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë deri më 28 shkurt 2020.

Me qëllim të ushtrimit të mandatit kushtetutës dhe po ashtu me qëllim të ushtrimit të funksionit si institucion i barazisë në vend, Avokati i Popullit, nga ankesat e shumta që ka pranuar (më tepër se 40 ankesa deri në kohën e raportimit) lidhur me Ligjin nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, më 5 dhjetor 2019, ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, si dhe vendosjen e masës së përkohshme deri në vendosjen përfundimtare nga gjykata. Lidhur me këtë çështje, Gjykata Kushtetuese, më 19 dhjetor 2019, ka nxjerrë vendim për masë të përkohshme, me të cilin ka pezulluar zbatimin e ligjit në fjalë deri më 30 mars 2020.

Përkitazi me rastet e publikimit të aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese në Gazetën Zyrtare, Avokati i Popullit ka vërejtur se në ligjet e publikuara në Gazetën Zyrtare mungon njoftimi se dispozitat e ndonjë ligji janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese. Një rast konkret është identifikuar tek rasti i vlerësimit të përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese, me Aktgjykimin KO 157/18, më 28 mars 2018, ka vlerësuar se paragrafi 1.7 i nenit 14 të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës nuk është në pajtim me Kushtetutën dhe të njëjtin e ka shfuqizuar. Mirëpo, një njoftim të tillë nuk e hasim në Gazetën Zyrtare ku rezulton se Ligji për Kryqin e Kuq, përkatësisht neni 14, paragrafi 1.7, gjendet në zbatim pa marrë parasysh që kjo dispozitë është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese. Të njëjtën situatë e kemi edhe te Ligji nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dispozitat e të cilit janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese me Aktgjykimin KO171/18, i datës 20 maj 2019. Bëhet fjalë për nenin 4, paragrafi 1, në lidhje me nenin 3, paragrafi 1.1, nenin 6, paragrafi 1.3, dhe nenin 19, nënparagrafët 5, 6, 7 dhe 8, për të cilët Gjykata Kushtetuese ka vendosur se nuk janë në pajtim me Kushtetutën, e të cilët akoma figurojnë në Gazetën Zyrtare sikur të ishin në fuqi.

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit konsideron se duhet të merren veprime urgjente që në Gazetën Zyrtare të vendosen njoftimet për të gjitha ligjet, të cilat, pjesërisht apo në tërësi, janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, për shkak se nuk janë në pajtim me Kushtetutën dhe se çdo vazhdim i zbatimit të tyre përbën shkelje të Kushtetutës.

Sistemi gjyqësor

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton se çdokush ka të drejtë për mbrojtje gjyqësore në rast të shkeljes apo të mohimit të ndonjë të drejte, që është e garantuar me Kushtetutë dhe të drejtën për mjete efektive juridike, nëse konstatohet se e drejta i është shkelur. Secilit i është garantuar e drejta për gjykim të pavarur, të paanshëm dhe të bazuar në ligj.

Mbrojtjen e të drejtave të njeriut në gjykatë e plotëson edhe kontrolli gjyqësor i administratës apo kontrolli i ligjshmërisë së akteve të organeve të administratës, me të cilat vendoset për të drejtën, obligimin apo interesin e bazuar në ligj. Me vendosjen e kësaj mbrojtjeje, qytetarët në masë të caktuar janë të siguruar nga aktet e paligjshme të administratës.

Një sfidë e vazhdueshme e sistemit gjyqësor mbetet moszbatimi i standardeve për të drejtat dhe për liritë e njeriut, siç parashihet me nenin 53 të Kushtetutës, sipas të cilit interpretimi i të drejtave të njeriut dhe i lirive themelore duhet të bëhet në pajtim me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj). Referimet në praktikën e GjEDNj-së janë të pakta dhe, në rastet kur kjo ndodh, ato bëhen në mënyrë të përgjithësuar, por pa përcaktuar në mënyrë konkrete vlerësimet e GjEDNj-së dhe lidhshmërinë e rrethanave të rastit në praktikë.

Avokati i Popullit, sa i përket mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive të njeriut në fushën e gjyqësorit, ka mandat të kufizuar të përcaktuar me Ligjin për Avokatin e Popullit, sipas të cilit Avokati i Popullit mund të japë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor, duke mos ndërhyrë në raste dhe në procedura ligjore që janë duke u zhvilluar në gjykata, përveç çështjeve që kanë të bëjnë me pretendimet për administrimin e drejtësisë, përkatësisht me rastet e zvarritjeve të procedurave gjyqësore dhe me ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Në bazë të numrit të ankesave të paraqitura në IAP gjatë këtij viti raportues, qytetarët vazhdojnë të përballen me zvarritje të procedurave për vendosjen e rasteve të tyre me vite të tëra si dhe mosekzekutim të vendimeve gjyqësore të plotfuqishme, të cilat ndikojnë në pamundësinë e realizimit të të drejtave të tyre. Aq më tepër, Avokati i Popullit vëren se ekziston një perceptim i qytetarëve për mungesë të objektivitetit të gjyqtarëve gjatë vendosjes së rasteve të tyre, për këtë arsye Avokati i Popullit ka pranuar kërkesa për monitorim të seancave gjyqësore.

Bazuar në ligjin në fuqi, të gjitha vendimet përfundimtare duhet të publikohen, publikimi i aktgjykimeve ndihmon në sistemin gjyqësor që të jetë sa më transparent dhe llogaridhënës ndaj qytetarëve. Avokati i Popullit vëren se kemi një rritje të numrit të aktgjykimeve të publikuara.²²

²²<https://www.gjyqesori-rks.org/2019/12/16/rritet-numri-i-aktgjykimeve-te-publikuara/>

Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve dhe e prokurorëve

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve,²³ i cili Avokatit të Popullit i jep kompetenca shtesë. Ky ligj i jep Avokatit të Popullit, në raste specifike, dy lloj kompetencash: 1) kompetencën për t'i kërkuar Këshillit Prokurorial dhe Këshillit Gjyqësor fillimin e procedurës disiplinore, dhe 2) kompetencën për të ushtruar ankesë te Gjykata Supreme, në raste individuale.

Avokati i Popullit konsideron se të dyja kompetencat e përcaktuara nga ligji tejkalojnë kompetencat e zakonshme të Avokatit të Popullit, duke marrë parasysh Ligjin për Avokatin e Popullit, ligje të tjera në fuqi dhe opinionet e Komisionit të Venecias.

Për sa i përket kompetencës për të kërkuar fillimin e procedurës disiplinore, Ligji për Avokatin e Popullit e njeh këtë kompetencë vetëm në një situatë specifike: në rastet e dështimit për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”* (po aty, neni 25, par. 2; theks i shtuar). Ndërsa, siç u pa më sipër, ligji në diskutim e tejkalon këtë dispozitë, duke i dhënë Avokatit të Popullit kompetencën për të kërkuar fillimin e procedurës disiplinore edhe në raste të mosrespektimit të afatit për marrjen e vendimeve, si dhe në raste të hedhjes poshtë të ankesave pa plotësuar kushtet ligjore.

Për sa i përket kompetencës për të ushtruar ankesë tek Gjykata Supreme, situata qëndron edhe më e dallueshme. Sipas Komisionit të Venecias: *“Në përgjithësi, duket e parapëlqyeshme që t'i jepet Avokatit të Popullit kompetencën për të dhënë rekomandime të përgjithshme lidhur me funksionimin e sistemit gjyqësor dhe të mënjanohet kompetenca për të ndërhyrë në raste individuale...”*²⁴

Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës gëzon kompetenca më të gjera për të ndërhyrë në rastet gjyqësore sesa që rekomandohet nga Komisioni i Venecias për institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut, në përgjithësi; mirëpo, edhe në ligjet e Kosovës, Avokatit të Popullit nuk i jepet kompetenca për të iniciuar ankesa gjyqësore në rastet individuale. Në vend të kësaj, Avokati i Popullit, sipas ligjeve të tjera në fuqi, ka të drejtë vetëm: 1) të iniciojë rastet gjyqësore në raste të përgjithshme, por jo në raste të individëve, ose 2) të ndërhyjë në raste të individëve, por jo të iniciojë ankesa në raste të tilla. Për shembull, Avokati i Popullit:

- mund të paraqesë argumente në mbështetje të ndonjë pale në procedurë gjyqësore, në cilësinë e *amicus curiae*,²⁵ por jo edhe të iniciojë ankesa në emër të asaj pale;
- mund të iniciojë konflikt administrativ atëherë kur është në interes të publikut të përgjithshëm, apo për të mbrojtur të drejtat e veta,²⁶ por jo edhe në rastet e individëve; dhe

²³ Publikuar në Gazetën Zyrtare 23/2018, më 26.12.2018.

²⁴ CDL-AD(2007) 024, *Opinion on the draft law on the People's Advocate of Kosovo adopted by the Venice Commission at its 71st Plenary Meeting* (Venecia, 1-2 qershor 2007), §19)

²⁵ *Shih* Ligjin për Avokatin e Popullit, neni 16, par. 9; dhe Ligjin nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 9, par. 2, nënpar. 13.

²⁶ *Shih* Ligjin për Konfliktet Administrative, neni 10, par. 2, dhe neni 18.

- mund të kërkojë prej Gjykatës Kushtetuese kontrollin abstrakt të kushtetutëshmërisë së ligjeve, dekretëve të presidentit dhe të kryeministrit, rregulloreve të qeverisë dhe statuteve të komunës,²⁷ por nuk mund të paraqesë ankesë për të mbrojtur të drejtat e individëve.

Duke i dhënë Avokatit të Popullit kompetencën për të iniciuar ankesa drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme në raste të individëve, ligji në diskutim tejkalon dukshëm jo vetëm standardet ndërkombëtare të Komisionit të Venecias, por edhe kompetencat e deritanishme të Avokatit të Popullit, sipas ligjeve të mëparshme të Republikës së Kosovës.

Duke u bazuar në ligjin e cekur më lart, Avokati i Popullit ka pranuar një numër të ankesave kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilat i ka proceduar brenda afateve, ashtu siç e përcakton Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.²⁸ Vlen të theksohet se Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje në të gjitha këto raste dhe ka pasur bashkëpunim të mirë.

Zvarritja e procedurave gjyqësore

Sikur edhe viteve paraprake, Avokati i Popullit vazhdon të pranojë ankesa kundër gjykatave, që kryesisht kanë të bëjnë me zvarritje në vendosjen e rasteve të tyre.

Ankesat kryesisht kanë të bëjnë me zvarritje të procedurave lidhur me kontestet e natyrës civile, konteste pronësore, konteste nga marrëdhënia e punës. Kjo vjen si pasojë e numrit të madh të rasteve të vjetra të pazgjidhura dhe paraqitja e rasteve të reja.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK), në raportin statistikor të gjykatave për nëntëmujorin 2019, ka raportuar se numri i lëndëve të ngelura si të pazgjidhura është 219,922. Sipas këtij raporti, gjykatat kanë pasur në punë gjithsej 328,080 lëndë gjyqësore, ndërsa kanë zgjidhur 108,004. Në këtë periudhë raportuese qytetarët kanë parashtruar 82,521 lëndë të reja gjyqësore.²⁹

Nga kjo mund të konstatohet se para gjyqësorit në pritje për shqyrtim dhe vendosje gjendet një numër i madh i lëndëve, të cilat do të duhej të vendoseshin në pajtim me legjislacionin, gjë që kërkon që KGjK-ja, por edhe institucionet e tjera përgjegjëse, të angazhohen për gjetjen e një zgjidhjeje ligjore.

Avokati i Popullit vëren se kur bëhet fjalë për zvarritje procedurale, sidomos në lëndët që kalojnë nga një instancë në instancën tjetër përgjatë procesit të shqyrtimit apo në situatë kur rastet kthehen në rigjykim, gjykatat kanë tendencë që periudhën e vendosjes së rastit ta llogarisin prej ditës kur rasti i është kaluar asaj gjykate, ndërsa sipas praktikës së GjEDNj-së, periudha e llogaritjes për zgjidhjen e një rasti gjyqësor fillon prej ditës kur qytetarët kanë paraqitur padinë në gjykatën kompetente,³⁰ po ashtu kur paraqitja para një autoriteti administrativ përbën një kusht paraprak për paraqitjen në gjykatë, afati mund të përfshijë edhe kohëzgjatjen e procedurës administrative paraprake të detyrueshme.³¹

²⁷ *Shih* Kushtetutën, neni 113, par. 2.

²⁸ A.nr. 749/2019, A.nr. 682/2019, A.nr. 672/2019, A.nr. 652/2019, A.nr. 627/2019, A.nr. 591/2019.

²⁹ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/25932_Raporti_Statistikor_Gjykatave_Nentemujor_2019.pdf, faqe 3.

³⁰ Poiss kundër Austrisë, § 58 dhe Bock kundër Gjermanisë § 35.

³¹ Konig kundër Gjermanisë § 98 ; X kundër Francës § 31 ; Kress kundër Francës (GC) § 90.

Procedurave të stërzgjatura nëpër gjykata i kontribuon edhe regjistrimi me numër të ri rendor të rasteve të kthyera në rigjykim, veprim ky i cili nuk paraqet afatin real kur është inicuar padia në gjykatë dhe shkakton vonesa të reja, duke bërë që rasti të mos trajtohet brenda një afati të arsyeshëm. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit, në vitin 2018, i kishte rekomanduar Këshillit Gjyqësor të Kosovës që me një akt të brendshëm të përcaktohet se rastet që kthehen në rigjykim duhet të trajtohen me prioritet në krahasim me paditë e reja.³² Ky rekomandim ka hasur në reagime pozitive nga ana e KGJK-së dhe që sipas këtij organi, ky rekomandim pritet të zbatohet nëpërmes Sistemit të Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL).

Megjithatë, Avokati i Popullit vlerëson se zvarritjet në procedimin e rasteve gjyqësore shkelin të drejtën për gjykim të drejtë, proces të rregullt, brenda afatit të arsyeshëm kohor, të drejtën për mjete efektive juridike dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të përcaktuara me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.³³

Po ashtu edhe mosemërimi nga Kuvendi i Republikës së Kosovës i anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i kontribuon shtimit të numrit të lëndëve në gjykatë. Këshilli është jofunksional që nga data 21 janar 2019, për shkak të mungesës së kuorumit dhe për pasojë qindra ankesa lidhur me kontestet e punës së nëpunësve civilë dhe të kandidatëve për praninë në shërbimin civil kanë mbetur pa u shqyrtuar.

Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore

Avokati i Popullit, gjatë këtij viti, ka pranuar një numër të konsiderueshëm të ankesave³⁴ lidhur me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Numri i lëndëve të ekzekutimeve civile në nivel të vendit mbetet ende i ulët, gjë që për Avokatin e Popullit mbetet shqetësues. Raporti nëntëmujor i vitit 2019 i KGJK-së, sa i përket lëndëve të ekzekutimeve civile, tregon se gjykatat kanë pasur në punë 10.516 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 5.073 lëndë, ndërsa 5.443 lëndë kanë mbetur të pazgjidhura.³⁵

Me këtë rast, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen e autoriteteve përkatëse se, sipas KEDNj-së dhe praktikës së GjEDNj-së, ekzekutimi i vendimeve të plotfuqishme është pjesë e së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e që obligon ato për ndërmarrjen e masave të domosdoshme për realizimin e kësaj të drejte.

Numri i ankesave të paraqitura në IAP tregon se qytetarët kanë vështirësi të mëdha edhe gjatë realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave në procedurën e shkallës së parë, në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative. Ato kanë të bëjë me mosefikasitetin e kësaj gjykate lidhur me kontestet administrative. Nga hetimet e zhvilluara rezulton se kjo gjykatë, me rastin e shqyrtimit të kontesteve administrative, përveç zvarritjeve, nuk vendos mbi substancën e çështjes,

³² Ex officio Raport me rekomandime A.nr. 445/2018

³³ A.nr. 558/2019, A.nr. 925/2017. Në të dy rastet paditë janë parashtruar në vitin 2012 në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

³⁴ A.nr.189/2019, A.nr.270/2017, A.nr.418/2019, A.nr.628/2019, A.nr.801/2019; A.nr.461/2018 A.nr.850/2018.

³⁵ [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/25932_Raporti_Statistikor_Gjykatave_Nentemujor_2019 .pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/25932_Raporti_Statistikor_Gjykatave_Nentemujor_2019.pdf), faqe 38.

por vetëm për shkeljet procedurale, duke e kthyer çështjen për vendosje te organi administrativ,³⁶ ndërsa organet administrative, gjatë rishqyrtimit, kryesisht marrim vendime refuzuese dhe çështja përsëri përfundon në gjykatë.³⁷

Një situatë e tillë është shqetësuese për Avokatin e Popullit, ngase qytetarët privohen nga e drejta për mjete efektive juridike. Në veçanti, kjo situatë i afekton personat me aftësi të kufizuara që aplikojnë për pensionet e personave me aftësi të kufizuara në Departamentin e Administratës Pensionale të Kosovës (DAPK) të MPMS-së, të cilët me këtë rast janë të detyruar të ndjekin procedura që ripërsëriten.

Përmbauesit privatë

Të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e që në vete ngërthen edhe çështjen e vendimeve të formës së prerë në procedurën administrative dhe gjyqësore, përmbauesit privatë e kanë fuqizuar duke e përmirësuar nivelin e ekzekutimit të vendimeve administrative dhe gjyqësore³⁸ dhe qytetarëve u është ofruar mundësi më efikase dhe efektive në realizimin e të drejtave të tyre. Por në disa raste përmbauesit privatë i kanë tejkaluar normat ligjore, të cilat i përcaktojnë kufizimet dhe përjashtimet lidhur me ekzekutimin e vendimeve,³⁹ duke lëshuar urdhra përmbauesit për ekzekutimin e vendimeve në bankat komerciale, me ç’ rast kanë bllokuar llogaritë bankare të ankuesve.

Avokati i Popullit gjatë hetimit ka vërejtur se palëve u janë bllokuar llogaritë bankare nga përmbauesi privat, për shkak të mosshlyerjes së borxheve, ndërsa kanë qenë shfrytëzues të pensioneve dhe këto të hyra janë bllokuar në procesin e ekzekutimit në kundërshtim me ligjin, ku përcaktohen kufizimet ligjore për shumat të cilat nuk mund të jenë objekt i ekzekutimit. Pas ndërmjetësimit të Avokatit të Popullit me përmbauesin, për riprogramimin e borxhit, është arritur zgjidhja e çështjeve të ankuesve që llogaritë bankare të tyre të zhblokohen dhe ndalesat të bëhen në pajtim me ligjin.

Pushteti ekzekutiv

Qeverisja e mirë, miradministrimi dhe të drejtat e njeriut ndërlidhen në atë mënyrë që fuqizojnë njëra tjetrën. Puna e organeve shtetërore lidhet ngushtë me të drejtat dhe me liritë e njeriut.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si mekanizëm i kontrollit të administratës shtetërore, ka rol të rëndësishëm në forcimin e përgjegjshmërisë së administratës shtetërore, gjithashtu mund të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së administrimit nga zbulimi i rasteve të “keqadministrimit” dhe ngritjen e vetëdijes së nëpunësve civilë në pritjet e publikut në lidhje me qeverisjen e mirë dhe miradministrimin, duke ndikuar që sistemi administrativ të jetë më transparent dhe më i qashtë për të gjithë qytetarët.

Vlen të përmendet këtu se një numër i konsiderueshëm i ankesave ndaj pushtetit ekzekutiv kanë të bëjë me kufizimin e qasjes në dokumentet publike.

³⁶ A.nr. 543/2016

³⁷ A.nr. 329/2018, A.nr. 92/2018, rastet ende nuk janë vendosur nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

³⁸ Ligji nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbauesit, Ligji nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbauesit neni 22, dokumenti përmbaues.

³⁹ Po aty, neni 111 - Përjashtimi nga përmbauesi; dhe neni 112 - Kufizimi i përmbauesit.

Avokati i Populli ka hapur për hetim 29 raste *ex officio*, prej të cilave një numër i konsiderueshëm i çështjeve kanë të bëjë me punën e ekzekutivit në të dyja nivelet qeverisëse, lidhur me të cilat Avokati i Popullit ka nxjerrë rekomandime apo ka shprehur qëndrimet e tij, me ç' rast vlen të përmenden rastet në vijim:

- detyrimet pozitive të shtetit përkitazi me mbrojtjen nga dhuna në familje për të drejtën në jetë, që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe nga neni 2 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;
- detyrimet pozitive të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 3 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;
- çështja e fëmijëve në situatë rruge;
- vlerësimi i sistemit të ofrimit të shërbimeve sociale në Kosovë;
- situata e personave me aftësi të kufizuara në komunën e Gjilanit;
- rritja e numrit të zyrtarëve policorë në Janjevë;
- mungesa e mjeteve juridike efektive për zgjidhjen e kontesteve të punës nga nëpunësit civilë dhe nga kandidatët për pranim në shërbimin civil;
- trajtimi i personave me HIV dhe AIDS në Kosovë etj.

Përveç çështjeve të sipërpërmendura, Avokati i Popullit ka nxjerrë rekomandime apo ka shprehur opinionet e tij lidhur me ankesat e paraqitura nga personat fizikë a juridikë, e që kanë të bëjnë me:

- harmonizimin e Ligjit nr.06/L-012 për Kryeqytetin e Republikë së Kosovës, Prishtinën me Ligjin nr.04/L-076 për Policinë;
- ndryshimin e Udhëzimit Administrativ MAPL nr.2014/01 për Procedurën e Emërimit të Nënkyretarëve në Komuna;
- çështjen e mosvazhdimin të licencave të punës së gjeodetëve të kategorisë së dytë dhe për mosharmonizim të dispozitave ligjore të legjislacionit sekondar;
- taksën administrative në shumën prej 30 eurosh për të iniciuar procedurë disiplinore ndaj mjekëve, e përcaktuar nga Oda e Mjekëve;
- ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2014 për Regjistrimin dhe Funkionimin e Organizatave Joqeveritare;
- kushtëzimin me anëtarësim në Shoqatën e të Verbërve të Kosovës për t'u pajisur me librezë të verbërisë, me qëllim të përfitimit të të drejtave dhe të beneficioneve të garantuara sipas Ligjit nr. 04/L-092 për Personat e Verbër;
- ruajtjen dhe fshirjen e të dhënave personale për personat e përfshirë në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK);
- mosndërmarrjen e veprimeve adekuate në drejtim të lirimit të hapësirave publike në Fushë Kosovë;

- mohimin e së drejtës për shkollim të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim “Xheladin Deda” në Pejë;
- vlerësimin profesional të fëmijëve me aftësi të kufizuara në ambiente të përshtatshëm për fëmijët, në mënyrë që t’u mundësohet arsimimi adekuat, në pajtim me nevojat individuale;
- menaxhimin e papërshtatshëm të deponisë sanitare të mbeturinave në Velekincë të komunës së Gjilanit.

Janë 41 rekomandime që Avokati i Popullit ia ka drejtuar qeverisë dhe resorëve të saj, prej të cilave deri më tani janë zbatuar vetëm 9, ndërsa të tjerat nuk janë zbatuar ose janë në pritje për zbatim. Duhet sqaruar këtu se Avokati i Popullit e ndan çështjen e zbatimit të rekomandimeve dhe përgjigjet në kërkesat e Avokatit të Popullit gjatë hetimit të rasteve. Me përgjigjen në kërkesat e Avokatit të Popullit gjatë fazës së hetimit situata është relativisht e kënaqshme. Megjithatë, disa nga resorët qeveritar janë krejtësisht të papërgjegjshëm ndaj kërkesave të Avokatit të Popullit, me ç’ rast duhet të veçohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.

Sa i përket qeverisjes lokale, Avokati i Popullit ka adresuar 18 rekomandime, prej të cilave janë zbatuar vetëm 3, ndërsa përgjegjshmëria e komunave ndaj kërkesave të Avokatit të Popullit gjatë fazave të hetimit është mjaft e kënaqshme.

Avokati i Popullit thekson se shumë nga çështjet e paraqitura në Raportin Vjetor të vitit 2018, sa i përket pushtetit ekzekutiv, kanë mbetur të pa trajtuara nga autoritetet përkatëse, por edhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh se Raporti Vjetor i vitit 2018 nuk është shqyrtuar nga Kuvendi, megjithëse është paraqitur brenda afatit.

Reforma në administratën publike

Avokati i Popullit përshëndet iniciativën për rregullimin e sektorit publik për nga aspekti organizativ ashtu edhe për nga aspekti i rregullimit së çështjes së pagave, duke çmuar këtu edhe ndihmën e Bashkimit Evropian në reformën e administratës. Një administratë publike e reformuar në pajtim me Kushtetutën, parimin e ndarjes së pushteteve dhe sundimit të ligjit përbën bazamentin e funksionimit të shtetit. Sidoqoftë, sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit, pakoja e ligjeve për reformën e administratës, në veçanti Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligji nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, duket se nuk janë në pajtim me Kushtetutën dhe as me sundimin e ligjit në përgjithësi.

Ligji për Zyrtarët Publikë i jep qeverisë së Republikës së Kosovës kompetenca për krijimin e bazës ligjore për punësim të zyrtarëve publikë në institucionet e Republikës së Kosovës, duke përfshirë këtu edhe zyrtarët publikë në institucionet e pavarura, si dhe në subjektet e tjera në sektorin publik, pa marrë parasysh specifikat e statusit kushtetues të këtyre subjekteve. Avokati i Popullit vlerëson se Ligji për Zyrtarët Publikë nuk e ka marrë parasysh faktin se subjekte të ndryshme në sektorin publik, çështjet organizative, funksionale dhe të veprimtarisë së tyre i kanë të rregulluara në mënyrë të veçantë, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet e tyre organike.

Ligji për Pagat në Sektorin Publik, mes tjerash, e përcakton sistemin e pagave dhe të shpërblimeve për zyrtarët publikë, të cilët paguhen nga buxheti i shtetit dhe rregullat për përcaktimin e pagave të

punonjësve të ndërmarrjeve publike në Kosovë. Ligji për Pagat në Sektorin Publik e autorizon qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës për nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji. Avokati i Popullit vlerëson se ky ligj dhe Shtojca një (1) e këtij ligji nuk kanë arritur ta bartnin frymën kushtetuese në kuptimin e ndarjes së pushteteve, të barazisë para ligjit dhe as garantimin e së drejtës pronësore. Për më shumë, Avokati i Popullit konsideron se ky ligj nuk është në pajtim me parimet e sundimit të ligjit, për shkak të mangësive në kuptimin e qartësisë, saktësisë dhe parashikueshmërisë së tij. Avokati i Popullit i ka pranuar më shumë se 40 ankesa nga subjekte të ndryshme të sektorit publik, të parashtruara kundër Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, duke përfshirë këtu ankesat nga të punësuarit në shëndetësi, në arsim, në polici dhe në shërbimin civil.

Avokati i Popullit ka ngritur në Gjykatën Kushtetuese çështjen e përputhshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe të Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik dhe po ashtu ka kërkuar vendosjen e masës së përkohshme në të dyja ligjet, për të evituar kështu dëmet e pariparueshme që do të mund të shkaktoheshin me zbatimin e këtyre ligjeve, në veçanti nga Ligji për Pagat.

Duhet të përmendet fakti se Avokati i Popullit, në raportin e vitit 2017, e kishte njoftuar Kuvendin për qëndrimet e tij rreth rritjes së pagave të kabinetit qeveritar, për të cilat akoma konsideron se ka qenë e pabazuar në ligj dhe në kundërshtim me Kushtetutën. Një rritje e tillë e pagave ka shkaktuar efekt negativ në sektorin publik, me ç' rast është rritur presioni mbi qeverinë, por edhe mbi Kuvendin, me rastin e hartimit të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik dhe se ky ligj ka pësuar ndryshime të atypëratyshme duke degraduar kështu vetë qëllimin e ligjit dhe duke e vënë në rrezik qëndrueshmërinë buxhetore dhe vetë zbatimin e tij.

Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme

Me gjithë faktin se Avokati i Popullit ka pranuar diku rreth 20 ankesa kundër AKP-së dhe kundër Dhomës së Posaçme, situata sa i përket çështjeve që ndërlidhen me AKP-në dhe me Dhomën e Posaçme ka mbetur pothuajse e pandryshuar.

Ankesat kanë të bëjnë kryesisht me zvarritje të vendosjes së rasteve nga Dhoma e Posaçme, qoftë për kompensimin e pagave të papaguara të punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara, qoftë lidhur me kontestet pronësore të pronave të paluajtshme të privatizuara nga AKP-ja.

Avokati i Popullit vlerëson se ka një lëvizje pozitive për faktin se Ligji nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ka hyrë në fuqi në fillim të korrikut të vitit 2019. Ky ligj ka shmangur pengesat në rritjen e numrit të gjyqtarëve në Dhomën e Posaçme, çështje kjo për të cilën Avokati i Popullit i ka raportuar disa herë Kuvendit. Sa i përket zbatimit të ligjit, ka zhvillime pozitive, sepse, më 24 dhjetor 2019, presidenti i Republikës së Kosovës ka dekretuar 4 gjyqtarë dhe Këshilli Gjyqësor e ka shtuar numrin e bashkëpunëtorëve profesionalë, të përkthyesve dhe një të zytari ligjor, menjëherë pas hyrjes së ligjit në fuqi. Me këtë priten përmirësime pozitive sa i përket së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm në vendosjen e lëndëve.

Ndërmarrjet publike

Gjatë vitit raportues janë paraqitur 58 ankesa kundër ndërmarrjeve publike, prej të cilave 21 janë hapur për hetim, ndërsa një rast është hapur për hetim sipas detyrës zyrtare.⁴⁰ Ankesat e paraqitura kanë të bëjnë kryesisht me mospërgjigje në kërkesat e drejtuara ndërmarrjeve publike, kufizimi i qasjes në dokumente publike, mosekzekutimi i vendimeve të plotfuqishme gjyqësore etj. Gjatë hetimit te ankesave dhe veprimeve të Avokatit të Popullit, 7 ankesa janë zgjidhur sipas kërkesës së ankuesve.

Avokati i Popullit ka dalë me Raport me rekomandime⁴¹ në lidhje me kushtëzimin e shkyçjes nga rrjeti i ngrohjes me pagesën e tërësishme të borxhit, sipas një rregulloreje të brendshme të TERMOKOS-it. Gjatë trajtimit të rastit, Avokati i Popullit ka gjetur se një rregullore e brendshme e TERMOKOS-it është në kundërshtim me Rregulloren e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë dhe ka adresuar rekomandime për TERMOKOS-in dhe për ZRrE-në përkitazi me harmonizimin e rregullores se brendshme të TERMOKOS-it me Rregulloren e ZRrE-së. Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga ZRrE-ja me zotimin se këto rregullore do të harmonizohen.

Avokati i Popullit vëren që kushtëzimet si formë e shpejtë e inkasimit të borxheve janë një metodë që haset shpesh jo vetëm të ndërmarrjet publike, por edhe nga resorët e ndryshëm të pushtetit ekzekutiv dhe se për raste të tilla është raportuar nëpërmes raporteve individuale ashtu edhe në raportet vjetore të Avokatit të Popullit.

Përgjegjësia për mjedisin jetësor

Kushtetuta e vendit përgjegjësinë për mbrojtje të mjedisit e ka renditur në Kapitullin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore,⁴² dhe po ashtu mbrojtja e mjedisit është përcaktuar në vlerat themelore ndër parimet në të cilat bazohet rendi kushtetues i vendit.⁴³

Institucioni i Avokatit të Popullit, edhe gjatë vitit raportues, ka vazhduar me hetimin, mbikëqyrjen e rasteve lidhur me të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, dhe promovimin e së drejtës. Nga këto hetime ka rezultuar se veprimet për fuqizimin e zbatimit të ligjit duhet të kenë prioritet për t'i dhënë drejtimin e duhur politikave për mbrojtjen e mjedisit dhe shmangien e problemeve mjedisore, si dhe përmirësimit të gjendjes së mjedisit.

Gjendja e ajrit, e ujit dhe e tokës, edhe përgjatë vitit për të cilin po raportojmë, nuk ka shënuar përmirësime. Gjendja e tillë e mjedisit rrezikon shëndetin e qytetarëve. Nuk është vërejtur ndonjë

⁴⁰ 595/2019 - OIK /. N.P kundër Ndërmarrjes Publike (NP) "Ambienti" në Ferizaj, për shkak të mohimit të së drejtës së punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje në pushim gjatë orarit të punës.

⁴¹Rasti A.nr. 131/2018

⁴²Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 52, par. 2, Përgjegjësia për Mjedisin jetësor, "Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton."

⁴³Po aty, neni 7 [Vlerat]

1. Po aty, Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, së drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

aktivitet i rëndësishëm, cili do të ndikonte drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Ndërtimi i hidrocentraleve ka ngjallur pakënaqësi dhe reagim të publikut.

Përmirësim nuk është shënuar as në drejtim të së drejtës së privatësisë, të gëzimit të shtëpisë dhe mbrojtja nga ndikimi i zhurmës. Organet kompetente nuk kanë arritur ende ta miratojnë ligjin e ri. Taksa ekologjike, e paraparë me Ligjin për Taksën Rrugore dhe Ekologjike të Automjeteve,⁴⁴ vazhdon të mos shfrytëzohet sipas dedikimit të mbledhur. Koordinimi dhe bashkëpunimi i aktiviteteve të institucioneve kompetente për zgjidhjen efektive të problemeve mjedisore ende mbetet sfidë. Nuk është vërejtur ndonjë plan afatgjatë në drejtim të përmirësimit të planifikimit hapësinor, e as të menaxhimit të mbeturinave dhe deponive.

Përgjithësisht ka pak progres sa i përket fushës së mjedisit, i cili kryesisht shënohet në miratimin e strategjive përkatëse në çështjet e mjedisit.⁴⁵

Promovimi dhe edukimi për të drejtën e qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm mbetet në fazë të hershme. Institucionet kompetente shëndetësore kanë shënuar përmirësim në informim dhe në edukim të publikut përkitazi me ndikimin e mjedisit në shëndetin publik. Për dallim nga vitet paraprake, është vënë re një angazhim i shtuar i shoqërisë civile në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Mbetet të fuqizohet roli i mediave në drejtim të vetëdijesimit dhe të edukimit të publikut për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe të informimit me praktikata e mira dhe ndikimin në të drejtat e njeriut.

Nuk janë vërejtur përpjekje serioze për të ndërmarrë veprime në drejtim të bashkimit me iniciativën globale lidhur me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.⁴⁶

Avokati i Popullit ka shpërndarë fletëpalosjen *“Përgjegjësia për mjedisin jetësor”*⁴⁷, me qëllim të informimit të qytetarëve me të drejtën e tyre për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, si dhe informimin për institucionet përgjegjëse, të cilat sigurojnë respektimin e kësaj të drejte.

Më 25 shkurt 2019, Avokati i Popullit, përkitazi me pakënaqësinë e shprehur nëpërmjet protestës qytetarëve dhe të shoqërisë civile për ndërtimin e hidrocentraleve në lumin Lumbardhë, nëpërmjet komunikatës për media kërkoi nga autoritetet që të respektojnë të drejtën e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe të drejtën për informim për çështjet mjedisore, si procese të cilat duhet t’i paraprijnë çdo projekti me ndikim në mjedis. Po ashtu kërkoi që shteti të bëjë balancim të drejtë në mes të interesave të qytetarëve për mbrojtje të mjedisit, të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të zhvillimit të hidro-energjisë.

⁴⁴Ligji nr. 04/L-117 për Taksën Rrugore dhe Ekologjike të Automjeteve, neni 1, par 2. Me këtë ligj gjithashtu rregullohet edhe vendosja e taksës ekologjike për automjetet e regjistruara në Kosovë dhe për automjetet e huaja. Taksa ekologjike ka për qëllim ngritjen e cilësisë së mbrojtjes së ambientit.

⁴⁵Raporti për Kosovën* 2019, *“Kosova është në një fazë të hershme të përgatitjes në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Është arritur pak progres, kryesisht përmes miratimit të strategjive përkatëse, por problemet serioze mjedisore vazhdojnë të ndikojnë në jetesën dhe shëndetin e popullsisë.”*

⁴⁶Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm: qasja në ujë të pastër dhe në kanalizim; sigurimi i qasjes në energji të përbalueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë; të bërit e qyteteve dhe vendbanimeve të jetuara nga njerëzit, gjithëpërfshirëse, të përshtatshme dhe të qëndrueshme; marrjen e veprimeve urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe ndikimet e saj; mbrojtjen e ujërave; mbrojtjen, rivendosjen dhe promovimin e qëndrueshëm të ekosistemit tokësor, menaxhimin në mënyrë të qëndrueshme të pyjeve, luftimin e shkretëtirëzimit, ndalimin e degradimit të tokës dhe ndalimin e humbjes së biodiversitetit.

⁴⁷<https://www.oik-rks.org/2018/11/01/e-drejta-per-mjedis-te-sigurt-dhe-te-shendetshem/>

Më 22 mars 2019, Avokati i Popullit, me rastin e shënimit të ditës botërore të ujërave, nëpërmjet komunikatës për media ftoi qytetarët dhe institucionet që, përveç obligimit kushtetues për mbrojtje të mjedisit, duhet ta respektojnë të drejtën e të gjithëve për qasje në informata, për pjesëmarrje në vendimet që lidhen me ujërat, dhe realizimin e së drejtës në drejtësi. Po ashtu u lansua video spoti “*E drejta për mjedis të sigurtë dhe të shëndetshëm*”, synim i të cilit ishte përcjellja e mesazhit: “duke mbrojt ambientin, mbrojmë Kushtetutën, jetën dhe vendin”. Video spoti vuri në pah ndikimin e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës në shëndetin e njeriut, si dhe rolin vital të tyre në mirëqenien e njeriut.

Më 22 mars 2019, u lansua video spoti “Stop Diskriminimit”, me qëllimi të promovimit të një mjedisi me mundësi për qasje të barabartë dhe pa diskriminim i të gjithëve pa dallim, në rrugë dhe objekte.

Më 5 qershor 2019, Avokati i Popullit, në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit në Kosovë, me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Mjedisit, organizuan tryezën me temën: “*Mjedisi i sigurt dhe i shëndetshëm – e drejtë e njeriut dhe përgjegjësi kushtetuese*”. Ttryeza u organizua me qëllim të diskutimit të gjendjes së mjedisit në Kosovë dhe gjetjes së modaliteteve për adresim adekuat të problemeve mjedisore nga ana e institucioneve kompetente. Po ashtu u theksua rëndësia e bashkëpunimit të institucioneve publike me Avokatin e Popullit dhe me Auditorin e Përgjithshëm, në drejtim të ndërmarrjes së veprimeve për përmirësimin e gjendjes së mjedisit në vend.

Avokati i Popullit ka qenë pjesë e aktiviteteve të organizuara në muajin qershor 2019, në kuadër të projektit “*Avokimi për mbrojtjen e mjedisit dhe eficientë e energjisë në Kosovë*”, i implementuar nga Environmentally Responsible Action (ERA) group, në partneritet me BIRN Kosovë, TV Mreža dhe Bankwatch. Janë organizuar takime me qytetarë, me gazetarë, me aktivistë të të drejtave të njeriut dhe me përfaqësues të shoqërisë civile, në Prishtinë, në Ferizaj, në Gjilan e Gjakovë dhe u prezantuan çështjet mjedisore të trajtuara nga perspektiva e Avokatit të Popullit.

Më 16 shtator 2019, Avokati i Popullit mori pjesë në Javën e Kosovës për Zhvillim të Qëndrueshëm (KSDW), me temë: “*Mbrojtja e Mjedisit: Kërkesa për bashkëpunim rajonal dhe qeverisje të mirë*”. Në këtë ngjarje u diskutuan çështjet e së drejtës mjedisore nga këndvështrimi i Avokatit të popullit.

Më 10 dhjetor 2019, Avokati i Popullit, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, në bashkëpunim me shoqërinë civile, organizoi për të tretin vit me radhë marshin “*Çohu për të Drejtat e Njeriut*”. Synimi i këtij marshi ishte dërgimi i mesazhit për angazhim më të shtuar, gjithëpërfshirës dhe ndërinstitutional për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me theks të veçantë për mbrojtjen e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. Avokati i Popullit, në fjalimin përmbyllës të kësaj ngjarjeje, ka shprehur shqetësimet për problemet mjedisore me të cilët ballafaqohet vendi, si: ndotja e ajrit, e ujit dhe e tokës, mungesa e hapësirave të gjelbëruara, degradimi i tokës dhe i lumenjve, ndërtimi i hidrocentraleve, problemet me zhurmën, keqmenaxhimi i mbeturinave.

Ajri

Problem i vazhdueshëm me ndikim serioz në të drejtën e qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm dhe kërcënim serioz për shëndetin e qytetarëve⁴⁸ ka vazhduar të jetë cilësia e ajrit. Edhe

⁴⁸Raporti për Kosovën 2019, “*Cilësia e ajrit vazhdon të paraqesë kërcënim madhor për shëndetin e njerëzve*”, fq. 84.

pse nuk ka ndonjë studim të detajuar për shpërndarjen dhe koncentrimin e ndotësve, sektori i energjisë⁴⁹, transporti dhe industria (cilësia e derivateve të naftës⁵⁰), bujqësia, mbeturinat⁵¹ si dhe sistemi i ngrohjes me lëndë joekologjike (dru dhe thëngjill⁵²), vazhdojnë të mbeten ndotësit më të mëdhenj në vend.

Edhe gjatë vitit 2019 u shënuan tejkalime të pluhurit në formë PM 10 dhe PM2.5⁵³, në disa lokalitete të vendit. Tejkalime të theksuara të Vlerave Maksimale të Lejuara (VML)⁵⁴ janë regjistruar në shumicën e stacioneve monitoruese gjatë muajit janar, shkurt, tetor, nëntor dhe dhjetor.⁵⁵

Përkundër problemeve serioze me cilësinë e ajrit, gjetja e vendit pa plan veprimi dhe pa masa shtesë mbrojtëse, edhe këtë vit, në periudhat e krizave me tejkalime janar-shkurt dhe tetor, nëntor dhe dhjetor, është tregues i dështimit të organeve kompetente për ta respektuar përgjegjësinë kushtetuese për mbrojtjen e mjedisit dhe për t'i përmbushur obligimet e përcaktuara në Ligjin nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja dhe me Ligjin nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit. Ende nuk është krijuar Task-forca ndërministrorë për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Nuk u ndërморën veprime sipas obligimeve të dala nga rezoluta e Kuvendit të Kosovës për ndotjen e ajrit,⁵⁶ e 2 shkurtit 2019. Obligimi i shtetit për aplikimin e masave të efijencës së energjisë vazhdon të mbetet në vullnet të individit, pa mbështetje institucionale dhe pa ndonjë formë subvencionimi nga shteti. Nuk është vërejtur ndonjë ndryshim i dukshëm në zgjerimin e rrjetit të ko-gjenerimit⁵⁷, as në zgjerimin dhe rikultivimin e hapësirave të gjelbra dhe pyjeve;⁵⁸ as në ofrimin e lehtësirave për qytetarët për zëvendësimin e metodave të dëmshme joekologjike të ngrohjes, me metoda të pastra alternative ekologjike;⁵⁹ as në përmirësimin e transportit publik;⁶⁰ në kontrollën teknike të automjeteve, e as në menaxhimin e mbeturinave urbane dhe industriale. Dështimi i organeve kompetente për të marrë veprime konkrete dhe efektive për përmirësimin e gjendjes së ajrit është tregues i kufizimit të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm kur i kemi parasysh efektet afatshkurta të aerondotjes nga partikulat, të cilat çojnë drejt rritjes së numrit të të sëmurëve me astma bronkiale, bronkiti kronik, sëmundjet kronike obstruktive të mushkërive tek moshat e shtyra, rritjen e

⁴⁹ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Raport për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2018.

⁵⁰ Zyra Kombëtare e Auditimit, Raport, tetor 2019, Sistemi i kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së derivateve të naftës, “Sistemi ekzistues i kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së derivateve të naftës nuk është në gjendje të sigurojë cilësinë e derivateve të naftës në importe dhe në tregun e brendshëm”, “Cilësia e derivateve të naftës në import nuk është siguruar në nivelin e duhur”.

⁵¹ Instituti për Politika Zhvillimore/INDEP, Cilësia e Ajrit në Kosovë, Drejt Standardeve Evropiane, fq. 14.

Agjencia e Statistikave të Kosovës, Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit Anketa e Mbeturinave Industriale, 2018, dhjetor 2019.

⁵² Instituti për Politika Zhvillimore/INDEP, Cilësia e Ajrit në Kosovë, Drejt Standardeve Evropiane, fq. 5.

⁵³ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Raport për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2018.

⁵⁴ Udhëzimi Administrativ 02/2011 për Normat e Cilësisë së Ajrit, janë të lejuara 35 ditë të tejkalimit të PM10 brenda një viti

⁵⁵ <https://kallxo.com/gjate/perballja-e-kosoves-me-vrasesin-e-heshtur/>, “Në Kosovë, numri i ditëve me ndotje të lejuar është 35 ndërsa vetëm gjatë këtij viti (2019) ky numër ka arritur në 50 ditë me ajër të ndotur mbi vlerat e lejuara”.

⁵⁶ Rezoluta e Kuvendit të Kosovës për ndotjen e ajrit, 2 shkurt 2019, neni 7.

⁵⁷ Po aty, neni 7.

⁵⁸ Po aty, neni, 8.

⁵⁹ Po aty, neni 9

⁶⁰ Po aty, neni 13

numrit të pranimeve spitalore nga sëmundjet kardiovaskulare dhe ato respiratore, kancer, shkurtim të jetës dhe rritje të shkallës së mortalitetit⁶¹.

Është shënuar përmirësim në sistemin e informimit lidhur me cilësinë e ajrit. Dita e monitorimit vazhdon të zgjidhet nga vetë operatori dhe mund të mos e paraqesë gjendjen reale të shkarkimeve nga operatori, saktësia e raportimit të operatorëve ende vazhdon të jetë indikative dhe joreale. Raportet e operatorëve nuk verifikohen nga organet kompetente mbikëqyrëse/inspektoratet. Në këtë vit janë pranur asete për matjet e ajrit, por ato deri në fund të vitit nuk kanë funksionalizuar. Stacionet e monitorimit kanë vazhduar të operojnë me probleme të ndryshme. Të dhënat që gjenerohen nga këto stacione raportojnë gjendjen e përgjithshme të cilësisë së ajrit, pa identifikuar burimin e shkarkimeve (energjetika, transporti, amvisëria, ngrohja etj.). Mangësitë në funksionalizimin e disa prej parametrave brenda periudhave të ndryshme kohore si rezultat i dëmtimeve, prishjeve apo thjesht mungesës së servisimit⁶², vë në pikëpyetje relevancën e informatave.

Një ndër problemet e evidentuara me ndikim në ndotjen e ajrit është edhe mungesa e menaxhimit të mbeturinave dhe ndikimi i kundërmimit në mjedisin jetësor. Lidhur me gjendjen në stacionin transfer të deponisë së mbeturinave në rrugën “Ali Ibra” në Gjakovë, Avokati i Popullit i është drejtuar Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (IKShP)⁶³ me kërkesë për vlerësimin e ndikimit të kundërmimit në shëndetin publik. Më 1 nëntor 2019, IKShP-ja, nëpërmjet Vlerësimit nr. 01/1261, për situatën sanitaro-higjienike dhe epidemiologjike, kishte gjetur: *“Gjendja në lagjen “Ali Ibra” në Gjakovë paraqet rrezik për shëndetin e qytetarëve, duke konstatuar se aktualisht nuk ka epidemi, por ajo mund të ndodhë si pasojë e gjendjes së krijuar në terren.”* Dislokimi i deponisë është njëri nga 15 rekomandimet e IKShP-së drejtuar MMPH-së dhe Komunës së Gjakovës, zbatimi i këtyre rekomandimeve është duke u monitoruar nga IAP-ja.

Problemet e planifikimit hapësinor dhe lëshimet në procesin e kontrollit të ndërtimit kanë bërë që sistemet e ajrosjes dhe tymtarët e objekteve të kufizojnë të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të drejtën e privatësisë dhe gëzimit të shtëpisë së qytetarëve.⁶⁴

Uji

Edhe në këtë vit obligimi ligjor për zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, si të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social - ekonomik të vendit, ka vazhduar të përcillet me shumë paqartësi. Organet kompetente për administrimin dhe menaxhimin e resurseve ujore⁶⁵ kanë dështuar të sigurojnë mbrojtje të resurseve nga ndotja, tejshfrytëzimi dhe keqpërdorimi.

⁶¹Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, Analizë e ndotjes së ajrit në Kosovë, Prishtinë, 24 dhjetor 2019.

⁶²Po aty, fq.27

⁶³A. nr. 750/2019

⁶⁴A. 342/2018

⁶⁵Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, neni 13, Përgjegjësitë e Ministrisë: 1. Ministria është përgjegjëse për: 1.5. administrimin dhe menaxhimin e të gjitha resurseve ujore në territorin e Republikës së Kosovës; 1.6. kryerjen e të gjitha punëve dhe aktiviteteve administrative, profesionale dhe punëve të tjera organizative dhe zhvillimore që obligohen me këtë ligj;

Mosarritja e menaxhimit të mbeturinave, sidomos atyre minerare⁶⁶, shkarkimet e operatorëve, urbanizimi i pakontrolluar, bujqësia intensive janë faktorët që kanë vazhduar të ndikojnë në ndotjen e ujërave. Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve ujore dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve, duke tejkaluar kapacitetet, ende mbetet një nga format e degradimit të resurseve ujore, me pasoja të pariparueshme në ekosistem. Ende vazhdon shtypja e substratit të lumenjve nga makineritë; gërmimi i gropave të thella, si pranë, po ashtu edhe në brendi të lumenjve; gërmimi në bashkërrjedhje të bashkimit të degëve të vogla në lumenj kryesor; ndërtimi i rrugëve në shtretërit e lumenjve; ndërrimi i rrjedhës natyrale të lumenjve; erozioni i tokës; zvogëlimi i stabilitetit të substratit të lumenjve, sidomos në rastet e vërshimeve; si dhe ndryshim natyror në ekosistemin e lumit, florës dhe faunës.

Masat parandaluese, masat për minimizimin e përdorimit dhe pengimin e ndotjes, parimi *ndotësi paguan dhe shfrytëzuesi paguan* vazhdojnë ende të mbeten dispozita ligjore të pazbatueshme. Edhe pse të ndaluara me ligj, ka vazhduar nxjerrja e rërës, zhavorrit, gurëve, deponimi i dheut, hedhja e mbeturinave, materialeve të ngurta dhe shkarkimi i materieve të lëngëta të pa trajtuara, në ujë rrjedha, liqene, akumulime dhe në brigjet e tyre. Ndotja e skajshme nga shkarkimi i ujërave të zeza të pa trajtuara në lumenj dhe kundërmimi kanë vazhduar ta kufizojnë jo vetëm të drejtën në mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, por edhe privatësinë e qytetarëve dhe gëzimin e pronës së qytetarëve. Mungesa e trajtimit të lumenjve para fazës së shkarkimit në lumenj vlerësohet të jetë një ndër ndotësit kryesorë të ujërave sipërfaqësore. Numri i impianteve mbetet mjaft i kufizuar, ndërsa instalimi i tyre ende në fazën e planifikimit. Shkarkimet e ujërave të zeza dhe i atyre industriale bëjnë që lumenjtë Sitnica, Ibër, Drenica etj. të jenë lumenjtë më të ndotur në Kosovë. Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka hetuar degradimin e lumit Graçanka dhe ndikimin e ndotjes në të drejtat e qytetarëve.⁶⁷

Kosova, në veçanti pjesa lindore, gjatë vitit raportues është karakterizuar me reshje të pakta dhe rënie të nivelit të ujërave.

Resurset ujore të vendit vazhdojnë të shfrytëzohen si nga operatorë, po ashtu edhe nga industria. Shfrytëzuesit më të mëdhenj të ujërave vazhdojnë të jenë KEK-u, Feronikeli dhe Sharrceci. Alarmante vlerësohet të jetë rrjedhja e pakontrolluar e ujërave të deponisë së Mirashit dhe deponisë së hirit në Obiliq (liqeni i kaltër ku bëhen shkarkimet e ujërave të hidraulikut) dhe depërtimi në ujërat nëntokësor⁶⁸. Po ashtu, ende vazhdon lirimi i emisioneve me metale të rënda gjatë procesit teknologjik nga Feronikeli. Përmbajtja e metaleve të rënda në xehen fillestare, si Fe, Ni, Co, Cd, Cr, As, Pb etj. dhe proceset metalurgjike që e shoqërojnë procesin e tërësishëm e karakterizojnë Feronikelin ndotës se kategorisë A.⁶⁹

Hidrocentralet

Ndërtimi i hidrocentraleve në vend ka nxitur reagim dhe shumë pakënaqësi te qytetarët dhe te shoqëria civile. Procesi i operimit të hidrocentraleve është përcjellë me shumë paqartësi, si për shkak të

⁶⁶Raporti për Kosovën 2019, “Mbeturinave e rrezikshme minerare, si dhe shkarkimet industriale drejtpërdrejtë në lumenj dhe deponitë industriale vazhdojnë të përbëjnë rrezik serioz ndaj dheut dhe ujit”.

⁶⁷Ex Officio, 631/2019.

⁶⁸Hydrogeochemical analyses of the ground water in the Mirash landfill area and problem analysis Control report, GIZ 2016, M. Sc. Eng. Evelina Rathje dhe emisioni “Teta në Kosovë”, 24 maj 2018.

⁶⁹Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Raport për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2018, fq. 52

mungesës së transparencës së institucioneve përgjegjëse për ligjshmërinë e operimit të tyre, e posaçërisht lidhur me respektimin e proceseve të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe qasjes në informata. Kapaciteti i ulët i prodhimit të energjisë në raport me ndikimin serioz në mjedis, ndërprerja e rrjedhave të ujit dhe përkeqësimi i habitateve janë tregues të mjaftueshëm për nevojën e menjëhershme për rivlerësimin me kujdes të politikave për operimin e hidrocentraleve, si dhe shfrytëzimin e ujërave për prodhimin e energjisë.

Duke konsideruar se çështja e operimit të hidrocentraleve në Deçan dhe në Shtërpce është duke u përcjellë me shumë paqartësi dhe institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur asnjëherë të jenë mjaftueshëm të qarta lidhur me ligjshmërinë e operimit të hidrocentraleve, ndërsa veprimet e tyre kanë vazhduar të ngelin të zbehta në drejtim të zgjidhjes së çështjes, përderisa reagimet dhe pakënaqësitë e qytetarëve dhe të shoqërisë civile janë rritur, më 17 korrik 2019, Avokati i Popullit iu drejtua ministrit të MMPH-së me Kërkesë për Masë të Përkohshme.

Derisa në publik është duke u zhvilluar një debat i gjerë dhe gjithëpërfshirës lidhur me këtë çështje, institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur asnjëherë të jenë mjaftueshëm të qarta lidhur me ligjshmërinë e operimit të hidrocentraleve dhe veprimet e tyre kanë vazhduar të ngelin të zbehta në drejtim të zgjidhjes së çështjes, përderisa reagimet dhe pakënaqësitë e qytetarëve dhe të shoqërisë civile janë në rritje. Të gjitha përpjekjet e deritanishme të organeve për ta adresuar problemin dhe pakënaqësitë e qytetarëve janë duke u treguar si mjete joefektive për zgjidhjen e problemit.

Duke vërejtur se në rastin konkret kemi të bëjmë me ndikimin në mjedis dhe në ujëra, Avokati i Popullit, bazuar në Ligjin nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, qëllimi i të cilit është mbrojtja e resurseve ujore nga ndotja, nga tejshfrytëzimi dhe nga keqpërdorimi, i cili përcakton në mënyrë të qartë se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore nga fusha e resurseve ujore, përfshirë edhe ligjet e tjera nga fusha e mjedisit jetësor, vlerëson se Ministria është organi kompetent, i cili duhet të japë sqarime të qarta lidhur me këtë çështje.

Toka

E drejta e qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm vazhdon të kufizohet nga ndotja dhe degradimi i tokës. Kanë munguar politikat dhe masat specifike, të cilat do të ndikonin në mbrojtjen e tokave dhe të cilat do të parandalonin pasojat mjedisore dhe socio-ekonomike të degradimit të tokave.

Ndryshimi i destinimit të tokës nga toka bujqësore në tokë ndërtimore, zënia e tokës me mbeturina të llojeve të ndryshme të prodhuara nga industria, minierat, gurëthyesit, transporti, materiet radioaktive dhe mbeturinat urbane, eksploatimi i qymyrit nga mihjet sipërfaqësore, shkarkimet e ujërave të zeza kanë vazhduar të shkaktojnë ndryshime në vetitë kimike, fizike ose biologjike të tokës, duke rezultuar në dobësimin e potencialit të saj prodhues.⁷⁰ Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe komunat nuk kanë informata të sakta lidhur me sipërfaqen tokësore, së cilës i është ndërruar destinimi. Ende mungon sistemi informativ për tokat.

⁷⁰Po aty, fq. 27. “Sipërfaqe të tokës me ndërtime në vitin 2001, 24978.47 ha, kanë arritur në 51057.52 ha në vitin 2018”

Përkundër kërkesave të dala nga Ligji për Planifikimin Hapësinor, për zhvillim të qëndrueshëm dhe të baraspeshuar, mbrojtje të tokës bujqësore dhe mjedisit, vazhdon mosangazhimi serioz i organeve kompetente të nivelit qendror dhe lokal për vënien nën kontroll të konvertimit të shpejtë të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Instalimi dhe operimi i gurishteve në vend, sidomos i operatorëve ilegalë⁷¹, ka vazhduar të jetë ndër problemet serioze në vend. Çështja e operimit, respektimi i procedurave për ligjshmërinë e operimit mbetet çështje që duhet shqyrtuar me kujdes, për arsye të paqartësive procedurale.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit zhvilloi hetime lidhur me ligjshmërinë e operimit të gurëthyesit të instaluar te vendi “Shpella e Kusarit”, në fshatin Kusarë, në komunën e Gjakovës⁷². Pas pakënaqësive dhe reagimit në formë të protestave të banorëve të fshatrave Kusar, Dol, Pjetërshan, Lipovec dhe Raçë nga ndikimit në mjedis dhe parregullsitë e operimit të gurëthyesit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor tërhoqi Pëlqimin mjedisor për operim të gurëthyesit.

Përfshirja e sipërfaqeve pyjore në kuadër të zonave të mbrojtura nuk ka arritur ta parandalojë vazhdimin e dëmtimit të sipërfaqeve pyjore. Ka vazhduar prerja e pyjeve, ndërtimi ilegal në zona të mbrojtura dhe ndërtimi i rrugëve. Ripyllëzimi nuk po arrihet të bëhet në proporcion të përafërt me degradimin e sipërfaqeve pyjore.

Mbeturinat

Përkundër ndikimit të ndotjes nga mbeturinat në mjedis dhe në shëndetin e njeriut, si dhe pasojave afatgjate e të pariparueshme, organet kompetente ende nuk kanë arritur të ndërmarrin veprime efektive në drejtim të përmirësimit të menaxhimit të mbeturinave dhe të deponive. Asnjë hap nuk është bërë në përafrimin me nismën globale të zhvillimit të qëndrueshëm, ku do të përfshiheshin ripërdorimi, përpunimi dhe riciklimi i mbeturinave. Mbledhja, transporti, trajtimi, dhe deponimi përfundimtar i mbeturinave, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktiviteteve, janë çështje që kërkojnë tani më veprime të shpejta dhe shqyrtim serioz shtetëror.

Deponitë sanitare regjionale të mbeturinave Mirash (Prishtinë), Dumnicë (Podujevë), Velekincë (Gjilan), dhe Landovicë (Prizren), përkundër obligimeve për administrimin e duhur të mbeturinave të dala nga Ligji nr. 02/L-30 për Mbeturina, duke krijuar kushte për zvogëlimin e rrezikshmërisë së mbeturinave, vazhdojnë të operojnë me problemet, si: mosfunksionimi i sistemeve të pompimit të ujërave të deponisë; kompresimi jo i mirë i mbeturinave të deponuara dhe mbulimi jo i mjaftueshëm i mbeturinave; shkarkimi në tokë dhe në lumenj i ujërave të pa trajtuara nga deponitë dhe depërtimi i tyre në ujëra nëntokësor.

Ndotja nga ambalazhet dhe qeset plastike kërkon shqyrtim serioz dhe ndalim të përdorimit dhe zëvendësim me materiale të riciklueshme.

⁷¹ <https://www.kosovo-mining.org/aktivitet/komunikate-per-media-prishtine-31-dhjetor-2019/>, “Gjatë vitit 2019, Inspektorati i KPMM-se në aksionin për zbatimin e Planit Operativ për parandalimin dhe ndalimin e operimeve ilegale, së bashku me Policinë e Kosovës, Inspektoratin e Mjedisit, Inspektoratin e Pylttarisë si dhe Inspektoratet Komunale. Pas përfundimit të këtij aksioni në 194 vende të operimeve ilegale janë vendosur shiritat për ndalimin e punës prej të cilave janë 99 seperacione, 16 shfrytëzim, 78 baza betoni dhe asfalti si dhe një fabrikë përpunimi”.

⁷²Ex Officio nr. 416/2019.

Avokati i Popullit, lidhur me mosarritjen e menaxhimit të deponisë sanitare të mbeturinave në fshatin Velekincë të komunës së Gjilanit, publikoi Raportin me rekomandime *Ex officio* nr. 479/2017. Në këtë raport u evidentuan problemet e mosarritjes së mbajtjes nën kontroll të deponisë dhe depërtimin e lehtë të personave të paautorizuar brenda deponisë, në raste të shpeshta të të miturve, Avokati i Popullit vlerësoi se mosvendosja e një rrethoje të qëndrueshme, e cila do ta pengonte hyrjen e personave të paautorizuar, që ka rezultuar edhe humbjen e jetës, është tregues i shkeljes të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm të qytetarëve. Raporti po ashtu ka evidentuar edhe dështimin e Inspektoratit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe të inspektoratit komunal për të ndërmarrë masa në përputhje me legjislacionin në fuqi, për mbikëqyrjen e operatorit që menaxhon deponinë e mbeturinave.

Zhurma

E drejta e privatësisë së qytetarëve të vendit dhe pasja e pronës vazhdon të cenohet nga zhurma, nga vibrimet dhe nga zhurma e liruar nga operatorë industrialë, hotelierë, transporti dhe individë. Edhe në këtë vit përpjekjet e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për të nxjerrë një ligj, i cili do të garantonte shmangie, parandalim ose zvogëlim në baza prioritare të efekteve të dëmshme, përfshirë edhe bezdisjen si rezultat i ekspozimit të zhurmës në mjedis, mbeti përsëri vetëm në formë projektligji. Po ashtu nuk është vërejtur ndonjë ndërhyrje në vendosjen e paneleve në autostrada, të cilat do t'i mbronin vendbanimet nga zhurma.

Zona e interesit të veçantë ekonomik “Fusha e Mihjes së Re”

Banorët e zonës me interes të veçantë ekonomik “Fusha e Mihjes së Re”, të pa shpronësuar, vazhdojnë të jenë viktimat të dështimit të shtetit për zgjidhjen e çështjes. Gjendja e mjedisit është larg standardeve të dëshirueshme dhe normat e ndotjes sipas raporteve ekzistuese, shpeshherë tejkalojnë kufijtë e lejuar të përcaktuar me legjislacionin vendor. Përkundër obligimit pozitiv të shtetit, zhvendosja, shpronësimi apo lëvizja e një numri të konsiderueshëm të banorëve nga ato hapësira, si masë proporcionale dhe efektive për zgjidhjen e çështjes, nuk është kryer që nga viti 2004. Vendimi për devijimin e vijës së mihjes duke tejkalluar pjesën e mbetur të fshatit Hade ka lënë pezull qytetarët, duke ua kufizuar të drejtën e tyre për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të drejtën e jetës, privatësisë dhe pasjes së pronë dhe lirinë e lëvizjes.

Planifikimi hapësinor

Mosrespektimi i nenit 52 të Kushtetutës, i cili garanton promovimin e një procesi demokratik të pjesëmarrjes së publikut në proceset e planifikimit mjedisor, si dhe mungesa e transparencës, kanë ndikuar që në vend të vazhdojë krijimi i hapësirave që nuk arrijnë të krijojnë zhvillim të balancuar të qëndrueshëm, të bazuar në nevojat publike dhe ekonomike.

Mungesa e bashkërendimit të veprimeve mes ministrisë, komunave, organizatave lokale dhe ndërkombëtare, me qëllim të harmonizimit të planifikimit hapësinor në Kosovë, ka ndikuar që qytetarët edhe më tutje ballafaqohen me mungesë të një rregullimi të qëndrueshëm të hapësirave, që do të ofronin trajtim të barabartë, lëvizje të lirë, qasje adekuate në shërbimet publike, si dhe cilësi të lartë dhe kualitative të jetesës. Ndikim serioz në të drejtat e njeriut vlerësohet mospërfshirja e

interesave të të gjithë qytetarëve, në veçanti të nevojave të personave me aftësi të kufizuara, të të moshuarve, të fëmijëve, të të rinjve⁷³, brenda planeve rregulluese të hollësishme.

Kualitetin jetësor të qytetarëve vazhdon ta rëndojë mungesa e respektimit të kushteve ndërtimore për ndërtimin e objekteve, si: respektimi i përqindjes së sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzueshme për shputën e ndërtesës në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale; përqindja e sipërfaqes së përgjithshme të gjelbërimit për absorbim të reshjeve atmosferike në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale; kërkesa minimale për vend-parkim; të drejtën e ndriçimit natyror; kushteve të qasjes adekuate në rrugë publike dhe në infrastrukturë teknike; kufizimeve të ndotjes mjedisore; dhe të zhurmës⁷⁴, kushteve për mbrojtje nga zjarri, vërshimeve, tërmeteve etj. Mbikëqyrja inspektive dhe inspektimit final vazhdojnë të funksionojnë me probleme. Shqetësuese vazhdon të mbetet dështimi i shtetit në respektimin e të drejtave të njeriut, trajtimit të barabartë, lëvizjes së lirë, qasjes adekuate dhe pa diskriminim në shërbimet publike të personave me aftësi të kufizuara, nga mosarritja e përfshirjes së nevojave të tyre gjatë planifikimit hapësinor. Po ashtu, nuk është shënuar ndonjë përmirësim për qasje lehtësuese në objekte, sidomos në objekte të institucioneve publike, ashtu sikurse është paraparë me Udhëzimin Administrativ nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara⁷⁵.

Avokati i Popullit, gjatë vitit raportues, publikoi Raportin me rekomandime Ex officio Nr.340/2017 në lidhje me situatën e personave me aftësi të kufizuara në komunën e Gjilanit, që kishte të bënte me qasjen e personave me aftësi të kufizuar (PAK) në pronat publike, në infrastrukturën rrugore. Nëpërmjet raportit është konstatuar se mospërshtatja/mosakomodimi i arsyeshëm i personave me aftësi të kufizuar, në përputhje me nevojat e tyre specifike, përbën diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar, e përcaktuar sipas nenit 1 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Avokati i Popullit ka rekomanduar miratimin e Strategjisë Komunale për PAK-un dhe përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe krijimin e pjerrinave në vendkalimet për këmbësorë për personat me aftësi të kufizuara.

Problem serioz në mjediset urbane mbetet uzurpimi arbitrar i hapësirave publike dhe vazhdimi i neglizhimit të organeve kompetente për lirimin e tyre. Avokati i Popullit, në Raportin me rekomandime lidhur me mosndërmarrjen e veprimeve adekuate për lirimin e hapësirave publike në komunën e Fushë Kosovës⁷⁶, ka konstatuar se Komuna, duke mos i liruuar hapësirat publike të uzurpuara, ka pamundësuar lëvizjen e lirë dhe të papenguar të qytetarëve dhe i ka rekomanduar Komunës së Fushë Kosovës që, në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë ligjore dhe në bashkëpunim me autoritetet e tjera përgjegjëse, të ndërmarë veprime të menjëhershme për lirimin e plotë të pronës publike të uzurpuar, në mënyrë që qytetarëve t'u mundësohet lëvizja e lirë dhe e papenguar.

⁷³ Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 01/2018 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme.

⁷⁴ Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, neni 21, "Kushtet e Ndërtimit"

⁷⁵ Udhëzimi Administrativ nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara.

⁷⁶ A.nr. 842/2017

Çështje serioze që kërkon adresim të menjëhershëm me ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtën e jetës, në të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm dhe në të drejtën e pronës, janë problemet lidhur me mbikëqyrjen institucionale të vlerësimit të përputhshmërisë së objekteve ndërtimore të përfunduara me lejen e ndërtimit, me rregulloret e tjera dhe me kërkesat e zbatueshme. Mungesa e mbikëqyrjes dhe e certifikimit final të përdorimit të objekteve paraqet nevojën e menjëhershme për ndërmarrjen e masave nga institucionet kompetente për vlerësimin e sigurisë së objekteve për përputhshmërinë me rregullat e përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, e mbi të gjitha me rregullat e sigurisë nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera dhe me ato kundër ndotjes dhe degradimit e mjedisit.

Rrugët

Gjendja e trotuareve/shtigjeve për këmbësorë mbetet e njëjtë. Një gjendje e tillë e pamundëson lëvizjen e lirë dhe të papenguar të qytetarëve, e në veçanti të personave me aftësi të kufizuara. Ka vazhduar trendi i ndërtimeve pa përmirësim të gjendjes së shtigjeve për qytetarët. Hapësirat e lëvizjes për këmbësorë vazhdojnë të jenë me gjerësi të pamjaftueshme në krahasim me numrin e banorëve; lartësi jashtë normave të caktuara; mungesë të elementeve për qasje dhe rampave të cilat do ta mundësonin lidhjen pa ndërprerje në mes të niveleve të ndryshme të trotuareve. Nuk është vërejtur ndryshim në lidhjen pa pengesë me sipërfaqet publike dhe me rrugët e qarkullimit kryesor. Vendet e qarkullimit publik vazhdojnë të jenë me gropa dhe me puseta të dëmtuara; të zëna me vetura, inventar dhe rrethoja hoteliere, mallra dhe material ndërtimor, pa masë mbrojtëse apo shenja paralajmërimi.

Ndërtimet në toka bujqësore të lagjeve të reja dhe në ato ekzistuese me ndërtime të ulëta, pa vlerësuar ndikimin në mjedis të ngritjes së numrit të banorëve dhe pa zgjeruar rrugët ekzistuese ka vazhduar me trend të njëjtë. Nuk është shënuar ndonjë përmirësim në lidhjet përmes nënkalimeve dhe mbikalimeve të vendbanimeve, të cilat do të mundësonin lëvizjen e lehtë, të sigurt, të shpejtë në rrugët magjistrale e rajonale. Në këtë situatë është duke ndikuar mospërfshirja e qytetarëve në dëgjime publike, si formë e vendimmarrjes në proceset e ndërtimit të rrugëve.

Duhet të ndërmerren veprime për përmirësimin e masave mbrojtëse pranë institucioneve shkollore dhe kopshteve të fëmijëve, e cilat do të ndikonin në sigurinë e fëmijëve.

E drejta në jetë dhe e drejta për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm në vend kanë vazhduar të kufizohen me problemet dhe me mangësitë në infrastrukturën rrugore të vendit. Mbi 10% e aksidenteve në vendin tonë janë të shkaktuara nga faktori rrugë. Vrazhdësia e sipërfaqeve të rrugëve, mikro dhe makro deformimet në rrugë, mungesa e ndriçimit të rrugëve, mungesa e shenjzimit adekuat, mangësitë e sinjalizimit, mungesa e rrethimit të ndërtimeve në rrugë, mungesa e mirëmbajtjes së duhur janë elemente të cilat në vendin tonë e bëjnë faktorin e dytë me radhë si shkaktar të aksidenteve në trafik rrugor.⁷⁷ Po ashtu, kyçja e mjeteve transportuese të rënda nga vendpunishtet në rrugë magjistrale, pa asnjë masë preventive për të penguar përhapjen e baltës, ngre mundësinë e rrezikut për aksidente.

Të tjera

⁷⁷Zyra Kombëtare e Auditimit, dhjetor 2019, Raporti i Auditimit të Performancës siguria në Trafikun rrugor

Qasja në informata mjedisore në vend përcillet me vështirësi, përkundër faktit që kjo e drejtë është e integruar në tërë legjislacionin mjedisor dhe i garanton secilit person juridik ose fizik të drejtën për t'u informuar për gjendjen e mjedisit. Rekomandimi i Avokatit të Popullit, për vite me radhë, për largimin e dokumenteve me përmbajtje mjedisore nga lista e dokumenteve të kufizuar me ligj ka gjetur zbatim në Ligjin (e ri) për Qasje në Dokumente Publike. Nenin 17, par. 3.3, i ligjit, i cili rregullon “Bazat e lejueshme për refuzimin e qasjes në dokumente publike”, saktëson se qasja në dokumente publike gjithnjë lejohet, nëse: *“dokumenti publik i kërkuar ka të bëjë me mjedisin, mbeturinat, substanca të rrezikshme ose informata të raporteve të sigurisë në mjedis, ashtu si janë të parapara me ligjin përkatës për mbrojtjen e mjedisit.”*

Gjatë vitit raportues është vërejtur angazhim i shtuar i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës, si institucion për monitorim dhe parandalim të sëmundjeve mjedisore, për ta informuar publikun lidhur me ndikimin e mjedisit në shëndetin publik. Ndihmesë në punën e IKShP-së do të ishte funksionalizimi i sistemit të informimit shëndetësor, i cili përmes të dhënave faktike do ta elaboronte ndikimin e ndotjes së mjedisit në jetën dhe në shëndetin e qytetarëve, si dhe do të ishin indikatorë nëpërmjet të cilëve do të evidentoheshin sëmundjet si pasojë e ndotjes.

E drejta për qasje në dokumente publike

Transparenca dhe llogaridhënia njihen si parime ndër më të rëndësishmet në botën demokratike dhe se të dy këto parime janë në shërbim të qeverisjes së përgjegjshme dhe funksionale. Në një shtet demokratik, qeverisja transparente dhe llogaridhënese synohet të arrihen nëpërmjet promovimit të interesit publik. Në këtë drejtim, transparenca në funksion të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nënkupton qasjen e lehtë dhe të papenguar të publikut në të dhënat dhe dokumentet e prodhuara, pranuar, mbajtura apo kontrolluara nga institucionet publike.

Kushtetuta (neni 41) dhe Ligji për Qasje në Dokumente Publike garantojnë dhe rregullojnë të drejtën e qasjes në dokumente publike, me përjashtim të informacioneve të kufizuara me ligj. Kjo e drejtë nuk është e drejtë absolute, por është e drejtë e cila duhet të balancohet me të drejtat e tjera.

E drejta për qasje në dokumente publike, përveç me legjislacion vendor, garantohet edhe me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (neni 19), me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 19) dhe me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj (neni 19).

Në korrik të vitit 2019 ka hyrë në fuqi Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), i cili e garanton të drejtën e secilit person, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje në dokumente publike, të prodhuara, pranuar, mbajtura apo kontrolluara nga institucionet publike, si dhe të drejtën për ripërdorimin e dokumenteve të sektorit publik. Ky ligj e përcakton Agjencinë për Informim dhe Privatësi si organ të pavarur, përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për qasje në dokumente publike dhe për mbrojtje të të dhënave personale, me qëllim që të mbrohen të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, si dhe garantimin e qasjes në dokumente publike. Agjencia për Informim dhe Privatësi është themeluar në

bazë të ligjit të veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale,⁷⁸ me të cilin përcaktohet se kjo agjenci përfaqësohet nga Komisionari, i cili emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe i cili është përgjegjës për sigurimin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Ndër të tjera, me këtë ligj rregullohen edhe procedurat mbi ankimin administrativ, ku agjencia shërben si shkallë e dytë dhe është kompetente për shqiptimin e gjobave ndaj institucioneve publike dhe ndaj zyrtarëve përgjegjës. Ndërsa kompetenca e Avokatit të Popullit, sipas nenit 21 të LQDP-së, është t'i ndihmojë qytetarët në realizimin e së drejtës për qasje në dokumentet publike, sipas Kushtetutës, sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit.

Trendi i rritjes së numrit të ankesave të paraqitura te Avokati i Popullit lidhur me pretendimin për mohim të së drejtës për qasje në dokumente publike ka vazhduar edhe në këtë vit. Përderisa në vitin 2018 ishin paraqitur 61 ankesa, prej të cilave 56⁷⁹ ishin hapur për hetim, në vitin 2019 janë paraqitur 106 ankesa, prej të cilave 99 janë hapur për hetim.

Nga 99 ankesat e hetuara për cenim apo shkelje të së drejtës për qasje në dokumente publike, 73 janë nga OJQ-të dhe nga mediat, ndërsa 26 ankesa janë nga persona fizikë. Deri në fund të vitit raportues, 36 ankesa të trajtuara janë mbyllur me realizimin e qasjes në dokumentet e kërkuara, në dy nga këto raste qasja në dokumentet e kërkuara është realizuar pas rekomandimeve të Avokatit të Popullit drejtuar institucioneve përgjegjëse.⁸⁰ Ankesat e tjera mbesin ende në procedurë të hetimeve dhe në pritje të zbatimit të rekomandimeve të dhëna. Avokati i Popullit konsideron se trendi i rritjes së ankesave të parashtruara në IAP mund të jetë rezultat i ndërgjegjësimit të qytetarëve për të drejtat që burojnë nga Kushtetuta dhe nga ligji, për transparencë dhe llogaridhënie më të përgjegjshme nga autoritetet publike në vend, mungesa e Komisionarit për Informim dhe Privatësi, por edhe rezultat i ngritjes së besimit te Avokati i Popullit për sa i përket trajtimit të ankesave për qasje në dokumente publike.

Shumica e ankesave të pranuar nga Avokati i Popullit gjatë vitit raportues, lidhur me qasjen në dokumente publike, janë kundër institucioneve publike në nivel qendror (Figura 1).

⁷⁸ Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

⁷⁹ Raporti vjetor 2018 i Institucionit të Avokatit të Popullit, faqe 73.

⁸⁰ A.nr 260/2019 dhe A.nr. 108/2019.




Figura 1. Palët përgjegjëse në ankesat lidhur me QDP-në

Nga hetimet e zhvilluara për këto ankesa vërehet se gjendja nga viti i kaluar nuk ka ndryshuar. Vazhdojnë të jenë evidente shkeljet e së drejtës për qasje në dokumente publike të raportuara në Raportin Vjetor 2018 të Avokatit të Popullit.⁸¹ Gjendja është e njëjtë sa i përket mosklasifikimit të dokumenteve, mungesës së kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës në trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, por edhe mungesa e vullnetit të institucioneve për zbatimin e ligjit.

Në rastet kur institucionet publike refuzojnë qasjen apo lejojnë qasje të kufizuara, në të shumtën e rasteve dështojnë të nxjerrin vendim dhe të japin arsytim të bazuar në ligj. Mbetet shqetësim mosveprimi i autoriteteve përgjegjëse, edhe përkundër që Avokati i Popullit u drejtohet me rekomandime këtyre autoriteteve,⁸² në bazë të ankesave të pranuara dhe hetimeve të zhvilluara përkitazi me ankesat që kanë të bëjnë me qasjen në dokumente publike.

Qasja e lehtë dhe pa pengesa në dokumente dhe në informacione është mjet i rëndësishëm që ndikon në ndërtimin e besimit mes institucioneve dhe qytetarëve në transparencë të veprimeve, në efikasitetin dhe efektivitetin e administratës publike. Zbatimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike është i rëndësishëm në ndërgjegjësimin e punonjësve të administratës dhe për detyrimin që kanë ata në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, por edhe të ndërgjegjësimin të qytetarëve për shërbimet që i pret

⁸¹ Raporti Vjetor 2018 i Institucionit të Avokatit të Popullit.

⁸² A.nr. 826/2018 kundër PK; A.nr. 839/2018 kundër KGJK; A.nr. 869/2018 kundër MeF; A.nr. 203/2019 kundër Komunës së Fushë Kosovës; A.nr. 256/2019 kundër Komunës së Podujevës; A.nr.275/2019 kundër Komunës së Skenderajt; A.nr. 29/2019 kundër Telekomit të Kosovës; A.nr.265/2019 kundër MPJ; A.nr. 292/2019 kundër Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit; A.nr. 337/2019 kundër KPK; A.nr. 448/2019 kundër KPK; A.nr. 496/2019 kundër MPJ dhe A.nr. 662/2019 kundër MASHT; A.nr.363/2019 kundër MPJ.

nga administrata. Megjithatë, në praktikë zbatimi i këtij ligji vazhdon të përcillet me vështirësi të natyrave të ndryshme. Me ndryshimet që sjell ligji i ri për qasje në dokumente publike dhe pas emërimit të Komisionarit për Informim dhe Privatësi është e pritshme që këto vështirësi të tejkalohen.

III. Të drejtat e fëmijëve

Gjendja e të drejtave të fëmijëve

Të drejtat e fëmijëve përbëjnë një pjesë integrale të të drejtave të njeriut. Edhe këtë vit, analiza e situatës së fëmijëve tregon që fëmijët ende hasin në vështirësi për gëzimin e plotë të të drejtave të tyre. Këto vështirësi janë të shfaqura gati në të gjitha fushat e jetës së tyre, veçanërisht në realizimin e të drejtës për arsim dhe mbrojtje sociale dhe shëndetësore. Një jetë e lirë nga dhuna është e drejtë themelore dhe parakusht i domosdoshëm për mirëqenien dhe shëndetin fizik dhe mendor të fëmijës. Pavarësisht kësaj, në Kosovë dhuna vazhdon të jetë e pranishme. Fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në situatë rruge janë veçanërisht të rrezikuar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, dhunës e diskriminimit. Mungesa e të dhënave në shumë prej fushave të shtjelluar më poshtë siç janë fëmijët në situatë rruge, përdorimi i substancave narkotike dhe fëmijët me aftësi të kufizuara vështirësojnë hartimin e politikave efektive dhe të përshtatshme ndaj nevojave të fëmijëve. IAP ka përfshirë rekomandime konkrete për secilën nga fushat e adresuara përgjatë raportit. Natyrisht, është qenësore që këto procese të përfshijnë zërin dhe pikëpamjen e fëmijës në pajtim me zhvillim gradual të aftësive të tij/ saj. Plotësimi i kornizës ligjore me miratimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës shënon një hap të rëndësishëm drejt realizimit të drejtave të tyre. Sidoqoftë, miratimi i ligjeve mbetet vetëm një hap simbolik nëse nuk përcillet me hapa konkretë dhe zbatim të suksesshëm.

Korniza ligjore dhe të drejtat e fëmijëve

Në qershor Kuvendi miratoi Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës (LMF), gjashtë vite pas fillimit të procesit për draftimin e tij. Ky është ligji i parë në vend që adreson specifikisht të drejtat e fëmijës. IAP ka qenë i përfshirë në mënyrë aktive përgjatë këtij procesi, duke qenë pjesë e grupit punues, dërgimit të komenteve lidhur me projektligjin si dhe pjesëmarrës në takime avokuese për miratimin e tij. Ligji hyn në fuqi një vit pas publikimit në Gazetën Zyrtare⁸³ dhe përbëhet nga nëntë kapituj.

Po ashtu, duke u bazuar në Ligjin për Avokatin e Popullit dhe LMF-në, në tetor IAP ka nxjerr Rregulloren për Procedurat e Veçanta për Pranimin, Trajtimin dhe Adresimin e Ankesave të Paraqitura nga Fëmijët apo Ankesave që kanë të bëjnë me të Drejtat e Fëmijëve. Rregullorja përcakton rregulla të veçanta për pranimin, trajtimin dhe adresimin e ankesave që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve, duke garantuar dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e tyre të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet dhe me aktet e tjera, si dhe me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, veçanërisht me KDF. Rregullorja do të zbatohet nga stafi i IAP gjatë procedurave të ankesave që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve duke u bazuar në parimet e mosdiskriminimit, mbrojtjes së interesit më të mirë të fëmijës, respektimin e dinjitetit dhe personalitetit të fëmijës, marrjen e mendimit të tij, adresimin me shpejtësi dhe pa vonesa të paarsyeshme si dhe ofrimin e shërbimit të personalizuar e të specializuar për çdo fëmijë.⁸⁴ Rregullorja po ashtu përfshin një dispozitë të veçantë lidhur me pjesëmarrjen aktive të fëmijës në trajtimin e rastit,⁸⁵ të drejtën e tij për të shpreh mendimin e tij mbi

⁸³Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, 2019, neni 66.

⁸⁴Rregullorja Nr. 01/2019 për Procedurat e Veçanta për Pranimin, Trajtimin dhe Adresimin e Ankesave të Paraqitura nga Fëmijët apo Ankesave që kanë të bëjnë me të Drejtat e Fëmijëve, 2019, neni 3.

⁸⁵LMF, neni 13.

mënyrën e zgjidhjes së ankesës si dhe mundësinë që intervistimi kur është i nevojshëm të bëhet me ndihmën e psikologut apo të personit tjetër profesional.

Analizë e shkurtër e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës

Kapitulli i parë përmban dispozitat e përgjithshme lidhur me qëllimin e ligjit, fushëveprimin dhe përkufizimet. Ligji zbatohet si për fëmijët me shtetësi kosovare brenda dhe jashtë territorit të Kosovës ashtu edhe për fëmijët pa shtetësi, të pa regjistruar, azilkërkues, refugjat ose me shtetësi të huaj që gjenden brenda Kosovës. Ai është i bazuar në masë të madhe në Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF) dhe në përputhshmëri me Direktivën 2011/92/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të 13 dhjetorit 2011, për luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë.

Shprehja “Fëmijë” është përkufizuar në mënyrë të tillë që përfshin të gjithë qeniet njerëzore nën moshën 18 vjeçare përpos në ato raste kur mosha madhore arrihet më herët në pajtim me legjislacionin ekzistues. Në rastin kur mosha e personit nuk është plotësisht e përcaktuar, por ekzistojnë arsye që lënë të nënkuptohet se personi është fëmijë, sipas ligjit ai/ajo konsiderohet fëmijë. Kjo është një qasje progresive për mbrojtjen e fëmijës dhe është veçanërisht e rëndësishme në rastet e fëmijëve migrantë dhe refugjatë të cilët mund të mos jenë në posedim të dokumenteve identifikuese të cilat provojnë moshën e tyre. Ndërsa, përkufizimi i “fëmijës me aftësi të kufizuar” përmban modelin social të aftësisë së kufizuar duke iu referuar fëmijës me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në shoqëri, sikur pjesa tjetër e shoqërisë. Po ashtu, ligji përfshin edhe përkufizimin e drejtësisë mike ndaj fëmijës dhe një përkufizim të detajuar dhe gjithëpërfshirës të dhunës.

Kapitulli i dytë ka përfshirë parimet themelore të njohura në KDF-së: e drejta për jetë, mbijetesë dhe zhvillim, interesi më i mirë i fëmijës, zhvillimi gradual i aftësive, dhe mosdiskriminimi. Ndryshe nga KDF, LMF liston edhe respektimin e pikëpamjes së fëmijës si një ndër parimet themelore.

Kapitulli i tretë rregullon kornizën institucionale duke listuar mekanizmat për të drejtat e fëmijës; qendrorë dhe lokalë.⁸⁶ Ligji ka paraparë për secilin detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse përfshirë edhe rolin e IAP-së si dhe bashkëpunimin dhe koordinimin në mes të mekanizmave qendrorë dhe lokalë, për zbatimin e këtij ligji, të legjislacionit në fuqi dhe të politikave shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.⁸⁷ Gjithashtu është paraparë edhe krijimi i Tryezës Multidisiplinare për Ndihmë në Menaxhimin e Rastit që nënkupton grupin multidisiplinar të përbërë nga profesionistë të ndryshëm të cilët ndërveprojnë dhe koordinojnë përpjekjet e tyre për të trajtuar rastet specifike të abuzimit, keqtrajtimit të fëmijës dhe lënien pas dore të tyre në bazë të interesit më të mirë të fëmijës.⁸⁸ Është paraparë edhe themelimi i linjës telefonike falas për mbrojtjen e fëmijës ku u ofrohet ndihma fëmijëve

⁸⁶Struktura dhe mekanizmat institucionalë për të drejtat e fëmijës në nivel qendror janë: Institucioni i Avokatit të Popullit; ministritë përkatëse sipas fushës që mbulojnë, në lidhje me të drejtat e fëmijës; njësia përkatëse për qeverisje të mirë, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit; Komiteti Ndërministror për të Drejtat e Fëmijës; dhe Këshilli për të Drejtat e Fëmijës. Ndërsa, struktura dhe mekanizmat institucionalë në nivel lokal janë: komuna; departamenti përkatës sipas fushës që mbulojnë në lidhje me të drejtat e fëmijës; qendra për punë sociale; dhe ekipi për të drejtat e fëmijës.

⁸⁷LMF, neni 9 dhe 10.

⁸⁸Po aty, neni 21.

që kanë nevojë të marrin informata dhe këshilla për të drejtat e tyre, si dhe për të raportuar rastet e dhunës.⁸⁹

Kapitulli i katërt mbulon masat për mbrojtjen e fëmijës duke u nisur nga parandalimi, masat e mbrojtjes ligjore, masat për aftësim prindëror, detyrimi ligjor për raportim si dhe mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore. Ligji ka paraparë edhe themelimin e Shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve. Këto shtëpi duke zbatuar konceptin e qasjes miqësore, reagimit urgjent dhe veprimin ndërdisiplinor do të ofrojnë shërbime emergjente për mbrojtjen e fëmijës, dhe do të shërbejnë si qendra për zhvillimin e procedurave për të gjitha rastet e dhunës, me theks të veçantë veprave penale kundër integritetit seksual, kur fëmija është viktimë apo dëshmitar.⁹⁰ Rastet e pranuar nga IAP sidomos rasti i këtij viti që rezultoi me marrjen e jetës së 11 vjeçarit që është shtjelluar në pjesën e detyrimeve pozitive të shtetit lidhur me mbrojtjen e të drejtës për jetë tregojnë se themelimi i këtyre shtëpive është i domosdoshëm për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijës.

Kapitulli i pestë mbulon mbrojtjen e fëmijës në familje dhe komunitet dhe çështjet siç janë përgjegjësitë familjare, institucionale, individuale, edukimin dhe arsimin, ndalimin e ndëshkimit trupor, mbrojtjen e të drejtës për privatësi, kohën e lirë dhe lojën. Po ashtu, është e përfshirë një dispozitë specifike për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen nga praktikat e dëmshme dhe dhuna në përgjithësi.

Kapitulli i gjashtë përfshin parimet e punës së fëmijës, moshën minimale për punë dhe punën e ndaluar për fëmijë ndërsa ai i shtatë përfshin format specifike të mbrojtjes së fëmijës. Gjithashtu dispozita të veçanta adresojnë kapacitetin e fëmijës për të ndërmarrë veprime ligjore, drejtësinë mike, ndihmën juridike dhe qasjen në organe të drejtësisë, ndihmën mjekësore dhe psikologjike, rehabilitimin dhe masat për riintegrim dhe pjesëmarrjen e fëmijës në konfliktin e armatosur. Nenet reflektojnë diversitetin e çështjeve të cilat i adreson ligji dhe gjithëpërfshirjen e tij.

Kapitulli i tetë përmban dispozita ndëshkuese kundërvajtëse. Ndërsa kapitulli i fundit përmban edhe obligime për institucionet përkatëse që të zbatojnë programe edukativo-arsimore që sensibilizojnë mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijës. Po ashtu, qeveria obligohet të lansojë fushatë promovimi dhe të hartojë program për vetëdijësimin e publikut lidhur me ligjin.

Ligji ka paraparë që 14 fusha të ndryshme të rregullohen me akte nënligjore për të cilat obligon që të nxirren në afat prej një (1) viti, nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Ky është vetëm njëri nga treguesit që mbetet shumë punë për zbatimin e tij. Ndonëse miratimi i ligjit shënon një hap të madh në fushën e të drejtave të fëmijëve, në mënyrë që ai të jetësohet dhe fëmijët realisht të gëzojnë të drejtat e tyre, ligji duhet të zbatohet në tërësi dhe me seriozitet nga institucionet përkatëse.

Ankesat e parashtruara lidhur me të drejtat e fëmijëve

⁸⁹Po aty, neni 22.

⁹⁰Po aty, neni 30.

Avokati i Popullit gjatë këtij viti raportues ka pranuar 101 ankesa, një numër i të cilave është parashtruar kryesisht nga prindër të fëmijëve. Nga ky numër, 29 janë shpallur të papranueshme, ngase çështjet me të cilat kanë pasur të bëjnë ato kanë qenë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit, nuk ka shkelje të drejtave të njeriut, apo ankuesit kanë pasur mundësi të i shfrytëzojnë ose kanë qenë në shfrytëzim të mjeteve juridike. Nga 72 ankesat, e vendosura për hetim, 19 janë filluar sipas detyrës zyrtare.

E drejta e fëmijëve në arsim

Rastet pranë IAP lidhur me të drejtën në arsim të cilat janë hetuar, duke përfshirë edhe rastet e iniciuara sipas detyrës zyrtare kanë trajtuar: mungesën e kushteve për mësim në shkolla; vështirësitë dhe pengesat për mësim për fëmijët me aftësi të kufizuara në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim (QBMK); përdorimin e dhunës ndaj fëmijëve; mos përgjigje në ankesë lidhur me mosdhënie të provimit të maturës; mospërgjigje lidhur me ankesën për trajtim dhe vlerësim të dijës; mosvlerësim të testit të maturës; humbjes së vitit; mospranim në shkollën profesionale; riorganizimin e arsimit në komunë; ndërprerje të shkollimit për shkak të largësisë së madhe të shtëpisë nga shkolla dhe rrezikut për kalimin e rrugës përmes malit; kushteve joadekuate për mësim dhe suspendim nga shkolla.⁹¹ Nga 34 raste të pranuar, 16 kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve, prej tyre 4 janë mbyllur, një është zgjedhur sipas kërkesës së ankuesit, në dy është konstatuar se nuk ka shkelje të të drejtave dhe në tjetrin rast ankuesi është udhëzuar për veprimet që duhet të ndërmerret.

Avokati i Popullit vitin e kaluar i kishte rekomanduar komunës së Podujevës dhe Deçanit, për të ndërmarrë veprime për renovimin e objekteve shkollore në dy fshatra të tyre. Shkolla në komunën e Podujevës ishte rinovuar vitin e kaluar ndërsa IAP këtë vit është njoftuar se edhe komuna e Deçanit kishte ndërmarrë veprimet përkatëse në renovimin e shkollës “Esad Mekuli” në fshatin Maznik. Lidhur me renovimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore si dhe mungesën e kushteve elementare për mësim IAP edhe këtë vit filloi hetimet sipas detyrës zyrtare bazuar në shkrimin me titull “Shkollim bashkë me minj e insekte” të gazetës “Koha Ditore”. Sipas informatave fillestare të dërguara nga autoritetet komunale, komuna ka planifikuar që përveç tjerash në shkollë të rregulloj edhe nyjat sanitare. IAP do të vazhdoj të merret me çështjen në mënyrë që të sigurohet që fëmijëve u ofrohen kushtet e nevojshme për mësim.

Gjithashtu sipas detyrës zyrtare duke u nisur nga artikulli i gazetës “Express” Avokati i Popullit ka filluar hetimet lidhur me çështjen e mos vijimit të shkollës për tre vite të disa fëmijëve, të një fshati nga komuna e Vushtrrisë për shkak të largësisë së madhe të shtëpisë nga shkolla dhe kalimit në rrugën që bie përmes malit që përbën rrezik për fëmijët. Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit kishte kontaktuar me përfaqësues të shkollës, drejtorisë komunale dhe njërin prind, i cili kishte pohuar se përkundër premtimeve gojore dhe mundësive të përmendura nga autoritetet komunale, fëmijët e tij ende nuk janë duke shkuar në shkollë për shkak të mungesës së sigurimit të transportit. Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit mbetet të takohet me përfaqësues të tjerë komunalë në mënyrë që të sigurohet që autoritetet ndërmarrin veprimet e nevojshme që fëmijëve, në pajtim me interesin më të mirë të tyre, tu ofrohet

⁹¹A. nr. 254/2019; A. nr. 457/2019; A. nr. 497/2019; A. nr. 538/2019; A. nr. 569/2019; A. nr. 745/2019; A. nr. 779/2019; A. nr. 796/2019; A. nr.877/2019;A.nr. 720/2019.

transporti, që ata të mund të vazhdojnë mësimin, ashtu siç e garantojnë standardet vendore dhe ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve.

Ndaj ankesës së pranuar nga një nxënës, Avokati i Popullit i kishte drejtuar letër me rekomandim kryetarit të komunës përkatëse.⁹² Për shkak të mungesave të shumta të paarsyeshme (25) si dhe sjellëve jodisiplinore, nxënësit i është shqiptuar masa disiplinore suspendim nga shkolla për 1 muaj, me obligim që ai të transferohet në një shkollë tjetër. Mirëpo, vendimi është bërë i pa ekzekutueshëm për shkak se nxënësi nuk është pranuar në asnjë shkollë tjetër për ndjekjen e mësimin për atë periudhë. Pas hetimeve, Avokati i Popullit ka gjetur se vendimi i shkollës ka qenë pa bazë ligjore dhe ka konstatuar se ai i shkel të drejtat dhe liritë e njeriut për faktin se është në kundërshtim me parimet bazë të funksionimit të shtetit demokratik, siç është parimi i ligjshmërisë, parimi kushtetues i sundimit të ligjit dhe parimi i sigurisë juridike. Avokati i Popullit i ka rekomanduar komunës që urgjentisht të ndërmerri masat adekuate për trajtimin e nxënësit lidhur me mungesën e tij nga procesi mësimor dhe zëvendësimin e orëve të humbura si rrjedhojë e zbatimit të vendimit të paligjshëm.

Dhuna dhe gjendja e sigurisë në shkolla

Dhuna vazhdon të mbetet e pranishme në jetën e fëmijëve. Ajo cenon realizimin e të drejtave të fëmijëve me pasoja afatgjata të dëmshme në shëndetin dhe vetëvlerësimin e tyre. LMF jep një përkufizim të detajuar dhe gjithëpërfshirës të dhunës.⁹³ Fëmijët janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj dhunës për shkak të moshës së tyre dhe se shpesh dhuna ndaj tyre kryhet në duart e të rriturve, përfshirë personat të cilët fëmijët duhet të ju besojnë dhe varen nga ta. Fëmijët e vegjël sidomos kanë mungesë të njohurive për të drejtat e tyre dhe nuk mund të flasin për të mbrojtur veten.

Gjatë kësaj periudhe raportuese Avokati i Popullit ka zhvilluar hetime për tri raste, të hapura sipas detyrës zyrtare.⁹⁴ Njëri nga këto raste kishte të bënte me pohimet e “Gazetës Express”, në shkrimin me titull: *“Mësuesi nga Ferizaj e godet pa ndalur me shuplaka nxënësin në orë të mësimin”*. Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit u njoftua se autoritetet shkolllore, përkatësisht Drejtoria Komonale e Arsimit në Ferizaj ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për trajtimin e rastit, përkatësisht lidhur me rastin ndaj mësimitdhënësi janë shqiptuar masat disiplinore. Edhe në një rast tjetër lidhur me shkrimin e gazetës *“Bota Sot”*, me titullin: *“Një muaj paraburgim ndaj mësuesit që dyshohet se keqpërdori seksualisht 27 nxënës në Gjakovë”*. Mësimitdhënësi dyshohet se ka ngacmuar seksualisht 27 nxënës të një klase, ndaj të cilit është ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Gjakovë. Pas hetimeve të kryera rezultoi se autoritetet komunale, policore dhe prokuroriale, kanë ndërmarrë

⁹²A. nr. 877/2019.

⁹³Shih LMF, neni 3 (1.22): *“Dhunë - të gjitha format fizike dhe/ose emocionale të keqtrajtimin, shpërdorimit seksual, neglizhencës apo trajtimin neglizhent, shfrytëzimit komercial ose çdo lloj shfrytëzimi që ka si rezultat dëmtimin e mundshëm apo të vërtetë të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit apo të dinjitetit të fëmijës në kontekst të raportit të përgjegjësisë, besimit, apo forcës”*. Më tutje *“Dhunë, përfshin por nuk kufizohet në veprat apo veprimet e qëllimshme që i bën një person personit tjetër, si: përdorimi i forcës fizike, presioni psikik, çdo veprim që shkakton apo kanos dhembjen fizike dhe psikike; shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale, cenimit të dinjitetit; sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat; ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë; përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së personit tjetër; vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike”*.

⁹⁴Ex officio nr. 715 /2019, ex officio nr. 56/2019 dhe ex officio nr. 85/2019.

veprimet e nevojshme dhe se rasti është duke u trajtuar ne Gjykatë. Autoritetet komunale njoftojnë IAP se mësimdhënësit i është shkëputur marrëdhënia e punës.

LMF shprehimisht parasheh se personat e dënuar për abuzim seksual dhe shfrytëzim të fëmijës iu ndalohet të ushtrojnë profesione që përfshijnë çdo formë kontakti me fëmijët.⁹⁵ Po ashtu, ligji parasheh nxjerrjen e aktit nënligjor për rregullat dhe procedurat për mbajtjen e bazës së të dhënave me ADN-të e personave të dënuar për veprat penale kundër integritetit seksual. Në bazë të së cilës, Ministria përkatëse për arsim dhe drejtoritë përkatëse komunale për arsim duhet të sigurojnë që personat e dënuar për abuzim seksual apo shfrytëzim të fëmijës të mos përfshihen në sistemin arsimor.

Gjithashtu, një rast tjetër kishte të bënte me pretendimet në shkrimin e portalit "Indeks Online", me titullin: *"Polici i cili mori mirënjohje për punën, shfrytëzoi seksualisht dhe e detyroi të abortojë 16 vjeçarën ..."*. Sipas portalit, një nxënëse nën moshën 16-vjeçare, kishte shkuar në polici për të denoncuar profesorin e saj për marrëdhënie seksuale, por, në vend të gjetjes së ndihmës, ajo është shfrytëzuar seksualisht nga polici i cili ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare dhe pozitën. Pas hetimeve të kryera rezultoi se autoritetet policore dhe prokuroriale, kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe se rasti është duke u trajtuar në Gjykatë. Vajzat janë veçanërisht të rrezikuara nga dhuna si rrjedhojë e diskriminimit dhe dhunës së përhapur në baza gjinore. Trajtimi i këtij rasti dhe rasteve të ngjashme kërkon një qasje të ndjeshme gjinore dhe të bazuar në të drejtat e fëmijëve. IAP do të vazhdojë të monitorojë rrjedhën e këtyre proceseve gjatë vitit të ardhshëm për të siguruar se mirëqenia e fëmijës dhe interesi i tij janë në rend të parë.

Fëmijët me aftësi të kufizuara

Fëmijët me aftësi të kufizuara janë ende duke përjetuar vështirësi serioze dhe përballen me pengesa për gëzimin e plotë të të drejtave të përcaktuara me ligj. Fëmijët me aftësi të kufizuara i përkasin një prej grupeve më të rrezikuara të fëmijëve. Kjo rrezikshmëri dallon varësisht nga ndërveprimi i faktorëve të ndryshëm siç janë gjinia, banimi në zona rurale, etniciteti apo të qenit fëmijë në situatë rruge. Vajzat me aftësi të kufizuara janë shpesh edhe më të rrezikuara për shkak të diskriminimit gjinor. Andaj vëmendje e veçantë duhet të ju kushtohet atyre për të marrë masat e nevojshme, sidomos në aspektin e mbrojtjes nga dhuna në baza gjinore, për të siguruar që ato të kenë qasje në të gjitha shërbimet dhe përfshihen plotësisht në arsim e shoqëri.

Edhe Kosova po synon që të zbatojë një model social të aftësisë së kufizuar ku pengesa nuk shihet në vetë aftësinë e kufizuar, por në një kombinim të pengesave sociale, kulturore, dhe fizike me të cilat ndeshen fëmijët me aftësi të kufizuara në jetën e tyre të përditshme. Një përkufizim i tillë është përfshirë edhe në LMF-në, i cili përmban disa dispozita të veçanta që adresojnë mbrojtjen e fëmijës me aftësi të kufizuara.⁹⁶ Pavarësisht kësaj mbrojtjeje ligjore dhe dispozitave të shumta të tjera të shpërndara në ligje të ndryshme, hartimi i legjislacionit nuk është i mjaftueshëm që fëmijët të gëzojnë këto të drejta por nevojitet zbatim i duhur i tyre.

Mungesa e të dhënave vazhdon të mbetet problematike. Mbledhja e të dhënave të sakta dhe të plota të cilat pasqyrojnë gjendjen aktuale të fëmijëve me aftësi të kufizuara është qenësore për krijimin e

⁹⁵LMF, neni 58.

⁹⁶LMF, neni 42 (2.9) dhe neni 46.

politikave efektive dhe shpërndarjen e burimeve të nevojshme për financimin e programeve. Të rriturit me dhe pa aftësi të kufizuar gjatë vendosjes së politikave dhe marrjes së vendimeve në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të sigurojnë që fëmijët të dëgjohen në të gjitha procedurat që prekin ata dhe që pikëpamjet e tyre të respektohen në përputhje me zhvillimin gradual të aftësive të tyre. Fëmijëve duhet t'u sigurohet çfarëdo mënyre e komunikimit që ju nevojitet atyre për të lehtësuar shprehjen e pikëpamjeve të tyre.

Gjatë këtij viti Avokati i Popullit ka pranuar tri ankesa lidhur me fëmijët me aftësi të kufizuara. Njëri rast kishte të bënte me mohimin e së drejtës për shkollim të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim (QBMK) “Xheladin Deda” në Pejë për të cilin Avokati i Popullit ka lëshuar edhe një Letër rekomandim.⁹⁷ Ankuesi kishte pohuar se fëmija i tij nuk është duke vijuar mësimin në këtë institucion në mungesë të shërbimeve të kujdestarisë/asistencës gjatë ndërrimit të natës. Gjatë takimeve dhe korrespondencës me përfaqësuesit e QBMK-së, Avokati i Popullit është njoftuar se si rrjedhojë e rritjes së numrit të nxënësve në këtë vit shkollor me 13 fëmijë me dëmtime të rënda dhe të shumëfishta është rritur nevoja për shtim të personelit ngase personaliteti i deri atëhershëm nuk kishte qenë i mjaftueshëm. Përfaqësuesi po ashtu, ka njoftuar se MASHT e ka themeluar një komision për shqyrtimin e vendeve të punës dhe gjetjen e mundësisë së plotësimit të nevojave për fëmijët në këtë institucion. Mirëpo, sipas tij, edhe pas disa takimeve, nuk është arritur ndonjë zgjidhje. Pas hetimeve, Avokati i Popullit ka konstatuar se në QBMK nuk ofrohen shërbime në pajtim me dispozitat ligjore dhe se kjo përbën shkelje të të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Avokati i Popullit i ka rekomanduar MASHT t'i ndër marrë masat përkatëse për ofrimin e shërbimeve të kujdesit 24 orësh, për fëmijët e vendosur në qendër.

Rasti tjetër kishte të bënte me vlerësimin profesional të fëmijës. Fillimisht ankesa ishte drejtuar kundër Komunës së Prishtinës (KP), përkitazi me çështjen e sigurimit të asistentit personal për mësimnxënie dhe sigurimin e transportit për fëmijën me aftësi të kufizuar. Avokati i Popullit kishte filluar hetimet dhe KP kishte shprehur gatishmëri për sigurimin e transportit. Ndërsa lidhur me sigurimin e asistentit personal KP ishte arsyetuar se kjo nuk është e mundur në mungesë të buxhetit. Më pastaj, pavarësisht shprehjes se gatishmërisë si nga KP dhe prindërit e fëmijës, ankuesja kishte hasur në vonesa nga komuna lidhur me vlerësimin profesional të fëmijës. Si rezultat, Avokati i Popullit kishte lëshuar një Letër rekomandim.⁹⁸ KP kishte kthyer përgjigje se tregon gatishmëri që procesi i vlerësimit të kryhet.

Rasti i fundit mbetet ende në hetime, dhe ka të bëjë me vendimin e Doganës së Kosovës, me të cilin ankuesit i është refuzuar kërkesa për lirimin nga pagesa e detyrimeve importuese për automjetin e kujdestarit të personave me aftësi të kufizuara.

Fëmijët në situatë rruge

Në maj të këtij viti, Avokati i Popullit ka publikuar raportin me rekomandime të iniciuar ex-officio dërguar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe

⁹⁷A. nr. 245/2019, lidhur me mohimin e së drejtës për shkollim të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim “Xheladin Deda” në Pejë, 7 maj 2019.

⁹⁸A. nr. 888/2017 lidhur me vlerësimin profesional të fëmijës me aftësi të kufizuara, 15 prill 2019.

Teknologjisë (MASHt) dhe Policisë së Kosovës, lidhur me fëmijët në situatë rruge.⁹⁹ Duke u bazuar në hetimet e kryera nga Avokati i Popullit si dhe përvojën me fëmijët në situatë rruge, ky raport analizoi dukurinë e fëmijëve në situatë rruge, identifikoi shkeljet e të drejtave të fëmijëve dhe dha rekomandime konkrete drejtuar institucioneve përgjegjëse për t'i ndërmarrë veprimet përkatëse në këtë fushë. Raporti ka vënë në pah se përkundër dispozitave ligjore të shpërndara nëpër ligje të ndryshme që kanë për qëllim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe aplikueshmërisë së drejtpërdrejtë të KDF-së, gjendja e këtyre fëmijëve nuk ka ndryshuar shumë nga vitet e kaluara.

Ndonëse hulumtimet nga organizatat tregojnë se varfëria dhe shkaqet e rënda ekonomike janë disa nga arsyet pse fëmijët gjenden në situatë rruge, në Kosovë vazhdon të mbetet problem mungesa e të dhënave. Të dhëna të plota mungojnë lidhur me numrin e fëmijëve duke përmbajtur: moshën, përkatësinë, gjininë, gjendjen ekonomike dhe shkaqet të cilat i shtojnë në situatë rruge, në mënyrë që të hartohen politika sa më të suksesshme dhe efektive për të adresuar këtë dukuri. Avokati i Popullit i ka rekomanduar MPMS-së që në bashkëpunim me Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK) t'i mbledhë këto të dhëna. Gjithashtu, MPMS-ja së bashku me komunat duhet t'i forcojë dhe t'i zhvillojë kapacitetet për ofrimin e shërbimeve cilësore për fëmijët dhe familjet e fëmijëve që jetojnë dhe/ose punojnë në rrugë, duke përfshirë këtu edhe ndarjen e buxhetit të qëndrueshëm. Qendrat për punë sociale kanë raportuar se ata vetëm pjesërisht i përmbushin standardet minimale për ofrimin e shërbimeve fëmijëve në punë, për arsye se kanë mungesë të buxhetit dhe të punëtorëve të trajnuar.¹⁰⁰ Më tutje, MPMS-ja duhet të krijojë programe të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta për fëmijët në situatë rruge, pa u kufizuar në qendrat e kujdesit ditor për rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre. Një shembull i mirë në këtë drejtim është hapja e Qendrës për Qëndrim Ditor për fëmijët në situatë rruge nga Terre des Hommes dhe Komuna e Prishtinës. Qendra ofron një ambient të ngrohtë ku fëmijë kanë mundësinë të integrohen dhe përfitojnë nga shërbime të ndryshme, siç janë: shujtat ushqimore, lojërat edukative, socializimi e aktivitetet arsimore, si dhe këshillimi profesional. Kjo praktikë do të duhej të ndiqej edhe nga komunat e tjera.

Në anën tjetër, të dhënat ekzistuese nga Policia e Kosovës tregojnë se një numër i konsiderueshëm i këtyre fëmijëve janë të përfshirë në kërkim lëmoshe dhe viktime të trafikimit të qenieve njerëzore, keqtrajtimit dhe braktisjes.¹⁰¹ Policia e Kosovës duhet t'i ndërmarrë veprimet përkatëse për identifikimin dhe largimin e fëmijëve nga rruga kur ata janë pjesë/viktima të rrjeteve kriminale që merren me trafikim dhe shfrytëzim të fëmijëve. Po ashtu, në rastet kur kemi të bëjmë me kthimin e fëmijëve në vendin e origjinës, duhet t'i bashkëpunojë dhe bashkërendojë aktivitetet me institucionet përkatëse për të siguruar kthimin e sigurt të tyre në përputhje me interesin më të mirë të fëmijëve.

Raporti i Avokati i Popullit ka konstatuar se fëmijët në situatë rruge janë të pambrojtur në shumë aspekte dhe se mirëqenia e tyre fizike, mendore, emocionale, shëndetësore dhe sociale është e rrezikuar. Rrjedhimisht, gjendja e tanishme e fëmijëve në situatë rruge përbën shkelje të të drejtave të fëmijëve dhe kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar të institucioneve shtetërore.

⁹⁹Ex officio 514/2016, në lidhje me çështjen e fëmijëve në situatë rruge.

¹⁰⁰Po aty, paragrafi 29.

¹⁰¹Po aty, paragrafi 39.

LMF-ja ka paraparë që qeveria, sipas propozimit të MPMS-së dhe të Ministrisë për Punë të Brendshme, të nxjerrë një akt nënligjor që rregullon procedurat efektive për identifikimin, raportimin, referimin, shfrytëzimin, neglizhencën dhe abuzimin e fëmijës si dhe për mbrojtjen e fëmijës në situatë rruge.¹⁰² Ky akt nënligjor duhet të nxirret deri në një vit pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Me 17 nëntor, Avokati i Popullit mbajti takim me përfaqësuesit e policisë, MPMS-së dhe QPS-së, për t'u informuar lidhur me adresimin e rekomandimeve. Policia e Kosovës ka njoftuar Avokatin e Popullit se është duke bërë zbatimin e rekomandimeve. Fillimisht, policia ka dy plane operative në nivel vendi, ku përfshihet tërë territori i Kosovës dhe përmes së cilave janë identifikuar fëmijët në rruge. Këto të dhëna janë ndarë sipas gjinisë dhe kallëzimet përkatëse janë ngritur kundër prindërve për veprën "Keqtrajtimi dhe braktisja e fëmijëve". Sipas policisë, nuk kanë pasur raste me veprën e trafikimit të fëmijëve në situatë rruge. Ata gjithashtu kanë organizuar aktivitete parandaluese, duke hartuar në bashkëpunim me OSBE-në një broshurë në tri gjuhë, e cila, përveç tjerash, përfshin edhe çështjen e fëmijëve në situatë rruge. Gjithashtu, në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar janë mbajtur ligjërata në 10 komuna dhe takime me 1730 pjesëtarë të komuniteteve të ndryshme dhe me secilin është trajtuar edhe kjo dukuri.

Ndërsa MPMS-ja ka njoftuar se ka ndërmarrë disa veprime duke nënshkruar marrëveshje me kryetarë të komunave, me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të formave të rënda të punës. Gjithashtu janë nënshkruar marrëveshje me OJQ dhe me projekte të Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe se janë duke u hartuar forma standarde për ofrimin e shërbimeve për fëmijët në situatë rruge. MPMS-ja ka hartuar koncept-dokumentin për ndihma sociale, i cili ende nuk është miratuar, por që parasheh shtesa për fëmijë pa kritere diskriminuese. Ndërsa është miratuar koncept-dokumenti për financat e pushtetit lokal, ku është përcaktuar krijimi i grantit specifik për shërbimet sociale që do t'u mundësonte QPS-ve dhe komunave të prioritojnë kategoritë sociale që janë në nevojë dhe të krijojnë shërbime dhe të kontraktjnë shërbime përmes organizatave të ndryshme. Lidhur me mungesën e të dhënave, MPMS-ja ka njoftuar Avokatin e Popullit se në bashkëpunim me ASK-në kanë arritur që në kuadër të anketës MICS të përfshihet edhe një formular i veçantë, i cili do të shërbejë për grumbullimin e të dhënave më të plota të moshës, origjinës dhe shkaqeve që i shtyjnë fëmijët në situatë rruge. MASHT-i nuk ishte prezent, por i është përgjigjur me shkrim Avokatit të Popullit. Nga të dhënat e marra nga MASHT-i vërehet se janë duke bërë përpjekje të vazhdueshme për të trajtuar rekomandimet që të kenë rezultate në rritjen e monitorimit dhe mbikëqyrjes nga inspektorati, rritjes së raportimit cilësor nga shkollat dhe zvogëlimin e braktisjes, duke siguruar gjithëpërfshirjen e fëmijëve në arsimin cilësor dhe zhvillimin e tyre të plotë.

Të rinjtë/fëmijët viktimë të abuzimit me substanca narkotike

KDF-ja parasheh obligime për shtetet për të mbrojtur fëmijët nga përdorimi i paligjshëm i drogave narkotike dhe i lëndëve psikotropike dhe për të mos lejuar që fëmijët të përdoren për prodhimin dhe trafikimin e paligjshëm të këtyre lëndëve. LMF-ja gjithashtu adreson këtë çështje në dy nene: mbrojtja e fëmijës nga substancat e dëmshme dhe të ndaluara dhe puna e ndaluar për fëmijë.¹⁰³ Ligji parasheh

¹⁰² LMF, neni 26(6).

¹⁰³ LMF, neni 43 dhe 51 (2.3).

që masat e duhura mbrojtëse dhe parandaluese si dhe avokimi për të jetuar një jetë të shëndetshme, të lirë nga çdo lloj abuzimi me substanca narkotike, duhet të rregullohet me akt nënligjor.¹⁰⁴ Duke u bazuar në obligimet që rrjedhin nga LMF-ja dhe nga KDF-ja, institucionet duhet t'i ndërmarrin të gjitha masat qoftë legjislative, administrative, shoqërore apo edukative, për t'i mbrojtur fëmijët në këtë aspekt.

Në dhjetor, Avokati i Popullit publikoi raportin ex-officio në lidhje me përdorimin e substancave narkotike nga fëmijët.¹⁰⁵ Raporti me rekomandime i drejtohet Ministrisë së Shëndetësisë, Policisë së Kosovës, MPMS-së, MASHT-it, Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK) dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK). Qëllimi i këtij raporti ishte vlerësimi i gjendjes aktuale në Kosovë rreth përdorimit të substancave narkotike nga fëmijët dhe adresimi i rekomandimeve tek institucionet përkatëse, në mënyrë që t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme në parandalimin dhe në trajtimin e fëmijëve përdorues të substancave narkotike.

Avokati i Popullit është takuar me përfaqësues të OJQ-së “Labirinth”, të Koalicionit të Organizatave për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF), me përfaqësuesit e MKRS-së, Policisë së Kosovës, me grupin ROR, MASHT dhe MSh. Po ashtu, Avokati i Popullit ka kërkuar të dhëna nga KPK-ja dhe nga KGjK-ja. Raporti rithekson se në Kosovë nuk ka studime gjithëpërfshirëse lidhur me përdorimin e substancave narkotike nga fëmijët, ndonëse ekzistojnë disa studime të pjesshme dhe shërbime parandaluese e rehabilituese që ofrohen nga OJQ-të. Sipas të dhënave ekzistuese nga OJQ “Labirinth”, në vitin 2018, mosha mesatare e fillimit të përdorimit të drogës ishte 16 vjeç. Kryesisht këta të rinj kishin filluar duke përdorur kanabis. Mosha mesatare e përdorimit të drogës së parë ka rënë dukshëm, përderisa në vitin 2007 ishte 21 vjeç.¹⁰⁶ Përdorimin e drogave nga të rinjtë e konfirmojnë edhe të gjeturat e Policisë së Kosovës, ku vetëm në periudhën prej tetor 2017 deri në tetor 2018 ishin arrestuar 150 nxënës gjatë patrullimeve rreth shkollave për mbajtje të marihuanës. Gjithashtu, policia ka konfiskuar 62.74 gr marihuanë brenda shkollës, 167.15 gr marihuanë në oborr të shkollës dhe 4 kg e 0.52 gr marihuanë në afërsi të shkollave. Numri më i madh i rasteve janë iniciuar në regjionin e Prishtinës, pasuar nga Ferizaj, Mitrovica, Gjilani, Peja, Prizreni dhe Gjakova. Policia ka njoftuar IAP-në se atë kanë mbajtur 417 ligjërata me nxënës lidhur me drogat dhe rreziqet e përdorimit të tyre.¹⁰⁷ Përderisa temat e substancave narkotike shtjellohen në kuadër të planprogrameve shkollore dhe aktivitete vetëdijesimi me nxënës, ka mangësi në raport me takimin me prindër për t'i informuar ata lidhur me parandalimin e konsumimit të këtyre substancave.

Përkundër të dhënave ekzistuese lidhur me përdorimin e këtyre substancave nga të rinjtë dhe prezencën e tyre në shkolla, Kosova ende nuk ofron shërbime të veçanta të rehabilitimit fizik për fëmijët viktime të abuzimit me narkotikë. Po ashtu, ka nevojë për zhvillimin e programeve të integritimit në përgjigje të nevojave në rritje të fëmijëve dhe familjeve të tyre. Avokati i Popullit ka konstatuar se mungojnë qendra të specializuara për trajtimin e të rinjve përdorues të substancave narkotike dhe mungesë të programeve përkatëse të vetëdijesimit dhe parandaluese, si dhe mungesë e shërbimeve dhe trajtimit të përdoruesve si për nga shtrirja gjeografike, ashtu edhe për nga cilësia. Po

¹⁰⁴ Po aty, neni 43.

¹⁰⁵ Ex officio nr. 489/2018 në lidhje me përdorimin e substancave narkotike nga fëmijët

¹⁰⁶ Po aty, paragrafi 18.

¹⁰⁷ Po aty, paragrafi 20.

ashtu mungon një bazë unike gjithëpërfshirëse e të dhënave, duke përfshirë edhe shkaqet që i shtyjnë fëmijët të përdorin substanca narkotike, llojin e tyre dhe rastet e dyshimta të vdekjeve nga to. Mungesë të të dhënave që i referohen veprave specifike penale nga Kapitulli i XXIII i Kodit Penal (Veprat penale të narkotikëve) kanë edhe KGJK-ja dhe KPK-ja.¹⁰⁸ Në mungesë të të dhënave është e pamundur të hartohen politika cilësore dhe efikase. Më tutje, punëtorët e QPS-ve kanë mungesë ekspertize për t'u marrë me këto raste. MSh-ja, Policia e Kosovës, MPMS-ja, MASht-i, KGJK-ja dhe KPK-ja respektivisht duhet t'i adresojnë rekomandimet e dala nga ky raport në pajtim me mandatin e tyre. Në dhjetor, IAP-ja mori përgjigje nga KGJK-ja për zbatim të rekomandimit për avancimin e bazës së të dhënave lidhur me vendimet gjyqësore që kanë të bëjnë me veprat penale specifike (jo vetëm me nene) nga Kapitulli XXIII i Kodit. KGJK-ja informoi se gjatë vitit 2018-2019 është vënë në zbatim Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL), përmes së cilës regjistrohen të gjitha lëndët në gjykatë, duke përfshirë edhe lëndët penale për të mitur. Tutje, në shkresën e pranuar nga KGJK-ja thuhet se ky organ gjatë vitit 2020 do të avancojë më tutje SMIL-in për të nxjerrë raporte edhe me të avancuara dhe me të dhëna më të detajuara, duke përfshirë edhe raporte të ndryshme që mund të dalin si kërkesa nga institucione apo nga organizata të ndryshme.

Të drejtat e fëmijëve në procedurat në organe gjyqësore dhe administrative

Edhe gjatë kësaj periudhe të raportimit, në IAP janë pranuar një numër i ankesave kundër gjykatave, që kanë të bëjnë me zvarritje të procedurës gjyqësore për të vendosur lidhur me kompensimin e dëmit për lëndimet e shkaktuara fëmijës në aksident komunikacioni, vërtetim atësie, besimin e fëmijëve në ruajtje dhe edukim, mosrealizimin e kontakteve personale të fëmijës me prindin dhe mospagimin e alimentacionit, si dhe ka monitoruar disa sosh me kërkesën e ankuesve.¹⁰⁹ Lidhur me çështjen e mospagimit të alimentacionit dhe mosrealizimin e kontakteve apo pamundësinë e realizimit të kontakteve të rregullta me fëmijë, në IAP janë pranuar ankesa edhe kundër qendrave për punë sociale (QPS).¹¹⁰ Në rastin e ankesave kundër gjykatave, Avokati i Popullit u është drejtuar gjykatave, prej të cilat ka kërkuar informata për veprimet e ndërmarra si dhe në disa raste ka konstatuar se ka pasur edhe shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Gjykatat do të duhej t'i ndërmerrnin të gjitha veprimet e nevojshme që rastet që kanë të bëjnë me fëmijë apo prekin të drejtat e fëmijëve të vendosen pa vonesa, brenda afateve të përcaktuara ligjore, në mënyrë që të mos dëmtohet apo rrezikohet shëndeti i fëmijëve, mirëqenia apo edhe jeta e tyre. Ato gjithashtu do të duhej t'i ndërmerrnin të gjitha veprimet që interesi më i mirë i fëmijëve të jetë parësor gjatë punës së tyre lidhur me fëmijët, përfshirë këtu edhe respektimin e së drejtës së fëmijëve për t'u dëgjuar, sipas neneve 3 dhe 12 të KDF-së. Ndërsa në rastin e ankesave kundër QPS-ve, Avokati i Popullit, pas hetimit të tri prej pesë ankesave të pranuar, ka konstatuar se QPS-të kanë ndërmarrë veprimet përkatëse.

Mbrojtja sociale dhe shëndetësore e fëmijëve

IAP-ja, gjatë kësaj periudhe raportuese, nga fusha e mbrojtjes sociale dhe shëndetësore e fëmijëve, ka filluar dhe hetuar gjashtë raste të reja, përfshirë edhe rastet sipas detyrës zyrtare. Rastet kishin të bënin,

¹⁰⁸ Po aty, paragrafi 53 (e)

¹⁰⁹ A. nr. 635/2019, A. nr. 547/2019, A. nr. 240/2019, A. nr. 26/2019.

¹¹⁰ A. nr. 700/2019, A. nr. 664/2019, A. nr. 703/2019, A. nr. 66 /2019, A. nr. 818/2019.

ndër të tjera, me: lirim nga tarifa doganore për kujdestarin e fëmijës me aftësi të kufizuar, dyshimin për ngacim seksual dhe dhunim si dhe kërkesën për ndihmën e psikologut për fëmijën e ankueses, i vendosur në Qendrën Korrektuese për të Mitur.

Në raportet e mëhershme, Avokati i Popullit ka theksuar se zbatimi i nenit 4 të Ligjit nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, ka shkaktuar që shumë familje në gjendje të rëndë materiale të mbesin edhe pa ndihmën sociale, të cilën e gëzonin deri në momentin kur fëmija mbush pesë vjet.¹¹¹ Pavarësisht faktit që janë bërë ndryshime në nenin 4 të këtij ligji, kjo në fakt nuk e ka përmirësuar gjendjen e familjeve të varfra, për faktin e kufizimit të moshës së fëmijëve. Për më tepër, kushtet e përcaktuara për ndihmë sociale, me dispozitat ligjore në fuqi, kanë ndikuar në keqësimin e gjendjes ekonomike të shumë familjeve, duke shkaktuar edhe pengesa dhe vështirësi në mirërritjen e fëmijëve dhe mirëqenien e familjeve në përgjithësi. Këto kushte në veçanti e vështirësojnë gjendjen tek familjet në rrethana të vështira socio-ekonomike, e kjo sidomos vlen për komunitetet e marginalizuara. Avokati i Popullit rithekson se neni 4 i këtij ligji, përtej çdo dyshimi, shkel interesin më të mirë të fëmijës, madje mungesa e ndihmës sociale për fëmijë dhe familje në nevojë kushtëzon dhe ndikon në shëndetin fizik dhe mental të fëmijës, si dhe në edukimin e në zhvillimin e mëtutjeshëm të tij. Avokati i Popullit ka konstatuar se neni 4 i ligjit është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me standardet ndërkombëtare, veçmas me KDF-në, e cila është drejtpërdrejt e zbatueshme në Republikën e Kosovës. Edhe në këtë vit, Avokati i Popullit rekomandon që Kuvendi i Republikës së Kosovës ta ndryshojë nenin 4, paragrafi 5, të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, në mënyrë që kufizimi i moshës pesëvjeçare të fëmijës të ngrihet në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, në pajtim me nocionin e termit “fëmijë” dhe në qëllim të përmbushjes së obligimeve kushtetuese. Sipas të dhënave të siguruar në takimin me përfaqësuesen e MPMS-së, më 17 nëntor, Avokati i Popullit është njoftuar se ministria ka draftuar koncept-dokumentin për ndihmat sociale, i cili eliminon këtë kriter diskriminues. Sidoqoftë, koncept-dokumenti ende nuk është miratuar.

Në dhjetor të vitit 2019, Avokati i Popullit ka publikuar raportin me rekomandime ex-officio, me të cilin vlerëson nëse ofrimi i shërbimeve sociale në Republikën e Kosovës është në pajtim me standardet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe jep rekomandimet specifike në drejtim të përmirësimit të gjendjes aktuale.¹¹² Raporti ka gjetur se punëtorët e asistencës sociale dhe të ndihmave ekonomike nuk janë punëtorë socialë, përjashtuar disa, dhe se një shumicë e konsiderueshme e tyre ka kryer vetëm shkollën e mesme. Gjithashtu, numri i tyre është i pamjaftueshëm për t'i kryer detyrat e QPS-ve, të parapara me ligj. Në veçanti, sa i përket fëmijëve, shumica e QPS-ve nuk janë në gjendje ta përmbushin obligimin ligjor rreth Organit të Kujdestarisë. Asnjë QPS nuk ka psikolog të licencuar, i cili mund të japë mendimin profesional për besimin e fëmijëve për çështjet e adoptimit si dhe për fusha të tjera. Po ashtu, QPS-të nuk përfshihen në hartimin e buxhetit komunal dhe komunat nuk parashohin mjete për mbulim të nevojave për fëmijë, për prindër vetushqyes, për viktime të trafikimit etj. Veçanërisht problematike është mungesa e hapësirës/dhomës së kontaktimit për realizimin e kontaktit fëmijë-prindër për rastet kur prindërit janë të ndarë apo të shkurorëzuar, ose që janë në

¹¹¹ Raporti Vjetor 2018, fq. 82.

¹¹² Ex-officio nr. 59/2019 lidhur me vlerësimin e sistemit të ofrimit të shërbimeve sociale në Kosovë, Prishtinë, 17 dhjetor 2019.

proces të ndarjes apo të shkurorëzimit, si dhe në rastet e dhunës në familje. Nga 38 QPS, 22 prej tyre nuk kanë fare dhomë kontaktimi. Meqë vendimi i gjykatës obligon që realizimi i kontaktit të kryhet brenda hapësirës së qendrës, për ta kryer detyrën e tij, shumë shpesh ndodh që punëtori duhet të qëndrojë bashkë me prindin dhe me fëmijën gjatë kohës së zhvillimit të kontaktit, apo ta lirojë zyrën që ata të qëndrojnë së bashku. Në disa qendra, punëtorët shumë herë detyrohen që ta vendosin fëmijën me prindin në një hapësirë ku gjendet ndonjë karrige dhe asgjë tjetër, apo në dhoma pa ngrohje dhe pa kushte minimale për qëndrim, qoftë 1 orë apo më gjatë, apo detyrohen të mos mbahen kontaktimet e plota, për shkak të kushteve jo të mira. Raporti konstaton se QPS-të janë shndërruar në institucione administrativo-teknike, për shkak të mungesës së stafit profesional dhe mungesës së objekteve përcjellëse për ofrim të shërbimeve adekuate. Ka mungesë të mbikëqyrjes, të planifikimit, të financimit dhe të avancimit të shërbimeve në përputhje me nevojat e komunave. Avokati i Popullit i ka rekomanduar qeverisë së Kosovës, MPMS-s dhe komunave që t'i adresojnë problemet e identifikuaera.

Drejtësia për të mitur

Drejtësia për të mitur në Kosovë rregullohet me Kodin e Drejtësisë për të Mitur (KDM), i cili është miratuar në Kuvend në shtator të vitit 2018. KDM-ja rregullon procedurën penale për të miturit, duke e siguruar realizimin e interesit të tyre më të mirë bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, ndalimin e diskriminimit në çfarëdo baze si dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve që të shprehin lirshëm mendimin e tyre.¹¹³ Po ashtu, Kodi ka për qëllim që të evitojë kufizimin e lirisë personale të të miturve në masë sa më të madhe të mundshme dhe promovon qasjen e drejtësisë miqësore. Kodi është i drejtuar në dhënien e përparësisë të zbatimit të masave edukuese përballë dënimit me burgim, me fokus në dhënien përparësi edukimit dhe risocializimi, si dhe aftësisimit dhe specializimit përmes një qasjeje shumëdisiplinore dhe bashkëpunimit institucional.¹¹⁴ Qasja në sistemin arsimor është veçanërisht e rëndësishme për ta realizuar risocializimin dhe riintegrimin e të miturve në shoqëri.

Me gjithë ndryshimet e sjella nga Kodi i ri, gjatë analizës së tij, Avokati i Popullit ka vërejtur kundërthënie në pjesën e dispozitave kalimtare dhe përfundimtare, të cilat krijojnë zbrazëti dhe pasiguri juridike. Si rrjedhojë, në prill të vitit 2019, Avokati i Popullit u është drejtuar me një opinion¹¹⁵ deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, anëtarëve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit që, në pajtim me Ligjin për Nisma Legjislative, ta propozojnë ndryshimin e dispozitave kalimtare të KDM-së.¹¹⁶ Po ashtu i ka dërguar edhe një Letër rekomandimi për këtë çështje kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

¹¹³ Republika e Kosovës, Kodi nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, 2018, neni 1.

¹¹⁴ Po aty.

¹¹⁵ Opinion i Avokati të Popullit ex officio nr. 67/2019 në lidhje me hyrjen në fuqi dhe zbatimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur me propozim për Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, prill 2019.

¹¹⁶ Republika e Kosovës, Ligji nr. 04/-L-025 për Nisma Legjislative, neni 5.

Neni 140 i Kodit të ri ka përcaktuar se me hyrjen në fuqi të tij pushon së vlefturi Kodi i vjetër i vitit 2010. Ndërsa neni i mëposhtëm 141 krijon një praktikë legjislative të pazakontë: “*Ky Kod hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa fillon të zbatohet gjashtë (6) muaj nga dita e hyrjes në fuqi.*”¹¹⁷ Kodi i ri është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më datën 18 tetor 2018 dhe atëherë Kodi ka hyrë në fuqi pas 15 ditësh, më 2 nëntor 2018. Por sipas së njëjtës dispozitë i bie që zbatimi i tij të fillojë më 2 maj 2019. Për pasojë është krijuar një rrethanë ku për gjashtë muaj, nga data 2 nëntor 2018 deri më 2 maj 2019, nuk zbatohen dispozitat e asnjëit prej kodeve dhe se gjatë kësaj periudhe nuk ka ekzistuar një bazë ligjore për procedimin e rasteve penale, si dhe zbatimin e masave të dënimeve ndaj të miturve. Kjo ka qenë shqetësuese për Avokatin e Popullit, sidomos marrë parasysh ndjeshmërinë e çështjeve të cilat i rregullon Kodi. Në fund, IAP-ja ka rekomanduar dy alternativa legjislative si zgjidhje praktike: të përcaktohet se Kodi i vjetër zbatohet deri më 2 maj 2019; ose të përcaktohet zbatimi retroaktiv i Kodit të ri për periudhën nga 2 nëntor 2018. Avokati i Popullit ka favorizuar aplikimin e alternativës së parë, pasi që një zgjidhje e tillë po ashtu respekton parimin e veprimit retroaktiv të ligjit penal duke pasur konsideratë ekzistimin e një kohe të arsyeshme nga momenti i miratimit të Kodit të ri deri në fillimin e zbatimit (*vocatio legis*). Fatmirësisht, pas ngritjes së kësaj çështjeje nga Avokati i Popullit, Komisioni ka iniciuar procesin për ndryshimin e tij. Në mbledhjen e mbajtur më datë 10.4.2019 ka vendosur që të hartojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit nr. 06/L-006 të Drejtësisë për të Mitur dhe të njëjtin e ka proceduar për mendim në qeveri në pajtim me Rregulloren e Kuvendit.

Në pajtim me mandatin e tij, Avokati i Popullit ka realizuar vizita në Qendrën Edukativo-Korrektuese dhe Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan dhe ka pranuar ankesa lidhur me të drejtat e të miturve.

Gjatë vizitave në Qendrën Edukativo-Korrektuese dhe Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan, Avokati i Popullit ka monitoruar zbatimin e të drejtave të personave të mitur dhe ka dalë me rekomandime përkatëse për përmirësimin e punës së tyre. Lidhur me Qendrën Edukativo-Korrektuese, Avokati i Popullit i ka rekomanduar MD-së që ushqimi për të miturit të jetë i bollshëm dhe i përshtatshëm, të funksionalizohen kabinetet të cilat ende nuk janë funksionale dhe të angazhohen trajnerët adekuatë për punë në këto kabinete.¹¹⁸ Ndërsa për Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur i ka rekomanduar MD-së që t’i përmirësojë kushtet e akomodimit në pavijonet ku mbahen të miturit e paraburgosur dhe në pavijonet e tjera dhe të zbatohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale sa i përket llogaritjes së stazhit të beneficuar për zyrtarët korrektues.¹¹⁹

Në vitin 2018, Avokati i Popullit kishte pranuar dy ankesa lidhur me pamundësimin për dy të mitur (një vajzë dhe një djalë) për vazhdimin e studimeve universitare gjatë vuajtjes së dënimit në Qendrën Korrektuese në Lipjan.¹²⁰ Këto ankesa kishin nxjerrë në pah boshllëkun ligjor në adresimin e kësaj

¹¹⁷ Kodi nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, neni 141.

¹¹⁸ Raport me rekomandime i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës për vizitën në Qendrë Edukativo-Korrektuese në Lipjan, Prishtinë, 26 gusht 2019.

¹¹⁹ Raport me rekomandime i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës për vizitën në Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan, Prishtinë, 24 maj 2019.

¹²⁰ Raporti vjetor 2018, fq. 83.

çështjeje dhe pamundësinë për personat e privuar nga liria për ta realizuar të drejtën e tyre për arsim të garantuar nga Kushtetuta, aktet ndërkombëtare dhe ligjet përkatëse. Andaj, Avokati i Popullit iu ka drejtuar MASHT-it dhe MD-së me rekomandime për të nxjerrë një akt nënligjor në pajtim me Ligjin nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe me Ligjin nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.¹²¹ Ky akt do të duhej ta sqaronte me përpikëri mënyrën e realizimit të së drejtës për arsimim parauniversitar të personave të mitur dhe madhorë që janë në vuajtje të dënimit, për t'ua mundësuar atyre realizimin e së drejtës në arsim. Avokati i Popullit, edhe gjatë vitit 2019, nuk ka marrë përgjigje lidhur me këtë çështje dhe një akt i tillë nuk është hartuar ende.

Për vitin 2019, Avokati i Popullit ka pranuar po ashtu tri ankesa lidhur me drejtësinë për të mitur.¹²² Njëra ankesë kishte të bënte me pakënaqësinë e palës me vendimin për dënimin e fëmijës, përkatësisht caktimin e masës korrektuese. Pas hetimeve disa mujore dhe takimeve me të miturin dhe institucionet relevante, pala është këshilluar për të drejtën në ankesë lidhur me aktvendimin e gjykatës. Ndërsa lidhur me rastin e dytë, ankesa kishte të bënte me moszbatimin e KDM-së dhe zbatimin e gabuar të Kodit Penal. Pas hetimeve, Avokati i Popullit ka konstatuar se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të fëmijëve, ngase personi kishte mbushur 18 vjet kur është kryer vepra penale. Rasti i tretë kishte të bënte me të drejtat e të miturit në Qendrën Korrektuese për qasje në shërbime shëndetësore të psikologut. Pas hetimeve u konstatua se i mituri kishte në fakt qasje tek psikologu dhe kishte marrë trajtimin e duhur për gjendjen e tij.

Detyrimet pozitive të shtetit lidhur me të drejtën për jetë

Në dhjetor të vitit 2019, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime ex-officio që kishte për qëllim të tërheqë vëmendjen e institucioneve publike për detyrimet pozitive të shtetit lidhur me të drejtën për jetë në rastin e K. V., të cilit i është marrë jeta nga një person tjetër.¹²³ Këto detyrime janë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe me nenin 2 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Gjithashtu, raporti vlerëson efektshmërinë e veprimeve të ndërmarra nga institucionet. Pas zhvillimit të hetimeve dhe pas rishikimit të legjislacionit përkatës, instrumenteve ndërkombëtare dhe dokumentacionit të çështjes, Avokati i Popullit ka konstatuar se ka pasur shkelje të të drejtave të fëmijëve. Prokuroria, policia dhe QPS-ja nuk i kanë përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore për mbrojtjen e jetës së viktimës. Autoritetet përgjegjëse ishin në dijeni për ekzistimin e rrezikut real kundër fëmijës viktimë e ndjeshme e abuzuar seksualisht dhe dështuan t'i ndërmarrin masat për mbrojtjen e jetës së tij. Avokati i Popullit ka konstatuar një sërë shkeljesh të procedurës dhe dispozitave, siç është dështimi i prokurorisë në informimin e mbrojtësit të viktimave, mospërfshirja e Organit të Kujdestarisë, si organ komunal profesional për çështjen sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të të rriturve, si dhe zvarritjen e procedurave. Përderisa babi i të dyshuarit dhe nëna e viktimës ishin intervistuar dhe kishin dëshmuar në polici për kryerjen e veprës penale, prej kur është njoftuar prokuroria, i është dashur gjashtëdhjetë e tri (63) ditë të intervistohet i dyshuari. Po ashtu, në dokumentacionin e çështjes nuk pasqyrohet e as dëshmohet

¹²¹Po aty, fq. 84.

¹²²A. nr. 38/2019; A. nr. 814/2019; A. nr. 356/2019.

¹²³Ex officio nr. 567/2019, në lidhje me detyrimet pozitive të shtetit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 2 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në rastin e K.V., Prishtinë, 6 dhjetor 2019.

asnjë veprim procedural-ligjor se i dyshuari është ndalur apo arrestuar, si dhe asnjë nga veprimet e tjera ligjore në dispozicion të prokurorisë nuk janë shfrytëzuar. Situata cilësohet edhe më e rëndë duke u nisur nga fakti se i dyshuari e kishte pranuar fajësinë dhe se ndaj tij ishin referuar një numër i madh i rasteve në prokurori për vepra të ndryshme penale dhe ndaj të njëjtit ishin ngritur pesëmbëdhjetë (15) aktakuza. Në anën tjetër, viktima dhe familja e tij nuk kishin pranuar asnjë shërbim psikologjik, përpos një seance prej 25 minutash për fëmijën dhe atë pas dyzet e tri (43) ditësh. Viktima jo vetëm se ishte fëmijë që e bën atë viktimë të ndjeshme, por ishte fëmijë në situatë rruge, në një familje të komunitetit ashkali, me gjendje të rëndë ekonomike, me asistencë sociale, familje e cila më herët kishte pasur dhunë në familje. Të gjitha këto rrethana e rëndojnë situatën dhe rrisin obligimet e institucioneve për të vepruar. Avokati i Popullit i ka rekomanduar prokurorisë të iniciojë hetimet e brendshme dhe se rastet e tilla duhet të trajtohen me urgjencë dhe në mënyrë efektive. Ndërsa policisë i ka rekomanduar ngritjen e kapaciteteve profesionale jo vetëm në të drejtën në jetë, por edhe për hetime të rasteve të dhunës seksuale kundër fëmijëve. MPMS-ja në bashkëpunim me komunën duhet t'i zhvillojë kapacitetet e QPS-së në ofrimin e shërbimeve profesionale në raste të tilla, të sigurojë psikolog në qendër dhe të ofrojë trajnime për stafin lidhur me qasjen e bazuar në të drejta të fëmijëve.

IV. Barazia para ligjit

Avokati i Popullit është mekanizëm i barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim. Përveç pranimit dhe hetimit të ankesave dhe mbrojtjes së personave në rastet konkrete të diskriminimit, Avokati i Popullit gjithashtu është i autorizuar që të hetojë dhe veprojë me vetiniciativë *ex-officio*, kur ekziston dyshimi i bazuar se kemi të bëjë me diskriminim.

Sipas Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, Avokati i Popullit ka rol të gjerë në promovimin e mbrojtjes nga diskriminimi. Në këtë kuptim, Avokati i Popullit ka zhvilluar takime me Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, përkitazi me zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Ligjit për Barazi Gjinore. Gjithashtu, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit kanë qenë pjesë e vlerësimit *Ex post* të Ligjit 05/L-020 për Barazi Gjinore, i cili ishte i organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore.

Në përputhje me kompetencat që burojnë nga Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, për bashkëpunim me partnerët socialë, me organizatat joqeveritare dhe me mekanizmat relevantë të vendeve të tjera, Avokati i Popullit ka realizuar takime të rregullta. Po ashtu, Avokati i Popullit ka mbajtur takime edhe me OJQ, të cilat mbrojnë barazinë gjinore, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, komunitetet LGBTI etj.

Me qëllim të promovimit të barazisë si dhe reagimit ndaj situatave diskriminuese, në raport me sjelljet e paligjshme ndaj individëve të komunitetit LGBTI, Avokati i Popullit ka në procedure hartimin e një doracakut për mbrojtje nga diskriminimi.

Në takimin e tretë rajonal midis avokatëve të popujve dhe komisionarëve për mbrojtje nga diskriminimi të Shqipërisë, Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut, i mbajtur në Vlorë më 31 tetor deri më 1 nëntor 2019, u formalizua bashkëpunimi përmes Memorandumit të Bashkëpunimit, ku palët nënshkruese u pajtuan që ta shtojnë dhe ta intensifikojnë bashkëpunimin, shkëmbimin e përvojës dhe ndihmën reciproke.

Gjatë këtij viti raportues, Avokati i Popullit ka trajtuar çështjet në vijim:

- ka nxjerrë Opinion për Komisionin e Pavarur për Media në lidhje me sigurimin e qasjes në informim për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara të dëgjimit, në kuadër të debateve televizive për zgjedhjet nacionale të vitit 2019;
- është paraqitur në cilësinë e mikut të gjykatës në 5 raste të hetuara;
- u është drejtuar institucioneve përgjegjëse me 28 rekomandime nëpërmjet raporteve në 7 raste;
- ka parashtruar 2 padi për çështje të diskriminimit;
- ka realizuar 13 vizita në vendbanimet e komuniteteve rom, egjiptian dhe ashkali;
- ka mbajtur 4 ligjërata për persona me aftësi të kufizuara, gratë në Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan, si dhe gratë në politikë.

Paraqitja e raporteve, e rekomandimeve, e opinioneve, paraqitja në cilësinë e mikut të gjykatës *amicus curiae*,¹²⁴ qoftë në ankesat individuale të parashtruara tek Avokati i Popullit apo në raste e trajtuara sipas detyrës zyrtare, ka krijuar një praktikë të rëndësishme në çështjet e diskriminimit. Kjo praktikë si e tillë është në dispozicion për të gjitha palët e interesuara dhe publikohet në faqen zyrtare të institucionit.¹²⁵

Një e arritur e Avokatit të Popullit në punën e tij për promovimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe kundër trajtimit të pabarabartë është anëtarësimi i Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës në *Rrjetin Evropian të Organeve të Barazisë (EQUINET)*, ku institucioni është bërë anëtar i pesëdhjetë i barabartë i këtij organi.¹²⁶

Zbatimi i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹²⁷ është ligj bazik kundër diskriminimit, duke përfshirë edhe Ligjin për Barazinë Gjinore¹²⁸ dhe Ligjin për Avokatin e Popullit¹²⁹. Gjithashtu, edhe disa nga dispozitat e ligjeve të posaçme ndalojnë diskriminimin. Në këtë drejtim mund të përmendim Ligjin e Punës,¹³⁰ Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës,¹³¹ Ligjin për Aftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara¹³², Ligjin për Liritë Fetare në Kosovë,¹³³ Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtareve të tyre¹³⁴ etj. Siç është e njohur tanimë, konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut përfshihen drejtpërdrejt në Kushtetutë dhe kanë përparësi ndaj legjislacionit të brendshëm.

Sidoqoftë, krijimi i një sistemi ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi nuk nënkupton realizimin e vetë qëllimit dhe përfundimin e përpjekjeve për të arritur barazinë në të drejtat. Përkundër krijimit të mekanizmave të mbrojtjes kundër diskriminimit nuk mund të jemi të kënaqur me rezultatet e arritura në parandalimin dhe raportimin e rasteve të diskriminimit, si dhe për vetëmbrojtjen nga diskriminimi.

Është e qartë se praktika vendore gjyqësore kundër diskriminimit ende është e varfër. Mungon përvoja e mjaftueshme në fushën e aplikimit të ligjit kundër diskriminimit. Edhe më tej qytetarët, për një sërë arsyesh, rrallë parashtrojnë në gjykatë dhe institucione tjera raste kundër diskriminimit. Viktimat e

¹²⁴ Neni 9.2.13 LMD “Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi”;

¹²⁵ <https://www.oik-rks.org/>

¹²⁶ Bruksel, 23 tetor 2019, Avokati i Popullit, z. Hilmi Jashari, prezantoi para anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme EQUINET kërkesën e Institucionit të Avokatit të Popullit për t’u bërë anëtar të plotë në Rrjetin Evropian të Organeve të Barazisë (EQUINET). Me këtë rast, z. Jashari theksoi se Institucioni i Avokatit të Popullit vepron në përputhje me Statutin EQUINET dhe kriteret e paracaktuara më herët dhe kështu plotëson kushtet e nevojshme për anëtarësim, krahas me institucionet e tjera të barazisë që janë anëtare të këtij rrjeti.

¹²⁷ Ligji nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

¹²⁸ Ligji nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore.

¹²⁹ Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit.

¹³⁰ Ligji nr. 03/L-212 i Punës.

¹³¹ Ligji nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

¹³² Ligji nr. 03/L-019 mbi Aftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-078.

¹³³ Ligji nr.02/L-31 për Liritë Fetare në Kosovë.

¹³⁴ Ligji nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjestarëve të Tyre në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-020.

diskriminimit janë dekurajuar pjesërisht nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore, të cilat zgjasin me vite.

Gjithashtu, veprimet dhe sjellja e zyrtarëve në zinxhirin e institucioneve përkatëse, nga policia përmes autoriteteve gjyqësore, nuk u japin viktimave besim në diskrecionin dhe mbrojtjen e privatësisë së tyre dhe ka një nevojë të qartë për të bërë më shumë përpjekje në profesionalizmin dhe trajnimin e nëpunësve publikë.

Gjykatat themelore rrallë përdorin një pako të ligjeve për të drejtat e njeriut ose marrin vendime bazuar në parimet primare të akteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të përfshira në Kushtetutë, megjithëse ato janë pjesë përbërëse të sistemit juridik të Kosovës. Gjithashtu, gjykatat në Kosovë, përveç Gjykatës Kushtetuese që është një përjashtim, nuk përdorin ose i referohen praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, për çka i obligon Kushtetuta.¹³⁵ Ky problem nuk është specifik vetëm për rastet e diskriminimit.

Për më tepër, duket që gjyqësorit i mungon monitorim i duhur i lëndëve që i përkasin diskriminimit, për shkak të identifikimit dhe kategorizimit joadekuat të lëndëve të tilla. Lëndët e diskriminimit nuk kanë një shenjë specifike të gjykatës, kështu që është shumë e vështirë të monitorohen. Duke shikuar vetëm shenjën dhe/ose numrin e lëndës nuk është e mundur të përcaktohet nëse një lëndë ishte iniciuar për shkak të diskriminimit.

Si pasojë e kësaj ekziston një nevojë e pashmangshme për të krijuar një sistem për monitorimin e praktikës gjyqësore në rastet e diskriminimit, si dhe për monitorimin e zgjidhjes së problemeve që lindin në raste. Një parakusht për një bazë të tillë të dhënash të praktikës gjyqësore është që gjykatat t'i regjistrojnë dhe t'i monitorojnë çështjet e diskriminimit si një lloj të veçantë të kontesteve. Pa një sistem të tillë, gjykatësit ende nuk do të mundë të bëjnë dallimin e qartë të diskriminimit nga sjelljet e tjera të paligjshme. Rastet e diskriminimit duhet të monitorohen në mënyrë të qartë, për shkak të përputhshmërisë së praktikës gjyqësore.

Zyra e Qeverisjes së Mirë¹³⁶ brenda Zyrës së Kryeministrit, si një organ institucional në promovimin dhe zbatimin e LMD-së dhe si një organ që monitoron zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ka treguar angazhim në monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga institucionet përkatëse, përmes organizimit të një sërë aktiviteteve për promovimin e LMD-së. Sidoqoftë, mbetet sfida që qytetarët e Kosovës nuk janë të njoftuar në masë të madhe me nocionin e diskriminimit dhe mekanizmat për mbrojtjen e së drejtës për barazi.

LMD-ja gjithashtu përcakton mekanizma institucionalë për mbrojtje nga diskriminimi në ministritë dhe komunitat,¹³⁷ disa kanë caktuar zyrtarë përkatës për të koordinuar zbatimin e këtij ligji, ndërsa disa prej tyre kanë ngritur njësi të posaçme pune që kanë si detyrë të veçantë të merren me çështje të diskriminimit.

Për dallim nga vendet ku ka institucione të specializuara për mbrojtjen nga diskriminimi, ligji e ka caktuar Institucionin e Avokatit të Popullit, si një institucion kompetent për mbrojtje nga diskriminimi.

¹³⁵ Shih nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

¹³⁶ Shih nenin 10 të LMD-së.

¹³⁷ Shih nenin 11 të LMD-së.

Në kuptim të kësaj, Avokati i Popullit vazhdimisht përpiqet ta përmbushë mandatin e tij në trajtimin e rasteve të diskriminimit dhe fuqizimin e kapaciteteve në fushën e promovimit të kësaj të drejte dhe gjatë gjithë këtyre viteve është angazhuar në zhvillimin e marrëdhënieve që kontribuojnë në promovimin e barazisë dhe forcimin e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, si dhe me organet rajonale dhe ndërkombëtare që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e barazisë.

Avokati i Popullit u është përgjigjur rregullisht thirrjeve të organizatave joqeveritare dhe organizatave të tjera për të drejtat e njeriut, duke marrë pjesë në panele, takime që analizojnë të drejtat e grupeve sociale të cenueshme. Ai gjithashtu iu drejtua qytetarëve me njoftime për shtyp në prag të shënimit të ditëve ndërkombëtare të grupeve përkatëse në rrezik diskriminimi (ditët e grave, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet LGBT, romët dhe egjiptianët etj.), duke u bërë thirrje autoriteteve publike që ta respektojnë, mbrojnë dhe promovojnë të drejtën e barazisë nga pikëpamja e kompetencave të tyre.

Sidoqoftë, në legjislacionin e Kosovës kundër diskriminimit janë caktuar dy organe të nivelit qendror, që kanë detyrim t'i mbulojnë të gjitha ankesat me natyrë diskriminuese: Avokati i Popullit, si një institucion jogjyqësor, dhe gjykatat kompetente. Është e pakontestueshme që këto organe të luajnë rolin më të madh në zbatimin e legjislacionit kundër diskriminimit dhe krijimin e praktikave të mira dhe të qëndrueshme vendëse në çështjet e diskriminimit.

Shikuar në përgjithësi, legjislacioni i Kosovës kundër diskriminimit duhet t'i përmbushë pritjet si një formë ligjore për ta sfiduar pabarazinë, mirëpo ende ka rrugë të gjatë për zbatimin e plotë të tij.

Diskriminimi në punë

Punonjësit perceptojnë shtetin dhe shoqërinë e tyre edhe sipas qëndrimit të shtetit ndaj punës humane, kushteve të barabarta për punë të mirë dhe pajtueshmëri me dispozitat ligjore përkatëse,¹³⁸ ndër të tjera, sepse ata e kalojnë pjesën më të madhe të kohës në punë.

Diskriminimi në fushën e punës është i ndaluar,¹³⁹ domethënë është e ndaluar të shkelen mundësitë e barabarta në të drejtën e punës, siç është: zgjedhja e lirë e punësimit, avancimi në shërbim, trajnimi profesional dhe rehabilitimi profesional, shpërblimi i barabartë për punë me vlerë të barabartë, në kushte të drejta dhe të kënaqshme pune, për të pushuar, në arsim dhe anëtarësim në sindikatë. Dallimi, përjashtimi ose dhënia e përparësive lejohet vetëm në bazë të kriterëve të njohurive dhe aftësisë, dhe në asnjë mënyrë në ndonjë prej arsyeve të ndaluara të diskriminimit.

Sidoqoftë, diskriminimi në punë është shpesh jo qartë i dukshëm dhe i vështirë për t'u provuar, për dallim nga diskriminimi në fusha të tjera, sepse ai është i mbuluar nga një formë specifike juridike, që rrjedh nga mundësia diskrecionale e punëdhënësit, e cila bazohet në nevojat e punës së bërë.

Nga pikëpamja legjislative, Ligji i Punës është ligj themelor që rregullon marrëdhëniet juridike midis punonjësve dhe punëdhënësve. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e

¹³⁸ Shih Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 24, Barazia para ligjit, dhe neni 49, E drejta për të punuar dhe ushtruar një profesion, Ligji nr. 03/L-212 i Punës dhe Ligji nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Ligji nr. 2004/3 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligji nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore.

¹³⁹ Ligji nr. 2004/3 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligji nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore, si dhe Ligji nr. 03/L-212 i Punës ndalojnë në mënyrë të qartë diskriminimin në fushën e punës, pra shkeljen e mundësive të barabarta për themelimin e marrëdhënies së punës dhe gëzimin nën kushte të barabarta të të gjitha të drejtave në fushën e punës.

sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës. Përveç Ligjit të Punës, të drejtat në lidhje me punësimin për disa kategori të punonjësve të sektorit publik rregullohen me ligje të veçanta¹⁴⁰. Me Ligjin nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë janë përcaktuar masat për ta përmirësuar sigurinë dhe shëndetin e punonjësve në procesin e punës. Rregullimi ligjor përfshin ligje të tjera në fushën e ligjit të punës.¹⁴¹

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹⁴², Ligji për Barazinë Gjinore, si dhe Ligji i Punës ndalojnë në mënyrë të qartë diskriminimin në fushën e punës, pra shkeljen e mundësive të barabarta për themelimin e marrëdhënies së punës dhe gëzimin e kushteve të barabarta të të gjitha të drejtave në fushën e punës.

Duke analizuar legjislacionin përkatës, Avokati i Popullit mendon se ai është gjithëpërfshirës dhe se dispozitat e tij ofrojnë mekanizma të përshtatshëm për mbrojtje të barabartë të punëtorëve në sektorin publik dhe privat në mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës.

Vëzhgimet e përgjithshme të Avokatit të Popullit në lidhje me problemet dhe diskriminimin në punë në Republikën e Kosovës, për të cilën po dëshmojmë gjatë periudhës raportuese, janë pak a shumë të njëjta si në periudhat e mëparshme raportuese dhe nuk ka rezultate dhe përparime më të dukshme në këtë drejtim.

Shkalla e papunësisë në Kosovë ende nuk ka tendencë të bjerë. Sipas statistikave, Kosova vazhdon të ketë nivel të lartë të papunësisë. Për shkak të shkallës së lartë të papunësisë, rastet e diskriminimit në vendin e punës ende raportohen shumë rrallë në mekanizmat e mbrojtjes, pasi punonjësit kanë frikë nga hakmarrja e punëdhënësve të tyre.

Sa i përket sistemit të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë¹⁴³, nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm në raport me periudhën e mëparshme të raportimit. Në aksidentet në vendin e punës, ndërtimtaria vazhdon të udhëheqë si sektor me numrin më të madh të lëndimeve dhe vdekjeve në punë si pasojë mosrespektimit të rregullave themelore të sigurisë në punë. Në Kosovë ende nuk ka ndonjë regjistrer të strukturuar të aksidenteve në punë dhe ekziston një nevojë urgjente për të zhvilluar një sistem të tillë ligjor bazuar në aktet ligjore për regjistrimin e të gjitha aksidenteve në punë me 3 ose më shumë ditë të humbura pune, siç është bërë në të gjitha vendet e BE-së, sipas Metodologjisë Evropiane për Statistikat e Aksidenteve në Punë (ESAW).

Gjithashtu, stërzgjatja e procedurave gjyqësore në zgjidhjen e çështjeve të punës vazhdon të mbetet një sfidë në zbatimin e ligjit. Procedurat e tejkzgjatura dhe mungesa e një gjykate të specializuar që merret vetëm me çështjet e punësimit mbeten pengesa në funksion të zbatimit të ligjit të punës sa i përket mbrojtjes gjyqësore të të drejtave.

¹⁴⁰ Ligji nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

¹⁴¹ Ligji nr. 03 / L-017 për Inspektionin e Punës, Ligji nr. 04/L-011 për Organizimin e Sindikatave të Kosovës, Ligji nr.03 /L-200 për Grevën, Ligji nr. 04 /L-008 për Këshillin Ekonomik Social, Ligji nr. 03/L-136 për Lëshimin e Licencave për Punë dhe Punësim të Shtetasve të Huaj, Ligji nr. 03 /L-019 për Aftësimin Profesional dhe Rehabilitimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

¹⁴² Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nenet 1,2,3,8.

¹⁴³ Është rregulluar me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-212 të Punës dhe Ligjit nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Avokati i Popullit gjatë periudhës raportuese ka monitoruar zbatimin e së drejtës nga marrëdhëniet e punës, ka pranuar informata nga institucionet përkatëse¹⁴⁴, ka mbledhur informacione nga terreni mbi bazën e të cilave ka inicuar edhe hetime sipas detyrës zyrtare dhe ka pranuar ankesa individuale lidhur me diskriminimin në fushën e punës.

Avokati i Popullit ka hapur rast sipas detyrës zyrtare¹⁴⁵ në lidhje me mungesën e mjeteve juridike efektive për zgjidhjen e kontesteve të punës ndërmjet nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil. Rasti u hap në bazë të një artikulli të botuar në gazetën “Koha Ditore”, të 7 majit 2019, me titull: “Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMShCK) ka qenë jofunksional për pesë muaj, me rreth 500 ankesa të pashqyrtuara”.

Pas hetimit, analizës ligjore dhe gjendjes faktike në këtë rast, Avokati i Popullit, më 18 qershor 2019, ka publikuar një raport me rekomandim, me të cilin i rekomandoi Kuvendit të Kosovës, që sa më shpejt t’i emërojë anëtarët e KPMShCK-së dhe të mundësojë funksionimin e tij.

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën¹⁴⁶ për diskriminim lidhur me rrethanat e punësimit në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB). Pas përfundimit të konkursit dhe procedurave të tjera që lidhen me konkurs, ankuesi u zgjodh si asistent në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike. Senati i UMIB-it, vendosi ta shtynte nënshkrimin e kontratës së punës me ankuesin derisa të merret mendimi i Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK) lidhur me mundësinë e konfliktit të interesit në rastin specifik. Avokati i Popullit në këtë rast rekomandoi që, duke pasur parasysh të drejtën kushtetuese lidhur me të drejtën e punës dhe të ushtrimit të profesionit dhe të drejtën e barazisë para ligjit, duke iu shmangur çdo formë të diskriminimit, për ç’ gjë mund t’i referohet edhe Raportit me rekomandime nr. 853/2016 të Avokatit të Popullit, në lidhje me kriteret diskriminuese në konkurset për punësim në UP.

Avokati i Popullit konsideron se konkurset duhet t’i respektojnë kriteret e përcaktuara, kualifikimet e kërkuara dhe aftësitë e tjera të punës të kandidatit që aplikon për vendin e punës. Në të gjitha rastet e punësimit ose avancimit, trajtimi i privilegjuar nuk duhet të ndodhë për shkak të lidhjeve familjare ose të ngjashme, siç nuk duhet edhe për të njëjtat arsye të ketë një trajtim negativ ose përjashtues për kandidatët e tjerë.

Gjithashtu, Avokati i Popullit, në përputhje me përgjegjësitë e veta ligjore¹⁴⁷, në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae), gjykatave në Kosovë u ka dërguar mendimet e mëposhtme:

¹⁴⁴ Informacione të mbledhura në lidhje me shkeljet e së drejtës për punë, nga takimet e mbajtura gjatë periudhës raportuese me Inspektorin e Përgjithshëm të Inspektoratit të Kosovës dhe Presidentin e Unionit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës.

¹⁴⁵ Ex officio nr. 421/2019,

¹⁴⁶ A.nr. 30/2019,

¹⁴⁷ Neni 16 paragrafi 9 i Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit përcakton: “Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimit.” Po ashtu, duhet të ketë ndër mend që, me nenin 18, paragrafi 1.1, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit ka përgjegjësitë: “1.1. të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre.”

Duke vepruar në bazë të ankesës së ankuesit¹⁴⁸ kundër qeverisë së Republikës së Kosovës dhe kundër Ministrisë së Infrastrukturës, Avokati i Popullit, në cilësinë e mikut të gjykatës, ia dërgoi një opinion Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Në bazë të provave të paraqitura dhe fakteve të mbledhura, si dhe ligjeve përkatëse, Avokati i Popullit erdhi në përfundim që ankesat e ankuesve ishin të arsyeshme dhe se kishte pasur shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Prandaj, Avokati i Popullit kishte konstatuar se parashtruesit e ankesave ishin emëruar në poste nga të emëruarit politikë, kategori të nëpunësve publikë dhe nuk ishin pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe se marrëdhënia e tyre kishte përfunduar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Duke vepruar në bazë të ankesës së Këshillit të Grevës kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës¹⁴⁹, në lidhje me të drejtën për trajtim të barabartë, dinjitoz dhe jodiskriminues në punë, më 31 maj 2019, Avokati i Popullit ia dërgoi një opinion (amicus curiae) Gjykatës Themelore në Prishtinë, para së cilës procedohet procedura gjyqësore në lidhje me çështjen e ankuesit, në mënyrë që ta informojë të njëjtin për gjetjet dhe konkluzionet për çështjen në shqyrtim të nxjerra nga Avokati i Popullit.

Ky opinion ligjor fokusohet në sqarimin e bazës juridike dhe analizës ligjore në lidhje me ankesën e Këshillit të Grevës, i cili përfaqëson stafin e punonjësve civilë të punësuar në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, në lidhje me kërkesat e tyre për të drejtën për trajtim të barabartë, dinjitoz dhe jodiskriminues në punë.

Sipas pohimit të ankuesve, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e saj të mbajtur më 20 dhjetor 2017, mori Vendimin nr. 04/20 për rritjen e pagave, të cilat, përveç stafit politik, në mënyrë selektive ishin përfitues edhe disa zyrtarë të shërbimit shtetëror në kuadër të Zyrës së Kryeministrit: Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm (po ashtu në mënyrë selektive), Zyra Ligjore, Sekretariati për Koordinimin dhe Zyra për Komunikim me Publikun, jashtë këtij vendimi kishin mbetur punonjësit me statusin e nëpunësve shtetërorë, si: Zyra e Qeverisjes së Mirë, Zyra e Planifikimit Strategjik, Zyra e Administratës Qendrore, Zyra e Buxhetit dhe Financave, Zyra e Prokurimit, Zyra e Publikimit të Gazetës Zyrtare, Zyra e Komisionarit të Gjuhëve, Zyra e Komuniteteve, Zyra për Bashkëpunim Rajonal, Njësia e Arkivave dhe Njësia Qeveritare e Personave të Zhdukur. Parashtruesit të ankesave gjithashtu pohuan se Vendimi nr. 04/20 për rritjen e pagave, përfshirë këtu edhe stafin selektiv të nëpunësve civilë të Zyrës së Kryeministrit, i solli ata në trajtim jo të barabartë dhe në të njëjtën kohë shkaktoi probleme në funksionimin e mirë të Zyrës së Kryeministrit, duke e bërë stafin administrativ brenda zyrave, të cilat janë pjesë e vendimit të lartpërmendur, paga më të larta se drejtorët e zyrave të ekspertëve që veprojnë brenda Zyrës së Kryeministrit.

Në përgjigjen e kryeministrit të Republikës së Kosovës, dorëzuar Avokatit të Popullit, në lidhje me çështjen konkrete, më 23.11.2018, theksohet se është marrë parasysh neni 92, paragrafi 4, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili përcakton: *“Qeveria merr vendime në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligje, propozon projektligje dhe ndryshime dhe plotësime të ligjeve ekzistuese e akteve të tjera, si dhe mund të japë mendimin rreth projektligjeve të cilat nuk janë të propozuara nga*

¹⁴⁸A. nr. 671/2017

¹⁴⁹A. nr. 620/2018

ajo”. Neni 93, paragrafi 4, i cili përcakton: *“Merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve.”* Po ashtu përmendet neni 4 i Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, Rregulloren nr. 15/2017 dhe Rregulloren nr. 16/2017, ku, ndër tjerash, përcaktohen përgjegjësitë e Qeverisë së Republikës së Kosovës: *“Qeveria ushtron pushtetin e vet ekzekutiv në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi që ka të bëjë me Qeverinë”, dhe “Qeveria me qëllim të ushtrimit të kompetencave të përcaktuara me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi; merr vendime me propozimin e autoriteteve të larta të administratës shtetërore; nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve.”* Në këtë rast, Avokati i Popullit së pari rikujton se Vendimi nr. 04/20, datë 20 dhjetor 2017, nuk përmban asnjë referencë juridike për shërbimet civile të Kosovës; së dyti, edhe pse baza juridike e mësipërme i jep të drejtën Qeverisë së Republikës së Kosovës të marrë vendime, ato duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, në kuptimin që ato nuk janë diskriminuese, siç është në këtë rast kundër parashtruesve të ankesës.

Avokati i Popullit, duke iu referuar praktikës e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në vendimin për rastin *Burden v. UK*¹⁵⁰: *“Një dallim në trajtimin e personave në situata të ngjashme ... është diskriminuese nëse nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm; me fjalë të tjera, nëse nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet”,* vlerëson se konstatimi i tillë i gjykatës duhet të vlejë edhe në rastin konkret të parashtruesve të kërkesave. Prandaj, Vendimi nr. 04/20, ad-hoc, i 20 dhjetorit 2017, i cili përfaqëson vullnetin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të rritur në mënyrë selektive pagat për zyrtarët civilë, si në rastin konkret, duke justifikuar një qëllim të ligjshëm dhe të ketë një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të synuar, pa ndonjë bazë juridike të vendosur paraprakisht dhe të përfshirë në vendim, krijon pabarazi dhe paraqet shkelje të dispozitave ligjore të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionin përkatës për shërbimin civil të Republikës së Kosovës¹⁵¹ dhe paraqet shkelje të nenit 3 të Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.¹⁵²

Avokati i Popullit dërgoi një opinion ligjor në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në të cilën aktualisht kalon procedura ligjore lidhur me çështjen e ankuesit në një ankesë individuale¹⁵³ kundër Universitetit Publik “Hasan Prishtina” (UP), lidhur me diskriminimin në bazë të kufizimeve të moshës gjatë zgjedhjes për tituj akademikë në UP, ose në lidhje me nenin 178, paragrafi 1, pika 2, të Statutit të UP, për titullin e asistentit universitar, i cili, përveç kushteve të tjera, përcakton se kandidati: *“Të jetë jo më i vjetër se 30 vjet (respektivisht 35 vjet në Fakultetin e Mjekësisë) kur emërohet për herë të parë. Përjashtimisht kandidati mund të zgjidhet asistent universiteti deri në moshën 40 vjeçare nëse ka gradën e doktorit të shkencës.”*

Mbrojtja e tërësisë të së drejtës për punësim nënkupton zbatimin e plotë të parimit të kapaciteteve profesionale dhe dhënien e së drejtës për konkurrencë të hapur në procesin e punësimit të të gjithë kandidatëve të interesuar, pa shkelur procedurën ligjore përkatëse me rastin e punësimit në

¹⁵⁰ Aktgjykimi i GjEDNj-së, *Burden v. UK*, më 29 prill 2008.

¹⁵¹ Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në nenin 43 dhe neni 44.

¹⁵² Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 3, paragrafët 1 dhe 2.

¹⁵³ A.nr.587/2018.

institucionet publike. Prandaj obligimi i respektimit të kësaj të drejte kërkon shmangien e masave, të cilat pengojnë ose parandalojnë gëzimin e së drejtës në punësim dhe përfshijnë respektimin e parimit të barazisë në procedurat e aplikimit për punësim, pa kritere të cilët janë diskriminuese.

Barazia në punësim është kushti themelor i barazisë para ligjit. Prandaj, një personi, për shkak të ndonjë karakteristike personale të tij, përkatësisht në rastin konkret, për shkak të moshës, nuk mundet, pa një arsytim objektiv dhe të arsyeshëm me ekzistimin e një qëllimi të ligjshëm, pa arsye t'i mohohet e drejta në punësim, e cila është plotësisht në dispozicion dhe u njihet të tjerëve. Në bazë të ankesës së ankuesit shihet se Rektorati i UP-së edhe më tej vazhdon me moszbatimimin e Aktgjykimit A.nr.1242/2010, i datës 9 dhjetor 2013.

Në bazë asaj që është theksuar më lart, Avokati i Popullit konsideron se kufizimi i moshës në rastin konkret, i paraparë me statutin e UP-së, në bazë të cilit është nxjerrë vendimi i Senatit të UP-së, paraqet akt diskriminues. Avokati i Popullit, në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*), ka informuar gjykatën për qëndrimin e tij në lidhje me këtë çështje, me shpresë se në këtë mënyrë do të kontribuojë në sqarimin e situatës konkrete.

Avokati i Popullit, gjatë periudhës raportuese, gjithashtu duke u bazuar në kompetencat ligjore,¹⁵⁴ ia ka drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dy kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy ligjeve: Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrтарët Publikë dhe Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik.

Avokati i Popullit ka vlerësuar se Ligji për Zyrтарët Publikë nuk ka marrë parasysh faktin që subjektet e ndryshme në sektorin publik çështjet e tyre organizative, funksionale dhe afariste i kanë rregulluar veçmas, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me ligjet përkatëse. Përveç kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Zyrтарët Publikë, Avokati i Popullit gjithashtu ka kërkuar shqiptimin e masës së përkohshme për pezullimin e menjëhershëm të dispozitave kontestuese të këtij ligji.

Gjykata Kushtetuese ka shqyrtuar dhe vendosur në lidhje me këtë kërkesë për masë të përkohshme, duke mos paragjykuar pranueshmërinë dhe meritën e kërkesës së Avokatit të Popullit, duke aprovuar masën e përkohshme në kohëzgjatje deri më 28 shkurt të vitit 2020 dhe menjëherë ka pezulluar zbatimin e plotë të Ligjit për Zyrтарët Publikë me kohëzgjatje të njëjtë.

Në kërkesën e drejtuar Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik dhe Shtojca një (1) e këtij ligji, nuk kanë arritur të përçojnë frymën kushtetuese në aspektin e ndarjes së pushteteve, barazisë para ligjit dhe as garancitë e së drejtës pronësore. Për më tepër, Avokati i Popullit konsideron që ky ligj nuk është në përputhje me parimet e sundimit të ligjit, për shkak të mangësive në pikëpamje të qartësisë, saktësisë dhe parashikueshmërisë së tij.

Avokati i Popullit ka pranuar mbi 40 ankesa individuale nga subjekte të ndryshme të sektorit publik, të cilat janë parashtruar kundër Ligjit për Pagat në Sektorin Publik.

¹⁵⁴Neni 16, paragrafi 10, i Ligjit nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit: “Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.”

Avokati i Popullit ka kërkuar edhe aplikimin e masës së përkohshme në zbatimin e Ligjit për Pagat në Sektorin Publik deri në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese, duke konsideruar se masa e përkohshme është e domosdoshme për ta mbrojtur interesin publik dhe për t'i shmangur dëmet e pariparueshme që do të mundë të shkaktoheshin me zbatimin e këtij ligji.

Gjykata Kushtetuese e ka shqyrtuar kërkesën e Avokatit të Popullit dhe duke mos paragjykuar pranueshmërinë dhe meritën e kërkesës, ka aprovuar masën e përkohshme në kohëzgjatje deri më 30 mars të vitit 2020 dhe menjëherë ka pezulluar zbatimin e plotë të këtij ligji në kohëzgjatje të njëjtë.

Diskriminimi ndaj pensionistëve

Në Kosovë janë të regjistruar mbi 260 mijë pensionistë. Shumica e tyre me vite jetojnë me pensione bazike, të cilat shpesh nuk janë të mjaftueshme as për t'i mbuluar shpenzimet elementare të jetës, duke e shndërruar jetën e tyre në luftë për mbijetesë.

Skemat e pensioneve ose të kompensimeve momentalisht janë të rregulluara me tetë ligje të ndryshme, të cilat nuk janë harmonizuar sa duhet dhe bien ndesh me njëri-tjetrin. Kështu që, është vështirësuar zbatimi i tyre në praktikë.

Edhe pse qeveria ka ndërmarrë hapa të caktuar në reformimin e fushës së sistemit të pensioneve dhe beneficioneve dhe në planin e saj ka hartimin e një ligji të vetëm për pensionet, i cili në një vend do të përfshijë dhe trajtojë të gjitha të drejtat në pensione si dhe krijimin e Fondit për Sigurime Sociale, me të cilin ligj do të përcaktoheshin struktura organizative, forma e menaxhimit, shkalla e kontributeve dhe pensioni invalidor, e gjithë kjo me qëllim të harmonizimit me praktikën evropiane, mbetet e paqartë se kur kjo reformë do të zbatohet në tërësi.

Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit ka përfunduar hetimin në rastin ex-officio¹⁵⁵, në lidhje me trajtimin e pabarabartë të pensionistëve nga bankat komerciale në Kosovë në ofrimin e shërbimeve bankare të kredive dhe Bankës Qendrore të Kosovës i është drejtuar me raport. Avokati i Popullit ka hasur në dy situata, që bankat komerciale në Republikën e Kosovës kanë krijuar dhe ofrojnë lloje të shumta të kredive për nevoja të qytetarëve, në mesin e të cilëve janë kredit për kategoritë e posaçme të qytetarëve si dhe për qëllime të veçanta. Mirëpo në ofertat e bankave nuk ka kredi enkas të krijuara për pensionistët dhe nga kreditë ekzistuese asnjë kredi që i ofrohet qytetarëve nuk është në dispozicion për pensionistët të moshës mbi 65 vjeç, për shkak të moshës së tyre, deri sa kjo e drejtë në një situatë të krahasueshme nuk i mohohet kategorive të tjera të pensionistëve nën moshën 65 vjeç, si dhe personave mbi moshën 65 vjeç që kanë biznese të regjistruara, si dhe personave të punësuar.

Avokati i Popullit në këtë situatë ka konstatuar që, me zbatimin e kësaj praktike, bankat në mënyrë të drejtpërdrejtë diskriminojnë qytetarët në bazë të kriterit të drejtpërdrejtë – moshës, si karakteristikë personale, sepse për shkak të mohimit të së drejtës për shfrytëzimin e shërbimeve bankare të kredisë, në një situatë të krahasueshme vendosin një grup të qytetarëve në pozitë të pafavorshme në raport me personat e tjerë, të cilët nuk kanë një karakteristikë të tillë personale. Mosha e klientit nuk ka kurrfarë ndikimi në aftësinë kreditore, sepse nuk është i “matshëm financiarisht”, dhe as që nga mosha e klientit mund të varet nëse ai do të mundë në mënyrë efikase dhe me kohë të bëjë shlyerjen e kredisë.

¹⁵⁵ Ex officio nr. 450/2018.

Mosha është vetëm njëri prej kushteve për realizimin e së drejtës në lloje të caktuara të pensioneve dhe personat e moshuar kanë të drejtë në qasje të barabartë në shfrytëzimin e të gjitha shërbimeve publike.

Avokati i Popullit nuk mohon që banka ka të drejtë që për grupe të caktuara të klientëve të përcaktojë kushte të veçanta, në bazë të të cilave do ta miratojë kreditë e kërkuara, por edhe në raste të tilla kushtet duhet të jenë objektive, të krahasueshme dhe të barabarta për të gjithë dhe nuk mund të jenë të lidhura me karakteristikat personale të klientëve, përkatësisht, duhet të respektohen rregulloret për mbrojtje nga diskriminimi me karakter imperativ dhe të cilat janë obliguese për të gjithë. Vlerësimi i bankave me rastin e shqyrtimit dhe përpunimit të kërkesave kreditore duhet të jetë i bazuar ekskluzivisht në kriteret kuantitative dhe kualitative, të cilat marrin parasysh të gjitha karakteristikat e një klienti të caktuar në çdo rast individual, pa asnjë përjashtim të përgjithshëm të bazuar në ndonjë karakteristikë personale. Vetëm një qasje dhe mënyrë e tillë e veprimit siguron që të gjithë klientët nën kushte të barabarta mund t'i shfrytëzojnë shërbimet bankare.

Avokati i Popullit në rastin konkret konsideron se bankat në mënyrë të vazhdueshme duhet ta përmirësojnë politikën kreditore, në mënyrë që t'u përgjigjen sfidave në kuptim të përshtatjes ndaj situatave të reja të krijuara në shoqëri, që ka rëndësi të veçantë për të gjithë popullatën, pa diskriminim të asnjë baze të mbrojtur ligjore.

Avokati i Popullit me këtë raport i ka rekomanduar Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) të ndërmarrë veprime konkrete në drejtim të miratimit të reformave dhe harmonizimit të politikave të bankave në Kosovë me rregulloret pozitive-juridike nga fusha e legjislacionit kundër diskriminimit, me qëllim të parandalimit të diskriminimit të qytetarëve të moshuar, përkatësisht të pensionistëve, në shfrytëzimin e shërbimit bankar të kredisë, dhe që bankat në të ardhmen të kenë kujdes që me praktikën, politikën dhe vendimet e tyre të përmbahen nga bërja e pajustificuar e dallimeve ose nga trajtimi i pabarabartë (përjashtimi, kufizimi ose dhënia e përparësisë) në raport me persona ose grupe të personave, e cila bazohet në ndonjë karakteristikë personale.

Mbrojtja shëndetësore dhe sociale

Avokati i Popullit, ashtu si në raportet vjetore paraprake, shpreh shqetësimin e tij se deri më tani Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore nuk është pjesë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.¹⁵⁶

Gjatë këtij viti raportues, në IAP, nga fusha e mbrojtjes shëndetësore dhe sociale, janë pranuar gjithsej 287 ankesa, prej tyre 109 janë hapur për hetim. Avokati i Popullit konsideron se institucionet publike kompetente në Kosovë duhen shtuar përpjekjet e tyre në ndërmarrjen e masave për përmirësimin dhe zhvillimin e disa sektorëve jetikë, që mundësojnë zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

Bazuar në vlerësimet e Avokatit të Popullit, faktorët kryesorë që janë duke ndikuar në rëndimin e gjendjes ekonomike dhe sociale në Kosovë janë: papunësia, mungesa e legjislacionit për sigurime shëndetësore, si dhe legjislacioni i cili e rregullon çështjen e skemës së ndihmës sociale në Kosovë.

Më 17 dhjetor 2019, Avokati i Popullit, në hetimet sipas detyrës zyrtare, publikoi Raportin me rekomandime përkitazi me vlerësimin e sistemit të ofrimit të shërbimeve sociale në Kosovë.¹⁵⁷ Raporti

¹⁵⁶Shih <https://www.oik-rks.org/2019/04/08/>, Raportin Vjetor të Avokatit të Popullit, të vitit 2018, fq.102.

jep rekomandime specifike dhe konkrete lidhur me veprimet që duhet t'i ndërmarrë Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe komunat përkatëse, në drejtim të përmirësimit të gjendjes aktuale. Avokati i Popullit konstaton se sistemi i mbrojtjes sociale në Kosovë nuk është në nivel të kënaqshëm, si rezultat i mosfunksionimit adekuat të qendrave për punë sociale (QPS) në raport me ofrimin e shërbimeve sociale profesionale për të gjithë qytetarët e vendit, pa dallim. QPS-të janë shndërruar në institucione administrativo-teknike dhe shumë më pak në institucione ku ofrohen shërbime sociale profesionale dhe krejt kjo për pasojë të mungesës së stafit profesional dhe për mungesë të objekteve përcjellëse për ofrim të shërbimeve adekuate.

Në këtë raport, Avokati i Popullit konstaton se ka mungesë të mbikëqyrjes, të planifikimit, të financimit dhe të avancimit të shërbimeve në përputhje me nevojat e komunave dhe ka mungesë të zhvillimit të një sistemi të mbrojtjes sociale nëpër komuna dhe në vetë Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila ka shkaktuar dhe vazhdon të shkaktojë probleme të mëdha. Avokati i Popullit në këtë raport i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës që ta rikthejë mbikëqyrjen, përgjegjësinë dhe kompetencat menaxhuese ndaj QPS-ve nën ministrinë përkatëse dhe ta ndryshojë/plotësojë Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, përmes të cilit do të rregullohej në tërësi mandati, roli, kompetencat, përgjegjësitë dhe struktura e qendrave për punë sociale.

Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që t'i hartojë dhe t'i miratojë rregulloret e brendshme për qendrat për punë sociale dhe të bëhet kostimi i shërbimeve sociale për secilin shërbim individualisht, sidomos ato shërbime të cilat kërkojnë mjete financiare, si: strehimi i viktimave të dhunës në familje, i viktimave të trafikimit, i fëmijëve pa përkujdesje familjare dhe të braktisur, i fëmijëve të keqtrajtuar, i fëmijëve në situatë rruge, shërbimi në institucion apo në shtëpi për personat e moshuar pa përkujdesje familjare, për fëmijët me aftësi të kufizuar, për fëmijët dhe të rriturit me çrregullime mendore, për strehim social, pakoja familjare në bazë të numrit të anëtarëve, riintegrimi etj.

Ndërsa komunës së Junikut, Parteshit, Mamushës, Kllokotit dhe Gracanicës, Avokati i Popullit u rekomandoi që t'i themelojnë dhe t'i funksionalizojnë QPS-të, derisa Qeveria e Republikës së Kosovës ta rikthejë mbikëqyrjen, përgjegjësinë dhe kompetencat menaxhuese ndaj QPS-ve nën ministrinë përkatëse.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen në shqetësimin të cilin edhe në vitet paraprake i ka ngritur në raporte vjetore lidhur me kriterin e vendosur për përfitim të ndihmës sociale, përkatësisht kufizimi për përfitim të ndihmës sociale për fëmijët nën moshën 5 vjeçe në Ligjin për Skema Sociale në fuqi, mirëpo kjo çështje ende mbetet e pazgjidhur.

Në Kosovë ende nuk është duke gjetur zbatim Ligji për Sigurimin Shëndetësor, cili u miratua në prill të vitit 2014 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.¹⁵⁷ Megjithatë, ky ligj akoma nuk ka gjetur zbatim dhe kjo ndikon drejtpërdrejt tek qytetarët e Republikës së Kosovës, në kushtet e shërbimeve mjekësore. Avokati i Popullit rekomandon që Qeveria e Kosovës menjëherë të ndërmarrë veprime konkrete me qëllim të zbatimit praktik të këtij ligji.

¹⁵⁷ A. nr.59/2019

¹⁵⁸ Ligji nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9450>

Strehimi social

Banimi është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme për stabilitet social, shëndet dhe zhvillim kualitativ të mirëqenies njerëzore. Të gjithë njerëzit kanë të drejtë në standard të jetesës, që është i përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tyre (Deklrata Univerzale për të Drejtat e Njeriut). Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit në Kosovë obligon Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe komunat në ofrimin dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për banim për qytetarët.

Bazuar në të dhënat e IAP-së, kërkesa e qytetarëve në nevojë për banim edhe në këtë vit vazhdon të jetë e lartë, edhe pse vërehen disa lëvizje pozitive, të cilat, megjithatë nuk janë të mjaftueshme.

Në këtë vit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka nënshkruar marrëveshje të mirëkuptimit me disa komuna në Kosovë përkitazi me ndërtimin e shtëpive për komunitetet joshumicë, si pjesë e projektit kapital “Mbështetje për komunitetet joshumicë”. Avokati i Popullit ka informata se ka filluar ndërtimi i shtëpive në komunat përfituese, megjithatë, nga ankesat e ankuesve sa i përket banimit është vërejtur mungesa e pronave private të shumë familjeve të përfshira në programet sociale të ndërtimit. Familjet me kushte të rënda ekonomiko-sociale në vendbanimet e tyre nuk i plotësojnë as kushtet elementare të banimit, ata nuk kanë prona të regjistruara në emër të tyre, prandaj ky fakt edhe e ka pamundësuar që këto familje të jenë në listën e përfituesve për ndërtim të shtëpive, duke pasur parasysh se ndër kriteret për përfitim për ndërtimin e shtëpive ka qenë që parashtruesit e kërkesave të kenë pronë-parcelë toke të regjistruar në emër të personit që aplikon.

Në këto raste komunat nuk kanë ofruar ndonjë zgjidhje që rasteve sociale t’u sigurojnë ndonjë parcelë për ndërtim të shtëpive, me arsyetim të mungesave buxhetore. Gjithashtu komunat kanë dështuar të sigurojnë edhe ndërtimin e ndonjë objekti adekuat për strehimin e këtyre familjeve, të cilat jetojnë në kushte të rënda ekonomiko-sociale, ashtu si në rastin e ankuesit N. S. nga Mitrovica, i cili nuk e ka të zgjidhur çështjen e strehimit të vet.¹⁵⁹ Sipas përgjigjes së dërguar nga Komuna e Mitrovicës tek Avokati i Popullit, bëhet e ditur se kjo komunë ka numër të madh të kërkesave të tilla, prandaj, në mungesë të mjeteve buxhetore nuk mund të ofrojnë zgjidhje të banimit. Njëjtë ishte deklaruar edhe Komuna e Pejës në rastin e hapur për hetime në IAP në ankesën individuale.¹⁶⁰

Më 26 qershor 2019, Avokati i Popullit ka pranuar ankesën e një qytetari tjetër nga Prizreni, i cili pohon se është person i verbër dhe jeton së bashku me gruan dhe një fëmijë në një pronë, e cila, sipas informatave, është pronë shoqërore.¹⁶¹ Si rezultat i vjetërsisë së ndërtesës, mungesës së mirëmbajtjes dhe ndërhyrjeve konservuese, kjo ndërtesë, gjatë vitit 2016, është vlerësuar e rrezikshme për banim. Me përkrahjen e Komunës së Prizrenit dhe lejes përkatëse nga Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Monumenteve janë kryer disa ndërhyrje në këtë objekt, kurse ankuesi është udhëzuar të paraqitet në Komunën e Prizrenit. Përkundër interesimit të Avokatit të Popullit, ende nuk është bërë ndonjë zgjidhje për banim të qëndrueshëm për familjen në fjalë.

¹⁵⁹ A.nr. 759/2018

¹⁶⁰ A.nr. 622/2019

¹⁶¹ A.nr. 540/2019

Më 17 korrik 2019, Avokati i Popullit ka pranuar ankesën e një qytetari nga komuna e Pejës përkitazi me mungesën e banimit.¹⁶² Sipas ankuesit, për shkak të mungesës së vendbanimit ai është detyruar të jetojë në shtëpinë e cila nuk i plotëson as kushtet më elementare të jetesës, ndërsa Komuna nuk ka arritur të gjejë zgjidhje adekuate. Avokati i Popullit është informuar nga Komuna e Pejës se pritet të shqyrtohet mundësia e ndërtimit të një shtëpie për këtë familje, prandaj rasti vazhdon të mbetet i hapur për hetime në IAP.

Personat me aftësi të kufizuara

Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara edhe pse garantohen me akte ndërkombëtare dhe me ato vendore, Avokati i Popullit vlerëson se gjendja e tyre vazhdon të jetë shqetësuese. Që nga viti 2018, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kishte deklaruar se ka filluar hartimin e një koncept-dokumenti për hartimin e një ligji gjithëpërfshirës në mbrojtje të personave me aftësi të kufizuar, megjithatë nuk është bërë ndonjë përparim në këtë drejtim.

Personat me aftësi të kufizuar vazhdojnë të përballen me shumë vështirësi, sikurse në punësim, qasje në hapësira publike dhe institucione publike, në transport publik, varfëri dhe vështirësi në realizimin e të drejtave në beneficione të garantuara sipas legjislacionit në fuqi.

Disa nga barrierat me të cilat ballafaqohen personat e verbër në Kosovë janë edhe mungesa e shtigjeve të prekshme, semaforët e zëshëm, publikimet dhe njoftimet në alfabetin e Brajlit në institucione.

Avokati i Popullit ka pranuar një numër ankesash nga personat e verbër lidhur me kushtëzimin me anëtarësim në Shoqatën e të Verbërve të Kosovës (ShVK) për t'u pajisur me librezat të anëtarësisë, me qëllim të përfitimit të të drejtave dhe të beneficioneve të garantuara. Neni 21 i Ligjit nr. 04/L-092 për Personat e Verbër parasheh: *“Për zbatimin e këtij ligji, dhe pa mohuar të drejtat e individëve ose grupeve të tjera, Shoqatës së të Verbërve të Kosovës i njihet e drejta e përfaqësimit të të verbërve dhe fitimit të shërbimeve të posaçme, në varësi të plotësisë të kushteve [...]”*¹⁶³

Avokati i Popullit konstatoi se përcaktimi i ShVK-së si shoqatë e vetme me kompetencë ligjore për t'i pajisur personat e verbër me librezat të verbërisë dhe krijimin e regjistrave të evidencave të librezave të lëshuara për përfituesit nga ky ligj karshi shoqatave të tjera, të cilat po ashtu janë të regjistruara si OJQ për mbrojtjen e interesave e personave të verbër, përbën diskriminim dhe bie në kundërshtim me nenin 17, paragrafi 8, të Ligjit nr. 04/L-092 për Personat e Verbër, si dhe me Ligjin nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, i cili në nenin 3, paragrafi 1, përcakton: *“Çdo person në Kosovë gëzon të drejtën e plotë për t'u asociuar dhe themeluar OJQ-në”* dhe par.2 përcakton se *“Asnjë person nuk obligohet që të asociohet kundër vullnetit të tij dhe asnjë person nuk diskriminohet në asnjë mënyrë për shkak të vendimit për t'u asociuar apo për të mos u asociuar.”*

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën e parashtruar nga OJQ “Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës” (KGVK) parashtruar kundër Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) dhe kundër Shërbimit

¹⁶² A.nr. 572/2019

¹⁶³ Shih <https://www.oik-rks.org/2019/04/08/>, Raportin Vjetor të Avokatit të Popullit, të vitit 2018, fq.88.

Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), përkitazi me moslirimin nga pagesa të personave të verbër në dalje të objektit të QKUK-së dhe të ShSKUK-së në Prishtinë.¹⁶⁴

Avokati i Popullit në këtë rast konstatoi se, edhe pse Ligji nr. 04/L-092 për Personat e Verbër, në nenin 6, i cili përcakton: *“Personat e verbër lirohen nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë. Në rast vetëpunësimi ata lirohen nga çdo detyrim fiskal, ndërsa në rast se zhvillojnë veprimtari si persona juridikë, ata gëzojnë lehtësira tatimore të cilat i realizojnë sipas ligjeve në fuqi”*, ky obligim ligjor nuk ishte duke u respektuar nga QKUK-ja dhe nga ShSKUK-ja. Në tabelat në hyrje të këtij institucioni nuk ishte e evidentuar që personat me aftësi të kufizuar janë të liruar nga pagesa. Avokati i Popullit rekomandoi se detyrimi nga zyrtarët e angazhuar tek hyrje-daljet e objektit të QKUK-së dhe të ShSKUK-së që personat e verbër të paguajnë shumën e përcaktuar të të hollave përbën veprim të kundërligjshëm dhe kjo praktikë duhet menjëherë të ndalohet në të gjitha institucionet publike. Rekomandimet e dhëna nga Avokati i Popullit janë marrë parasysht nga autoritetet përgjegjëse.

Avokati i Popullit vlerëson se ndër kategoritë që më së paku gëzojnë respektim të të drejtave të njeriut në Kosovë janë personat me vështirësi në të dëgjuar. Kjo kategori nuk është e përfshirë në asnjë skemë sociale të përcaktuar me ligj. Më 30 shtator 2019, Avokati i Popullit nxori Opinionin¹⁶⁵ përkitazi me sigurimin e qasjes në informim për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar të dëgjimit, në kuadër të debateve televizive për zgjedhjet nacionale të vitit 2019. Në kanalet televizive në Kosovë, gjatë fushatës elektorale në zgjedhjet e jashtëzakonshme për deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nuk është vërejtur të jenë angazhuar interpretë të certifikuar në *Gjuhën e Shenjave*,¹⁶⁶ prandaj konsiderohet se kjo kategori e personave nuk kanë arritur të informohen rreth programeve politike, me qëllim të vlerësimit të ofertës më të mirë politike për votim të kandidatëve për deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ky opinion iu dërgua Komisionit të Pavarur për Media (KPM) dhe të gjitha kanaleve televizive të licencuara.

Sikurse në vitet paraprake, edhe në këtë vit raportues, IAP ka pranuar ankesa përkitazi me shkeljen e së drejtës si dhe diskriminimin në realizimin e beneficioneve të personave me aftësi të kufizuar, përkitazi me lirim nga pagesa e detyrimeve të importit për kategorinë e personave me nevoja të veçanta, përkatësisht personat e verbër dhe personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë.¹⁶⁷ Personat me aftësi të kufizuar të drejtën në lirim nga pagesa e detyrimeve të importit e kanë të garantuar me dispozitat e nenit 182 në lidhje me nenin 76-81 të Aneksit A të Kodit Doganor dhe Akcizave në Kosovë nr. 03/L-109; me nenin 10 të Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë nr. 05/L-067, me nenin 6 të Ligjit nr. 04/L-092 për Persona të Verbër; Pika 1.12 e nenit 30 të Ligjit nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, në nenin 10, ka paraparë lirim nga detyrimet e importit. Kjo e drejtë u njihet vetëm personave të cilët paraprakisht janë pajisur me patentë shoferi dhe me kushtin që automjeti të jetë i dizajnuar apo i përshtatur për përdorim nga

¹⁶⁴ A. nr.235/2019.

¹⁶⁵ Ex officio nr. 744/2019.

¹⁶⁶ Sipas Rregullores (QRK) nr. 15/2014 për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës, neni 3, par. 1.7, “Gjuha e shenjave” – nënkupton Gjuhën e shenjave e cila ka rregullat e saj gramatikore, strukturën e fjalisë dhe nuancat kulturore.

¹⁶⁷ A. nr. 571/2019

personat me aftësi të kufizuara. Ndërkaq, asnjë nga këto akte nuk e ka paraparë lirim nga taksat e automjeteve doganore për personat e kësaj kategorie, të cilët, për arsye objektive, nuk kanë automjet të përshtatur për aftësinë e kufizuar të tyre dhe nuk kanë mundësi të kenë patentë shoferi për ta vozitur automjetin.

Po ashtu, personat me aftësi të kufizuar, të cilët mjete ndihmëse për lëvizje përdorin karrocet, ashtu siç është raportuar nga Avokati i Popullit në raportet vjetore paraprake, akoma ballafaqohen me probleme të njëjta në lëvizjen pa pengesa, përfshirë edhe objektet e institucioneve publike.

Më 3 korrik 2019, Avokati i Popullit publikoi Raport me rekomandime në rastin e hetuar sipas detyrës zyrtare lidhur me situatën e personave me aftësi të kufizuara në komunën e Gjilanit.¹⁶⁸ Ky raport i referohet qasjes së personave me aftësi të kufizuar në pronat publike, në infrastrukturën rrugore si dhe të drejtën për arsim dhe punësimin e tyre në institucionet publike në Komunën e Gjilanit. Konstatimi i Avokatit të Popullit është se Komuna e Gjilanit ka dështuar t'i zbatojë dhe t'i përmbushë obligimet që burojnë nga neni 12 i Ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, duke mos përmbushur numrin e nevojshëm të të punësuarve nga radhët e personave me aftësi të kufizuara dhe se mosdhënia e një përshtatjeje/akomodimi të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuar, në përputhje me nevojat e tyre specifike përbën diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar, ashtu siç përcaktohet në Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, i cili është në fuqi. Disa nga rekomandimet e këtij raporti janë në fazën e zbatimit nga Komuna e Gjilanit.

Barazia gjinore

Barazia gjinore është parakusht themelor i demokracisë për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të bazuar në gjini. Ajo e nënkupton parimin e barazisë para ligjit për njerëz të gjinive të ndryshme. Arritja e barazisë gjinore është një nga objektivat kryesore dhe është prioritet për zhvillimin e çdo shoqërie demokratike, në të cilën të gjithë anëtarët e saj do të trajtohen në mënyrë të barabartë, në të gjitha situatat, pa diskriminim.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton barazinë gjinore si vlerë themelore në shoqërinë tonë dhe nënkupton mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe të meshkujve në jetën ekonomike, sociale, politike, kulturore dhe në fushat e tjera të jetës shoqërore.

Sipas ligjit, barazia gjinore nënkupton ushtrimin e plotë dhe të barabartë të të drejtave të femrave dhe të meshkujve si dhe mbrojtjen nga diskriminimi me bazë gjinore në mundësi, përfitime, qasjen në shërbime dhe në jetën shoqërore e politike.

Sa i përket ankesave, të cilat Avokati i Popullit i ka pranuar gjatë kësaj periudhe, mund të nxirret përfundimi se diskriminimi gjinor është i pranishëm si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Rastet e diskriminimit gjinor rrallëherë denoncohen, për shkak të mosnjohjes së drejtave si dhe mungesës së praktikës gjyqësore në rastet e diskriminimit, megjithatë gjatë vitit 2019, Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar 65 raste sa i përket barazisë gjinore, prej të cilave 39 janë hapur si raste për hetime.

¹⁶⁸Ex officio nr. 340/2017

Barazia gjinore ndërlidhur me çështjen e së drejtës në punë

Diskriminimi gjinor në punë nënkupton kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë të pabarabartë në kontekstin e punës, për shkak të përkatësisë gjinore. Situata e vështirë sociale-ekonomike dhe niveli i lartë i papunësisë në Kosovë ndikon në varësinë e gruas nga bashkëshorti dhe familja e tij. Kjo posaçërisht ndodh në zonat rurale ku shumica e femrave nuk janë në gjendje t'i kenë burimet e tyre financiare dhe nuk kanë mundësi ta fuqizojnë veten në këtë aspekt.

Bazuar në ankesat e parashtruara në IAP, edhe gjatë këtij viti raportues është vërejtur fakti se gratë kanë pas vështirësi për të garuar në tregun e punës¹⁶⁹ dhe ato kanë shumë pak gjasa të punësimit, posaçërisht për pozita më të larta, madje edhe në rast kur ato kanë kualifikime të njejta.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka pranuar ankesa nga qytetarët lidhur me diskriminimin në marrëdhëniet e punës. Natyra e ankesave ka të bëjë me shkelje të së drejtës për punë në procedurat e konkurseve për zgjedhje dhe avancime, pastaj edhe me ngacmim seksualë në vendin e punës.

Avokati i Popullit i është drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë në cilësinë e mikut të gjykatës (Amicus Curiae), përkitazi me nevojën e mbrojtjes nga diskriminimi në bazë të gjinisë si dhe trajtimit të barabartë në punësim, duke iu referuar ankesës së pranuar në institucion.¹⁷⁰

Ky mendim juridik përqëndrohet në sqarimin e bazës dhe të analizës ligjore përkitazi me ankesën e ankueses, lidhur me diskriminimin në bazë të gjinisë dhe trajtimin e pabarabartë në procedurat e konkursit të brendshëm për pozita udhëheqëse në institucionin përgjegjës. Po ashtu, Avokati i Popullit ka ngritur edhe shqetësimin në përbërjen e komisionit vlerësues që ishte vetëm prej anëtarëve të gjinisë mashkullore dhe ka konsideruar se ka pasur shkelje të përfaqësimit të barabartë, konkretisht kategorisë kushtetuese dhe Ligjit për Barazi Gjinore.

Në këtë periudhë të raportimit është pranuar ankesë kundër një kompanie me autorizime publike, përkitazi me pretendimet e ankueses për ngacmim nga drejtori i saj, e që më pas ankuesja është ndëshkuar me mosvazhdim të kontratës së punës.¹⁷¹ Pas reagimit të Avokatit të Popullit ndaj autoritetit përgjegjës, autoriteti në fjalë ka dërguar përgjigje në të cilën thuhej se ankueses i ka skaduar kontrata e punës. Ndërkohë ankuesja ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Avokati i Popullit ka pranuar edhe dy ankesa të tjera lidhur me ngacmimin seksual në vend pune. Pas veprimeve të ndërmarra nga Avokati i Popullit, rastet janë proceduar nga punëdhënësi dhe nga autoritetet përkatëse.¹⁷²

Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe zbatimi i Ligjit për Barazi Gjinore

Avokati i Popullit vazhdimisht e ka ngritur çështjen e mospërfaqësimit të barabartë në listat e kandidatëve, të cilët garojnë në zgjedhje, për shkak se këto lista janë në kundërshtim me Ligjin nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore dhe me Ligjin nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe që këto

¹⁶⁹ A. nr. 119/2019

¹⁷⁰ A. nr. 637/2018

¹⁷¹ A. nr. 48/2019

¹⁷² A. nr. 577/2019

ligje kërkojnë trajtim të barabartë në të gjitha sferat. Kjo përfshin pjesëmarrjen në çështjet publike, të drejtën për të zgjedhë dhe të drejtën për të qenë i zgjedhur, të drejta të cilat nuk janë zbatuar në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019, si nga subjektet politike të cilat i kanë propozuar listat e kandidatëve, e as nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gjatë certifikimit të partive politike.

Avokati i Popullit në vitin 2018 e ka trajtuar çështjen e interpretimit të legjislacionit nëpërmjet parimeve të përgjithshme për interpretimin e akteve normative dhe zbatimin e këtyre parimeve në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përkatësisht të respektimit të barazisë gjinore.¹⁷³ Këto parime interpretuese të ligjit vlejné edhe në raportin ndërmjet Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore dhe Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me kërkesat e tyre për përfaqësim gjinor mes përfaqësuesve të zgjedhur.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton: *“Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30%) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30%) për qind janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë.”*

Ndërsa Ligji për Barazi Gjinore paraqet një kërkesë më të rreptë: *“Organet legislative (...) janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji.”*; duke theksuar: *“Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legislative arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse.”*

Cilit ligj duhet t'i jepet përparësi në rregullimin e kësaj çështjeje - Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme apo Ligjit për Barazi Gjinore? Në këtë rast, dy prej parimeve interpretuese janë relevante. Që të dyja i japin përparësi Ligjit për Barazi Gjinore.

Për sa i përket parimit *lex specialis*, në fillim mund të duket e paqartë se cili ligj duhet konsideruar i posaçëm dhe cili i përgjithshëm, mund të duket se secili ligj rregullon një fushë të ndryshme specifike, prandaj asnjëri nuk gëzon përparësi në raport me tjetrin. Prandaj, më 27 shtator 2019, Avokati i Popullit i ka parashtruar Gjykatës Themelore në Prishtinë (GjThP), gjegjësisht Departamentit të Përgjithshëm, padi me kërkesë për masë të përkohshme përkitazi me shkeljen nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të së drejtës për trajtim të barabartë të grave në të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes¹⁷⁴.

KQZ-ja i ka certifikuar listat me emrat e kandidatëve për deputetë të propozuara nga subjektet politike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019, megjithatë nuk i ka pasur parasysh garancitë kushtetuese e ligjore sa i përket barazisë gjinore, në mënyrë specifike trajtimin e barabartë të grave në të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes.

Avokati i Popullit, si institucion i barazisë sipas Ligjit për Barazi Gjinore dhe si institucion me kompetenca të përcaktuara edhe me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, i është drejtuar me padi

¹⁷³ Raporti me rekomandime nr. 441/2018, datë 28 shtator 2018.

¹⁷⁴ A.nr.743/2019

GjThP-së, duke kërkuar nga gjykata që të vendosë se sjellja e KQZ-së e ka shkelur të drejtën për trajtim të barabartë të grave në të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, të ndalojë ndërmarrjen e veprimtarive, të cilat shkelin apo mund të shkelin të drejtën për trajtim të barabartë, apo të kryejnë veprimtari të cilat eliminojnë diskriminimin apo pasojat e tij në lidhje me trajtimin e pabarabartë të grave në të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, dhe ta publikojë në media vendimin, i cili vërteton shkeljen e së drejtës për trajtim të barabartë.

Për më tepër, Avokati i Popullit, bashkë me padinë në fjalë, ka kërkuar edhe vendosjen e masës së përkohshme në procesin zgjedhor, mbi bazën e argumenteve që parashtron padia në fjalë dhe i kërkoi gjykatës aprovimin e kësaj mase.

E drejta e pronës dhe e trashëgimisë

Ligjet në fuqi i japin grave dhe burrave të drejta të barabarta në pronë, me gjithë faktin se shumica e pronave janë të regjistruara në emër të burrave. Pengesa më e madhe për një jetë të pavarur të grave është edhe fakti që gratë në shumicën e rasteve nuk kanë ndonjë pronë private. Ligjet të cilat mundësojnë zbatimin e barazisë gjinore dhe mundësojnë qasjen e barabartë të grave në pronë janë: Ligji për Pronën, Ligji për Barazi Gjinore, Ligji për Trashëgimi, Ligji mbi Familjen dhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Pozita e grave në lidhje me të drejtën e tyre për të trashëguar qëndron përballë një sërë pengesash sociale, ligjore dhe institucionale në Kosovë. Paragrafi 1 i nenit 3 të Ligjit të Trashëgimisë, përcakton: *“Të gjithë personat fizikë në kushte të njëjta janë të barabartë në trashëgimi”*, duke definuar qartësisht se ndarja e trashëgimit mes anëtarëve të familjes duhet të jetë në kushtet të njëjta, pa përjashtuar trashëgimtarët në baza gjinore. Megjithatë, në praktikë vërehen probleme sa i përket zbatimit të këtij ligji në lidhje me gjininë.

Ligji për Barazi Gjinore u mundëson pjesëmarrje të barabartë në të gjitha fushat jetësore të të dy gjinive në Kosovë, po ashtu edhe në të drejtën pronësore. Në zonat rurale vazhdon të ekzistojë përparësia e anëtarëve meshkuj të familjes për të trashëguar pronën familjare si pasojë e së drejtës zakonore, e cila në një masë të madhe vazhdon të ketë ndikim në shoqërinë kosovare. Sa i përket çështjes së pronës dhe trashëgimisë, në shoqërinë tonë është diskutuar shumë herë çështja e *heqjes dorë* nga trashëgimtarët në favor të trashëgimtarit, një situatë e tillë është e pranishme në të gjitha komunitetet në Kosovë.

Një hap pozitiv i Qeverisë së Kosovës, në drejtim të forcimit të masave afirmative të regjistrimit të pronës së përbashkët të bashkëshortëve, ka qenë miratimi i Udhëzimit Administrativ 03/2016. Në muajin maj të vitit 2019 është bërë ndryshimi i këtij udhëzimi (Udhëzimi 02/2019), me të cilin është zgjatuar periudha kohore e zbatimit të tij edhe për katër vjet. Qëllimi i kësaj mase afirmative ishte që të rrisë qasjen në pronë nga gratë, regjistrimi i pronës në emër të tyre si dhe ta përshpejtojë arritjen e barazisë mes burrave dhe grave në aspektin e të drejtave pronësore.

Beneficionet që kanë dalë nga ky udhëzim janë: lirimi nga tarifa për shërbimin e regjistrimit, lirimi nga tatimi mbi pronën për periudhën njëvjeçare dhe lirim nga tarifa për shpenzimin e noterit.

Rastet që ka pranuar Avokati i Popullit kanë të bëjë me shkeljen e së drejtës pronësore, janë duke u trajtuar në gjykatat kompetente dhe Avokati i Popullit është duke i monitoruar seancat gjyqësore. Megjithatë kjo nuk e ndalon Avokatin e Popullit që të zhvillojë hetime lidhur me ankesën në bazë të kompetencave të tij që burojnë nga Ligji për Barazi Gjinore dhe nga Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi.¹⁷⁵

Rrjedhimisht, Avokati i Popullit konsideron se edukimi, ngritja e nivelit të informimit mbi të drejtat pronësore, përfitimim e tyre si dhe hartimi i Strategjisë nacionale për të drejtat pronësore, kanë shumë rëndësi dhe konsiderohen si çështje thelbësore për t'u dhënë fund praktikave joformale të pengimit të grave për t'u shënuar si trashëgimtare të ligjshme.

Dhuna në familje

Ligji e përcakton dhunën në familje si formë e abuzimit që ushtrohet nga një person kundër personit tjetër dhe që rezulton në cenim të integritetit të tij fizik, moral, psikologjik, seksual, social ose ekonomik. Kjo lloj dhune nuk njeh asnjë mjedis kulturor, etnik, arsimor, apo ekonomik.

Avokati i Popullit, sikurse në raportet paraprake vjetor, edhe kësaj herë rekomandon përfshirjen e Konventës së Stambollit në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Me përfshirjen e kësaj Konvente, shteti në të ardhmen do të angazhohej për t'i marrë masat e nevojshme legislative dhe masa të tjera për të krijuar një sistem efektiv, gjithëpërfshirës dhe të koordinuar të parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna në familje, e cila nënkupton mbrojtjen nga diskriminimi në bazë të gjinisë.

Institucionet përgjegjëse kanë vështirësi për vlerësimin e prezencës së dhunës në familje. Pengesë për paraqitjen e rastit të dhunës në familje, ndër tjera, është edhe presioni dhe paragjykimet shoqërore ku dhuna në familje shihet si turp dhe si çështje private, e cila nuk duhet të paraqitet jashtë rrethit familjar. Vetë ekzistenca e Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje do të thotë se dhuna në familje nuk është vetëm çështje personale e një anëtarit të familjes, por është një çështje sociale dhe shtetërore, e cila duhet të trajtohet nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Gjatë këtij viti raportues, si një hap pozitiv, Avokati i Popullit e konsideron zbatimin e rekomandimit të tij, të parashtruara në raportet vjetore paraprake, për përfshirjen e dhunës në familje në Kodin Penal të Kosovës, në nenin 248, si veprën penale ku ushtruesi i dhunës dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.

Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për mbrojtje nga dhuna në familje, e miratuar nga qeveria (2016-2020), ka për qëllim që palët përgjegjëse të trajtojnë me prioritet të gjitha rastet e dhunës në familje, sigurojnë qasje në shërbime të integruara cilësore, garantojnë drejtësi dhe përgjegjësi për viktimat, sigurojnë rehabilitim dhe riintegrim të viktimave/mbijetuarve të dhunës në familje dhe të rrisin vetëdijësimin e mbarë shoqërisë sonë.

Rritja e numrit të rasteve të raportuara në polici, përveçqë tregon se aktet e dhunës janë në rritje, është tregues që viktimat gjatë kalimit të kohës janë edukuar ligjërisht për të raportuar dhunën tek autoritetet kompetente. Fuqizimi i grave për të njohur dhe të kërkuar të drejtat e tyre është fakt thelbësor në luftimin e dhunës, dhe jo vetëm në luftimin e dhunës fizike dhe psikologjike. Përveç kësaj, nevojitet

¹⁷⁵ A.nr.272/2019, A.nr.633/2019

punë shtesë për zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve për viktimat e dhunës, duke përfshirë ndihmën financiare, strehimin, arsimin, trajnimin dhe ndihmën për punësim, si dhe krijimi një numri të mjaftueshëm të shtëpive të sigurta për gratë dhe fëmijët që janë viktimat e dhunës.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Avokati i Popullit ka pranuar disa kërkesa për monitorimin e rasteve në Gjykatën Themelore në Prishtinë¹⁷⁶, në bazë të të cilave përfaqësuesit e Avokatit të Popullit kanë monitoruar proceset gjyqësore¹⁷⁷ për viktimat e dhunës në familje¹⁷⁸.

Gjatë vitit 2019, Avokati i Popullit, në pajtueshmëri me mandatin e tij kushtetues dhe ligjor, ka publikuar Raportin Ex. Officio nr. 346/2019, të cilin ua ka përcjellë autoriteteve përgjegjëse dhe i njëjti ka të bëjë me detyrimet pozitive të shtetit përkitazi me mbrojtjen nga dhuna në familje, për të drejtën në jetë, të drejta këto që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si dhe nga neni 2 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj.

Ky raport është iniciuar sipas detyrës zyrtare nga Avokati i Popullit, me qëllim që ta vlerësojë aplikimin e parimeve kryesore të detyrimeve pozitive të shtetit përkitazi me të drejtën në jetë, në lidhje me rastin e dhunës në familje, i datës 22 prill 2019, në lagjen Dardania të Prishtinës.

Raporti vlerëson realizimin efektiv të të drejtave të personave/viktima të dhunës në familje në Kosovë në raport me qasjen në kujdes dhe trajtim të kësaj kategorie të personave, duke u ndalur në veçanti tek diskriminimi, pabarazia, dështimi i autoriteteve gjegjëse në mbrojtjen e të drejtave të viktimave të dhunës në familje, si dhe detyrimet e shtetit për të mbrojtur jetën e qytetarëve. Këto të drejta të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente ndërkombëtare realizohen në praktikë përmes ligjeve, politikave dhe strategjive, implementimin e të cilave e ka analizuar ky raport, por meqenëse raporti konstatoi se ka shkelje sa i përket përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore kundrejt viktimave të dhunës në familje, si dhe detyrimeve të shtetit për të mbrojtur jetën e qytetarëve, Avokati i Popullit ka dalë me rekomandime konkrete për autoritetet gjegjëse lidhur me përmirësimin e gjendjes nga perspektiva e të drejtave të njeriut, me qëllim të ndërtimit të një sistemi në pajtim me parimet e sundimit të së drejtës.

- **Strehimoret**

Strehimoret ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje, shërbime rehabilituese dhe riintegruese cilësore për viktimat gra dhe fëmijë. Këto strehimore, përmes procedurave të aplikimit në MPMS, kanë pranuar përkrahje financiare në shumta të ndryshme, megjithatë ato janë të pa mjaftueshme për ofrimin adekuat të shërbimeve.

Edhe përkundër faktit se strehimoret përmes shoqërisë civile kanë avokuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës për një fond të qëndrueshëm nga buxheti i Kosovës, edhe sot situata mbetet e njëjtë. Akoma edhe sot nuk ka ndonjë fond emergjent, i cili do t'i përkrahte strehimore për të vepruar në situata ku kanë mungesë të fondeve financiare pavarësisht faktit se kërkesat për strehim të viktimave

¹⁷⁶ A.nr.307/2019

¹⁷⁷ A.nr. 521/2019

¹⁷⁸ A.nr.187/2019

janë të mëdha. Për ilustrim, vetëm gjatë vitit 2019, strehimorja e Prishtinës ka pasur 111 raste të trajtuara. Prandaj, Avokati i Popullit rekomandon që të sigurohen fondet e qëndrueshme për strehimoret në Kosovë, në mënyrë që viktimat e dhunës të trajtohen me dinjitet.

- **Gratë e mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës**

Gratë e mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës kanë filluar të trajtohen ligjërisht që nga viti 2018, kur është themeluar Komisioni dhe ka filluar aplikimi për njohjen e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës. Në raportin vjetor paraprak, Avokati i Popullit e ka ngritur si shqetësim formën e vendimeve të Komisionit pikërisht në pjesën e dispozitivit nuk përmban pjesën e arsytimit. Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës ka njoftuar Avokatin e Popullit se kjo praktikë është aplikuar me qëllim të ruajtjes së konfidencialitetit.

Megjithatë, Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës ka vepruar sipas rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe ka bërë ndryshime në formatin e vendimit për njohjen e statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës. Në zbatim të këtyre rekomandimeve, Komisioni Qeveritar, më 31 maj 2019, ka miratuar Udhëzuesin për rishqyrtimin e kërkesave për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës, i cili përmban formën e re të vendimit me arsytimin e kërkuar. Udhëzuesi është përgatitur në pajtim me dispozitat e Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Komunitetet pakicë në Kosovë

Avokati i Popullit gjatë kësaj periudhe raportuese ka pranuar 204 ankesa individuale nga pjesëtarët e të gjitha komuniteteve pakicë. Përveç ankesave individuale, IAP-ja e monitoroi situatën e përgjithshme me komunitetet në përgjithësi, por gjithashtu u bisedua me pjesëtarët e komuniteteve pakicë dhe përfaqësuesit e tyre në komunat Graçanicë, Ranillug, Prizren, Pejë, Lipjan, Dragash dhe Rahovec, si dhe me Komisionarin për gjuhë në Republikën e Kosovës.¹⁷⁹

Ashtu si në periudhën e mëparshme të raportimit, Avokati i Popullit konstaton se është bërë një përparim në disa çështje individuale, por nuk është bërë ndonjë përparim i madh dhe zgjidhje sistematike e problemeve, me të cilat përballen komunitetet pakicë në Kosovë, prandaj edhe me këtë rast e thekson domosdoshmërinë e zbatimit konsekuent të ligjit dhe parimit të barazisë para ligjit për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pa përjashtim.

Kthimi dhe siguria

Kur bëhet fjalë për kthimin e personave të zhvendosur dhe sigurinë e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, nuk ka ndonjë përmirësim të madh në raport me periudhën e mëparshme raportuese. Trendi i rënies së kthimit vazhdon edhe gjatë gjithë vitit 2019. Bazuar në statistikat e marra nga UNHCR-ja,

¹⁷⁹ Takimet u mbajtën në Ranillug (komuniteti serb) më 6.11.2019, Janjevë (komuniteti kroat) më 11.11.2019, Prizren (komuniteti boshnjak dhe turk) më 9.12.2019, me Komisionarin për gjuhë takimi u mbajt në Graçanicë më 13.12.2019, me drejtorin NVO VoRAE për situatën në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian takimi u mbajt në Graçanicë, më 18.12.2019. Informacionet lidhur me situatën e goranëve janë marrë me e-mail më 23.12.2019, kurse informacionet lidhur me komunitetin serb në komunat Pejë dhe Rahovec janë marrë më 1.12.2019, përkatësisht më 30.12.2019.

gjatë vitit 2018 janë kthyer 284 persona, kurse deri në fund të dhjetorit të vitit 2019 janë kthyer vetëm 190 persona, pjesëtarë të komuniteteve pakicë.¹⁸⁰

Përkundër raportimit shumëvjeçar për kushtet e jetesës dhe për strehimin e personave të zhvendosur që jetojnë në qendra kolektive për 20 vjet në Kosovë, në pjesët e banuara kryesisht nga pjesëtarë të komunitetit serbë, problemi ende nuk është zgjidhur plotësisht. Kjo çështje veçanërisht ka të bëjë me qendrat kolektive në komunën e Shtërpçës, ku ende jetojnë edhe 102 familje me gjithsej 247 persona. Përveç në Shtërpçe, qendrat kolektive janë akoma në funksion në pjesën veriore të Mitrovicës, Leposaviq, Zubin Potok dhe lagjen e kontejnerëve në Graçanicë.¹⁸¹

IAP-ja në periudhën raportuese e monitoroi punën dhe angazhimin e MKK-së në lidhje me çështjen e strehimit dhe ndihmës për të kthyerit, marrjen e dokumentacionit personal, integrimin dhe sigurinë. Në fakt IAP-ja i përshëndet përpjekjet dhe zbatimin e projekteve RRK5, të cilat i zbaton MKK-ja dhe përmes të cilave është siguruar çështja e banimit të 410 personave të kthyer, duke ndërtuar dhe pajisur me 60 shtëpi.¹⁸² IAP-ja gjithashtu e monitoroi përparimin e bërë në të ashtuquajturën “Nisma e Shkupit”, në kuadrin e së cilës janë formuar grupe të ndryshme pune, të cilat merren me të drejtat e pronës, dokumentet personale, sigurinë, dialogun dhe integrimin, menaxhimin e të dhënave dhe grupe të punës për planifikimin e zgjidhjeve. Pozitivisht mund të vlerësohet edhe puna për lëshimin e dokumenteve personale për personat e zhvendosur dhe të kthyerit, ku është bërë një përparim. Rezultatet pozitive u regjistruan gjithashtu gjatë vitit 2019 në lëshimin me kohë të lejeve të ndërtimit nga autoritetet komunale ku u ndërtuan shtëpitë për personat që janë kthyer.

Edhe pse Qeveria e Republikës së Kosovës në fillim të vitit 2018 e miratoi Rregulloren nr. 01/2018¹⁸³ për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, gjë të cilën edhe Avokati i Popullit e përshëndeti dhe e vlerësoi si qasje pozitive për zgjidhjen e problemeve të të kthyerve, rregullorja në fjalë nuk zbatohet plotësisht dhe në mënyrë konsistente. Përkatësisht, me këtë rregullore unifikohen procedurat midis mekanizmave të ndryshëm institucional, ndërsa është paraparë që institucioni qendror koordinues duhet të jetë MKK-ja, me ç’ rast për herë të parë është nxjerrë një kornizë juridikisht obliguese në lidhje me procesin e kthimit të personave të zhvendosur.

Situata e sigurisë është e qëndrueshme, disa incidente të përsëritura vazhdojnë të ndikojnë në perceptimin e sigurisë së pjesëtarëve të komunitetit serb dhe komunitetit rom, qoftë të atyre që jetojnë në Kosovë, qoftë atyre që janë zhvendosur, prandaj këto perceptime ndikojnë gjithashtu në klimën e favorshme në procesin e kthimit të këtyre individëve. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Kosovë (OSBE), në raportin e vet për “Vlerësimin e kthimit vullnetar në Kosovë”, i cili është publikuar në nëntor të vitit 2019, thekson se incidentet që evidentohen në vendet ku janë kthyer personat e zhvendosur më së shpeshti janë vjedhjet, sulmet verbale, por edhe fizike, zjarrvëniet, dëmtimi i trashëgimisë fetare lokale, bllokimi i vizitave për pelegrinët, si dhe kundërshtimet e hapura

¹⁸⁰ Sipas të dhënave statistikore zyrtare të UNHCR-së nga muaji janar deri në dhjetor të vitit 2019 janë kthyer 123 serbë kosovarë, 53 ashkalinj dhe egjiptianë dhe 14 romë.

¹⁸¹ Sipas të dhënave statistikore zyrtare të UNHCR-së të bëra në fund të dhjetorit 2019, në qendrat kolektive në Kosovë ende jetojnë 412 persona.

¹⁸² Në bazë të të dhënave që ka marrë IAP-ja nga MKK-ja, shtëpitë janë ndërtuar në komunat e Kosovës si në vijim: Graçanicë, Lipjan, Rahovec, Partesh-Pasjan, Novobërdë, Shtërpçe, Ranillug, Gjilan, Kllokot, Kamenicë dhe Vushtrri.

¹⁸³ Rregullore nr. 01/2018 e Qeverisë së Kosovës, e nxjerrë më 4.1.2018.

dhe protestat kundër kthimit të personave të zhvendosur.¹⁸⁴ IAP-ja megjithatë konsideron se, përveç asaj që u tha në aspektin e kthimit, më së shumti ndikon situata e pafavorshme ekonomike në vend, pra pamundësia e punësimit dhe pamundësia e sigurisë së qëndrueshme ekonomike, gjë që reflektohet edhe në faktin se për t'u kthyer vendosin vetëm popullata më e vjetër në moshë, kurse popullata e re në moshë shumë rrallë. Përveç faktit që nuk ka kthim të popullatës më të re, një problem i madh është gjithashtu shpërngulja e të rinjve nga radhët e të gjitha komuniteteve, për shkak të arsimit joadekuat dhe mungesës së mundësive për punësim. Çdoherë e më i madh është numri i atyre që pasi mbarojnë shkollën e mesme ose fakultetin shkojnë në vendet e rajonit, por edhe në vendet e BE-së, sepse nuk shohin ndonjë perspektivë për veten e tyre në Kosovë.

Përveç incidenteve më të shpeshta të lartpërmendura, që i prekin komunitetet e pakicave, duhet të theksohet gjithashtu se gjatë vitit 2019 në Lipjan varrezat ortodokse¹⁸⁵ u dëmtuan përsëri dhe e njëjta situatë është përsëritur në varrezat ortodokse në Rahovec. Edhe më tej, për shkak të protestave nga anëtarët e familjeve të personave të zhdukur, pamundësohet vizita e pjesëtarëve të komunitetit serb në varrezat dhe kishën ortodokse në Gjakovë.

Kur bëhet fjalë për veprat penale të nxitjes së urrejtjes kombëtare, racore dhe fetare, trazira dhe jotolerancë, në përputhje me nenin 147 të Kodit Penal të vjetër,¹⁸⁶ si dhe veprën penale të shkakimit të përçarjes dhe jotolerancës, sipas nenit 141 të Kodit Penal të ri,¹⁸⁷ nga data 1.1.2019 deri më 15.12.2019, Policia e Kosovës i regjistroi dhe hetoi vetëm 10 raste.

Përveç këtyre çështjeve të përgjithshme të sigurisë, IAP-ja gjithashtu e adresoi çështjen e sigurisë së komunitetit kroat në fshatin Janjevë të komunës së Lipjanit. Përkatesisht, më 26.2.2019, Avokati i Popullit e filloi një hetim sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) lidhur me sigurinë e qytetarëve kroatë dhe pronave të tyre në fshatin Janjevë.¹⁸⁸ Paralelisht me hapjen e hetimit të Avokatit të Popullit, komuniteti kroat nga Janjeva i dërgoi një letër të hapur Avokatit të Popullit me qëllim që të tërheqin vëmendjen për çështjen e sigurisë së vetë qytetarëve dhe pronave të tyre, për shkak të numrit të madh të vjedhjeve dhe grabitjeve në këtë fshat. Numri i madh i vjedhjeve janë bërë përditshmëri në Janjevë gjatë viteve të fundit, kurse policia ka qenë joefikase dhe e paaftë, për shkak të kushteve të dobëta, në të cilat punojnë në këtë fshat për të zgjidhur problemin në fjalë. Letra u nënshkrua nga 115 qytetarë të komunitetit kroat dhe me atë rast u bëjnë thirrje të gjitha institucioneve kompetente që të reagojnë, me qëllim që atyre t'u mundësohet një mjedis i sigurt, siguria dhe mbrojtja e pronave të tyre.

Avokati i Popullit, pas veprimeve të ndërmarra të hetimit dhe mbledhjes së informacionit dhe provave në terren, më datën 30.9.2019 i dërgoi Policisë së Kosovës një letër rekomandim me rekomandimin që Policia e Kosovës duhet të veprojë në përputhje me kompetencat që i janë dhënë me ligj, d.m.th. ta mundësojë rritjen e numrit të policëve në Janjevë, në mënyrë që të reagohet në mënyrë adekuate ndaj raportimit për autorët e krimit dhe që të punojnë në parandalimin e ekzekutimin të të njëjtave. Policia e Kosovës, brenda afatit ligjor, është përgjigjur se ajo është duke punuar për përmirësimin e gjendjes së

¹⁸⁴ <https://www.osce.org/sr/mission-in-kosovo/440744>.

¹⁸⁵ Në muajin korrik të vitit 2019 janë dëmtuar 24, kurse kah mesi i muajit dhjetor edhe 9 gurë varrezash në varrezat ortodokse në Lipjan, rasti është regjistruar në IAP kah mesi i muajit dhjetor si rast *ex officio* nr.952/19.

¹⁸⁶ Kodi pena nr. 04/L-082, neni 147.

¹⁸⁷ Kodi pena nr..06/L-074, neni 141. Kodi hyri në fuqi në muajin prill 2019.

¹⁸⁸ *Ex officio* nr. 133/2019

sigurisë në këtë fshat dhe se në periudhën në vijim pesë policë të tjerë do të caktohen të punojnë në stacionin lokal policor, me qëllim që të përmirësohet dukshmëria dhe perceptimi i sigurisë së banorëve të Janjevës. Po ashtu, përfaqësuesi i këtij fshati, kah fundi i vitit 2019, e informoi Avokatin e Popullit se janë shtuar patrullimet dhe se në Janjevë është përmirësuar situata e sigurisë, kështu që edhe numri i vjedhjeve dhe grabitjeve ishte zvogëluar.

Me problem të ngjashëm ballafaqohet komuniteti i goranëve, sepse në komunën e Dragashit, në fshatrat e banuara me goranë dhe boshnjakë, çdoherë e më të shpeshta janë vjedhjet dhe grabitjet, të cilat policia deri tani ka arritur t'i zgjidhë shumë pak. Banorët e këtyre fshatrave, në mënyrë të përsëritur, i janë drejtuar me kërkesën që të rritet numri i policëve ose nënstacioneve nëpër fshatra, mirëpo kërkesat e tyre nuk janë marrë parasysh. Në periudhën në vazhdim, Avokati i Popullit do t'i monitorojë zhvillimet e mëtejshme në lidhje me gjendjen e deklaruar të qytetarëve të komunës së Dragashit.¹⁸⁹

Regjistrimi civil dhe dokumentet e identitetit

Kur bëhet fjalë për çështjen e shtetësisë, regjistrimin civil dhe marrjen e dokumenteve të identitetit të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, qoftë të atyre që jetojnë në Kosovë, qoftë personave të zhvendosur, është e nevojshme të theksohet se ka pasur një përparim pozitiv në këtë çështje në krahasim me periudhën e mëparshme raportuese, por jo në të gjitha komunat në Kosovë. Në fakt, pas nxjerrjes së Vendimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) nr. 296/2018¹⁹⁰, me të cilin u lejohet të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, që e kanë regjistruar gjendjen e tyre civile në zyrat paralele të regjistrave civil të Republikës së Serbisë në territorin e Kosovës në periudhën prej 10.06.1999 deri më 14.09.2016, që të paraqesin kërkesat e tyre për regjistrim në Regjistrin qendror të gjendjes civile të Republikës së Kosovës, ku në bazë të certifikatës për gjendjen civile të lëshuar nga ana e institucioneve paralele ta bëjnë regjistrimin në Regjistrin qendror të gjendjes civile të Kosovës.

Pas skadimit të Vendimit të parë të MPB-së, i cili ishte i vlefshëm deri në fund të qershorit të vitit 2019, MPB në përputhje me kompetencat e veta lidhur me këtë çështje, e zgjati afatin për regjistrimin në fjalë dhe rregullimin e statusit qytetar me Vendimin nr. 785/19,¹⁹¹ i cili ishte i vlefshëm deri më 31.12.2019. Avokati i Popullit e monitoroi zbatimin e përshkrimit dhe njohjes së regjistrimit të fakteve dhe gjendjes së statusit qytetar, para së gjithash të pjesëtarëve të komunitetit serb dhe rom dhe me informacionet e marra nga terreni nga qytetarët dhe nga organizatat e shoqërisë civile dhe OJQ-të, mund të konstatohet se vendimi në fjalë i MPB-së pa ndonjë problem është aplikuar në të gjitha komunat e Kosovës. I vetmi përjashtim i transparencës dhe informimit të qytetarëve lidhur me regjistrimin në regjistrin civil të Republikës së Kosovës është shënuar në Pejë dhe Klinë, ku ka pasur ankesa të qytetarëve¹⁹² për zbatim jo të vazhdueshëm të këtij Vendimi nga ana e Zyrës së Regjistrimit Civil në këto komuna.

¹⁸⁹ Informatat lidhur me vjedhjet e shpeshta dhe grabitjet në fshatrat e komunës së Dragashit, IAP i mori përmes e_mailit më 23.12.2019 nga përfaqësuesi i komunitetit goranë.

¹⁹⁰ Vendimi i MBP nr. 296/2018, që u miratua më 05.07.2018., zbatim i të cilit filloi kah fundi i muajit gusht të vitit 2018. (i cili u nxor në pajtim me Marrëveshjen e Brukselit midis Kosovës dhe Serbisë)

¹⁹¹ Vendimi i MBP nr. 785/2019, që u miratua më 15.07.2019. dhe ka qenë në fuqi deri më 31.12.2019.

¹⁹² A. nr.446/2019

Për dallim nga viti 2018, kur një numër i madh ankesash janë paraqitur në IAP kundër zyrave të regjistrimit civil në Mitrovicën jugore, ndërsa nga ana e qytetarëve që jetojnë në Mitrovicën veriore, gjatë vitit 2019 ka qenë vetëm një ankesë, e cila është zgjidhur pozitivisht në pajtim me kërkesën e palës¹⁹³ për marrjen e certifikatës nga regjistri qendror i të lindurve dhe shtetësisë së Republikës së Kosovës. Në përmirësimin e situatës lidhur me lëshimin e certifikatave të lindjes dhe nënshetësisë kanë kontribuar edhe vendimet në fjalë të MPB të Republikës së Kosovës, në bazën e të cilave qytetarët kanë pasur mundësi ta rregullojnë statusin e tyre civil edhe në veri të Kosovës. Mirëpo, edhe më tutje mbetet e hapur çështja dhe problemi lidhur me zyrat për regjistrimin civil, të cilat nuk gjenden në qendrat e tyre në komunat Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq, por gjenden në fshatrat Çabër, Lipë dhe Banjë. Edhe pse Avokati i Popullit në raportin vjetor për vitin 2018 u bëri thirrje institucioneve kompetente që t'i kthejnë këto zyra të zhvendosura në qendrat e tyre urbane, sepse komunat në tri qytetet e përmendura në veri u bënë funksionale, kjo nuk ka ndodhur deri më tani.

Edhe në këtë periudhë raportuese, si në të gjitha periudhat e mëparshme, Avokati i Popullit tregon për mungesën e dokumenteve personale të pjesëtarëve të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Situata me dokumentet personale është përmirësuar deri diku, falë organizatave të shoqërisë civile, si dhe projektit të UNHCR, por ende ekziston një nevojë e madhe për të rritur ndërgjegjësimin për nevojën e qytetarëve pjesëtarë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptianë për ta regjistruar statusin e tyre civil dhe statusin e fëmijëve të tyre të mitur. Problem me marrjen e dokumenteve personale veçanërisht kanë të kthyerit, që janë pjesëtarë të këtyre tri komuniteteve, të cilët kthehen në Kosovë nga Maqedonia Veriore, Serbia dhe Mali i Zi. Për shkak të mungesës jo vetëm të dokumentacionit personal, por edhe për shkak se ata nuk janë të regjistruar në regjistrin qendror civil, një numër i qytetarëve nga radhët e komuniteteve në fjalë, juridikisht janë të padukshëm për sistemin, kështu që ata nuk janë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre në asnjë mënyrë, para së gjithash të atyre të drejtave që kanë të bëjnë me përfitimet sociale dhe ndihmën për personat në nevojë.

Të drejtat pronësore

Ashtu si në periudhat e mëparshme të raportimit, Avokati i Popullit edhe në këtë raport vjetor e adresoi gjithashtu çështjen e të drejtave pronësore të komuniteteve pakicë. Duke pasur parasysh që nuk ka pasur zhvillime konkrete pozitive në krahasim me periudhën e mëparshme të raportimit, Avokati i Popullit e konstaton dhe e rithekson shqetësimin e tij në lidhje me uzurpimin e paligjshëm të pronave private të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Kosovë, kryesisht komunitetit serb dhe rom, si dhe pjesëtarëve të komunitetit shqiptar në veri të Kosovës. Shumica e ankesave të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë të paraqitura tek Avokati i Popullit kanë të bëjnë me mbrojtjen e së drejtës së pronës, d.m.th. uzurpimin dhe/ose ri-uzurpimin e pasurive të paluajtshme, lëndët e të cilave janë në pritje para autoriteteve gjyqësore, si lëndë penale, por edhe si lëndë civile. Ende ekziston një numër i madh i lëndëve që janë të pazgjidhura në të gjitha instancat e gjyqësorit, vetëm prokuroritë kanë vazhduar të zbatojnë në mënyrë të vazhdueshme parimin e përparësisë së çështjeve të uzurpimit, gjë të cilën Avokati i Popullit me këtë rast e përshëndet dhe e vlerëson si një shembull pozitiv, me të cilin do të duhej të menaxhoheshin edhe organet gjyqësore, në të gjitha instancat.

¹⁹³ A. nr.559/2019

Sipas praktikës së vendosur, përveç IAP, me monitorimin e situatës lidhur me pronat e uzurpuara dhe me raportime merret edhe misioni i OSBE-së në Kosovë, i cili lidhur me këtë çështje, në mesin e nëntorit 2019, organizoi një punëtori gjithëpërfshirëse, në të cilën mori pjesë edhe IAP me përfaqësuesit e vet.¹⁹⁴ Përveç IAP morën pjesë edhe përfaqësues të Policisë së Kosovës, përfaqësues gjyqarë të Gjykatave Themelore nga të gjitha rajonet e Kosovës, përfaqësues të prokurorive nga të gjitha rajonet e Kosovës, si dhe përfaqësues të Agjencisë për Verifikimin e Pronave (ish-Agjencia Kosovare e Pronës, e cila ishte edhe pasardhësi ligjor i Drejtorisë për çështje banesore dhe pronësore (HPD) si kuazi autoritet gjyqësor *ad hoc* për t'i zgjidhur kërkesat në lidhje me pronën e uzurpuar dhe njohjen e të drejtave të pasurive të patundshme në Kosovë). Misioni i OSBE-së në këtë mënyrë, edhe një herë e theksoi, ashtu siç bëri Avokati i Popullit në periudhat e mëparshme të raportimit, domosdoshmërinë për t'u dhënë përparësi qoftë lëndëve penale, por edhe atyre civile që kanë të bëjnë me uzurpimin e pronës, në veçanti pronës së pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Kosovë. Gjithashtu, me këtë rast, u theksua, gjë të cilën e mbështet edhe IAP, që rastet uzurpimit që janë zgjidhur tashmë para HPD-së dhe më vonë para KPA-së të mos rishqyrtohen në procedurat e rregullta gjyqësore në Kosovë. Kjo mënyrë e shqyrtimit të lëndëve tashmë të zgjidhura paraqet mosrespektim të vendimeve të HPD-së dhe KPA-së, pra autoritetet gjyqësore diskutojnë në mënyrë të përsëritur për të drejtat pronësore të çështjeve tashmë të zgjidhura dhe kështu e dërgojnë një sinjal negativ për qytetarët, të cilët me vite të tëra nuk kanë mundësi ta kenë në dispozicion pronën e vet, që paraqet të drejtën e tyre të garantuar jo vetëm me Kushtetutë dhe me ligj, por të drejtën që ta gëzojnë në paqe pronën e vet, e cila gjithashtu garantohet me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)¹⁹⁵ me protokollet e saj.

Ankesat e paraqitura në IAP vitet e fundit, pra që janë parashtruar për uzurpim të pronës së personave privat në Kosovë tashmë janë zgjidhur, por edhe më tej organet gjyqësore, duke e injoruar faktin dhe parimin ligjor që për çështjen tashmë të gjykuar, nuk duhet diskutuar, vazhdojnë të trajtojnë padi të tilla, duke i sjellë autoritetet gjyqësore në pozitën që për shkak të mosrespektimit të parimit *res judicata* përsëri t'ua pamundësojnë pronarëve të patundshmërive që lirshëm ta kenë në dispozicion pronën e patundshme. Në lidhje me këtë çështje, Avokati i Popullit e shfrytëzon rastin të rikujtojë se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në aktgjykimin e vet në çështjen KI-104/10 dha opinionin e vet dhe se lëndët e natyrës pronësore, për të cilat tashmë është marrë një vendim i formës së prerë nga HPD dhe më vonë nga KPA nuk mund të jenë subjekt i rishqyrtimit të cilitdo autoritet tjetër gjyqësor ose administrativ në Kosovë, por që ato janë *res judicata* dhe që çdo ndërhyrje dhe rishqyrtim nga gjykatat ose autoritetet administrative mund të konsiderohet shkelje e të drejtave të qytetarëve, të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.¹⁹⁶ Prandaj, Avokati i Popullit është i mendimit se nëse organet gjyqësore, në lëndët civile të cilat janë zgjidhur tashmë nga HPD dhe/ose KPA, do të thirreshin në praktikën gjyqësore të Gjykatës

¹⁹⁴ Punëtorja në organizimin e misionit të OSBE-së në Kosovë me temën “Ri uzurpimi i kundërligjshëm i pronës” që u mbajt më 14.11.2019.

¹⁹⁵ KEDNJ, protokollit 1, neni 1 Mbrojtja e pronës „Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën që t'i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. [...]“

¹⁹⁶ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës i datë 23.04.2012, lënda nr. KI-104/10 Arsić Draža, pika 74., 75. i 77. aktgjykimi.http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ki_104_10_srb.pdf

Kushtetuese, në këtë mënyrë do ta zvogëlonin numrin e lëndëve që janë ende të pazgjidhura dhe kështu do ta zvogëlonin numrin e lëndëve të pazgjidhura dhe po ashtu do ta rrisnin efikasitetin në punën e tyre lidhur me këtë çështje. Për më tepër, duhet të insistohet në konsistencën në zbatimin e marrëveshjes së vitit 2009 ndërmjet AKP-së dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës për detyrimin e AKP-së për t'ia siguruar Agjencisë Kadastrale të Kosovës kopjet elektronike të vendimeve përfundimtare të Komisionit për çështje banesore dhe pronësore dhe HPD-së, me qëllim të azhurnimit të të dhënave kadastrale dhe regjistrimit të të drejtave pronësore në pasuri të paluajtshme. Meqenëse kjo marrëveshje nuk është jetësuar plotësisht, IAP mori ankesa për refuzim që prona e uzurpuar, e cila i është kthyer në posedim pronarëve edhe më tutje mbahet ose ndërmarrjet publike ose nga ish Ndërmarrja Publike e Strehimit.¹⁹⁷

Përveç lëndëve që lidhen drejtpërdrejt ose indirekt me uzurpimin e pasurisë, IAP gjithashtu ka regjistruar ankesa që kanë të bëjnë me punën e përmbaruesve privatë, kur bëhet fjalë për evikSIONIN e personave, të cilët në mënyrë të paligjshme gjenden në posedim të pronës së patundshme.¹⁹⁸ Është vërejtur se përmbaruesit refuzojnë të punojnë në lëndët e evikSIONIT të personave dhe gjësendeve nga prona e uzurpuar, ose më shpesh ndodh që zvarritet procedura e përmbarimit pa ndonjë arsytim të qartë dhe të justifikuar me ligj për veprime të tilla. Me këtë rast, Avokati i Popullit shpreh shqetësimin e tij për këtë çështje dhe u bën thirrje organeve kompetente, të cilët e mbikëqyrin punën e përmbaruesve privatë, që me kujdesin e duhur dhe me seriozitet ta shqyrtojnë çdo ankesë të paraqitur kundër zvarritjes në procedurat përmbarimore nga e përmbaruesve privatë, veçanërisht kur bëhet fjalë për evikSIONIN e personave, të cilët në mënyrë të paligjshme e uzurpojnë pronën e paluajtshme edhe pasi të jenë nxjerrë aktgjykime përfundimtare dhe të zbatueshme të autoriteteve gjyqësore.

Arsimi

Situata me arsimin në dy pista paralele vazhdon ende, siç raportoi Avokati i Popullit gjatë gjithë viteve të kaluara, kështu që situata në lidhje me arsimimin e komuniteteve pakicë nuk ka ndryshuar që nga periudha e mëparshme e raportimit.

Duhet marrë parasysh që arsimi në gjuhën serbe është i organizuar në të gjitha nivelet dhe në të gjitha zonat e Republikës së Kosovës, në të cilat jetojnë pjesëtarë të komunitetit serb, si dhe disa komunitete që e flasin gjuhën serbe (kroatët, një numër goranësh në Komunën e Dragashit, malazezët dhe romët, si dhe boshnjakët në veri të Kosovës). Ky sistem arsimor është akoma plotësisht i ndarë nga sistemi arsimor i Republikës së Kosovës dhe funksionon sipas kurrikulës së Republikës së Serbisë. Kjo situatë, për arsye politike, zgjat me vite të tëra. Komunitetet e tjera minoritare (turqit, boshnjakët, romët që jetojnë në zonat me shumicë shqiptare, si dhe Ashkalitë dhe Egjiptianët) ndjekin procesin mësimor sipas planit dhe programit të MASHT-it në gjuhën shqipe, turke dhe/ose boshnjake.

Ende nuk ka rezultate në zgjidhjen problemit të cilësisë së librave shkollorë në gjuhën boshnjake dhe turke, kështu që ky problem është akoma i pranishëm në të gjitha nivelet e arsimit. Kjo ka të bëjë qoftë me përkthimin e dobët të teksteve shkollore, qoftë në mos disponueshmërinë e teksteve shkollore për klasat e larta të arsimit fillor dhe të mesëm. Pjesëtarët e komuniteteve turke dhe boshnjake vazhdojnë

¹⁹⁷ A. nr.785/2019

¹⁹⁸ A. nr.908/2019

të ankohen për mësimin e shqipes në kuadër të arsimit fillor dhe të mesëm, sepse nxënësit gjatë arsimit në gjuhën e tyre amtare nuk mund të marrin njohuri të mjaftueshme në gjuhën shqipe.

Komuniteti boshnjak i Prizrenit e ka theksuar gjithashtu problemin e organizimit të orëve mësimore për 10 nxënës në shkollën fillore „Nazim Kokolari-Budakova“ në fshatin Jaglenicë, të cilët i vijnë mësimet në gjuhën boshnjake. Nxënësit në fjalë kanë mundësi t'i ndjekin mësimet në ndërtesën e shkollës fillore në fshatin Jaglenicë në gjuhën boshnjake vetëm deri në klasën e 5-të, kurse pas përfundimit të klasës së 5-të, është paraparë që këta nxënës nga klasa e 6-të të vazhdojnë të udhëtojnë në Prizren dhe ta organizojnë transportin personal, gjë që sipas pretendimeve të prindërve është e panevojshme, sepse kjo shkollë ka hapësira, të cilat mund të përdoren për mësimdhënie për të gjithë 10 nxënësit e mësimin në gjuhën boshnjake deri në përfundimin e arsimit fillor. Më 25 qershor 2019, prindërit e nxënësve iu drejtuan me një kërkesë Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prizrenit, megjithatë, deri në mes të dhjetorit 2019, ata nuk morën përgjigje në kërkesë e tyre që fëmijëve t'u mundësohet ta vazhdojnë arsimin në klasën e 6-të në fshatin e tyre.¹⁹⁹ IAP lidhur me këtë çështje, kah mesi i dhjetorit 2019, e njoftoi përfaqësuesin e Komunës së Prizrenit, të caktuar për bashkëpunim me IAP. Lidhur me këtë çështje është duke u zhvilluar monitorimi i mëtejshëm i situatës.

Deri në vitin e fundit akademik 2018/19, pjesëtarët e komuniteteve turke dhe boshnjake kanë pasur mundësi të regjistrohen dhe studiojnë në gjuhën e tyre në Universitetin Shtetëror "Ukshin Hoti" në Prizren, por që nga viti akademik 2019/20, kjo nuk është më e mundur, pasi akreditimi i universitetit është hequr. Studentëve, të cilët gjatë vitit të kaluar dhe gjatë viteve paraprake kanë qenë të regjistruar në këtë universitet, u është lejuar t'i ndjekin ligjëratat dhe t'u nënshtrohen provimeve, por këtë vit nuk u mundësua regjistrimi i studentëve të rinj. Përveç Universitetit të Prizrenit, pjesëtarët e komunitetit boshnjak kanë pasur mundësi të studiojnë në gjuhën e tyre edhe në Universitetin shtetëror „Haxhi Zeka“ në Pejë, të cilit i është ndërprerë akreditimi që nga viti akademik 2019/20. Nëse brenda një viti, këto universitete nuk arrijnë t'i përmbushin standardet e përcaktuara edhe pas vlerësimi të dytë negativ, atyre u kërcënohet mbyllja e plotë.

Komuniteti turk, përveç pamundësisë për t'i regjistruar studimet në gjuhën e vet në Prizren, për shkak të humbjes së akreditimit të Universitetit Shtetëror "Ukshin Hoti" në Prizren, nxori në pah problemin e testeve të Maturës në gjuhën turke për nxënësit, të cilët i kaluan këto provime pasi e mbaruan shkollën e mesme. Përkthimi i testeve të Maturës në gjuhën turke ka qenë, sipas tyre, shumë i dobët, i palexueshëm dhe i pakuptueshëm. Ata theksuan se ky problem po zgjat tashmë 3 vjet dhe se ata kishin njoftuar për këtë MASHT-in, mirëpo lidhur me lidhur me përkthimin e testeve në gjuhën turke nuk është ndërmarrë asgjë. Kur bëhet fjalë për librat shkollorë, situata është e njëjtë si me librat shkollorë në gjuhën boshnjake. Komuniteti turk importon libra shkollorë për të gjitha nivelet e arsimit nga Turqia, gjë që deri diku paraqet problem për shkak të papajtueshmërisë së sistemeve arsimore të Kosovës dhe Turqisë. Është theksuar edhe problemi lidhur me zhvillimin profesional të mësimdhënësve që japin mësim në gjuhën turke. Sipas pretendimeve të përfaqësuesve të komunitetit turk, seminarët ose cilado formë e aftësimit profesional të mësimdhënësve nuk janë të disponueshme në gjuhën turke, por vetëm në gjuhën shqipe, kështu që këta mësimdhënës edhe më tej janë të

¹⁹⁹ Informata është marrë në mbledhjen, e cila është mbajtur më 09.12.2019 në Prizren me përfaqësuesen e komunitetit boshnjak, kur IAP i është dorëzuar kopja e kërkesës së prindërve drejtuar komunës së Prizrenit më 25.06.2019.

përfshirë nga procesi i zhvillimit profesional në fushën e arsimit. Me këtë rast, qoftë nga pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, qoftë nga pjesëtarët e komuniteteve turke, boshnjake dhe gorane është theksuar edhe problemi që kuota prej 12% e vendeve të rezervuara për pjesëtarët e komuniteteve pakicë në universitetet shtetërore në Republikën e Kosovës nuk është përmbushur.²⁰⁰ Një shembull, të cilin e citoi Koordinator i Drejtorisë së Arsimit për Komunitetet jo-shumicë në Dragash, është rasti i regjistrimit në Fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin e Prishtinës, ku nga gjithsej 18 vende të rezervuara për studentë nga radhët e komuniteteve pakicë, shtatë prej tyre sa kanë aplikuar për regjistrim, nuk është pranuar asnjë nga radhët e komuniteteve pakicë.

Situata në arsimin e pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian gradualisht po përmirësohet nga viti në vit, kurse përqindja e fëmijëve që e ndjekin arsimin e detyrueshëm në të dy sistemet arsimore është rritur ndjeshëm. Edhe këtu situata nuk ka ndryshuar shumë që nga raportimi i mëparshëm i Avokatit të Popullit. Po ashtu na gëzon fakti që numri i studentëve në fakultete, që vijnë nga radhët e këtyre tri komuniteteve, kështu që në vitin akademik 2019/2020 janë regjistruar 53 studentë, që është 11 më shumë se një vit më parë.²⁰¹

OJQ-të lokale, të koordinuara dhe të udhëhequra nga OJQ-ja "VoRAE" nga Graçanica, me mbështetjen financiare të organizatave dhe donatorëve ndërkombëtarë, vazhdojnë ta udhëheqin me sukses një projekt mbështetjeje dhe ndihme në të nxënë për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta nga radhët e këtyre tri komuniteteve më të cenueshme. Mbështetje u ofrohet nxënësve përmes 20 qendrave arsimore që veprojnë në tërë Kosovën që synojnë uljen e niveleve të braktisjes së shkollës dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit. Përkundër sukseseve të mëdha që kanë arritur këto qendra në punën e tyre me fëmijët, edhe miratimit të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it për krijimin dhe funksionimin e qendrave arsimore të lartpërmendura, MASHT-i nuk e filloi zbatimin e tij, por përkundër buxhetit të alokuar, as nuk filloi financimi i qëndrueshëm i këtyre Qendrave Arsimore. Qendrat arsimore vazhdojnë të financohen përmes donacioneve përmes OJQ-ve.²⁰² Praktika pozitive e bursave për nxënësit të shkollave të mesme që i përkasin komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian nga ana e OJQ-së VoRAE, qeverisë së Zvicrës dhe MASHT-it, vazhdon. Duke pasur parasysh situatën e dobët ekonomike dhe sociale të familjeve romë, ashkali dhe egjiptiane, fëmijët nga këto komunitete shpesh e braktisin arsimin gjatë shkollës së mesme. Brenda vitit 2019, bursat dedikuar për këta nxënësit kanë siguruar mbështetje të mëtijshme për 500 fëmijë dhe kanë stimuluar motivimin e tyre për arsimim të mëtutjeshëm.²⁰³

Kur bëhet fjalë për njohjen dhe verifikimin e diplomave nga Universiteti i Mitrovicës Veriore (UMV), që nga miratimi i rregullores së Qeverisë në vitin 2015, e njëjta ka vazhduar të jetë e suksesshme.

²⁰⁰ Udhëzimi Administrativ nr.09/2016 për zbatimin e masave afirmative dhe numrit të vendeve të mbrojtura për regjistrimin e studentëve nga radhët e komuniteteve pakicë në institucionet publike të shkollimit të lartë.

²⁰¹ Të dhënat janë marrë nga raporti i misionit të OSBE-së në Kosovë „Rishikimi i pozitës së komunitetit rom, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë“, që u publikua në janar të vitit 2020., qasja më 10.01.2020. <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/443587>

²⁰² Informatat janë marrë në takimin me drejtorin e OJQ-së “VoRAE” që u mbajt në Graçanicë më 18.12.2019. dhe nga <https://vora.org/programs/1>

²⁰³ Po aty

Sidoqoftë, nuk është tejkeluar problemi në lidhje lënien jashtë procesit të verifikimit të diplomave që lëshohen nga sistemi arsimor serb brenda Kosovës, por me vulën dhe formularët që i lëshon Republika e Serbisë. Në lidhje me këtë çështje, IAP mori një ankesë nga një person, i cili pasi e mbaroi shkollën e mesme të ekonomisë në Llapnasellë, Komuna e Graçanicës, u paraqit për arsimim të mëtutjeshëm në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ANVS/ASHNA), në një konkurs për studentët e kontrollit të trafikut ajror.²⁰⁴ Mirëpo, gjatë paraqitjes së dokumentacionit, diploma e tij e shkollës së mesme nuk u vlerësua si e vlefshme dhe nga ankuesi është kërkuar që paraprakisht në afatin e caktuar ta nostrifikojë diplomën e shkollës së mesme, të cilën e ka kryer në Llapnasellë, në mënyrë që aplikacioni i tij të mund të merrej në konsideratë, gjë që nuk ishte e mundur. ANVS/ASHNA, në shpjegimin e vet për Avokatin e Popullit, në lidhje me ankesën e parashtruar të ankuesit, theksoi se lidhur me këtë çështje e kishte kërkuar edhe mendimin e MASHT-it, i cili i dha kësaj Agjencie udhëzime, sipas të cilave diploma e shkollës së mesme në Llapnasellë duhet të nostrifikohet, në mënyrë që e njëjta të merret në konsideratë.²⁰⁵

Për më tepër, në lidhje me kriteret dhe udhëzimet që e rregullojnë çështjen e diplomave të shkollave të mesme, Avokati i Popullit gjithashtu kërkoj një shpjegim nga Policia e Kosovës, e cila publikon konkurse për kadetë të Akademisë së Policisë.²⁰⁶ Në përgjigjen e Policisë së Kosovës theksohet se Policia e Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme nuk kërkojnë nga kandidatët që e kanë mbaruar shkollën e mesme brenda sistemit arsimor serb që t'i nostrifikojnë diplomat, por të njëjta i njohin si valide me rastin e aplikimit për kandidat për Akademinë e Policisë.²⁰⁷ Ankesa e përmendur është ende në procedim e sipër në IAP.

Bazuar në të gjitha sa tha më sipër, mund të konstatohet se nuk ekzistojnë udhëzime dhe instruksione unike të MASHT-it, por vendimet për validitetin e këtyre diplomave merren nga vetë institucionet e arsimit dhe institucionet e tjera në diskrecionin e tyre. Avokati i Popullit konstaton se kjo situatë është kundër produktive dhe se është e domosdoshme të miratohen udhëzime unike dhe kjo çështje të shqyrtohet nga institucionet kompetente me qëllim të inicimit të aktiviteteve të caktuara dhe gjetjes së një zgjidhjeje të qëndrueshme për këtë problem.

Përdorimi i gjuhës

Duke marrë parasysh që ende ekzistojnë sfida në përdorimin e gjuhës serbe si një nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës, në komunikimin e qytetarëve me organet shtetërore, por gjithashtu edhe brenda institucioneve publike, Avokati i Popullit me këtë rast mund të konstatojë se ka probleme me zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhës.

Edhe më tutje nuk zbatohet dygjuhësia e garantuar me Kushtetutë dhe me Ligjin për përdorimin e gjuhëve,²⁰⁸, ndërsa progresi në këtë drejtim është duke u zhvilluar shumë ngadalë.

²⁰⁴ A. nr. 210/2019

²⁰⁵ Avokati i Popullit ia dërgoi letrën ANVS/ASHNA më 03.09.2019, kurse shpjegimin nga ANVS/ASHNA, IAP e mori më 19.09.2019.

²⁰⁶ Email i dërguar nga IAP Policisë së Kosovës më 30.09.2019.

²⁰⁷ Përgjigja e Policisë së Kosovës, dërguar me email më 10.10.2019.

²⁰⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 5 dhe 59. Dhe Ligji nr. 02/L-037 për përdorim të gjuhëve,

Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit i dërgoi një letër rekomandimi Odës së përbaruesve privatë të Kosovës për një ankesë, të cilën IAP e regjistroi në fund të vitit 2018,²⁰⁹ që ka të bëjë me pagesën e një përkthimi të dokumentacionit zyrtar nga gjuha shqipe në gjuhën serbe nga ankuesi. Fatkeqësisht, Oda e përbaruesve privatë të Kosovës, por edhe personalisht ekzekutuesi privat, për punën e të cilit ishte drejtuar ankesa, nuk e kanë respektuar rekomandimin e Avokatit të Popullit dhe konsideruan se për përkthim duhej të bëhej pagesa.²¹⁰ Në këtë rast, Avokati i Popullit konstaton se ata persona, profesioni i të cilëve duhet domosdoshmërisht të kenë njohuri për ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, përveç të tjerash, nuk i zbatojnë Ligjet dhe nuk e respektojnë Kushtetutën në një mënyrë të qëndrueshme, siç ua kërkon jo vetëm profesioni por edhe Kushtetuta. Për këtë rast u informua edhe Komisioneri për Gjuhë i Republikës së Kosovës.

Gjatë këtij viti, Avokati i Popullit pranoi një ankesë nga “Iniciativa për Progres-INPO” (INPO), e cila ishte ngritur kundër komunës së Kllokotit, që ka të bëjë me kërkesën e INPO për qasje në dokumente publike. Komuna e Kllokotit kërkoi që kërkesa për qasje në dokumente publike të dorëzohet në gjuhën serbe, në mënyrë që komuna të mund t'i përgjigjet kërkesës së tyre. Në lidhje me këtë, Avokati i Popullit dy herë iu drejtua me letër komunës së Kllokotit, në të cilat mori përgjigje ku u informua që përfaqësuesit e INPO-s duhet të drejtohen zyrtarëve përgjegjës. Avokati i Popullit është duke monitoruar rezultatin e kësaj kërkesë për qasje në dokumente publike.

Në një bisedë me Komisionerin për Gjuhë në Republikën e Kosovës, të realizuar për të marrë informacione për mësimin e mbi përdorimin e gjuhëve, por me qëllim të raportimit vjetor të Avokatit të Popullit për këtë çështje, Komisioneri për Gjuhët deklaroi se zyra e tij pranoi vetëm 18 ankesa gjatë vitit 2019.²¹¹

Gjithashtu, në takim u konstatua se ende nuk ka është bërë zgjidhje sistematike për mësimin e të dy gjuhëve zyrtare, gjë që është shumë keq, meqë është e domosdoshme jo vetëm që të integrohen qytetarët që flasin vetëm serbisht, por kështu do të gjendej një mënyrë që të iniciohej ndërveprimi midis pjesëtarëve të komunitetit shqiptar dhe do të ndërpritej polarizimi i mëtutjeshëm i shoqërisë në përgjithësi. Sa i përket themelimit të Njesisë Qendrore të Përkthimit, formimi i së cilës është iniciuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës kur u mor vendimi në vitin 2017, për formimin e saj, kjo nuk ndodhi as gjatë vitit 2019. Ajo që është bërë në lidhje me këtë është se grupi i punës ka mbajtur disa takime dhe është hartuar koncept dokumenti si një propozim për funksionimin e Njesisë Qendrore të Përkthimit në nivelin e Qeverisë. Besohet se kjo njësi e përkthimit do të jetë funksionale gjatë vitit 2020. Gjithashtu, ekziston nevoja të theksohet interpretimi i dobët i Ligjit për përdorimin e gjuhëve, si dhe domosdoshmëria që ky ligj të rregullohet më shumë dhe të përpunohet me aktet nënligjore, gjë që deri nuk është bërë. Ajo që në takim është theksuar si diçka është nisma për themelimin e një katedre të Ballkanistikës në Universitetin Shtetëror të Prishtinës, në të cilin studentët e ardhshëm do të jenë në

²⁰⁹ A. nr. 699/2018,

²¹⁰ Letër rekomandimi i drejtuar Odës së përbaruesve privat më 13.06.2019 dhe përgjigja e Odës së përbaruesve privat, të cilën IAP e mori më 14.10.2019.

²¹¹ Takimi me Komisionerin për gjuhë, u realizua më 13.12.2019 në hapësirat e IAP në Graçanicë.

gjendje të studiojnë, ndër të tjera, edhe gjuhën serbe. Nisma është në fillimet e saj dhe ka sinjale pozitive dhe vullnet për ta filluar punën për këtë projekt deri në fund të vitit 2021.²¹²

Që nga tetori 2014, gjuha rome ka qenë në përdorim zyrtar në Komunën e Graçanicës, por deri tani, ky vendim nuk është zbatuar në mënyrë adekuate nga autoritetet lokale komunale, dhe për këtë arsye komuna nuk ka asnjë përkthyes të vetëm për gjuhën rome. Përveç kësaj, komuna përveç në shërbimin komunal, nuk ka të punësuar pjesëtarë të komunitetit rom, as në Zyrën për Komunitete dhe Kthim, por as në cilindo shërbim administrativ, megjithëse në këtë komunë ka kapacitete dhe mundësi për punësimin e tyre.

Ankesa për përdorimin e gjuhës boshnjake dhe turke kanë parashtruar përfaqësuesit e këtyre komuniteteve në komunën e Prizrenit. Në seancat e Asamblesë Komunale të Prizrenit për më shumë se një vit, nuk ka përkthim simultan për delegatët e komunitetit boshnjak dhe turk. Sipas pretendimeve të përfaqësuesve të komuniteteve në fjalë, ata në mënyrë të përsëritur e ngritën zërin për këtë problem, por u është thënë që nuk punojnë pajisjet për përkthim simultan, prandaj për shkak të problemeve teknike, të cilat mund të zgjidhen me lehtësi dhe shpejt, ata u privuan nga përkthimi i seancave të Kuvendit Komunal dhe të marrin pjesë në mënyrë adekuate dhe aktive në diskutime. Po ashtu, i gjithë dokumentacioni zyrtar i paraqitur nga niveli qendror vjen vetëm në gjuhën shqipe, gjë që në përgjithësi është problem jo vetëm në Komunën e Prizrenit, por edhe në komunat ku shumicën numerike e kanë pjesëtarët e komunitetit serb. Komuniteti turk në Prizren gjithashtu e vuri theksin në problemin me aparatit automatik për lëshimin e certifikatave të lindjes nga regjistri qendror i lindjeve (ekstrakte) sepse aparati nuk e ka opsionin për gjuhën turke, por e ka vetëm opsionin për gjuhën shqipe dhe serbe. Për këtë arsye, pjesëtarët e komunitetit turk në këtë qytet nuk mund ta përdorin këtë aparat, por për të njëjtin dokument duhet të aplikojnë në sportelet e zyrës për regjistrim civil në këtë komunë.²¹³ IAP për këto ankesa e ka njoftuar Komunën e Prizrenit dhe Komisionerin për Gjuhë. IAP do ta monitorojë situatën në lidhje me këtë çështje në periudhën e ardhshme.

²¹² Po aty

²¹³ Informacioni u pranua në një takim me përfaqësuesit e komuniteteve boshnjake dhe turke në Prizren më 9 dhjetor 2019.

V. Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (MKPT)

Ligji për Avokatin e Popullit e përcakton Avokatin e Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese (në tekstin e mëtejshëm: MKPT).²¹⁴

MKPT-ja, në kuadër të autorizimeve ligjore, realizon vizita të rregullta dhe pa paralajmërim në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin në qendrat e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut.²¹⁵

Gjatë periudhës raportuese, MKPT-ja ka realizuar 86 vizita (vizita të përgjithshme, *ad-hoc* dhe vizita përcjellëse) në institucionet në vijim: Qendra Korrektuese në Dubravë (QKD), Burgu i Sigurisë së Lartë (BSL), Qendra Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan (QKFML), Qendra Edukuese Korrektuese në Lipjan (QEKL), Qendra Korrektuese në Smrekonicë (QKS), Qendra e Paraburgimit në Gjiilan (QPGj), Qendra e Paraburgimit në Pejë, Qendra e Paraburgimit në Prizren, Qendra e Paraburgimit në Lipjan (QPL), Qendra e Paraburgimit në Prishtinë, Qendra e Mbatjes për të Huajt (QMH), Qendra për Azil (QA), Pika e Kalimit Kufitar Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë, Qendra Rajonale e Mbatjes në Prishtinë, stacionet policore në: Gjakovë, Shtime, Rahovec, Vushtri, Deçan, Pejë, Pika e Kalimit Kufitar “Vërmicë”, Podujevë, Drejtoria Rajonale Kufitare “Veri” Llluzhan, Qendra për Integrim dhe Rehabilitim të të Sëmureve Kronikë Psikiatrikë në Shtime (QIRSKP), Instituti i Psikiatrisë Forenzike (IPFK), Repartin e kujdesit intensiv psikiatrik në kuadër të Klinikës Psikiatrike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (UKIP), Shtëpia e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore (ShFAKM), Institutin Special në Shtime (ISSh), Shtëpia për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë (ShPMPF), Shtëpitë Integruese në Bashkësi (ShIB), Shtëpitë në Komunitet për Personat me Aftësi të Kufizuara Mendore (ShKPAKM), Qendrat e Shëndetit Mendor në Ferizaj (QShM), Prizren, Mitrovicë dhe Prishtinë.

Raportet me rekomandime të publikuara gjatë vitit 2019

MKPT-ja ka publikuar raportin me rekomandime për vizitën në QMH, ShFAKM, Pikën e Kalimit Kufitar Aeroporti Ndërkombëtarë “Adem Jashari” në Prishtinë, QKS, QPM, QKFML, QKD, QPP, QPL, QEKL, Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, Qendrën e Paraburgimit në Pejë dhe BSL. Po ashtu, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ka publikuar letër rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, QPGj, QKD dhe vizitën në stacionet policore në Pejë, Deçan, Gjakovë, Fushë Kosovë, Rahovec, Shtime, Vushtri, Pikën e Kalimit Kufitar “Vërmicë”, Lipjan dhe Qendrën Rajonale të Mbatjes në Prishtinë.²¹⁶ Përmes këtyre raporteve me rekomandime dhe letër rekomandimeve, MKPT-ja u ka dërguar autoriteteve kompetente 75 rekomandime.

²¹⁴ Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 17, paragrafi 2.2.

²¹⁵ Po aty, neni 17, paragrafi 2.

²¹⁶ Të gjitha raportet me rekomandime dhe letër rekomandimet të MKPT-së të dërguara autoriteteve kompetente gjatë vitit 2019 mund të gjenden në linkun në vijim: <https://www.oik-rks.org/raportet/raporte-mkpt-1/>

Bashkëpunimi me MKPT-në i institucioneve të vizituara

Gjatë vizitave të MKPT-së të realizuara në vitin 2019, zyrtarët e institucioneve të vizituara i kanë ofruar ekipit monitorues bashkëpunim të plotë dhe qasje të menjëhershme, si dhe i ofruan MKPT-së mundësinë që t'i intervistojë personat e privuar nga liria, pa prezencë të zyrtarëve të sigurisë, personelit mjekësor dhe zyrtarëve të institucioneve psikiatrike dhe të kujdesit social.

Policia e Kosovës

Garancitë procedurale kundër keqtrajtimit fizik

Sipas Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës (KPT), këto garanci garantojnë tri të drejtat themelore të personave të arrestuar, të cilat janë: e drejta për të njoftuar anëtarin e familjes apo personin, sipas përzgjedhjes, për faktin e arrestimit; të ketë avokat mbrojtës; të drejtën për shërbime mjekësore.²¹⁷ Garancitë procedurale kundër keqtrajtimit fizik të personave të arrestuar janë të mishëruara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës²¹⁸, në Kodin e Procedurës Penale²¹⁹ dhe në Ligjin për Policinë.²²⁰

Neni 13 i Kodit të Procedurës Penale përcakton: *“Çdo person i privuar nga liria duhet të njoftohet menjëherë në gjuhën të cilin ai/ajo e kupton për të drejtën për ndihmë juridike sipas dëshirës së tij, për të drejtën për të njoftuar anëtarët e familjes apo ndonjë person tjetër për faktin se është arrestuar dhe se këto të drejta aplikohen gjatë gjithë kohës së privimit nga liria.”* E drejta e të arrestuarit për shërbime mjekësore dhe dentare parashihet në nenin 169 të Kodit të Procedurës Penale.

Sa i përket njoftimit për arrestin, neni 168 i Kodit të Procedurës Penale më tej përcakton se personi i arrestuar ka të drejtë: ta njoftojë anëtarin e familjes apo personin tjetër, sipas përzgjedhjes së tij, për arrestin dhe vendin e ndalimit menjëherë pas arrestimit; njoftimi i familjarit apo personit tjetër lidhur me arrestimin mund të vonohet më së shumti deri në 24 orë kur prokurori i shtetit çmon se kjo kushtëzohet me nevoja të jashtëzakonshme për hetim të rastit. Kjo vonesë nuk aplikohet në rastin e personave të mitur.

Sipas Ligjit për Policinë, e drejta për të njoftuar familjen apo personin tjetër për arrestimin gjithashtu vlen edhe për personat të cilët janë në *“ndalim të përkohshëm”*, me qëllim të identifikimit ose për shkak të mbrojtjes së tyre dhe mbrojtjes së të tjerëve.²²¹

Keqtrajtimi fizik

Gjatë vizitave në stacionet e lartpërmendura policore, MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa nga personat e arrestuar (të cilët ishin në mbajtje në kohën e vizitës) për keqtrajtim fizik apo mosrespektim të të drejtave themelore të personave të privuar nga liria, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës

²¹⁷ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 2-të i Përgjithshëm, publikuar në vitin 1992. Shih në: <https://rm.coe.int/16806cea2f>

²¹⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 29 dhe 30.

²¹⁹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 13.

²²⁰ Ligji nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës.

²²¹ Po aty, neni 20 paragrafi 5.

së Kosovës, me Kodin e Procedurës Penale dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria.

MKPT-ja, gjatë vizitave në qendra korrektuese dhe të paraburgimit, gjatë intervistimit të të burgosurve, është interesuar për trajtimin e tyre nga Policia e Kosovës dhe për respektimin e të drejtave të tyre themelore, që nga momenti i arrestimit. Shumica dërmuese e të intervistuarve kanë pohuar se janë trajtuar në mënyrë korrekte nga Policia e Kosovës dhe se të drejtat e tyre themelore janë respektuar.

Megjithatë, MKPT-ja ka pranuar pohime nga disa të burgosur se ishin keqtrajtuar fizikisht nga Policia e Kosovës. Shumica e pohimeve i referohen momentit kur u arrestuan nga policia dhe periudhës së marrjes në pyetje nga hetuesit policorë.

Këto pohime kanë të bëjnë me tentimin për marrje të pohimit për kryerjen e veprës penale apo për të nxjerrë informata tjera relevante. MKPT-ja, në raste të tilla, ka analizuar dokumentacionin relevant shëndetësor, i cili përpilohet me rastin e pranimit të të burgosurve në qendra të paraburgimit dhe në qendrat korrektuese. Në disa raste, MKPT-ja ka vërejtur se në dosjet e tyre mjekësore janë evidentuar lëndime trupore.

MKPT-ja, pas shqyrtimit të të dhënave të grumbulluara, përfshirë edhe analizën e dosjeve mjekësore të të burgosurve në fjalë, i ka rekomanduar hetime të mëtejme Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK), bazuar në mandatin që ka ky institucion.²²²

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, mediat elektronike në Republikën e Kosovës publikuan video ku shihen pamje të një qytetari të arrestuar, i cili keqtrajtohet fizikisht dhe trajtohet në mënyrë poshtëruese dhe degraduese nga zyrtarët policorë në Stacionin Policorë në Gjakovë.

Në rastin në fjalë, më 19 nëntor 2018, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit vizitoi Qendrën e Paraburgimit në Pejë dhe pranoi ankesë nga qytetari, i cili shihet në videot e publikuara. Meqenëse tek ankuesi u vërejtën shenja të lëndimeve trupore, pas analizimit të dokumentacionit mjekësor dhe deklaratës së ankuesit, MKPT-ja, më 30 nëntor 2018, përmes një shkrese zyrtare i rekomandoi IPK-së që ta hetojë rastin në pajtim me mandatin që ka. Pas rekomandimit të MKPT-së, IPK-ja filloi hetimet preliminare ndaj zyrtarëve të përfshirë, rekomandoi suspendimin e zyrtarëve të përfshirë dhe, më 9 shtator 2019, në prokurorinë themelore kompetente ushtroi kallëzim penal me dyshimin se zyrtarët në fjalë kanë kryer veprën penale “*Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike*”, disa prej tyre në bashkëkryerje, kurse njëri nga ta veprën penale “*Keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit publik*”.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ka hapur 2 raste sipas detyrës zyrtare (*Ex Officio*)²²³ dhe ka hapur 15 raste për hetime të mëtejme, bazuar në ankesat e

²²² Raste të regjistruara në IAP për hetim të mëtejme, A.nr. 388/2019, A.nr. 169/2019. A.nr. 388/2019, pas hetimit nga IPK-ja, i kaluan Drejtorisë së Standardeve Profesionale të Policisë së Kosovës për hetime të mëtejme për shkelje eventuale disiplinore. A. nr. 169/2019, pas hetimit nga IPK-ja, çështja iu kalua Drejtorisë së Standardeve Profesionale të Policisë së Kosovës, për hetime të mëtejme.

²²³ *Ex officio* 784/2019, IAP kundër Policisë së Kosovës. *Ex officio* 773/2019 IAP kundër Policisë së Kosovës. Lidhur me rastin *Ex officio* 773/2019, më 12 dhjetor 2019, IPK e njoftoi Avokatin e Popullit se pas hetimeve preliminare çështjen ia ka kaluar Drejtorisë së Standardeve Profesionale për hetim të mëtejme për shkelje disiplinore. Ndërsa, në rastin 784/2019,

pranuara nga qytetarët e Republikës së Kosovës, kundër Policisë së Kosovës, bazuar në dyshimin se nga zyrtarët policorë u ushtrua keqtrajtim fizik, përdorim i tepruar i forcës fizike apo tejkalim i autorizimeve ligjore gjatë arrestimit të personave të caktuar. Pas analizimit preliminar, në 4 raste IPK-së iu rekomandua që të zhvillohen hetime të mëtejme lidhur me pretendimet e qytetarëve dhe që IAP-ja të njoftohet për rezultatin e hetimeve.

Në përgjithësi, MKPT-ja, bazuar në vizitat e realizuara gjatë këtij viti dhe vizitat e mëhershme, shqyrtimin e ankesave të pranuar, si dhe hetimet sipas detyrës zyrtare, vlerëson se nuk ka keqtrajtim fizik sistematik apo të përhapur nga Policia e Kosovës, por se bëhet fjalë për disa raste të izoluar.

Kushtet fizike të stacioneve policore të vizituara

Sa u përket kushteve fizike në vendet ku mbahen personat e ndaluar, MKPT-ja ka vërejtur se shumica e stacioneve policore të vizituara, përveç disave, i plotësojnë kushtet e domosdoshme për akomodim të personave të arrestuar, të përcaktuara me standardet e KPT-së.²²⁴ Kështu, MKPT-ja ka vërejtur se janë të nevojshme renovimet në stacionet policore në Gjakovë, Deçan, Pejë dhe Fushë Kosovë. Lidhur me këtë, MKPT-ja, më 16 dhjetor 2019, iu drejtua Policisë së Kosovës me një letër rekomandimi, përmes së cilës rekomandoi që të kryhen renovimet e nevojshme në stacionet e lartpërmendura policore, në mënyrë që kushtet fizike të akomodimit për personat e ndaluar në këto stacione të jenë në pajtim me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës dhe me standardet e KPT-së.

Qendrat korrektuese dhe të paraburgimit

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ka kryer vizita të përgjithshme, *ad hoc* dhe përcjellëse, në të gjitha qendrat korrektuese dhe të paraburgimit, si dhe në BSL. Qëllimi i këtyre vizitave ishte vlerësimi i progresit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rekomandimeve të MKPT të dërguara përmes raporteve të mëhershme me rekomandime, si dhe respektimi i të drejtave të të burgosurve të cilat garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (tani e tutje, *LESP*) dhe Ligjin nr. 05/L-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, si dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve. MKPT, gjatë periudhës për të cilën po raportohet ia dërgoi Ministrisë së Drejtësisë 55 rekomandime lidhur me vizitat në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit. Deri më tani autoritetet kompetente zbatuan plotësisht 12 rekomandime dhe pjesërisht zbatuan 4 rekomandime. Gjatë periudhës për të cilën po raportohet asnjë rekomandim i MKPT nuk u refuzua nga autoritetet kompetente.

Keqtrajtimi fizik

Gjatë vizitave në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit në vitin 2019, MKPT, nuk ka pranuar ankesa kredibile nga të burgosurit për keqtrajtim fizik apo përdorim të tepruar të forcës fizike.

IPK, pas hetimeve preliminare i ka rekomanduar Policisë së Kosovës suspendimin e zyrtarëve të involvuar. Ky rekomandim u zbatua më 9 tetor 2019. Më 8 nëntor 2019, IPK, ndaj zyrtarëve në fjalë, ushtroi kallëzim penal pranë Prokurorisë Themelore në Ferizaj.

²²⁴ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 2-të i Përgjithshëm, paragrafi 42, publikuar në vitin 1992. Shih në: <https://rm.coe.int/16806cea2f>

Përkundrazi, shumica e të burgosurve u shprehën në favor të një trajtimi shumë të mirë. Për më shumë, MKPT ka vërejtur komunikim të mirë interaktiv ndërmjet të burgosurve dhe zyrtarëve korrektues.

Incidentet ndërmjet të burgosurve

MKPT gjatë vizitave të realizuar në institucionet përkatëse është njoftuar për disa incidente në mes të burgosurve e të cilat raste janë evidentuar në formularë përkatës, si dhe në protokollat adekuate të njësive shëndetësore.

Më 21 nëntor 2019, Departamenti Shëndetësorë në Burgje (DSHB), e njoftoi MKPT se në spitalin e QKD, një i burgosur ka kërkuar ndihmë mjekësore pasi që sipas pohimeve të tij, ishte rrahur disa herë nga disa të burgosur. Personeli mjekësorë gjatë ekzaminimit të të burgosurit vërejti lëndime trupore të cilat u evidentuan në protokollat mjekësore në pajtim me Praktikën Standarde të Veprimit²²⁵ (PSV) dhe për këtë gjendje e njoftoi edhe drejtorinë e QKD. Më 25 nëntor 2019, MKPT kërkoi nga drejtoria e QKD, që të njoftohet me veprimet e ndërmarra në këtë rast.

Drejtoria e QKD, në të njëjtën ditë e njoftoi MKPT se të burgosurin në fjalë menjëherë e kanë vendosur në spitalin e burgut ku është duke vazhduar trajtimi mjekësorë dhe u njoftua Policia e Kosovës, e cila erdhi në vend të ngjarjes dhe filloi hetimin. MKPT, duke çmuar lartë veprimet e personelit mjekësorë dhe të drejtorisë së QKD, edhe nëpërmjet këtij raporti, ua rikujton autoriteteve obligimin që ta parandalojnë dhunën ndërmjet të burgosurve, për të cilët ata janë përgjegjës. Kjo përgjegjësi përfshinë obligimin për t'u kujdesur dhe për të miratuar masa preventive për të reduktuar rrezikun e dhunës, si dhe për t'i mbrojtur të burgosurit më të cenueshëm. Në përgjithësi, MKPT gjatë vizitave të realizuara në vitin 2019, ka vërejtur se raportet ndërmjet të burgosurve janë të mira dhe nuk ka klimë tensionuese ndërmjet tyre dhe se incidentet ndërmjet të burgosurve nuk duket të jenë problem madhorë për qendrat korrektuese dhe të paraburgimit.

Kushtet e akomodimit në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit

MKPT gjatë këtij viti, rekomandoi renovime në pavijonin numër 8 të QKD, në mënyrë që kushtet e akomodimit për të burgosurit të jenë në pajtim me LESP²²⁶ dhe standardet e përcaktuara nga KPT.²²⁷ Gjatë vizitës përcjellëse të realizuar në QKD, nga data 28 deri më 30 tetor 2019, MKPT vërejti se pavijoni numër 8 u rinovua plotësisht dhe për renovimin e pavijonit u angazhuan të burgosurit të cilët janë të akomoduar në këtë pavijon. MKPT, vërejti se janë të nevojshme renovime në pavijonin e spitalit të burgut dhe në pavijonin numër 5. Përmes letër rekomandimit, të dërguar më 16 dhjetor 2019, MKPT i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë që të bëhen renovimet e nevojshme në pavijonin numër 5 dhe pavijonin e spitalit të QKD.

Po ashtu, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT, u rekomandoi autoriteteve kompetente që të ndërmarrin veprime për të ndërprerë praktikën e përdorimit të pajisjeve të improvizuara elektrike nga të burgosurit për të ngrohur ujin, pasi një gjë e tillë mund të rrezikojë jetën e tyre. Gjatë vizitës

²²⁵ Praktika Standarde e Veprimit e DSHB-së. Për më shumë shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>

²²⁶ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 111, paragrafi 2.

²²⁷ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e banimit për një të burgosur në burgje, publikuar më 15 dhjetor 2015. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806cc449>

përcjellëse MKPT vërejtë se drejtoria ka kryer në varg kontrollesh dhe ka konfiskuar pajisjet e tilla. Kjo u konfirmua edhe përmes intervistave me të burgosurit. MKPT vërejtë një praktikë pozitive në QKD, ku para të gjitha pavijoneve në këtë qendër janë mbjellë kopshte me lule të cilat ndikojnë pozitivisht tek të të burgosurit në kuptim terapeutik.

Lidhur me rekomandimin e MKPT që të gjendet zgjidhje adekuate për të ofruar qasje për pacientët me aftësi të kufizuara në katin e dytë të spitalit, drejtoria e njoftoi MKPT se pacientët e tillë dërgohen në pavijonin 7 ku ka kushte adekuate në pajtim me gjendjen e tyre.

Përmes raportit me rekomandime për vizitën në QKS, të publikuar më 16 maj 2019²²⁸, MKPT, i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë që të rinovohet kulmi i pavijonit ku vendosen të dënuarit. Më 4 dhjetor 2019, drejtori i QKS, e njoftoi MKPT se ky rekomandim ende nuk është zbatuar dhe se drejtorisë qendrore të Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK) i ka drejtuar kërkesa për të evituar këtë mangësi për të cilën pritet që të evitohet vitin e ardhshëm. MKPT, do të monitorojë zbatimin e këtij rekomandimi edhe në të ardhmen përmes vizitave në këtë qendër.

Gjatë vizitës në QKFML, më 23 dhe 24 janar 2019, MKPT vërejtë se janë të nevojshme renovimet në hapësirat ku akomodohen të miturit e gjinisë mashkullore. Përmes raportit me rekomandime të publikuar më 24 maj 2019 u rekomandoi autoriteteve kompetente që të përmirësohen kushtet e akomodimit në pavijonet ku mbahen të miturit e paraburgosur dhe në pavijonet tjera, kur një gjë e tillë është e nevojshme. Përmes vizitave *Ad Hoc*²²⁹ të realizuara gjatë vitit 2019 në këtë qendër, MKPT ka vërejtur se renovimet kanë filluar dhe se shumicën e punëve po i kryenin të burgosurit.

Gjatë vizitës në QPM, MKPT vërejtë se kushtet e akomodimit në këtë qendër, në përgjithësi, janë në pajtim me LESP, me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve dhe me standardet e KPT, përveç në disa qeli ku ishte i nevojshëm rinovimi i dysHEMEVE të dëmtuara. Përmes raportit me rekomandime të publikuar më 28 qershor 2019, MKPT u rekomandoi autoriteteve kompetente që të rinovohen dysHEMETË e dëmtuara në disa qeli, sipas nevojës. Më 4 dhjetor 2015 drejtoria e Qendrës së Paraburgimit në Mitrovicë e njoftoi MKPT se punimet për renovimin e dysHEMEVE kanë përfunduar.

Përmes raportit me rekomandime për vizitën në QPP, MKPT, lidhur me kushtet e akomodimit u rekomandoi autoriteteve kompetente që burgosurit të furnizohet me mjete higjienike, në pajtim me LESP, të evitohen mangësitë teknike të funksionimit të dusheve, sipas nevojës dhe që të furnizohet kjo qendër e paraburgimit me dysHEKË të rinj dhe cilësorë. Më 11 shtator 2019, Drejtoria e QPP e njoftoi MKPT se të burgosurit janë duke u furnizuar me mjete higjienike në pajtim me LESP. Më tej në këtë njoftim thuhet se sa i përket furnizimit me dysHEKË të ri dhe cilësorë, drejtoria e përgjithshme e SHKK, i ka njoftuar se së shpejti do të ketë furnizime me dysHEKË të rinj.

Përmes raportit me rekomandime për vizitën në QPL, MKPT, sa i përket kushteve të akomodimit, u rekomandoi autoriteteve kompetente që të rinovohet kati i dytë i QPL, në mënyrë që kushtet e

²²⁸ Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën Korrektuese në Smrekonice. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/05/21/raport-i-mkpt-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-smrekonice/>

²²⁹ Vizita *Ad Hoc* e MKPT-së të realizuara në Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan më 4 prill, 20 qershor, 23 gusht dhe 4 nëntor 2019.

akomodimit për të burgosurit të jenë në pajtim me LEPS-në dhe me standardet e KPT. Më 27 nëntor 2019 drejtorja e QPL, njoftoi MKPT, se punët për renovimin e këtij kati pothuajse kanë përfunduar.

Sa i përket kushteve të akomodimit në BSL, MKPT, në raportin me rekomandime të publikuar më 22 nëntor 2019 ka konstatuar si në vijim: *“MKPT vëren se, në përgjithësi, kushtet e akomodimit në BSL janë në pajtim me LEPS-në, me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve dhe me Standardet e KPT-së. Sa i përket qasjes së personave me aftësi të kufizuara (edhe pse nuk kishte të tillë), të gjithë ashensorët ishin funksionalë, gjë që e mundëson qasjen e të burgosurve me aftësi të kufizuara.”*²³⁰ Megjithatë, MKPT vërejti se dyshemetë në pavijonet 1, 2, në stacionar dhe në pavijonin e pranimit janë dëmtuar dhe vazhdojnë të dëmtohen. Përmes raportit me rekomandime dërguar autoriteteve kompetente më 22 nëntor 2019, MKPT, u rekomandoi autoriteteve kompetente që të ndërmarrin veprime për të evituar këto mangësi. Më 4 dhjetor 2019, drejtorja e BSL, e njoftoi MKPT se stacionari i BSL u rinovua në tërësi dhe se më pastaj do të vazhdohet me renovimin e dyshemeve në objektet tjera.

Në raportin me rekomandime për vizitën në QEKL²³¹, MKPT ka konstatuar se dhomat ku qëndronin të miturit, sa i përket madhësisë dhe ndriçimit natyral dhe artificial, janë në pajtim me standardet e përcaktuar nga KPT dhe LEPS. Po ashtu, dhomat dhe tualetet të cilat janë të dedikuara për personat me nevoja të veçanta ofrojnë akomodim shumë të mirë dhe adekuat. MKPT konsideron se në përgjithësi kushtet e akomodimit në QEKL shkojnë përtej standardeve minimale dhe arrijnë nivelin e standardeve të dëshirueshme për akomodim të të miturve me masën edukuese.

MKPT, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, ka vizituar QPGJ dhe ka vërejtur se sa i përket kushteve të akomodimit në këtë qendër ato mbeten në nivel shumë të kënaqshëm dhe janë në pajtim me standardet e përcaktuar nga KPT²³² dhe LEPS.

Po ashtu, gjatë vizitës është vërejtur se rekomandimi i MKPT që të asfaltohet pjesa e rrugës së paasfaltuar e cila mund të paraqes vështirësi serioze gjatë stinës së dimrit dhe në kushte të reshjeve atmosferike për kryerjen e punës në pajtim me LEPS, nuk është zbatuar, pavarësisht përpjekjeve të drejtorisë dhe SHKK, për të bashkëvepruar në këtë drejtim me autoritetet komunale.

Sa i përket kushteve të akomodimit në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, MKPT edhe gjatë vizitës së fundit përcjellëse të realizuar më 15 nëntor 2019, ka vizituar një numër të qelive dhe ka konstatuar se hapësira e banimit për një të burgosur, ndriçimi dhe ventilimi nuk janë në pajtim me standardet e përcaktuar nga KPT dhe me LEPS. Më 16 dhjetor 2019, MKPT, përmes një letër rekomandimi, i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë që kushtet e akomodimit, përderisa kjo qendër është në përdorim, të jenë në pajtim me standardet minimale të përcaktuara me LEPS, me standardet e KPT dhe me standardet tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.

²³⁰Raport me rekomandime për vizitën në Burgun e Sigurisë së Lartë, publikuar më 22 nëntor 2019. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/11/25/raport-me-rekomandime-i-mkpt-se-lidhur-me-viziten-ne-burgun-e-sigurise-se-larte/>

²³¹Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën Edukativo-Korrektuese në Lipjan, publikuar më 26 gusht 2019. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/09/25/raport-me-rekomandime-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-edukativo-korrektuese-ne-lipjan/>

²³² Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih në: <https://rm.coe.int/16806cc449>.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT vizitoi Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë.²³³ Sa i përket kushteve të akomodimit, MKPT vërejt se qelitë ku akomodohen të burgosurit kanë dritë të mjaftueshme natyrore dhe hapësirë banimi e cila shkon përtej standardit të përcaktuar me LESP dhe me standardet e përcaktuara nga KPT. MKPT, përveç kësaj vërejt se dy qeli janë adekuate dhe në dispozicion për të burgosurit me aftësi të kufizuara.

Ushqimi

Sa i përket kualitetit dhe sasisë së ushqimit, MKPT gjatë periudhës për të cilën po raportohet ka pranuar ankesa nga të burgosurit në QKD. Lidhur me këtë, MKPT, më 11 nëntor 2019, ka kontaktuar me Agjencinë e Ushqimit dhe të Veterinës dhe përmes postës elektronike zyrtare ka kërkuar raportin e fundit të kësaj agjencie për inspektimin në QKD.

Pavarësisht obligimit për të bashkëpunuar me Institucionin e Avokatit të Popullit, i cili parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës²³⁴ dhe Ligjin për Avokatin e Popullit²³⁵, ky institucion nuk iu përgjigj kërkesës së dërguar.

Mbipopullimi

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT, ka vërejtur se mbipopullimi nuk paraqet problem për qendrat korrektuese dhe të paraburgimit. Madje, në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, Gjilan dhe në BSL, ka mjaft hapësirë të pashfrytëzuar për shkak të mungesës së inventarit dhe personelit korrektues për të akomoduar një numër më të madh të të burgosurve. Në raste të rralla, është vërejtur mbipopullim tejet simbolik në periudhat sa ka pasur renovime në pavijone të caktuara por i cili është evituar pa ndonjë vonesë të madhe.

Regjimi

MKPT-ja, sa i përket regjimit, përmes raporteve me rekomandime u ka rekomanduar autoriteteve kompetente që të bëjnë përpjekje në mënyrë që sa më shumë të burgosur të përfshihen në punë, edukim, trajnime dhe aktivitetet tjera të mirëfillta, në mënyrë që të arrihet risocializimi sa më i suksesshëm i të burgosurve. Në vizitat e realizuara në QKS, MKPT-ja vërejt se në përgjithësi 75 të dënuar janë të angazhuar në punë. Të dënuarit angazhohen në punë për pastrim, në kuzhinë dhe për mirëmbajtje të caktuara të objektit. Ndërsa gjatë stinës së verës, angazhimi në punë rritet dukshëm, pasi që QKS-ja posedon serrë ku kultivohen perimet dhe po ashtu brenda perimetrit të burgut ka edhe sipërfaqe me tokë bujqësore ku kultivohen kultura të ndryshme.

MKPT-ja, përmes raportit me rekomandime për vizitën në QKS, u ka rekomanduar autoriteteve kompetente që të ndërmarrin veprime për të funksionalizuar punëtoritë në dispozicion të kësaj qendre, në mënyrë që të burgosurit të përfitojnë nga mundësitë për aftësim profesional.

²³³Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, të realizuar më 28 tetor 2019, publikuar më 22 nëntor 2019. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/11/25/raport-me-rekomandimi-mkpt-se-lidhur-me-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-prishtine/>

²³⁴Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132, paragrafi 3.

²³⁵Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 25.

Më 24 korrik 2019, drejtori i QKS-së njoftoi MKPT-së se punëtorja e automekanikes dhe e saldimit janë funksionalizuar plotësisht dhe personeli profesional së bashku me një grup të të burgosurve kryen servisim të automjeteve në kuadër të ShKK-së. Po ashtu, drejtori e njoftoi MKPT-në se po bëhen përpjekje për të angazhuar zyrtar profesional për të përdorur punëtorinë e saldimit.

Më 20 nëntor 2019, ShKK-ja publikoi një njoftim në të cilin theksohet se shtatë të dënuar të akomoduar në QKS kanë filluar punën jashtë këtij institucioni korrektues pas miratimit të Udhëzimit Administrativ për Punën e të Burgosurve Jashtë Institucionit Korrektues.²³⁶

Gjatë vizitës në QKD (nga data 28 deri më 30 tetor 2019), MKPT-ja vërejti se u zbatua rekomandimi i MKPT-së që të funksionalizohet salla e sportit, i cili iu dërgua autoriteteve kompetente përmes raportit me rekomandime të datës 28 qershor 2019. MKPT-ja gjatë vizitës vërejti se funksionalizimi i sallës së sportit tani mundëson aktivitete të shumta sportive për të burgosurit. Aktivitetet sportive të burgosurit mund t'i zhvillojnë edhe fushën sportive në hapësirë të hapur në oborr të QKD-së.

Gjatë vizitës së fundit, MKPT-ja u njoftua nga drejtori se rreth 344 të burgosur në QKD janë të angazhuar në punë me pagesë. Drejtori ka filluar t'i angazhojë të burgosurit në punë në rinovimin e pavijoneve dhe punë të tjera. Gjithashtu, në kuadër të QKD-së funksionojnë tri punëtori, të cilat në fakt janë edhe qendra për trajnime profesionale, ku organizohen trajnime për saldim, ndërtimtari, axhustator, zdrukthëtari, mirëmbajtje teknike, instalim të ujit dhe instalim të rrymës. Në këto punëtori organizohen kurse me kohëzgjatje prej tre muajsh.

Bazuar në ndihmën e ofruar nga OJQ HELP, 10 të burgosurve iu ofrua trajnim profesional për saldim, të cilët edhe u certifikuan. Në kuadër të QKD-së funksionon shkolla e mesme ku vijojnë mësimin 44 të dënuar. MKPT-ja ka vërejtur se janë bërë përpjekje për të funksionalizuar njësinë ekonomike, e cila parashihet me LESP, por pritët miratimi i një udhëzimi administrativ, i cili do të precizonte punën e kësaj njësie ekonomike.

Ndërsa në Pavijonin Gjysmë të Hapur të QKD, të gjithë të dënuarit janë të angazhuar në punë në bujqësi dhe blegtori. Në oborin e pavijonit, gjatë vizitës, MKPT-ja vërejti kopshtin dhe serrën në të cilat kultivohen pemë dhe perime dhe të cilat përdoren për ushqim në QKD.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja, përmes raportit me rekomandime për vizitën në QEKL, u rekomandoi autoriteteve kompetente që t'i funksionalizojnë kabinetet, të cilat ekzistojnë në kuadër të qendrës, por të cilat ende nuk përdoren për shkak të mungesës së trajnuesve profesionalë. Më 19 shtator 2019, drejtori i QEKL-së e njoftoi MKPT-në për përpjekjen që është duke bërë për ta trajnuar personelin adekuat për të ofruar kurse të aftësisimit profesional për të miturit, duke i shfrytëzuar këto kabinete.

Përndryshe, përmes vizitave të realizuara gjatë këtij viti, MKPT-ja ka vërejtur se në QEKL u organizuan trajnime për ujësjellës, elektrikist, murator, trajnim për përdorim të kompjuterit, për prerje të flokëve, kursi i gjuhës angleze etj. Nga dokumentacioni i pranuar nga QEKL-ja shihet se një OJQ ka organizuar 12 seanca me të miturit, ku janë trajtuar tema të ndryshme nga jeta e përditshme. CARITAS KOSOVA ka mundësuar organizim të art terapisë dhe të teatër terapisë për të miturit, është

²³⁶ Për më shumë shih në: https://shkk.rks-gov.net/al/lajmi_single/2757

organizuar një koncert muzikor dhe po vazhdon programi EQUIP, i cili i dedikohet menaxhimit të stresit dhe zemërimit.

Në QKFML funksionon shkolla e mesme e ulët dhe shkolla e mesme e lartë në kuadër të sistemit publik të arsimit. Përmes vizitave të kryera gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja vërejtë se në dispozicion të të miturve kishte programe të ndryshme psiko-sociale, të organizuara nga organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare. Në mesin e tyre janë edhe art terapia dhe teatër terapia, si dhe u organizua ekspozita në të cilën janë prezantuar punimet e të miturve nga arti figurativ. Në dispozicion të të miturve dhe të të burgosurave madhore janë edhe aktivitetet sportive, programi EQUIP dhe angazhimi në punë, i cili gjatë stinës së verës është më i madh, pasi që QKFML-ja posedon edhe një serrë, në të cilën mund të angazhohen në punë të burgosurit. Sipas drejtorit, tash për tash ofrohen trajnime profesionale për ujë-instalues, për elektroinstalues dhe për ndërtimtari.

Gjatë vizitës në QPM, ku po ashtu akomodohen edhe të dënuarit, MKPT-ja ka vërejtur se rreth 13 të dënuar janë të angazhuar në punë. Në kuadër të QPM-së funksionojnë pesë punëtori, në të cilat të dënuarit mund të angazhohen në punë dhe në trajnime të ndryshme. Në dispozicion të të burgosurve janë edhe biblioteka, shëtitoret dhe salla e fitnesit. Përveç angazhimeve në punëtori, në punë pastrimi dhe në kuzhinë, gjatë kësaj periudhe në QPM u organizua edhe trajnimi për kontroll të agresivitetit, në të cilin u angazhuan 19 të burgosur. Ky trajnim u mbështet nga organizata joqeveritare HELP. MKPT-ja ka vërejtur se QPM-ja është pajisur mirë me hapësira për organizim të kurseve.

Gjatë vizitës në BSL, MKPT-ja ka vërejtur se rreth 70 të dënuar janë të angazhuar në punë. Në kuadër të BSL-së funksionon punëtorja e zdrukthëtarisë, në të cilën angazhohen në punë katër të dënuar dhe tani aty prodhojnë shtretër për QEKL.

Punëtoritë e tjera tani për tani nuk mund të aktivizohen, për shkak të mungesës së pajisjeve dhe trajnerëve kompetentë. MKPT-ja ka vërejtur se në dispozicion të të dënuarve janë edhe pajisjet për lojëra të ndryshme, siç janë: ping-pongu dhe tavolina për të luajtur futboll. Një pjesë të kohës të dënuarit në pavijone të caktuara (varësisht nga regjimi) mund ta kalojnë duke qenë të lirë që të lëvizin brenda pavijonit.

MKPT-ja pranoi ankesa nga të burgosurit në pavijonin 1 dhe nga të paraburgosurit në BSL lidhur me regjimin. Sipas pohimeve të tyre, shumicën e kohës e kalojnë të mbyllur në qeli (rreth 22 orë) dhe kanë në dispozicion vetëm shëtitjet në ajër të pastër (dy orë në ditë). Nga intervistat me këta të dënuar dhe të paraburgosur mund të nxirret përfundimi se ata regjimin ndaj tyre e kuptojnë si regjim ndëshkues.

MKPT-ja, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, ka vërejtur se në BSL fushat sportive janë të shtruara me beton me ngjyrë të bardhë, e cila pengon zhvillimin normal të aktiviteteve sportive, pasi që shkaktohen lëndime të shpeshta. Po ashtu shëtitoret janë të rrethuara nga muret e larta me të njëjtin material dhe ngjyrë, të cilat kanë reflektim verbues.

Përmes raportit me rekomandime të publikuar më 22 nëntor 2019, MKPT-ja u rekomandoi autoriteteve kompetente që të evitohet mangësia sa i përket ngjyrës së bardhë reflektuese, e cila është pengesë për aktivitete jashtë qelive. Më 5 dhjetor 2019, drejtori i BSL-së e njoftoi MKPT-në se, lidhur

me këtë rekomandim, ShKK-ja ka lidhur kontratë me një kompani, e cila ka bërë rregullimin e shëtitoreve të dëmtuara si dhe ngjyrosjen e mureve me ngjyrë anti-reflektuese.

Megjithatë, për MKPT-në mbetet shqetësues regjimi i cili u ofrohet të paraburgosurve në të gjitha qendrat e paraburgimit. Lidhur me këtë, MKPT-ja, pas vizitave në të gjitha qendrat e paraburgimit, përmes raporteve me rekomandime²³⁷, i ka rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë që të shtohen përpjekjet që të paraburgosurve t'u ofrohet një regjim, i cili do t'u mundësonte që të kenë edhe aktivitete tjera ditore, përveç shëtitjeve në ajër të pastër dy herë në ditë nga një orë. MKPT-ja ka vërejtur se angazhimi i tyre në punë është i rrallë dhe kjo ndodh për shkak se angazhimi i tyre është subjekt i lejes nga gjykata kompetente.

Megjithatë, në këtë drejtim, MKPT-ja vëren se neni 199, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Penale përcakton si në vijim: *“I paraburgosuri mund të kryejë punë të nevojshme për mbajtjen e rendit dhe pastërtisë në ambientin e tyre. Të paraburgosurit mund t'i lejohet të punojnë në aktivitete që i përgjigjen aftësive fizike dhe mendore brenda mundësive dhe kushteve me të cilat disponon institucioni dhe me kusht që të mos e dëmtojë procedurën penale. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos për këtë në marrëveshje me drejtorinë e institucionit”*.

Ndërsa neni 200, paragrafi 1, i LESP-së, lidhur me angazhimin e të paraburgosurit në punë, përcakton si në vijim: *“I paraburgosuri mund të angazhohet me punë në punëtori, punëtoritë e njësisë ekonomike të cilat gjenden në rrethin e institucionit korrektues përkatës pas marrjes së pëlqimit të gjykatës kompetente”*. Në raportin e KPT-së për vizitën në Republikën e Kosovës në vitin 2015, i cili u publikua në vitin 2016, KPT-ja, lidhur me regjimin për të paraburgosurit, shprehu shqetësimin që, pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve, të paraburgosurit shumicën e kohës e kalojnë në qelitë e tyre, përveç dy orëve të shëtitjes në ditë, duke shikuar TV dhe luajtur me letra.²³⁸ MKPT-ja konsideron se, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe rekomandimet e KPT-së, autoritetet kompetente duhet të bëjnë përpjekje që të rriten angazhimet jashtë qelisë për të paraburgosurit në qendrat tjera të paraburgimit, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.

Kontaktet me botën e jashtme

Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale,²³⁹ në rastin e personave të dënuar, përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar të korrespondencës (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj, e cila zgjat minimum një orë, si dhe në vizitë nga

²³⁷ Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, publikuar më 22 nëntor 2019, paragrafët 15-21. Shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/11/25/raport-me-rekomandimi-mkpt-se-lidhur-me-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-prishtine/>. Raport me rekomandime për vizitën në Burgun e Sigurisë së Lartë, publikuar më 22 nëntor 2019, paragrafët 12-23. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/11/25/raport-me-rekomandime-i-mkpt-se-lidhur-me-viziten-ne-burgun-e-sigurise-se-larte/>. Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, publikuar më 16 gusht 2019. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/08/19/raport-me-rekomandime-i-mkpt-se-lidhur-me-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-lipjan/>. Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, publikuar më 5 gusht 2019. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/08/06/raport-me-rekomandime-i-mkpt-se-ne-lidhje-me-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-prizren/>

²³⁸ Raporti i KPT-së për vizitën në Kosovë, publikuar në shtator 2016, paragrafi 46. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

²³⁹ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

fëmijët dhe bashkëshortet e tyre së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Përveç kësaj, ata kanë të drejtë për të bërë telefonata.

Lidhur me telefonatat, Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese²⁴⁰ përcakton se i dënuari ka të drejtë në biseda telefonike me anëtarët e familjes së ngushtë dhe me personat e tjerë. Gjatë vizitave në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit, MKPT-ja nuk ka pranuar asnjë ankesë nga të paraburgosurit dhe të dënuarit lidhur me këtë të drejtë.

Në rastin e të paraburgosurve, neni 200 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përcakton se të paraburgosurit mund të pranojnë vizita “*brenda kufijve të rregullave të qendrës së paraburgimit*”, bazuar në lejen e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nën mbikëqyrjen e tij. Më tej, Kodi përcakton se korrespondenca dhe vizitat tjera i nënshtrohen vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake.

Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund t’i vizitojnë të paraburgosurit dhe të korrespondojnë me ta, pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues ose personave të tjerë të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e të paraburgosurit dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit nuk mund të kontrollohen. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit.

Në rastin e shtetasve të huaj, atyre u ofrohet mundësia që me shkrim ose me gojë të kontaktojnë me përfaqësinë diplomatike apo me zyrën përkatëse të shtetit, shtetësinë e të cilit e ka ai.²⁴¹ MKPT, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, nuk ka pranuar ankesa lidhur me të drejtën për kontakte me botën e jashtme nga të dënuarit dhe të paraburgosurit. Përveç kësaj, MKPT ka vërejtur se në QKS dhe në QEKL, ka filluar të zbatohet programi për komunikim SKYPE, përmes së cilit të burgosurit mund të komunikojnë me familjet e tyre.

Çështja e përkthimit në gjuhët zyrtare në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë

Gjatë vizitës në QPM, MKPT pranoi shqetësimet e punëtorëve socialë rreth dokumentacionit zyrtar, i cili duhet t’u dorëzohet personave të privuar nga liria, të cilët janë të dy përkatësive etnike dhe i cili pranohej vetëm në njërin gjuhë dhe nuk përkthehej në gjuhët zyrtare, për shkak të mungesës së përkthyesit profesional.

Në raportin me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, MKPT theksoi si në vijim: “*MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet ta kenë parasysh obligimin ligjor që këto shërbime të ofrohen në gjuhët zyrtare të vendit, ashtu siç përcaktohet me Kushtetutë dhe me legjislacionin relevant që e rregullon këtë çështje*”. Përmes këtij raporti, MKPT u rekomandoi autoriteteve kompetente që të sigurohet përkthimi profesional në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Më 4 dhjetor 2019, QPM e njoftoi MKPT-në se çështja e përkthimit në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës është rregulluar duke përdorur shërbimet e përkthyesit zyrtar të QKS-së.

²⁴⁰ Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 54.

²⁴¹ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 33 paragrafi 1.

Legjislacioni sekondarë për luftimin e korrupsionit i cili parashihet me LESP

Sa i përket rekomandimit të MKPT-së lidhur me miratimin e legjislacionit sekondar për eliminim të korrupsionit, siç parashihet me nenin 5, paragrafi 3, të LESP-në, MKPT-ja konstaton se situata mbetet e njëjtë dhe se autoritetet kompetente nuk e kanë implementuar këtë rekomandim.²⁴² Megjithatë, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, ShKK-ja, me qëllim të luftimit të korrupsionit në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit, transferoi zyrtarët korrektues në vende pune në qendra tjera korrektuese dhe të paraburgimit.

Ankesa për trajtim diskriminues

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT ka pranuar ankesa nga të dënuarit për vepra penale të terrorizmit të cilët pohuan se po diskriminohen nga autoritetet sa i përket beneficioneve, pavarësisht se ata i plotësojnë kriteret ligjore. MKPT ka vërejtur se në raste të caktuara të dënuarit e kësaj kategorie kanë përfituar këto beneficione, edhe pse në numër shumë të vogël. MKPT, lidhur me këtë vëren se neni 92 i LESP, parasheh beneficione të caktuara për sjellje të mirë dhe angazhim në punë të të dënuarit, të cilat drejtori i aprovon pas rekomandimit të ekipit për planifikimin e mbajtjes së dënimit. Kjo çështje më tej rregullohet me Udhëzimin Administrativ për Rendin Shtëpiak në Qendrat Korrektuese (nenet 60-63), ku përcaktohet kriteret dhe kushtet që duhet të merren parasysh nga drejtorja me rastin e aprovimit të kërkesës. MKPT, vëren se ky rend shtëpiak përcakton se vendimi i drejtorit është përfundimtar, pra çështja është në diskrecion të drejtorit.

Kujdesi shëndetësor në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit

Shërbimet shëndetësore në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit menaxhohen nga Ministria e Shëndetësisë, respektivisht DShB-ja, nga viti 2013, pasi që deri atëherë ky shërbim menaxhohej nga Ministria e Drejtësisë. Shërbimet shëndetësore për të burgosurit ofrohen në njësitë shëndetësore të DShB në të gjitha qendrat korrektuese dhe të paraburgimit dhe në institucionet publike shëndetësore, sipas nevojës. Në kuadër të QKD funksionon edhe spitali i burgut.

Personeli, trajtimi dhe infrastruktura

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja, ka vërejtur se në të gjitha qendrat korrektuese dhe të paraburgimit, numri i personeli mjekësorë (mjekë të përgjithshëm dhe specialistë), është adekuat. Sa i përket personelit infermierik, MKPT-ja, përmes raportit me rekomandime për vizitën në QPL²⁴³, i ka rekomanduar Ministrisë së Shëndetësisë që të rritet numri i personelit të mesëm në njësinë shëndetësore në QPL, sipas nevojës. Më 2 korrik 2019, DShB-ja, përmes një shkresë zyrtare u pajtua me rekomandimin në fjalë dhe e njoftoi MKPT-në se do të bëhen përpjekje për të shtuar numrin e personelit bazuar në këtë rekomandim.

²⁴² Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën Korrektuese në Dubravë, paragrafi 9, publikuar më 28 qershor 2019.

²⁴³ Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, publikuar më 16 gusht 2019. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/08/19/raport-me-rekomandime-i-mkpt-se-lidhur-me-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-lipjan/>

Gjatë vizitës në QPM më 12 mars 2019, MKPT-ja u njoftua se nuk kishte psikolog të angazhuar në punë në këtë qendër. Lidhur me këtë, MKPT-ja, pas vizitës, kontaktoi me drejtorin e DShB, i cili e njoftoi se procedurat për rekrutim të psikologut të rregullt kanë përfunduar dhe se nga data 1 korrik 2019 do të fillojë punën kandidati i përzgjedhur.

Sa i përket varësisë nga droga, ofrohet trajtimi me metadon në të gjitha qendrat korrektuese dhe të paraburgimit. Trajtimi psikiatrik i të burgosurve ofrohet në spitalin e QKD-së dhe institucionet tjera publike shëndetësore. Megjithatë, MKPT-ja, gjatë vizitave ka vërejtur se trajtimi psikiatrik në spitalin e QKD-së, kryesisht bazohet në terapi dhe konsultime të rregullta me psikiatrin, por jo edhe në aktivitetet të mirëfillta psiko-sociale dhe terapi okupacionale. MKPT-ja, po ashtu, konsideron se bazuar në numrin e madh të të burgosurve, një psikolog, nuk është i mjaftueshëm për të ofruar shërbime psikologjike në QKD. Shërbimet psikiatrike ofrohen edhe në IPFK. Megjithatë, MKPT-ja vëren me shqetësim se ky institut ka në dispozicion të ShKK-së vetëm 12 shtretër.

Gjatë vizitës në QKFML, MKPT-ja intervistoi të miturin L.L dhe analizoi dosjen e tij mjekësore. Lidhur me këtë, MKPT-ja, më 15 janar 2019, i rekomandoi DShB-së që i mituri menjëherë të futet nën observim të përhershëm, deri në një vendim tjetër të autoriteteve shëndetësore. Reagimi i DShB-së dhe drejtorisë së QKFML-së ka qenë i menjëhershëm për të zbatuar këtë rekomandim dhe në ndërkohë, i mituri në fjalë u dërgua në trajtim të mëtejshëm në IPFK.

MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet të rrisin përpjekjet e tyre për të ofruar shërbime adekuate psikiatrike për të burgosurit me çrregullime serioze mendore, duke përfshirë këtu aktivitetet psiko-sociale dhe terapinë okupacionale, përveç terapisë dhe konsultimeve të rregullta me psikiatrin. Përveç kësaj, autoritetet kompetente duhet të rrisin përpjekjet për të rritur kapacitetet e institucioneve në të cilat trajtohen të burgosurit me çrregullime të tilla.

Kushtet materiale në spitalin e QKD-së

Në spitalin e QKD-së u rinovua kati i dytë. Megjithatë, MKPT-ja ka vërejtur se nuk ka çarçafë të mjaftueshëm për pacientët e shtrirë në spital dhe higjiena nuk është në nivelin e duhur. Lidhur me këtë gjendje, DShB-ja, më 16 korrik 2019, e njoftoi MKPT-në se mungon hapësira e mjaftueshme për trajtim të të burgosurve stacionar, mungojnë orenditë për vendosjen e rrobave të pacientëve dhe se pritjet rinovimi i katit të parë të spitalit. Ndër të tjera, DShB-ja e njoftoi MKPT-në se vështirësi në menaxhim të pacientëve po krijon mungesa e një institucioni të veçantë për trajtim të të burgosurve me nevoja të veçanta.

Infrastruktura

Gjatë vizitës në QPP, MKPT ka vërejtur se hapësira e cila shfrytëzohet për kujdesin shëndetësorë është e pamjaftueshme dhe nuk i plotëson as nevojat minimale. Në shfrytëzim është një dhomë e cila përdoret për të gjitha nevojat e kujdesit parësorë nga mjeku i burgut, infermierët, nga psikologu kur ka raste për te trajtuar, si dhe është hapësirë e përhershme e qëndrimit të personelit shëndetësor. Pavarësisht rekomandimit të MKPT që të krijohen kushte adekuate për punë për personelin mjekësorë,

edhe gjatë periudhës për të cilën po raportohet, gjendja e mbetet e njëjtë.²⁴⁴ E njëjta gjendje u konstatua edhe në Qendrën e Paraburgimit në Pejë. Përmes raportit me rekomandime, MKPT, u rekomandoi autoriteteve kompetente që të krijohen kushte adekuate për punë të personelit mjekësorë.²⁴⁵ Meqenëse gjendja e njëjtë u konstatua edhe gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT, përmes letër rekomandimit të dërguar më 16 dhjetor 2019²⁴⁶, ka ripërsëritur këtë rekomandim. Mangësi të tilla u konstatuan edhe në raportin e MKPT për vizitën në QPM.²⁴⁷ Kjo gjendje bie ndesh edhe me parimin e konfidencialitetit të shërbimeve mjekësore.

Gjatë vizitës në BSL, MKPT, ka vërejtur se kushtet fizike në një pjesë të njesisë shëndetësore nuk janë të mira, për shkak të dëmtimeve të dysHEMEVE. Në katin ku është e vendosur stomatologjia punohet në kushte të vështira, pasi që ka material ndërtimor kudo përreth dhe pluhur. Dhomat e qëndrimit nuk janë funksionale dhe janë në të njëjtin kat ku është ordinanca stomatologjike. Përmes raportit me rekomandime të publikuar më 22 nëntor 2019, MKPT u rekomandoi autoriteteve kompetente që të evitohen këto mangësi. Më 4 dhjetor 2019, BSL e njoftoi MKPT, se janë evituar këto mangësi në pajtim me rekomandimin e dërguar.

Kontrollet mjekësore të të sapo pranuarve

Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015 ka theksuar rëndësinë esenciale që kanë kontrollet mjekësore sidomos në rastet e të burgosurve apo të paraburgosurve të sapo-pranuar, jo vetëm për identifikimin e sëmundjeve infektive dhe parandalimin e vetëvrasjeve, por edhe nëpërmjet kontributit i cili jepet në aspektin e parandalimit të torturës përmes evidentimit të duhur të lëndimeve.²⁴⁸

Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale²⁴⁹ dhe PSV²⁵⁰ e DShB përcaktojnë obligimin që i burgosuri i sapo pranuar t'i nënshtrohet kontrollimit mjekësor brenda 24 orëve, nga momenti i pranimit. Obligime të tilla përcaktohen edhe me aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve, siç janë: Rregullat e Mandelës²⁵¹, Rregullat Evropiane të Burgjeve²⁵². MKPT, gjatë

²⁴⁴ Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, publikuar më 5 gusht 2019, paragrafi 31. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/08/06/raport-me-rekomandime-i-mkpt-se-ne-lidhje-me-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-prizren/>

²⁴⁵ Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, publikuar më 22 nëntor 2018, paragrafi 30. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2018/11/22/raport-me-rekomandime-i-mekanizmit-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-per-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-peje/>

²⁴⁶ Letër rekomandim i MKPT-së për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, publikuar më 16 dhjetor 2019. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/12/17/leter-rekomandim-perkitazi-me-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-peje/>

²⁴⁷ Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, publikuar më 28 qershor 2019, paragrafi 18. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/07/04/raport-me-rekomandime-i-mekanizmit-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-lidhur-me-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-mitrovice/>

²⁴⁸ KPT, Raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, publikuar në vitin 2016, paragrafi 62. Shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>

²⁴⁹ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 31.

²⁵⁰ Praktika Standarde e Veprimit, pika 1. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>

²⁵¹ Rregullat e Mandelës, Rregulli 34. Shih në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf

periudhës për të cilën po raportohet ka vërejtur se të gjithë të të burgosurve të sapo pranuar u bëhen kontrollet mjekësore brenda 24 orëve nga momenti i pranimit.

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore parashihet me PSV,²⁵³ e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, me LESP²⁵⁴ dhe Udhëzimin Administrativ për Rendin Shtëpiak në Qendra Korrektuese²⁵⁵, si dhe me aktet relevante ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve.²⁵⁶

Gjatë vizitës në QPP, MKPT vërejt një praktikë shqetësuese, e cila ka të bëjë me marrjen e mostrave të gjakut, të cilat vendoseshin në epruvetë dhe pastaj dërgoheshin në laboratorin e Qendrës së Mjekësisë Familjare nga infermieri apo nga zyrtari korrektues. Lidhur me këtë praktikë, MKPT, aty për aty rekomandoi ndërprerjen e praktikës së tillë, e cila nuk është në pajtim me rregullat mjekësore dhe shkel konfidencialitetin e shërbimeve mjekësore. Përmes raportit me rekomandime²⁵⁷, MKPT, e njoftoi DSHB për këtë dhe rekomandoi ndërprerjen e praktikës së tillë. DSHB, më 12 mars 2019, e njoftoi MKPT se ky rekomandim u implementua duke futur në funksion laboratorin doracak, ndërsa në rastet kur duhet të transferohen mostrat jashtë QPP, kjo nuk do të bëhet nga zyrtari korrektues por nga infermierët.

MKPT, bazuar në intervistat e zhvilluara me të burgosurit dhe me personelin shëndetësor, konstaton se në përgjithësi, këto shërbimet shëndetësore, jepen nën kushte të cilat respektojnë konfidencialitetin, respektivisht jepen pa praninë e zyrtarëve korrektues, përveç në rastet kur prania e tyre kërkohet nga mjeku. Ndërsa në dosjen mjekësore të të burgosurit ka qasje vetëm personeli shëndetësor.

Personeli i qendrave korrektuese dhe të paraburgimit

MKPT përmes raporteve me rekomandime për vizitat në qendra korrektuese dhe të paraburgimit, u rekomandoi autoriteteve kompetente, që sipas vlerësimit dhe nevojës të angazhojnë personel korrektues dhe punëtorë social shtesë.²⁵⁸ Rekrutim të personelit korrektues pati në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan ku numri i personelit korrektues u rrit për 51 zyrtarë. Në QKD, nuk pati shtim të personelit korrektues dhe të punëtorëve social, edhe pse një gjë e tillë u vlerësua si e nevojshme dhe u rekomandua nga MKPT.

²⁵² Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2006) 2 i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, pika 42.1. Shih në: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d>.

²⁵³ Praktika Standarde e Veprimit, pika 11. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>

²⁵⁴ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 49.

²⁵⁵ Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 25, paragrafi 3.

²⁵⁶ Rregullat e Mandelës, Rregullat Evropiane të Burgjeve, Standardet e KPT-së, dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.

²⁵⁷ Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, publikuar më 5 gusht 2019, paragrafi 30. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/08/06/raport-me-rekomandime-i-mkpt-se-ne-lidhje-me-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-prizren/>

²⁵⁸ Raporti me rekomandime për vizitën në Qendrën Korrektuese në Dubravë, publikuar më 28 qershor 2019. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/07/04/raport-me-rekomandime-i-mkpt-se-lidhur-me-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave/>

Procedura e parashtrimit të ankesave në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit

Sistemi efektiv i parashtrimit të ankesave është garanci themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe në qendra të paraburgimit. Personat e vendosur në këto qendra duhet të kenë mundësi për të parashtruar ankesë brenda burgut apo brenda qendrës së paraburgimit ku akomodohen dhe që në mënyrë konfidenciale t'u mundësohet qasja tek autoriteti i duhur.

Neni 91 i LESP, përcakton në hollësi procedurën sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të ShKK. Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT nuk ka pranuar ankesë nga të burgosurit për mos përgjigje nga organet kompetente të SHKK në ankesat dhe kërkesat e tyre. Përveç MKPT, të burgosurit mund t'u drejtohen me ankesa edhe organizatave Jo-Qeveritare të cilat i vizitojnë vendet e privimit të lirisë sipas marrëveshjes që kanë me ministrinë përkatëse.

Çështje të ndërlidhura me sigurinë

Duke konsideruar se pajisja e hapësirave të caktuara në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria me kamera të sigurisë përbën garanci shtesë kundër keqtrajtimit fizik dhe mbrojtje për zyrtarët e sigurisë nga akuzat e rrejshme për keqtrajtim fizik, MKPT, përmes raportit me rekomandime për vizitën në QKD²⁵⁹, QPGJ dhe në qendrat tjera korrektuese dhe të paraburgimit, u rekomandoi autoriteteve kompetente që të vendosen kamera të sigurisë në hapësirat ku ato mungojnë.

Gjatë vizitës përcjellëse në QKD, MKPT, vërejti se në dhomën e kontrollit u instaluan disa kamera rrotulluese të sigurisë të cilat marrin imazhe HD, ndërsa kompania e kontraktuar rregullonte ato të cilat nuk ishin në gjendje funksionale dhe shtonte kamerat e sigurisë aty ku mungonin. Po ashtu, QPGJ zbatoi rekomandimin e MKPT sa i përket pajisjes me kamera të sigurisë.

Peper spray me afat të skaduar

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT, ka vërejtur se zyrtarët korrektues posedonin në kuadër të pajisjeve të tyre *peper spray* me afat të skaduar.²⁶⁰ Përmes raporteve me rekomandime, MKPT, u rekomandoi autoriteteve kompetente që *peper spray* me afat të skaduar të hiqet nga përdorimi pasi që mund të ketë efekt shumë të dëmshme nëse përdoret në hapësira të mbyllura siç janë burgjet. Përmes vizitave të ndryshme, MKPT, u njoftua nga zyrtarët kompetent, se zyrtarët korrektues u furnizuan me *peper spray* të ri.

Megjithatë, MKPT, siç ka rekomanduar edhe në raportet tjera me rekomandime, sërish thekson se *peper spray*, nuk duhet të përbëjë pajisje standarde për të gjithë zyrtarët korrektues.

Masat disiplinore

²⁵⁹Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën Korrektuese. Shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/07/04/raport-me-rekomandime-i-mkpt-se-lidhur-me-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave/>. Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/12/12/raport-me-rekomandime-per-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-gjilan/>

²⁶⁰Lidhur me këtë shih raportet për vizitën në Qendrën Korrektuese në Dubravë, Qendrën e Paraburgimit në Prizren dhe Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, në: <https://www.oik-rks.org/raportet/raporte-mkpt-1/>

MKPT, gjatë vizitave të realizuara në qendra korrektuese dhe të paraburgimit, u fokusua në vlerësimin e respektimit të të drejtave të të burgosurve të cilëve iu shqiptua masa disiplinore e vetmisë. Në përgjithësi, MKPT, ka vërejtur se autoritetet respektuan të drejtat themelore të të burgosurve të cilëve iu shqiptua kjo masë, siç janë: kushtet e akomodimit të jenë në pajtim me standardet e LESP dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve, siç janë: e drejta për shërbime mjekësore të rregullta, për të dalje në ajër të pastër, për të mbajtur kontaktet me familjen, për të bërë dush etj. Po ashtu, MKPT ka vërejtur se të gjithë të burgosurve të cilëve iu shqiptua kjo masë, iu dorëzua kopja e vendimit të drejtorit të institucionit korrektues për shqiptimin e kësaj mase përmes së cilit ata këshillohen për mjetin e ankesës kundër të njëjtit.

Të huajt në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit

Gjatë vizitave në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit, MKPT, ka intervistuar një numër të shtetasve të huaj. MKPT nuk ka pranuar ankesa për mosrespektim të të drejtave të cilat u garantohen me LESP dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve. MKPT ka vërejtur komunikim interaktiv mjaftë të mirë ndërmjet kësaj kategori të të burgosurve me zyrtarët korrektues dhe të të burgosurit tjerë.

Qendra për Azilkërkues

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja 3 herë e ka vizituar Qendrën për Azilkërkues. Më 16 dhjetor 2019, Avokati i Popullit realizoi takim të drejtpërdrejtë me azilkërkuesit në qendër, të cilët i njoftoi me mandatin e IAP-së dhe dëgjoji kërkesat dhe ankesat e tyre. Këto ankesa i referohen cilësisë së ushqimit, i cili u shërbehet për darkë. MKPT-ja, në raportin me rekomandime për vizitën në këtë qendër, i publikuar më 14 qershor 2018, ka theksuar se ka pranuar ankesa nga azilkërkuesit në qendër sa i përket cilësisë së ushqimit, i cili u shërbehet në darkë. Drejtoria e Qendrës, më 24 korrik 2019, e njoftoi MKPT-në se ka angazhuar në qendër një kuzhinier për të përmbushur nevojat e azilkërkuesve për ushqim më cilësor dhe për të rritur sasinë e ushqimit që u shërbehet. Gjatë vizitës, drejtori e njoftoi Avokatin e Popullit se po përballet me probleme me kontraktuesit, të cilët nuk po i kryejnë obligimet e tyre. Me qëllim që të lehtësohet komunikimi dhe për t'i njoftuar azilkërkuesit për rolin dhe mandatin e Avokatit të Popullit, gjatë vizitës, azilkërkuesve u shpërndan broshuar në gjuhë të ndryshme.

Trajtimi

MKPT-ja nuk ka pranuar asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo sjellje të zyrtarëve të qendrës, përfshirë ata të sigurisë, që do të ishte në kundërshtim me respektimin e dinjitetit të azilkërkuesve, si dhe mosrespektim të të drejtave të tyre themelore, të cilat u garantohen me Ligjin për Azil.²⁶¹ Ligji në fjalë azilkërkuesve ua garanton të drejtat themelore në vijim: të qëndrojnë në Republikën e Kosovës, të kenë kushte themelore të jetesës, të kenë kujdesin shëndetësor, të kenë ndihmën sociale themelore, të kenë ndihmën ligjore pa pagesë, të drejtën për arsimim për aplikuesit fëmijë, të drejtën në lirinë e mendimit dhe besimit fetar, për punësim dhe të drejtën në trajnime profesionale.

²⁶¹ Ligji nr. 06/L-026 për Azil, neni 26.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, u shënuar rritje e numrit të azilkërkuesve të cilët kërkuan azil në Republikën e Kosovës. Sipas drejtorisë së Qendrës për Azilkërkues, deri më tani janë regjistruar 1642 azilkërkues, ndërsa në vitin 2018 janë regjistruar 594.

Kushtet e akomodimit në Qendrën për Azilkërkues në Magurë vazhdojnë të jenë të një standardi shumë të mirë. Po ashtu, në qendër ekzistojnë hapësira të përshtatshme për qëndrim të fëmijëve, këndi i lojërave brenda dhe këndi i lojërave në oborr.

Ndihma juridike falas

Ndihma juridike falas, si një e drejtë themelore, vazhdon të jepet nga OJQ CRPK (Civil Rights Program Kosovo). Ndërsa qasja, përveç Avokatit të Popullit, u garantohet edhe organizatave ndërkombëtare, siç janë: UNHCR, KPT, Kryqi i Kuq Ndërkombëtar dhe OJQ-ve vendore sipas marrëveshjes.

Qendra e Mbajtjes për të Huajt

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ka kryer 3 vizita në QMH, ka publikuar një raport me rekomandime për vizitën në këtë qendër dhe autoriteteve kompetente ua ka dërguar 6 rekomandime.²⁶² Në pikëpamje të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, paraburgimi (dërgimi i të huajit në mbajtje) duhet të jetë masa e fundit të cilën e zbatojnë autoritetet e një shteti për ta larguar të huajin nga territori, i cili është subjekt i kthimit me forcë.

Gjatë vitit 2019, 11 të huaj u vendosën në QMH dhe qëndruan vetëm pak kohë aty deri në depërtim nga territori i Republikës së Kosovës, pasi që Ministria e Punëve të Brendshme dhe Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) kanë nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi për Kthim të Asistuar Vullnetar dhe Riintegrim (Assisted Voluntary Return and Reintegration).²⁶³ Në përgjithësi, MKPT-ja vëren se autoritetet kompetente po zbatojnë më shpesh masat alternative në raport me masën e paraburgimit.

MKPT-ja po ashtu vëren se Ligji 04/L-219 për të Huajt i Republikës së Kosovës²⁶⁴ parasheh se masat tjera alternative kanë përparësi në raport me dërgimin e të huajit në mbajtje. Edhe KPT-ja, në standardet e përcaktuara në vitin 2017²⁶⁵, përcakton se paraburgimi i të huajit sipas ligjit për të huajt duhet të jetë masë e fundit dhe se masave të tjera alternative duhet t'u jepet epërsi.

Trajtimi

MKPT-ja nuk ka pranuar asnjë ankesë nga të huajt të cilët ishin në mbajtje, për keqtrajtim fizik apo sjellje të zyrtarëve të qendrës, e cila bie ndesh me respektimin e dinjitetit të tyre njerëzor.

²⁶² Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Mbajtjes për të Huajt, publikuar më 23 prill 2019. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/03/27/raport-me-rekomandime-te-mkpt-se-lidhur-me-viziten-ne-qendren-per-te-huaj-ne-vranidoll/>

²⁶³ Për më shumë shih në: <https://kosovo.iom.int/news/iom-kosovo-and-ministry-internal-affairs-sign-mou-avrr>

²⁶⁴ Ligji nr. 04/L-219 për të Huajt, neni 97, paragrafi 2.

²⁶⁵ KPT, Standardet e publikuara në mars të vitit 2017 për paraburgimin e të huajve. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>.

Kushtet e akomodimit në QMH

MKPT-ja ka vërejtur se të gjitha dhomat ku akomodohen të huajt në QMH ofrojnë akomodim të denjë, ngrohje, ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe artificial, si dhe dushe të cilat ishin në gjendje shumë të mirë. MKPT-ja konsideron se kushtet e akomodimit të QMH janë në nivel shumë të mirë.

Njoftimi me të drejtat dhe obligimet

Të huajt në QMH, për të drejtat dhe obligimet e tyre, njoftohen përmes broshurave të shkruara në gjuhët më të njohura, siç janë arabishtja, anglishtja, frëngjishtja, italishtja, turqishtja etj. MKPT-ja ka vërejtur se në këto broshura, të huajve në QMH, u jepen të dhëna për agjencitë, OJQ-të dhe institucionet të cilat mund t'i kontaktojnë lidhur me të drejtat e tyre, nuk përmbajnë të dhëna për Institucionin e Avokatit të Popullit dhe MKPT-në.

Regjimi

Neni 24, paragrafi 1, i Rregullores (MPB) nr. 04/2018 për Funksonimin e Qendrës për Mbajtjen e të Huajt (Rregullorja) përcakton se çdo i huaj i ndaluar në Qendër ka të drejtë për ajrosje së paku dy orë në ditë në mjediset e jashtme të Qendrës. Për arsye shëndetësore, udhëheqësi i Qendrës mund ta zgjasë kohën e ajrimit.

KPT, në standardet e përcaktuara në mars të vitit 2017²⁶⁶ për paraburgimin e të huajve, për shkak të imigracionit, thekson rëndësinë e një regjimi, i cili përmban sa më shumë aktivitete. Sipas KPT-së, sa më e gjatë që është periudha e mbajtjes së të huajve, po aq duhet të zhvillohen aktivitetet të cilat u ofrohen atyre. QMH tani ka një fushë të vogël sportive, e cila është e pajisur me elementet përcjellëse, ku të huajt mund të luajnë futboll dhe basketboll, gjë që ishte edhe rekomandim i MKPT-së.

Kontakti me botën e jashtme

Sipas standardeve të KPT-së²⁶⁷, të ndaluarit e huaj duhet të kenë çdo mundësi për të qenë në kontakt të mirëfilltë me botën e jashtme (përfshirë mundësitë për të bërë telefonata dhe për të pranuar vizita) dhe liria e tyre e lëvizjes brenda qendrës së mbajtjes duhet të kufizohet sa më pak që të jetë e mundur. Sipas nenit 25 të Rregullores, i huaji në mbajtje ka të drejtë të mbajë korrespondencë, të pranojë pako dhe sende të tjera. Po ashtu, të huajve në mbajtje u lejohej të pranojnë vizita.

Rregullorja përcakton se i huaji ka të drejtë të bëjë telefonata sipas nevojës në kohëzgjatje prej 5 minutash, duke filluar nga ora 9:00 deri në orën 16:00, çdo ditë pune. Sipas Rregullores, të huajve u mundësohen edhe thirrjet nga jashtë. Gjatë vizitave, MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa nga të huajt e akomoduar në QMH sa i përket së drejtës për kontakte me botën e jashtme.

Rekomandimet e MKPT-së dhe progresi i autoriteteve në zbatimin e tyre

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ua dërgoi autoriteteve kompetente rekomandimet si në vijim:

²⁶⁶ Standardet e KPT-së, publikuar në vitin 2017, në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>

²⁶⁷ Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>

- *QMH duhet të ketë në dispozicion së paku një infermiere, e cila do t'i kryente kontrollet mjekësore të sapo pranuarve, do ta shpërndante terapinë dhe do të kujdesej për dosjet mjekësore të të huajve në QMH.* Të sapopranuarëve u bëhet një kontroll mjekësore nga ekipet e emergjencës. Megjithatë, nuk ka pasur ndonjë progres sa i përket rekomandimit të MKPT-së për angazhim të së paku një infermiereje, e cila do t'i kryente kontrollet mjekësore të sapopranuarve, do ta shpërndante terapinë dhe do të kujdesej për dosjet mjekësore të të huajve në QMH.
- *QMH duhet t'i mbajë protokollat si në vijim: Protokolle për vetminë, për lëndime trupore, për vetëlëndime, për tentim-vetëvrasje, për abuzim seksual dhe të vdekjeve.* MKPT-ja ka vërejtur se mbahen të dhënat relevante në dosjen e të huajve të akomoduar në QMH, për të gjitha ngjarjet lidhur me të huajt e akomoduar në QMH dhe përdoret regjistri elektronik i MPB-së.
- *Personeli i sigurisë duhet t'u nënshtrohet trajnimeve adekuate për të punuar me këtë kategori.* Nuk ka pasur trajnime për personelin e sigurisë për të punuar me këtë kategori, pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve kompetente për të gjetur zgjidhje për këtë çështje.
- *Të huajt, për të gjitha të drejtat dhe obligimet e tyre të njoftohen përmes një dokumenti të veçantë, në gjuhën të cilën e kuptojnë dhe në të cilin ata vërtetojnë se i kanë kuptuar të drejtat dhe obligimet e tyre.* MKPT-ja ka vërejtur se të huajt njoftohen me të drejtat dhe obligimet e tyre përmes broshurave në gjuhë të ndryshme. Por ende nuk u përpilua dokumenti sipas rekomandimit të MKPT-së.
- *Të huajve, të cilëve u shqiptohet masa disiplinore e izolimit, t'u mundësohet gëzimi i të drejtave, në pajtim me standardet e përcaktuara nga KPT.* Sipas drejtorit të QMH, është në proces rishikimi i Rregullores së tanishme. MKPT-ja ka kërkuar që drafti i rregullores në fjalë t'i dërgohet për komente eventuale lidhur me pajtueshmërinë e saj me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
- *Të miratohet një Rregullore formale disiplinore, e cila do t'i precizojë procedurat disiplinore dhe të drejtat e të huajit, të cilit i shqiptohet një masë e tillë.* MKPT-ja me keqardhje vëren se nuk ka pasur progres në zbatimin e këtij rekomandimi. Miratimi i një rregulloreje formale disiplinore do të ishte një garanci shtesë për mbrojtjen e të drejtave themelore të të huajve në QMH.

Vizita në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja, nën vëzhgimin e ekspertëve të Këshillit të Evropës, më 7 maj 2019, vizitoi Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë. Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të huajve, të cilët, bazuar në Ligjin për të Huajt dhe në ligjet e tjera relevante, nuk mund të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës, janë subjekt i kthimit në vendet nga kanë ardhur apo mbahen përkohësisht në hapësirat e mbajtjes në pikën hyrëse të Aeroportit Ndërkombëtar në Prishtinë (ANP).

Hapësirat e mbajtjes në pikën hyrëse të ANP-së

Të huajt, të cilët duan ta kalojnë kufirin e Republikës së Kosovës dhe për këtë nuk i plotësojnë kriteret ligjore, si dhe nëse avio-transportuesi nuk është në gjendje që ta bëjë kthimin e tyre të menjëhershëm, mbahen në hapësira të veçanta në ANP, deri në 72 orë. Këto hapësira njihen edhe si hapësira të

mbajtjes në pikën hyrëse nëpër aeroporte. Gjatë vizitës së MKPT-së në ANP nuk kishte të huaj të akomoduar në këto hapësira.

Sa i përket kushteve të akomodimit në këto hapësira, MKPT-ja ka vërejtur se ato ofrojnë kushte të mira për akomodim, me inventar të mjaftueshëm për vendosjen e gjësendeve personale, pastërti në nivel të duhur, tualete të furnizuara me mjete higjienike, dushe në gjendje shumë të mirë dhe me dritë artificiale të mjaftueshme. Sa i përket kontakteve me botën e jashtme, në dispozicion të të huajve për kontakte me botën e jashtme është qasja në internet përmes “wi-fi”-së. Sa u përket shërbimeve mjekësore, MKPT-ja ka vërejtur se shërbimi mjekësor në kuadër të ANP-së ofron shërbime mjekësore 24 orë në ditë për personelin, të ndaluarit dhe për udhëtarët tjerë.

Informimi për statusin ligjor dhe me të drejtat e tyre

Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se në dhomat ku akomodohen të huajt, të cilët nuk mund ta kalojnë kufirin e Republikës së Kosovës, nuk ka informata të afishuara se kujt dhe si mund t’i drejtohen ata nëse kanë ankesa sa i përket trajtimit nga zyrtarët policorë apo nëse duan të dinë për statusin e tyre ligjor dhe për të drejtat e tyre. Bazuar në këtë, MKPT-ja, përmes raportit me rekomandime pas vizitës, u rekomandoi autoriteteve kompetente:

- Hapësirat e mbajtjes në pikat hyrëse të ANP-së të pajisen me informata relevante në gjuhë të ndryshme, përmes së cilave të huajt njoftohen për të drejtat e tyre, për statusin e tyre ligjor, si dhe për të drejtën për t’i kontaktuar me mekanizmat për mbrojtjen e drejtave të njeriut.
- Të njoftohet MKPT-ja sa herë që ka raste kur të huajt akomodohen në pikat hyrëse për mbajtje në ANP dhe për raste të dëbimit të tyre nga territori i Republikës së Kosovës.

Monitorimi i operacioneve të kthimit me forcë përmes linjave ajrore

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja monitoroi në ANP dy operacione të kthimit me forcë të shtetasve të Republikës së Kosovës nga autoritetet zvicerane. Ky monitorim bazohet në Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Komisioni Nacional Zviceran për Parandalim të Torturës.²⁶⁸ Gjatë monitorimit të operacioneve në fjalë, MKPT-ja ka vërejtur se të kthyerit me forcë janë trajtuar në mënyrë humane nga autoritetet policore të Republikës së Kosovës.

Institucionet e shëndetit mendor

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ka vizituar IPFK-në, Repartin e urgjencës dhe kujdesit intensiv psikiatrik të Klinikës Psikiatrike. Qëllimi i vizitave ishte vlerësimi i progresit të autoriteteve kompetente në implementimin e rekomandimeve të MKPT-së të dërguara përmes raporteve të mëhershme me rekomandime.²⁶⁹

²⁶⁸ Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Komisionit Nacional Zviceran për Parandalim të Torturës për monitorim të operacioneve të kthimit me forcë e nënshkruar më 24 prill 2019. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/04/25/nenshkruhet-memorandumi-i-mirekuptimit-ne-mes-te-zvices-dhe-kosoves-per-parandalim-te-tortures-dhe-monitorim-te-perbashket-te-operacioneve-te-kthimit-me-force/>

²⁶⁹ Raporti me rekomandime për vizitën në Institutin e Psikiatrisë Forenzike, publikuar më 28 gusht 2018. Për më shumë në: <https://www.oik-rks.org/2018/08/28/raporti-nga-vizita-ne-institutin-e-psikiatrise-forenzike/>. Raporti me rekomandime

MKPT-ja ka vërejtur se në këto institucione nuk pati progres domethënëse sa i përket implementimin të rekomandimeve. MKPT-ja, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, nuk ka pranuar ankesa nga të akomoduarit në këto institucione sa i përket trajtimit human dhe për mos respektim të të drejtave tjera themelore.

Shtëpitë Integruese në Bashkësi

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ka vizituar Shtëpinë Integruese në Bashkësi në Bresje, Drenas, Ferizaj, Pejë, Gjilan, Mitrovicë, Gjakovë dhe Prizren. Këto institucione menaxhohen nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK).

Legjislacioni relevant

Legjislacioni relevant gjendet në Ligjin nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor dhe në Udhëzimin Administrativ nr. 07/2009 për Shërbimin Profesional të Shëndetit Mendor në Republikën e Kosovës. Bazuar në dispozitat e akteve juridike të lartpërmendura, Shtëpia për Integrim në Bashkësi (ShIB) ofron kujdes kohë-gjatë shëndetësor në funksion të rehabilitimit dhe riintegrit social të klientëve me sëmundje dhe çrregullime kronike të shëndetit mendor.²⁷⁰ Vendosija e rezidentëve bëhet bazuar në kriteret e përcaktuara në udhëzim administrativ dhe në vendimin e komisionit përkatës për vlerësim. Paragrafi 7 i Udhëzimit Administrativ nr. 07/2009 thekson se në ShIB pranohen vetëm klientët me sëmundje dhe çrregullime kronike psikotike në remisio. Në ShIB nuk pranohen rastet me prapambetje mendore, demencat e të gjitha llojeve, sëmundjet e vartësisë dhe rastet sociale.

Trajtimi dhe kushtet e akomodimit

Secila Shtëpi për Integrim në Bashkësi ka kapacitet për 10 persona, në përjashtim të Mitrovicës, e cila i ka dy Shtëpi për Integrim në Bashkësi, me nga 10 shtretër, gjithsej kapacitet për 20 persona. Në të gjitha Shtëpitë për Integrim në Bashkësi kushtet e akomodimit në përgjithësi janë të mira, kanë ndriçim, ngrohje dhe ajrim të përshtatshëm. Mjediset sanitare u lejojnë privatësi rezidentëve dhe personelit të institucionit. Po ashtu, secili rezident në këto shtëpi ka dollapin personal për t'i ruajtur gjësendet personale. MKPT-ja gjatë vizitave ka vërejtur se në asnjërën nga shtëpitë nuk ka mbipopullim. MKPT-ja, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, u njoftua nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) se për regjionin e Pejës u ndërtua edhe një Shtëpi për Integrim në Bashkësi, në Deçan, me kapacitet për 10 persona.

Ushqimi

Ushqimi i pacientëve është një tjetër aspekt i rëndësishëm i kushteve të jetesës. KPT-ja thekson rëndësinë e veçantë që ka ushqimi për këtë kategori. Sipas KPT-së, ushqimi jo vetëm që duhet të jetë i përshtatshëm nga pikëpamja e sasisë dhe cilësisë, por edhe të jepet në kushte të kënaqshme.²⁷¹ MKPT-ja ka vërejtur se në secilën ShIB, ushqimin e përgatisin personeli bashkë me rezidentët. MKPT-ja,

për vizitën në Klinikën Psikiatrike të QKUK-së. Shih në: <https://www.oik-rks.org/2018/10/29/raport-me-rekomandime-lidhur-me-viziten-ne-klinikene-psikiatrike-ne-qkuk/>

²⁷⁰ Udhëzimi Administrativ (në Shëndetësi) nr. 07/2009 Për Shërbimin Profesional të Shëndetit Mendor në Republikën e Kosovës, neni 9 paragrafi 1.

²⁷¹ KPT, Pjesë nga raporti i 8-të i Përgjithshëm, i publikuar në vitin 1998. Shih në: <https://rm.coe.int/16806cd43e>

gjatë vizitave në këto institucione, nuk mori ankesa sa i përket ushqimit, përveç në Shtëpinë për Integrim në Bashkësi në Mitrovicë, ku ka pasur mungesa me furnizime.

Trajtimi dhe aktivitetet

Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur një qasje të afërt dhe miqësore nga personeli ndaj rezidentëve dhe kryesisht vërehej një klimë pozitive brenda shtëpive të vizituara. Rezidentët duken mirë për nga veshja dhe higjiena. MKPT-ja nuk ka hasur në shenja të lëndimeve trupore tek rezidentët. MKPT-ja ka intervistuar rezidentët dhe nuk ka pranuar ankesa për ndonjë formë të keqtrajtimit apo sjellje të personelit, të cilat cenojnë dinjitetin e rezidentëve.

MKPT-ja, gjatë vizitave në Shtëpitë për Integrim në Bashkësi, ka vërejtur se aktivitetet dallojnë nga institucioni në institucion. Në përgjithësi realizohen aktivitete, siç janë: shëtitjet 2 herë në vit në natyrë, lojë shahu, ping-pongu, punë dore etj. Ndërsa në Shtëpinë për Integrim në Bashkësi në Gjilan, rezidentët punojnë në serrë.

Standardet e KPT-së theksojnë se trajtimi psikiatrik duhet të bazohet në një qasje të individualizuar, gjë që nënkupton hartimin e një plani trajtimi për çdo pacient. Ai duhet të përfshijë një gamë të gjerë aktiviteteve rehabilituese dhe terapeutike, duke përfshirë qasje në terapi okupacionale, terapi në grup, psikoterapi individuale, art, teatër, muzikë dhe sporte. Rezidentët duhet të kenë qasje të rregullt në dhoma argëtimi të pajisura përshtatshëm dhe të kenë mundësinë çdo ditë të dalin në ajër të pastër në qiell të hapur, gjithashtu është e dëshirueshme që atyre t'u ofrohet arsimim dhe punë e përshtatshme.²⁷²

MKPT-ja shpreh brengosjen për faktin se Shtëpitë për Integrim në Bashkësi, të cilat janë vizituar, nuk kanë një plan të individualizuar të trajtimit me përfshirje të rezidentit. Prandaj MKPT-ja inkurajon personelin e tyre të punojë në këtë drejtim dhe kjo do ta lehtësojë edhe punën e personelit.

Kujdesi shëndetësor

MKPT-ja ka vërejtur se në Shtëpinë për Integrim në Bashkësi ofrohen shërbime të rregullta psikiatrike, të cilat kryhen nga psikiatri i qendrave të shëndetit mendor i atyre regjioneve, ndërsa në rast nevojë, shërbimet tjera shëndetësore dhe specialistike u ofrohen nga qendrat e mjekësisë familjare. MKPT-ja ka vërejtur në dosjet e tyre shëndetësore se rezidentët në këto shtëpi janë kryesisht të diagnostikuar me çrregullime psikotike, por që janë në fazën e remisionit dhe trajtohen me farmakoterapi. Bazuar në dosjet e analizuara nga MKPT-ja del se rezidentëve u bëhen analizat laboratorike të rregullta.

Personeli

Shtëpitë Integruese udhëhiqen nga drejtori i qendrave të shëndetit mendor të regjioneve përkatëse. Qendrat e shëndetit mendor janë qendra të hapura ditore, të cilat kanë personel profesional, si: psikiatër, psikolog dhe infermier, të cilët u ndihmojnë edhe Shtëpive të Integritimit në Bashkësi.

²⁷² Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, pjesë nga Raporti i 8-të i Përgjithshëm [CPT/Inf (98) 12].

MKPT-ja ka vërejtur se numri i personelit ndryshon në regjione dhe se në disa shtëpi mungon numri i nevojshëm i personelit, gjë që e vështirëson punën dhe si pasojë, zakonisht natën, kujdestaron vetëm një infermier. MKPT-ja inkurajon ShSKUK-në që ta rrisë numrin e personelit sipas vlerësimit dhe nevojës.

Mjetet e kufizimit

Sa u përket mjeteve të kufizimit, neni 27 i Ligjit nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor përcakton se kufizimi fizik i personave me çrregullime mendore zbatohet në institucionet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër dhe përfshin, sipas protokollit përkatës, elementet e mëposhtme: mbajtja me forcë e personit, përdorimi i detyruar i medikamenteve, imobilizimin, izolimin.

Bazuar në pohimet e personelit, rezidentëve dhe dosjeve të tyre, në këto shtëpi nuk përdoren mjetet mekanike të kufizimit fizik, por vetëm ato kimike, psiko-terapia, intervenimet farmako-terapeutike dhe nuk përdoren masat izoluese.

Lidhur me vizitat dhe gjetjet në këto institucione, MKPT-ja do të publikojë raport të veçantë me rekomandime, përmes të cilit do të theksohen gjetjet dhe rekomandimet konkrete për çështje të caktuara do t'u dërgohen organeve, të cilat i menaxhojnë këto institucione.

Shtëpitë me Bazë në Komunitet

Shtëpitë me Bazë në Komunitet vazhdojnë të rregullohen me dy udhëzime administrative: Udhëzimi Administrativ nr.11/2014 për punën dhe vendosjen e rezidentëve, personave me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendor në Institutin Special në Shtime dhe në shtëpitë me bazë në komunitet; dhe Udhëzimi Administrativ me nr.13/2010 për ofrimin e shërbimeve në komunitet-shtëpi për persona me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendor.

Vizitat e realizuara nga MKPT-ja në vitin 2019

Shtëpitë me Bazë në Komunitet, nga janari i vitit 2016, menaxhohen nga Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. MKPT-ja gjatë vitit 2019 ka vizituar 7 Shtëpi me Bazë në Komunitet: Shtëpitë me Bazë në Komunitet në Shtime, Ferizaj, Vushtrri, Deçan, Kamenicë, Graçanicë dhe Lipjan.

Kushtet materiale në shtëpitë e vizituara

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja u njoftua nga MPMS-ja se janë ndërtuar edhe dy shtëpi tjera me bazë në komunitet, në Prizren dhe Novobërdë, të cilat do të funksionalizohen nga viti 2020. Gjithashtu, gjatë vizitës së MKPT-së, Shtëpia me Bazë në Komunitet në Shtime ishte duke u rinovuar. Kapaciteti i tyre zyrtar është për 10 rezidentë. Megjithatë, MKPT-ja, gjatë vizitës në Shtëpinë me Bazë në Komunitet në Vushtrri, ka vërejtur se ishin akomoduar 13 rezidentë, ndërsa në Shtëpinë me Bazë në Komunitet në Kamenicë 12 rezidentë.

Gjatë vizitave të realizuara, MKPT-ja ka vërejtur se Shtëpitë me Bazë në Komunitet, sa u përket kushteve të akomodimit, përveç atyre në Ferizaj dhe Vushtrri, në përgjithësi janë në nivel të kënaqshëm. Dhomat dhe hapësirat ku akomodohen dhe zhvillojnë aktivitetet kanë ndriçim, ngrohje

dhe ajrim të përshtatshëm. Po ashtu, dhomat dhe mjediset sanitare u ofrojnë rezidentëve privatësinë e duhur.

Megjithatë, MKPT-ja ka vërejtur se Shtëpia me Bazë në Komunitet në Ferizaj nuk kishte kushte të mira të akomodimit, në kuzhinë disa pajisje nuk funksiononin, siç ishte makina për larjen e enëve, dushet ishin të dëmtuara, mungonte një makinë e madhe për pastrimin e rrobave, pasi që kjo kategori e rezidentëve varen plotësisht nga personeli. Përveç kësaj, personeli nuk ka dhomë për qëndrim dhe nuk ka hapësirë adekuate për dhënien e terapisë apo injeksioneve. Shpeshherë ballafaqohen me probleme me furnizim me barna, veshmbathje dhe mbuloja. Në raste të caktuara janë furnizuar me veshmbathje nga organizatat e ndryshme joqeveritare. Shtëpia me Bazë në Komunitet në Vushtri kishte kushte mesatare, nuk kishte hapësirë të përshtatshme në oborrin e shtëpisë dhe për qëndrim të rezidentëve.

MKPT-ja ka vërejtur se në Shtëpinë me Bazë në Komunitet në Lipjan i kushtojë vëmendje edhe dekorimit të hapësirave të qëndrimit ditor me punime që vetë rezidentët i bëjnë, për t'u dhënë stimulim pamor.

Ushqimi i pacientëve është një tjetër aspekt i kushteve të tyre të jetesës që është me rëndësi të veçantë për KPT-në. Ushqimi jo vetëm që duhet të jetë i përshtatshëm nga pikëpamja e sasisë dhe cilësisë, por edhe të jepet në kushte të kënaqshme²⁷³. MKPT-ja ka vërejtur se në secilën Shtëpi me Bazë në Komunitet ushqimin e përgatisin personeli. MKP-ja nuk ka pranuar ankesa sa i përket cilësisë dhe sasisë së ushqimit.

Keqtrajtimi fizik dhe incidentet ndërmjet rezidentëve

MKPT-ja nuk ka vërejtur indikacione se në shtëpitë e vizituara ushtrohet keqtrajtim fizik apo psikologjik nga personeli. Përkundrazi, në të gjitha shtëpitë e vizituara u vërejt përkushtimi i personelit për t'i trajtuar rezidentët në mënyrë humane. Për më shumë, u vërejt komunikim i mirë ndërmjet rezidentëve dhe personelit.

Përmes analizimit të dokumentacionit mjekësor dhe administrativ në Shtëpitë me Bazë në Komunitet në Ferizaj dhe Vushtri, MKPT-ja ka vërejtur se ka pasur raste të incidenteve ndërmjet rezidentëve dhe raste të vetëlëndimeve. MKPT-ja konsideron se obligimi i autoriteteve për t'u kujdesur për rezidentët përfshin edhe përgjegjësinë e tyre për t'i mbrojtur ata nga rezidentët e tjerë, të cilët mund t'i sulmojnë fizikisht.²⁷⁴

Trajtimi dhe aktivitetet

Sa u përket aktiviteteve në përgjithësi, në shumicën e shtëpive të vizituara, MKPT-ja u njoftua se rezidentët zakonisht dëgjojnë muzikë, shikojnë TV, merren me vizatime, bëjnë disa dalje në qytet, ndërsa në disa Shtëpi me Bazë në Komunitet realizojnë shëtitje në vende të largëta 2 herë në vit, në natyrë apo në qytete të tjera. MKPT-ja inkurajon udhëheqësit e këtyre institucioneve që t'i kushtojnë rëndësi zhvillimit të terapisë së punës edukative dhe aftësuese, aktiviteteve psiko-sociale dhe rekreative si dhe të kenë plan të individualizuar të trajtimit, sipas nevojave dhe aftësive të rezidentëve.

²⁷³ Po aty, paragrafi 35.

²⁷⁴ Për më shumë shih Raportin e KPT-së për vizitën në Bullgari, publikuar më 6 tetor 2017, faqe 75 paragrafi 153, në: <https://rm.coe.int/16807c4b74>

Kujdesi shëndetësor

MKPT-ja u njoftua se në Shtëpitë me Bazë në Komunitet shërbimet shëndetësore ofrohen nga Qendrat e Mjekësisë Familjare. Në Shtëpinë me Bazë në Komunitet në Ferizaj një rezident është me çrregullime të rënda. Bazuar në dosjen e tij shëndetësore, rezidenti përdor me vite terapinë e njëjtë psikiatrike, nuk është vizituar nga psikiatri për disa vite dhe nuk u rivlerësua gjendja e tij mendore. Shërbimet e psikiatrit në këtë institucion nuk janë në dispozicion për gati 5 vjet dhe kjo e vështirëson punën për infermierët.

Sipas personelit, shërbimet psikiatrike të rregullta nuk mund t'i marrin nga Qendra e Shëndetit Mendor në Ferizaj. Lidhur me këtë gjendje, MKPT-ja ka biseduar me drejtorin e Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, i cili e njoftoi se janë në pritje të angazhimit të një psikiatri. Gjithashtu në këtë Shtëpi ka pasur edhe probleme me furnizim me barna.

MKPT-ja vëren se neni 18, paragrafi 1, i Ligjit me nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, përcakton: *“Personave, që gjenden në institucionet rezidenciale të kujdesit social, u ofrohet këshillim, trajtim, rehabilitim dhe kujdes në shëndet mendor në mënyrë të barabartë dhe sipas standardeve shëndetësore, të miratuara nga Ministra e Shëndetësisë”*. Ndërsa, paragrafi 2 i këtij neni thotë: *“Mënyra e organizimit dhe e dhënies së shërbimeve, të parashikuara në paragrafin 1, të këtij neni, përcaktohet me akt të veçantë nënligjor të propozuar nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të miratuar nga Qeveria.”* Pavarësisht rekomandimit të MKPT-së që, në pajtim me Ligjin për Shëndet Mendor, të miratohen aktet nënligjore, i cili iu dërgua autoriteteve kompetente përmes Raportit me rekomandime për vizitën në Institutin Special në Shtime²⁷⁵, i cili u publikua më 22 shkurt 2017, MKPT-ja ka vërejtur se nuk ka pasur progres në zbatimin e këtij rekomandimi.

MKPT-ja, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, ka vizituar Institutin Special në Shtime dhe Shtëpinë e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore (ShFAKM) në Shtime, të cilat janë të menaxhuara nga MPMS-ja. Në Shtëpinë e Fëmijëve në Shtime, MKPT-ja ka realizuar vizitë përcjellëse dhe u konstatua se të gjitha rekomandimet e MKPT-së, të cilat iu dërguan autoriteteve kompetente përmes raportit me rekomandime, më 23 prill 2019, janë implementuar.²⁷⁶ Megjithatë, gjatë vizitës përcjellëse të realizuar më 5 nëntor 2019, MKPT-ja ka vërejtur se këtij institucioni i mungon hapësira e duhur për fizioterapi.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ka vizituar Shtëpinë për të Moshuar pa Përkujdesje Familjare, në Graçanicë, e cila funksionon nga viti 2014. Ky institucion nga viti 2016 menaxhohet nga Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Kjo shtëpi ka kapacitet për 10 rezidentë, gjatë vizitës u konstatua se janë prezentë 8 rezidentë. Kushtet e akomodimit janë shumë të mira. Sa i përket personelit, kjo shtëpi ka 17 të punësuar (një infermier, katër ndihmës mjekësorë, gjashtë kujdestarë dhe 5 persona në sigurimin e objektit). Bazuar në dosjet shëndetësore,

²⁷⁵ Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2018/01/31/raport-i-mkpt-instituti-special-ne-shtime/>

²⁷⁶ Raport me rekomandime për vizitën në Shtëpinë e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore, publikuar më 23 prill 2019. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/05/03/raport-i-mkpt-lidhur-me-viziten-ne-shtepine-e-femijeve-me-aftesi-te-kufizuara-ne-shtime/>

nuk kishte raste me demencë. MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa nga rezidentët lidhur me trajtimin apo për mosrespektim të të drejtave tjera të tyre.

Shtëpia për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare

Shtëpia për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (ShPMPF) është institucion me karakter social dhe vepron në kuadër të MPMS-së. Kapaciteti zyrtar i këtij institucioni është për 110 persona. Gjatë vizitës së fundit përcjellëse, e realizuar më 29 gusht 2019, MKPT-ja u informua se ishin 74 rezidentë prezentë.

Rekomandimet e MKPT-së të dërguara përmes raportit të publikuar më 25 janar 2018²⁷⁷:

1. Urgjentisht të bëhen investime sipas vlerësimit të nevojave, në ndërtesën e vjetër dhe hapësirat ku funksionon shërbimi mjekësor dhe shërbimi i stomatologjisë.

MKPT gjatë vizitës përcjellëse konstatoi se ka progres në këtë drejtim, janë gëlqerosur hapësirat e brendshme ku jetojnë rezidentët si dhe hapësirat ku janë të vendosura shërbimet shëndetësore. MKPT nga zyrtarët e institucionit në fjalë është njoftuar se shërbimi i stomatologjisë dhe fizioterapisë do të zhvendosen nga kati përdhese dhe do të kalojnë në katin e parë. MKPT inkurajon MPMS që të vazhdojë përpjekjet për të zbatuar plotësisht rekomandimin e lartpërmendur të MKPT.

2. Rezidentët të furnizohen me inventar adekuat në dhomat e tyre.

Gjatë vizitës MKPT konstatoi se ka progres në këtë drejtim, janë sjellë dollap të rinjë dhe dyshekë në dhomat e rezidentëve.

3. Të furnizohet institucioni me një auto-ambulancë.

Në përgjigjen e dërguar nga MPMS, theksohet se do të realizohet rekomandimi përmes planifikimit buxhetor gjatë vitit 2018, ose duke kërkuar që të sigurohet nga donatorët. Gjatë vizitës së fundit përcjellëse të realizuar më 28 gusht 2019, MKPT ka konstatuar se ky rekomandim ende nuk u implementua.

4. Shërbimi mjekësor të aplikojë protokolle për vetëlëndime, lëndime trupore, grevë urie, abuzime seksuale, vetëvrasje, si dhe vdekjeve në institucion.

Gjatë vizitës, MKPT, ka vërejtur se tani ky institucion ka të gjitha regjistrat ku evidentohen vetëlëndimet, lëndimet trupore, greva e urisë, abuzimet seksuale, vetëvrasjet, si dhe vdekjet në institucion.

5. Të organizohen trajnime specifike për personelin në pajtim me nevojat për trajtim të rezidentëve.

MKPT ka pranuar përgjigje me shkrim nga MPMS, në të cilën theksohet se në trajnimet që organizon Instituti Special në Shtime, marrin pjesë edhe personeli i SHPMPF. Gjithashtu kanë aplikuar në agjencinë e akreditimit në MASHT me programe adekuate për trajnim të këtij personeli i cili ofron

²⁷⁷ Raport me rekomandime për vizitën në Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare, publikuar më 25 janar 2018. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/12/23/raport-me-rekomandime-vizite-ne-shtepine-per-te-moshuar-dhe-pa-perkujdesje-familjare/>

shërbime për klientët dhe së shpejti do të fillohet me këto trajnime. Gjatë vizitës së fundit, MKPT ka konstatuar që personeli i SHPMMPF kanë marrë pjesë në disa trajnime të organizuara nga Instituti Special në Shtime.

6. Të rritet numri i personelit sipas vlerësimit të nevojave nga shërbimi shëndetësor.

Gjatë vizitës, MKPT ka konstatuar se ka progres në këtë drejtim, tani numri i personelit të mesëm u rrit në 3 persona.

VI. Përmbledhje e raporteve me rekomandime, letër rekomandimeve, opinioneve, amicus curiae dhe kërkesave për masë të përkohshme

Në vijim do të prezantohet një përmbledhje e shkurtuar e të gjitha raporteve dhe letër rekomandimeve, në të cilat Avokati i Popullit konstatoi shkelje të të drejtave të njeriut. Këtu po ashtu do të prezantohen edhe paraqitjet e Avokatit në cilësinë e mikut të gjykatës, opinionet e tij për çështjet e ndryshme që lidhen me të drejtat e njeriut dhe kërkesat për masë të përkohshme.

Raportet sipas detyrës zyrtare

Raport ex officio nr. 479/2017 lidhur me menaxhimin e papërshtatshëm të deponisë sanitare të mbeturinave në Velekincë të Gjilanit

Avokati i Popullit publikoi Raportin ex officio nr. 47/2017 lidhur me menaxhimin e papërshtatshëm të deponisë sanitare të mbeturinave në Velekincë të komunës së Gjilanit. Raporti është rrjedhojë e hetimeve të filluara nga Avokati i Popullit bazuar në një shkrim të portalit “Rajonipress”, i datës 6 korrik 2017, me titull: “*Nga plagët e eskavatorit humb jetën një gjilanas*”. Qëllimi i këtij raporti është të tërheqë vëmendjen e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe të Komunës së Gjilanit lidhur me mosarritjen e administrimit dhe mbajtjes nën kontroll të deponisë sanitare të mbeturinave në Velekincë të Gjilanit dhe mosndërmarrjen e masave nga organet përgjegjëse. Raporti synon të vë në pah ndikimin e keqmenaxhimit të deponisë në të drejtën për jetën dhe në të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm të qytetarëve.

Raport ex officio nr. 305/2019 për trajtimin e personave me HIV dhe AIDS

Mbrojtja e të drejtave dhe e lirive themelore të njeriut është thelbësore dhe shumë e rëndësishme për një përgjigje efektive në parandalimin dhe trajtimin e HIV-it në Kosovë. Përkundër faktit se Kosova ka bërë shumë përparime në reagimin ndaj HIV-it dhe AIDS-it, ka ende aspekte që kërkojnë vëmendjen e autoriteteve përgjegjëse, përkthazi me të drejtat e personave të prekur me HIV dhe AIDS. Ata vazhdojnë të përballën me sfida, sidomos në testimin dhe qasjen në parandalim, trajtim, kujdes shëndetësor dhe në shërbime të tjera të ndërlidhura me HIV-in dhe AIDS-in. Këto sfida janë të ndërlidhura edhe me barrierat ekonomike, me paragjykimet dhe me stereotipet, me pabarazinë gjinore dhe me prezencën e stigmës e të diskriminimit në institucionet shëndetësore.

Raporti ka për qëllim vlerësimin e aplikimit të standardeve të HIV testimit dhe të këshillimit në nivel vendi, më konkretisht, vlerësimin e aplikimit të parimeve kryesore gjatë HIV testimit, të cilat janë: dhënia e pëlqimit, konfidencialiteti, këshillimi, korrektësia e rezultateve të testimit dhe ndërlidhjet me shërbimet parandaluese, të kujdesit dhe trajtimit për HIV, si dhe të vlerësojë realizimin efektiv të të drejtave të personave që jetojnë me HIV në Kosovë në raport me qasjen në kujdes dhe trajtim, duke u ndalur në veçanti tek diskriminimi, pabarazia, dështimi në mbrojtjen e të drejtave, si dhe tek trajtimi i fëmijëve që jetojnë me HIV.

Raport ex officio nr. 514/ 2016 në lidhje me çështjen e fëmijëve në situatë rruge

Edhe në Kosovë, sikurse edhe në shumë vende të botës, një pjesë të popullatës e përbëjnë edhe fëmijët në situatë rruge. Këta fëmijë i shohim në rrugë vetëm apo në grupe, përveç tjerash, duke pastruar

xhamat e automjeteve, duke shitur gjësende të imëta, duke kërkuar lëmoshë apo nëpër kontejnerë. Përfshirja e tyre në këto aktivitete ua dëmton shëndetin, ua dëmton zhvillimin dhe mirëqenien, i vë në rrezik të ekspozimit ndaj dhunës, ndaj abuzimit seksual, ndaj eksploatimit dhe ndaj trafikimit.

Numri i saktë i tyre nuk dihet. Në nivel kombëtar nuk ka të dhëna zyrtare gjithëpërfshirëse për fëmijët në situatë rruge, që do të ofronin pasqyrë të qartë dhe të plotë për numrin dhe gjendjen e tyre. Evidentimi i tyre nga institucionet shtetërore nuk është i lehtë, shumë prej tyre janë në lëvizje, disa nga ta nuk mund të identifikohen për shkak të mungesës së dokumenteve personale dhe faktit se nuk janë të regjistruar në regjistrat e lindjes. Mosevidentimi i tyre, mungesa e të dhënave për ta, në njërin anë, i bënë ata “të padukshëm” përpara ligjit, i privon nga mundësitë e gëzimit të të drejtave të garantuara me legjislacionin në fuqi, përfshirë këtu mbrojtjen shëndetësore, arsimimin dhe shërbimet sociale. Në anën tjetër, një gjë e tillë e vështirëson dhe e pamundëson edhe punën e institucioneve shtetërore në zhvillimin e politikave adekuate dhe frytdhënëse për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të tyre.

Raporti ka për qëllim që të analizojë dukurinë e fëmijëve në situatë rruge; të identifikojë shkeljet e të drejtave të fëmijëve; si dhe të tërheqë vëmendjen e institucioneve përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve përkatëse për mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge.

Raport ex officio nr. 450/2018 përkitazi me trajtimin e pabarabartë të pensionistëve nga ana e bankave komerciale në Kosovë

Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për trajtimin e pabarabartë të pensionistëve, si klientë, në ofrimin e shërbimeve bankare për kredi nga ana e bankave komerciale në Kosovë.

Në bazë të informacioneve të cilat i ka pranuar Avokati i Popullit nga qytetarët e Kosovës, të cilët janë përfitues të pensioneve të pleqërisë, bankat komerciale në Republikën e Kosovës, personave më të vjetër se 65 vjeç, ua mohojnë të drejtën që t’i shfrytëzojnë shërbimet bankare për kredi, me arsyetimin se pensionistët janë përfitues të pensioneve dhe për këtë arsye nuk mund t’u aprovohet kredia. Me qëllim të përcaktimit të fakteve dhe të rrethanave relevante juridike në lidhje me këtë çështje, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit kanë zhvilluar takime të drejtpërdrejta me persona të autorizuar në filialet e disa bankave në Kosovë, të cilat u ofrojnë shërbime kreditore personave privatë. Ata kanë biseduar me ta për gjendjen aktuale në të cilën gjenden pensionistët mbi moshën 65 vjeç, si persona të interesuar për shërbimet bankare të kredive dhe prej tyre është kërkuar sqarim lidhur me trajtimin në fjalë, në kuptim të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili ndër të tjera, e përcakton moshën dhe gjendjen sociale si baza ligjërish të mbrojtura nga diskriminimi.

Duke e zbatuar këtë praktikë, bankat drejtpërsëdrejti i diskriminojnë qytetarët në bazë të një kriteri të drejtpërdrejtë – moshës, si karakteristikë personale, sepse për shkak të privimit të së drejtës për ta shfrytëzuar shërbimin bankar të kredisë, në një situatë të krahasueshme e vë një grup të qytetarëve në një pozitë më të pafavorshme sesa personat e tjerë që nuk e kanë atë karakteristikë personale.

Raport ex officio nr. 421/2019 për mungesën e mjeteve juridike efektive për zgjidhjen e kontesteve të punës

Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen në lidhje me mungesën e mjeteve efektive juridike për zgjidhjen e kontesteve të punës së nëpunësve civilë dhe të kandidatëve për pranim në shërbimin civil, si pasojë e mosëmërimit të anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK) nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe që ankuesve t'u ofrohet e drejta e garantuar kushtetuese dhe ligjore për mjete juridike efektive për vendosjen e kontesteve nga marrëdhënia e punës.

Raport ex officio nr. 340/2017 për situatën e personave me aftësi të kufizuara në komunën e Gjilanit

Raporti vë në pah problematikën e qasjes së personave me aftësi të kufizuar në pronat publike, në infrastrukturën rrugore si dhe të drejtën për arsim dhe punësimin e tyre në institucionet publike në komunën e Gjilanit dhe ka për qëllim që të tërheqë vëmendjen e autoriteteve kompetente, gjegjësisht Komunes së Gjilanit, për hapat e domosdoshëm që duhet të ndërmerren për respektimin e plotë të të drejtave të njeriut.

Në këtë raport Avokati i Popullit konstaton se mosdhënia e një përshtatjeje/akomodimi të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuar, në përputhje me nevojat e tyre specifike, përbën diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar, të përcaktuar sipas nenit 1 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Mos përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor është në kundërshtim me dispozitat ligjore. Po ashtu, Avokati i Popullit konstaton se Komuna e Gjilanit ka dështuar t'i zbatojë dhe t'i përmbushë obligimet që burojnë nga neni 12 i Ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, duke mos përmbushur numrin e nevojshëm të të punësuarve nga radhët e personave me aftësi të kufizuara.

Në këtë raport konsideron se institucionet publike duhet të vazhdojnë me veprime konkrete që të sigurohen qasje në objektet arsimore, si dhe punësimi i stafit mbështetës, e sidomos asistent personal, në mënyrë që të sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tyre.

Raport ex officio nr. 346/2019 për detyrimet pozitive të shtetit përkitazi me mbrojtjen nga dhuna në familje

Mbrojtja e të drejtave dhe e lirive themelore të njeriut është thelbësore dhe shumë e rëndësishme për një përgjigje efektive në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje në Republikën e Kosovës. Përkundër faktit se janë bërë shumë përparime në krijimin e mekanizmave reagues ndaj rasteve të dhunës në familje, ka ende aspekte që kërkojnë vëmendjen e autoriteteve përgjegjëse, përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për të drejtën për jetë. Viktimat e dhunës në familje vazhdojnë të përballen me sfida të ndryshme, sidomos nga mosfunksionimi i autoriteteve të krijuara enkas për parandalimin e kësaj dukurie shqetësuese, e cila në shumë raste po përfundon me fatalitet. Këto sfida janë të ndërlydhura edhe me barriera të ndryshme, me neglizhencë të autoriteteve, me

paragjykimet dhe stereotipat, me pabarazinë gjinore, si dhe me prezencën e stigmës e të diskriminimit në institucionet e ndryshme.

Raporti ka për qëllim vlerësimin e aplikimit të parimeve kryesore të detyrimeve pozitive të shtetit përkitazi me të drejtën për jetë, lidhur me vrasjen e trefishtë, e cila ndodhi më 22 prill 2019, në lagjen Dardania në Prishtinë dhe po ashtu të vlerësojë realizimin efektiv të të drejtave të personave/viktima të dhunës në familje në Kosovë në raport me qasjen për kujdes dhe trajtim, duke u ndalur në veçanti tek diskriminimi, pabarazia, dështimi i autoriteteve për mbrojtjen e të drejtave të viktimave të dhunës në familje, si dhe në detyrimet e shtetit për t'i mbrojtur jetët e qytetarëve.

Raport ex officio nr. 567/2019 për detyrimet pozitive të shtetit në rastin e K. V.

Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së institucioneve publike lidhur me detyrimet pozitive të shtetit përkitazi me të drejtën për jetë në rastin e K.V., të cilit, më 11 korrik 2019, i është marrë jeta nga një person tjetër. Gjithashtu, ky raport vlerëson se sa kanë qenë efektive dhe të shpejta veprimet e ndërmarra nga institucionet kompetente shtetërore me qëllim të respektimit të të drejtave të njeriut, në këtë rast në mbrojtjen e të drejtave të K.V., si dhe detyrimet e shtetit për të mbrojtur jetën e qytetarëve, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet si me dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare.

Avokati i Popullit, pas rishikimit të legjislacionit përkatës, të instrumenteve ndërkombëtare, të dokumentacionit të çështjes, të informatave dhe të të dhënave që i ka, nxjerr konkluzionin se në rastin konkret *ka pasur shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut*, përkatësisht shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit për mbrojtjen e së drejtës për jetë, si dhe të të drejtave të fëmijëve për mbrojtje nga dhuna dhe keqtrajtimi, pasi që autoritetet përkatëse nuk i kanë përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore, e as standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e jetës së viktimës, të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Raport ex officio nr. 468/2019 për detyrimet pozitive të shtetit në rastin e znj. Z. S.

Ky raport ka për qëllim të tërheqë vëmendjen lidhur me detyrimet pozitive që shteti ka përkitazi me garantimin e sigurisë dhe të jetës së qytetarëve si në rastin e znj. Z. S., e cila ishte sulmuar fizikisht më 29 maj 2019 në Lipjan dhe më 31 maj 2019 në Ferizaj nga disa qytetarë, krejt kjo si pasojë e nxitjes së urrejtjes në rrjetet sociale dhe nga portale të ndryshme mediale. Raporti gjithashtu tërheq vërejtjen mbi kufijtë e lirisë së shprehjes në raport me të drejtat e tjera dhe rrezikut të cenimit të privatësisë, të dinjitetit të njeriut, nxitjes së dhunës, të urrejtjes, të mosdurimit apo të prishjes së rendit publik.

Avokati i Popullit, në bazë të të gjitha dëshmive të paraqitura dhe të fakteve të mbledhura, si dhe ligjeve relevante, konstaton se në rastin konkret ka pasur shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, pasi që autoritetet përkatëse nuk i kanë përmbushur detyrimet e tyre kushtetuese dhe ligjore dhe as standardet ndërkombëtare të aplikueshme në Republikën e Kosovës, kundrejt ndërmarrjes së veprimeve konkrete në drejtim të mbrojtjes së jetës së viktimës Z. S., përkatësisht parandalimin e sulmit kundër saj në Lipjan dhe në Ferizaj. Së këndejmi, Avokati i Popullit konsideron se autoritetet kompetente të shtetit nuk kanë ofruar mbrojtje të mjaftueshme për viktimën Z. S., e cila ka qenë e ekspozuar ndaj rrezikut dhe për pasojë ajo u sulmua dy herë radhazi.

Raport ex officio nr. 489/2018 për përdorimin e substancave narkotike nga fëmijët

Qëllimi i këtij raporti është vlerësimi i gjendjes aktuale rreth përdorimit të substancave narkotike nga fëmijët dhe adresimi i rekomandimeve tek institucionet përkatëse në mënyrë që t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme në parandalimin dhe trajtimin e fëmijëve përdorues të substancave narkotike.

Avokati i Popullit konstaton se: ekziston mungesë e qendrave të specializuara për trajtimin e të rinjve përdorues të substancave narkotike dhe mungesë e programeve përkatëse të vetëdijesimit dhe parandaluese, si dhe mungesë e shërbimeve dhe trajtimit të përdoruesve të substancave narkotike, si për nga shtrirja gjeografike, ashtu edhe për nga cilësia; ekziston mungesë e një baze unike kombëtare (gjithëpërfshirëse) e të dhënave statistikore, duke përfshirë mungesën e të dhënave të plota për shkaqet dhe llojin e substancave narkotike edhe për rastet e dyshimta të vdekjeve nga substancat narkotike; ekziston mungesë e ekspertizës tek punonjësit e qendrave për punë sociale (në kuadër të mandatit të tyre ligjor) për t'u marrë me rastet e fëmijëve që përdorin substanca narkotike; prezenca e substancave narkotike dhe konfiskimet e tjera nga Policia e Kosovës në afërsi të institucioneve edukative arsimore dhe fakti që shumë të rinj janë të përfshirë në aktivitete të lidhura me drogën është tregues i qartë se institucionet shtetërore duhet të bëjnë më shumë në parandalimin e përdorimit të substancave narkotike dhe përmirësimin e kushteve të jetesës dhe në perspektivën afatgjatë të fëmijëve/të të rinjve në Kosovë. Në bazën e të dhënave të KGJK-së dhe KPK-së ekziston mungesë e të dhënave që i referohen veprave specifike penale nga Kapitulli i XXIII i Kodit.

Raport ex officio nr. 59/2019 për vlerësimin e sistemit të ofrimit të shërbimeve sociale

Nëpërmjet këtij Raporti me rekomandime, Avokati i Popullit vlerëson nëse ofrimi i shërbimeve sociale në Republikën e Kosovës është në pajtim me standardet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Raporti jep rekomandime specifike dhe konkrete lidhur me veprimet që duhet t'i ndërmarrë Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe komunat përkatëse në drejtim të përmirësimit të gjendjes aktuale.

Avokati i Popullit konstaton se Qendrat për Punë Sociale janë shndërruar në institucione administrativo-teknike dhe shumë më pak në institucione ku ofrohen shërbime sociale profesionale dhe krejt kjo për mungesë të stafit profesional dhe për mungesë të objekteve përcjellëse për ofrim të shërbimeve adekuate. Ka mungesë të mbikëqyrjes, të planifikimit, të financimit dhe të avancimit të shërbimeve në përputhje me nevojat e komunave; mungesa e zhvillimit të një sistemi të mbrojtjes sociale nëpër komuna dhe në vetë Ministrinë ka shkaktuar dhe vazhdon të shkaktojë probleme të mëdha. Sikur të ishte ngritur një sistem adekuat dhe funksional i mbrojtjes sociale, zgjedhjet komunale shumë pak do të kishin ndikuar në ofrimin e shërbimeve sociale profesionale, pasi që sistemi do të kishte funksionuar, si në arsim ashtu edhe shëndetësi.

Raportet me rekomandime

Raport A. nr. 683/2018 në lidhje me Ligjin nr. 06/L-012 për Kryeqytetin

Ligji nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën, neni 7, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, ndër të tjera, parashikon si kompetencë të Kryeqytetit edhe çështjet e sigurisë publike. Raporti ka tri qëllime kryesore: të vlerësojë nëse kjo kompetencë e Kryeqytetit është në

harmoni me Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë; të vlerësojë se cili ligj konsiderohet ligj special në situatën konkrete, si dhe t'u dërgojë institucioneve kompetente rekomandime specifike dhe konkrete për ndryshimin dhe plotësimin Ligjit nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, i cili rregullon sigurinë publike si kompetencë e Kryeqytetit.

Sipas këtij raporti, Parimi *lex specialis derogat legi generali* (në tekstin e mëtejshëm "*lex specialis*") përcakton se, kur një situatë e caktuar faktike hyn në fushëveprimin e dy akteve normative, përparësi i jepet *aktit të posaçëm* kundrejt *aktit të përgjithshëm*. Në Raport është përcaktuar se *lex specialis* konsiderohet ai akt normativ që i adreson rrethanat faktike në mënyrë më specifike, i jepet përparësi kundrejt atij akti që ka natyrë më të përgjithshme.

Raport A. nr. 119/2018 për mosvazhdimin të licencave të punës së gjeodetëve të kategorisë së dytë dhe për mos harmonizim të dispozitave të legjislacionit sekondar

Raporti bazohet në ankesën e pranuar nga M.S. dhe 37 gjeodetë të tjerë, në emër të gjeodetëve të kategorisë së dytë (gjeodetë me shkollim të mesëm), lidhur me mosvazhdimin e licencave të punës nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, si pasojë e mos harmonizimit të dispozitave të Udhëzimit Administrativ 01/2013 për licencimin e kompanive gjeodete dhe të gjeodetëve, i nxjerrë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) në vitin 2013. Raporti tërheq vëmendjen e MMPH-së për nevojën e ndërmarrjes së veprimeve urgjente për harmonizimin e nenit 4, të nenit 7 dhe të nenit 11 të UA 01/2013 për licencimin e kompanive gjeodete dhe të gjeodetëve, i nxjerrë nga MMPH-ja në vitin 2013, i cili rregullon kushtet e licencimit dhe ushtrimit të profesionit të gjeodetit. Mos harmonizimi ndërmjet dispozitave të lartpërmendura ka ndikuar në mosvazhdimin e licencave të punës për gjeodetët e kategorisë së dytë.

Raport A. nr. 674/2018 në lidhje me lirinë e asociimit

Raporti me Rekomandime ka për qëllim analizimin e ushtrimit të lirisë së asociimit në organizata joqeveritare dhe praktikës së deritanishme sa i përket pezullimit të aktiviteteve të organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës, në bazë të kërkesës së organit kompetent të sigurisë. Raporti bazohet në dy ankesa, që kanë të bëjnë me pezullimin e veprimtarisë së organizatave joqeveritare, duke u bazuar në kërkesën e organit kompetent të sigurisë. Në këtë raport, Avokati i Popullit vlerësoi se pezullimi i aktiviteteve të OJQ-ve vetëm mbi bazën e dyshimeve se veprimtaria e tyre nuk përkon me rendin juridik dhe të Kushtetues së Republikës së Kosovës dhe me të drejtën ndërkombëtare, pa ndonjë hetim të mirëfilltë nga organet e ndjekjes, paraqet ndërhyrje të drejtpërdrejtë në lirinë e asociimit dhe paraqet rrezik se shteti mundet në çdo kohë të ndërhyjë në veprimtarinë e cilësdo OJQ tjetër.

Raport A. nr. 288/2018 në lidhje me mosaprovimin e kërkesës për kthim në listat prioritare, si dhe efektin juridik të anulimit të Vendimit nr. 2/988 të Senatit të UP-së

Raporti trajton pretendimet e disa studentëve për shkëljen e së drejtës për arsim në rastin e mosaprovimit të kërkesës së tyre për kthimin në listat prioritare, pas anulimit të Vendimit nr. 2/988, i

datës 26 nëntor 2013, i nxjerrë nga Senati i Universitetit të Prishtinës. Ky raport shpjegon efektin juridik të anulimit të këtij vendimi dhe u adreson institucioneve kompetente rekomandime përkatëse.

Raport A. nr. 18/2018, 56/2018 dhe 57/2018 lidhur me kushtëzimin për anëtarësim në Shoqatën e të Verbërve të Kosovës

Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) për nevojën e ndërmarrjes së veprimeve për ndryshimin e Ligjit nr.04/L-092 për Personat e Verbër, në kreun III, ku përcaktohen Grupimet, Përfitimet nga Statusi i të Verbrit, Evidenca dhe Komisionet Mediko-Sociale, sipas të cilit, kompetenca për lëshimin e librezës së posaçme të verbërisë, si dokument, provë për përfitim nga ky ligj, në nenin 17, paragrafi 8, përcaktohet: *“Shoqatat bazuar në vendimin e Komisionit Mediko-social lëshon librezën e posaçme të verbërisë, si dokument, provë për përfitim nga ky ligj”*; në nenin 18, paragrafi 2, përcaktohet: *“Në fund të vitit kalendarik, por edhe sipas kërkesës së ministrisë përkatëse, Shoqata e të Verbërve të Kosovës obligohet të dorëzojë regjistrin e evidencave të librezave të lëshuara për përfituesit nga ky ligj.”*

Sipas pohimeve të ankuesve personat e verbër nuk po kanë mundësi të pajisen me librezë të verbërisë, për shkak të kushtëzimit me pagesën e tarifës së anëtarësisë në ShVK. Ankuesit pretendojnë se ky kushtëzim është i padrejtë, për faktin se pamundësia e marrjes së librezës së verbërisë, si mjet identifikues, ua pamundëson përfitimim e të drejtave dhe beneficioneve të garantuara sipas Ligjit nr. 04/L-092 për Personat e Verbër.

Avokati i Popullit konstaton se kushtëzimi i ankuesve me anëtarësim në ShVK, kundër vullnetit të tyre, personat e verbër pa anëtarësim i vendosë në pozitë të pabarabartë, në raport me personat e verbër të anëtarësuar, si dhe i privon ata nga e drejta e tyre për të gëzuar beneficionet që burojnë nga Ligji për Personat e Verbër.

Raport A. nr. 869/2018 për kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike

Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen lidhur me ankesën e Lëvizjes FOL (FOL) për qasje në dokumente publike parashtruar kundër Ministrisë së Financave (MF), si dhe analizimi i Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), përkitazi me ankesën në fjalë, si dhe detyrat e përgjegjësitë e institucioneve/autoriteteve publike në raport me zbatimin e këtij ligji në rastet e pranimit të kërkesave për qasje në dokumente publike.

Nëpërmjet postës elektronike, OJQ FOL i është drejtuar Ministrisë së Financave me kërkesë për qasje në dokumentin publik, përkatësisht për qasje në Listën me numrat identifikues të parcelave me shumën e vlerësuar të secilës parcelë, me pronësi private, të vlerësuara nga Ministria e Financave, në procesin e shpronësimit në kuadër të projektit *“Ndërtimi i auto-udhës A7.1 - Kryqëzimi në disnivel A6/A7.1 (Banullë) – Dheu i Bardhë: Kryqëzimi në disnivel A6/A7.1 (Banullë) - Udhëkryqi Bresalc - L=22.31km.* (me nr. prokurimi 205-17-2586-5-1-1), i kontraktuar nga Ministria e Infrastrukturës. Përderisa nga MF është njoftuar se i refuzohet qasja në dokumentin e kërkuar, me arsyetimin se publikimi i të dhënave të kërkuara do të ishte në kundërshtim me LQDP-në, përkatësisht në kundërshtim me nenin 12, paragrafët 1.2 dhe 1.6.

Në raport, Avokati i Popullit konsideroi se interesi i publikut për mënyrën e shfrytëzimit të parasë publike dhe për llogaridhënien është thelbësor në drejtim të promovimit dhe të forcimit të demokracisë dhe të qeverisjes së mirë. Rol të rëndësishëm në këtë aspekt kanë edhe shoqëria civile dhe mediat.

Raport A. nr. 542/2018 për kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike

Raporti ka për qëllim identifikimin e shkeljeve të të drejtave dhe të lirive themelore nga autoritetet përgjegjëse lidhur me ankesën e Organizatës Joqeveritare “Iniciativa për Progres-INPO” (INPO) për qasje në dokumente publike parashtruar kundër Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (MASHT); analizimin e Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP) përkitazi me ankesën në fjalë; si dhe identifikimin e detyrave dhe përgjegjësive të institucioneve/autoriteteve publike në raport me zbatimin e këtij ligji në rastet e pranimit të kërkesave për qasje në dokumente publike.

Nëpërmjet postës elektronike, OJQ INPO i është drejtuar udhëheqëses së Divizionit për Komunikim me Publikun e MASHT-it me kërkesë për qasje në vlerësimet e ligjshmërisë së akteve normative nga fusha e arsimit, e shkencës dhe e teknologjisë, që MASHT-i i ka punuar gjatë vitit 2017, si dhe për periudhën janar - qershor 2018, por nuk kishte pranuar përgjigje në këtë kërkesë.

Në raport, Avokati i Popullit konsideron së MASHT-i, përveçqë ka dështuar të përgjigjet në kërkesën e INPO-s për qasje në dokumente publike, ia rikujton MASHT-it detyrimin ligjor që rrjedh nga neni 25 i Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit.

Raport A. nr. 108/2019 për kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike

Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen Policisë së Kosovës lidhur me ankesën e A. N. (ankuesi) për qasje në dokumente publike; analizimin e Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP); detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse në raport me zbatimin e këtij ligji në rastet e pranimit të kërkesave për qasje në dokumente publike.

Ankuesi kishte aplikuar në konkursin e shpallur nga Policia e Kosovës për zyrtarë policorë, (nr. i Aplikacionit 05/01254), në të cilin ishte renditur i 73-ti, sipas pikëve të fituara (87.80). Ai i ishte nënshtruar testit psikologjik dhe testit mjekësor në klinikën e autorizuar për këtë qëllim. Pas publikimit të listës nga Komisioni Përzgjedhës për Menaxhimin e Procesit të Rekrutimit (Komisioni), ka rezultuar se ankuesi ka dështuar në kontrollin mjekësor. Pas kësaj, ankuesi parashtroi ankesë në Komision. Komisioni ia refuzoi ankesën. Ankuesi, nëpërmjet postës elektronike, i është drejtuar PK-së me kërkesë për qasje në dokumentet e kontrollit mjekësor, respektivisht për qasje në raportin e mjekut specialist për shëndetin e tij. Ankuesi pranoi përgjigje me të cilën i refuzohet kërkesa për qasje, me arsyetimin: “[...] të gjitha rezultatet dhe vlerësimet e testit psikologjik-kontrollit mjekësor janë të dhëna të klasifikuara dhe duhet të mbahen konfidenciale[...].”

Në raport, Avokati i Popullit konstatoi se refuzimi i kërkesës së ankuesit për qasje në raportin mjekësor në dosjen e tij si kandidat në procedurën e rekrutimit për zyrtarë policorë ia mohon ankuesit të drejtën për qasje në dokumente publike, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutë dhe me ligj.

Raport A. nr. 131/2018 në lidhje me kushtëzimin e shkyçjes nga rrjeti i ngrohjes

Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Ngrohtores së Qytetit “Termokos” (Termokos) lidhur me pasojat e mospërputhjes së Rregullores së Brendshme: Procedura për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve “NQ TERMOKOS” (Rregullorja e Brendshme e Termokosit) me Rregulloren nr. 9/2017 e ZRrE-së: Rregulla për shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë (Rregulli/ZRrE/nr.9/2017), si dhe të sqarojë pozicionin dhe rolin e ZRrE-së ndaj ndërmarrjeve të tjera energjetike.

Në raport, Avokati i Popullit konsideron se ekziston një mospërputhje në mes Rregullës ZRrE/nr. 9/2017 dhe Rregullores së Brendshme të Termokosit, për shkak se rregullorja e Termokosit i kushtëzon konsumatorët që borxhin ta kenë zero, në mënyrë që t’i realizohet kërkesa për shkyçje nga rrjeti i ngrohjes, ndërsa rregullorja e ZRrE-së nuk e përcakton një gjë të tillë. Avokati i Popullit konsideron se Termokosi duhet t’i harmonizojë të gjitha rregulloret e brendshme me rregulloret e ZRrE-së, në mënyrë që roli dhe detyrat e ZRrE-së të zbatohen sipas përcaktimeve ligjore.

Raport A. nr. 327/2018 lidhur me zvarritjen e procedurës në GjThP

Ky Raport me rekomandim ka për qëllim që të tërheqë vëmendjen Gjykatës Themelore në Prishtinë (GjThP) lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës C. nr. 926/15, e cila ka të bëjë me vërtetimin e së drejtës së pronësisë dhe të posedimit, pa vonesa të mëtutjeshme. Në këtë rast Avokati i Popullit rikujton se, sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, kohëzgjatja e procedurës llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore, e që në rastin konkret është nga viti 2003, dhe konstaton se zvarritja e tillë pa vendim përfundimtar shkel: të drejtën për gjykim të drejtë, proces të rregullt, brenda një afati të arsyeshëm kohor të përcaktuar dhe të mbrojtur me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 6 të KEDNj-së. Të drejtën për mjete efektive juridike të mbrojtura me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 13 të KEDNj-së. Të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të përcaktuara me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Raport A. nr. 558/2019 lidhur me zvarritjen e procedurës në GjThP

Qëllimi i këtij raporti është që të tërheqë vëmendjen e GjThP-së lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës C.nr. 1134/2012, pa vonesa të mëtutjeshme.

Në Raport, Avokati i Popullit rikujton se praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih, në mes tjerash, aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

Në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes së cilit ankuesi do të kishte mundur të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo të kompensimit.

Raport A. nr. 209/2018 lidhur me zvarritjen e procedurës në GjThP

Ky Raport me rekomandim ka për qëllim që të tërheqë vëmendjen Gjykatës Themelore në Prishtinë, lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C.nr.2694/13, pa vonesa të mëtejshme.

Avokati i Popullit në raport thekson se “arsyeshmëria” e kohëzgjatjes së procedurës sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së duhet të vlerësohet duke u thirrur në kriteret në vijim: kompleksiteti i lëndës, sjellja e parashtruesit të kërkesës dhe e organeve kompetente, dhe me çfarë është rrezikuar ankuesi në lëndën e përmendur “(GjEDNj [Dhoma e madhe], *Frydlender kundër Francës*, parashtrës numër 30 979/ 6 (2000), paragrafi 43, duke u thirrur në GjEDNj [Dhoma e madhe], *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë*, parashtrës nr. 35382/97, paragrafi 19 (2000), paragrafi 19).

Raport A. nr. 842/2017 për mosndërmarrjen e veprimeve adekuate në drejtim të lirimit të hapësirave publike nga Komuna e Fushë Kosovës

Ky raport ka për qëllim që të tërheqë vëmendjen kryetarit të komunës së Fushë Kosovës lidhur me nevojën për ndërmarrjen e veprimeve përkatëse për zbatimin, pa vonesa të mëtejshme, të Vendimit nr. Protokoli 325, i datës 18 prill 2017, i nxjerrë nga vetë ai për lirimin e hapësirave publike.

Avokati i Popullit në këtë raport konstaton se autoritetet komunale të Fushë Kosovës nuk kanë reaguuar në mënyrë adekuate ndaj kërkesave legjitime të qytetarëve dhe mungesa e vullnetit për t'i liruar hapësirat publike mund të nënkuptohet si mospërbushje e obligimeve ligjore që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale. Komuna e Fushë Kosovës nuk i ka realizuar kompetencat në shërbim të interesit publik dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të qytetarëve të saj.

Raport A. nr. 925/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në GjThP

Ky Raport me Rekomandim ka për qëllim që t'ia tërheqë vëmendjen Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës C.nr.3303/12, e cila ka të bëjë me kthim borxhi dhe kompensim dëmi, pa vonesa të mëtejshme.

Në raport, Avokati i Popullit vë në pah se, sipas GjEDNj-së, e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç është e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Raport A. nr. 352/2019 lidhur me moszbatimin e aktvendimit të GjThP-së nga KEDS

Qëllimi i këtij raporti është të tërheqë vëmendjen e Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS) lidhur me nevojën për ndërmarrjen e veprimeve përkatëse për zbatimin, pa vonesa të mëtejshme, të aktvendimit të formës së prerë, i nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Në këtë raport, Avokati i Popullit thekson se ekzekutimi i një vendimi të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm administrativ duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e pandarë e një ‘*gjykimi*’ për qëllim të së drejtës për një gjykim të paanshëm dhe duhet të zbatohet brenda një periudhe kohore të arsyeshme. Ky detyrim i takon shtetit dhe zvarritja e tepruar në zbatimin e vendimit të plotfuqishëm

dhe të ekzekutueshëm, apo mosndërmarrja e masave për ta zbatuar atë, përbëjnë shkelje të së drejtës për një gjykim të paanshëm dhe të së drejtës për një zhdëmtim të efektshëm.

Raport A. nr. 826/2018 për kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike

Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes lidhur me një ankesë individuale që ka të bëjë me qasje në dokumente publike të parashtruar kundër Policisë së Kosovës, analizimin e Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike përkitazi me ankesën në fjalë, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve/autoriteteve publike në raport me zbatimin e këtij ligji në rastet e pranimit të kërkesave për qasje në dokumente publike.

Duke iu referuar vendimeve të GjEDNj-së, Avokati i Popullit thekson se vonesat në dhënien e informatës mund t'ia heqin në mënyrë të vazhdueshme të gjithë vlerën informatës dhe interesimin lidhur me të, sepse një lajm përbën një shërbim që ikën shpejt dhe vonimi i botimit të tij, edhe për një periudhë të shkurtër kohore, mund t'ia mohojë lajmit tërë vlerën dhe interesin (rasti *The SundayTimes v. The United Kingdom*).

Raport A. nr. 849/2016 në lidhje me pretendimet për statusin e “dëshmitarit të mbrojtur”

Në zbatim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, Avokati i Popullit, nëpërmjet këtij raporti, ka për qëllim të ofrojë ndihmën në funksion të mbrojtjes së të drejtave të “dëshmitarit X2”, në lidhje me procedurën penale, përkatësisht statusin e tij ligjor gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim ndaj tij. Raporti trajton bazën ligjore në lidhje me statusin e dëshmitarit të mbrojtur, përkatësisht zgjatjen apo përfundimin e programit të mbrojtjes për “dëshmitarin X2”.

Në këtë raport, Avokati i Popullit konstaton se vendosja e “dëshmitarit X2” në pavijon për dëshmitarë të mbrojtur në Burgun e Sigurisë së Lartë, pa asnjë kontakt, e vë në pozitë të pabarabartë me të tjerët, për më tepër kur statusi i tij de-jure dhe de-facto nuk është vërtetuar të jetë “dëshmitar i mbrojtur”.

Raport A. nr. 662/2019 për kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike

Qëllim i këtij raporti është identifikimi i shkeljeve të të drejtave dhe të lirive themelore nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë lidhur me kërkesën e parashtruar nga ankuesja për qasje në dokumente publike; analizimin e Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike përkitazi me ankesën në fjalë; si dhe identifikimin e detyrave dhe përgjegjësive të institucioneve/autoriteteve publike në raport me zbatimin e këtij ligji në rastet e pranimit të kërkesave për qasje në dokumente publike, si dhe obligimin kushtetues për bashkëpunim me Avokatin e Popullit.

Avokati i Popullit konstaton se MASHT-i fare nuk është përgjigjur në kërkesën e pranuar për qasje në dokumente publike, që bie në kundërshtim me nenin 12, paragrafi 1, të LQDP-së, sipas të cilit institucioni publik detyrohet që brenda 7 ditëve prej kohës së regjistrimit të kërkesës (konfirmimi për pranimin e kërkesë iu ka dërguar ankueses më 13 qershor 2019), të nxjerrë vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose vendim të arsyetuar për refuzimin e plotë apo të pjesshëm dhe ta njoftojë kërkuarësin e dokumentit për të drejtat që i ka në raste të tilla. Ndërsa në rastet kur vendoset se dokumentet e kërkuara përmbajnë ndonjërin nga kufizimet e parapara me nenin 17 të LQDP-së,

atëherë institucionet publike detyrohen ta bëjnë testin e dëmit dhe interesit publik (neni 18, paragrafët 1 dhe 2).

Raport A. nr. 831/2018 për problemet e banorëve të lagjes “Ndre Mjeda” në Ferizaj për qasje në rrjetin e kanalizimit

Raporti është i bazuar në ankesën e banorëve të cilët ankohen se në lagjen “Ndre Mjeda” në Ferizaj, afërsisht 15 shtëpi janë të shkyçura nga rrjeti i kanalizimit, si pasojë e veprimeve të ndërmarra nga ana e personit fizik, I. M., me ç’ rast është shkaktuar ndotje me ujëra të zeza si dhe kundërmim i përgjithshëm pothuajse në të gjithë lagjen. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Komunës së Ferizajt me qëllim të zbatimit të së drejtës për ambient dhe ndërmarrjen e veprimeve përkatëse për zgjidhjen e problemeve rreth qasjes në rrjetin e kanalizimit të banorëve të lagjes “Ndre Mjeda” në Ferizaj.

Avokati i Popullit, duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe në faktet si dhe në ligjet relevante, të cilat përcaktojnë të drejtën për jetën private dhe familjare, konstaton se ka pasur shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara me ligjet e zbatueshme si dhe me KEDNj-në, pasi që autoritetet përgjegjëse komunale, të cilat sipas legjisllacionit në fuqi janë kompetente dhe kanë për obligim ndërmarrjen e detyrimeve pozitive lidhur me rastin, nuk kanë vepruar në përputhje me këto obligime.

Raport A. nr. 742/2019 për kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike

Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Agjencisë Kosovare për Inteligjencë për nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për zbatimin e së drejtës për qasje në dokumente publike, bazuar në kërkesën e Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, për qasje në të dhëna për numrin e rasteve që ka përgjuar AKI-ja gjatë vitit 2018 dhe sa persona janë përgjuar gjatë viti 2018.

Avokati i Popullit, për rastin në fjalë, konstaton se AKI-ja ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve pozitive lidhur me mundësimin, përkatësisht me lejimin për qasje në dokumente publike sipas kërkesës së parashtruar nga YIHRKS-ja, e cila e drejtë është e garantuar me akte vendore si dhe me instrumente ndërkombëtare. Për më shumë, Avokati i Popullit konsideron se, në rastin konkret, AKI-ja është dashur të veprojë në pajtim me nenin 13, paragrafi 2, të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, sipas të cilit përcaktohet se kërkuesi ka të drejtë që pas parashtrimit të kërkesës, të marrë aktvendim të arsyetuar me shkrim nga ai institucion publik përkitazi me refuzimin dhe të nxjerrë aktvendim me të cilin tregohen arsyet e refuzimit për qasje në dokumente publike.

Raportet e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Raport i MKPT-së lidhur me vizitën në Qendrën e Mbajtjes për të Huajt në Vranidoll

MKPT-ja, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t’i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë këtu edhe vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, qëndrimi i të cilëve në Republikën e Kosovës bie ndesh me ligjet në fuqi dhe të cilët janë subjekt i kthimit me forcë nga Republika e Kosovës.

Bazuar në këtë mandat, MKPT-ja, më 13 shkurt 2019, e ka vizituar Qendrën e Mbajtjes për të Huajt. Kjo Qendër funksionon në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DShAM) i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Sipas nenit 2 të Rregullores (MPB) nr. 04/2018 për Funksionimin e Qendrës për Mbajtjen e të Huajve (në tekstin e mëtejshëm “Rregullorja”), në këtë qendër vendosen të huajt të cilët janë subjekt i largimit me forcë, si dhe të huajt për të cilët konsiderohet se e cenojnë sigurinë publike, me qëllim të vërtetimit të identitetit të tyre dhe për arsye tjera.

Qëllimi i kësaj vizite ishte monitorimi i respektimit të të drejtave për të huajt, të cilët mbahen në QMH, të cilat parashihen me Ligjin për të Huajt, me Ligjin për Azil, me Rregulloren nr. 04/2018 për Funksionimin e Qendrës së Mbajtjes për të Huajt, me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe zbatimi i rekomandimeve të MKPT-së dërguar autoriteteve kompetente përmes raportit me rekomandime, i publikuar më 2 maj 2018.

Po ashtu, gjatë vizitës u trajtua çështja e procedurave të pranimit, njohja e të huajve me të drejtat e tyre, trajtimi dhe akomodimi, kujdesi shëndetësor i cili u ofrohet, kontaktet e mirëfillta me botën e jashtme, personeli i QMH-së dhe personeli i sigurisë, trajnimet dhe përgatitja adekuate e tyre për të punuar me këtë kategori, masat disiplinore të cilat mund t’u shqiptohen të huajve në QMH dhe mënyra e ekzekutimit të tyre, e drejta për të ankimuar masën e tillë dhe aspekte të tjera.

Raport i MKPT-së lidhur me vizitën në Shtëpinë e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore në Shtime

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit e ka vizituar Shtëpinë e Fëmijëve me nevoja të veçanta në Shtime (“Shtëpia e Fëmijëve në Shtime”). Gjatë vizitës më 9 gusht 2018, ishte ekipi i MKPT-së dhe dy ekspertë të Këshillit të Evropës (KE), në cilësi të vëzhguesve. Ndërsa vizita më 31 janar 2019 ishte vizitë përcjellëse, e cila u realizua nga ekipi monitorues i MKPT-së.

Shtëpia e Fëmijëve në Shtime menaxhohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe udhëhiqet nga menaxheri i Shtëpisë. Ky institucion është i vetmi në Kosovë i këtij lloji, i cili është hapur në vitin 2002, me kapacitet deri në dhjetë shtretër. Ofron shërbime 24 orë, si: ushqim, veshmbathje, përkujdesje shëndetësore, trajtim social. Institucioni nuk ka buxhet të caktuar, të ndarë, të planifikuar dhe të menaxhuar nga udhëheqësi i Shtëpisë, por bazohet në miratimin e kërkesave nga buxheti i MPMS-së.

Shtëpia e Fëmijëve në Shtime është institucion i tipit të hapur, ku rezidentët janë me diagnozën *pa aftësi në mësim (Prapambetje mendore)*. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka konstatuar se janë të vendosur 10 persona të moshave të ndryshme (aq sa është kapaciteti i saj): katër nën moshën 18 vjeçare, dy sapo i kanë mbushur 18 vjet, dy janë rreth të njëzetave dhe dy janë rreth të tridhjetave. Shtatë nga banorët kanë familje. Personeli i Shtëpisë së Fëmijëve në Shtime përbehet prej dhjetë personave, prej tyre një menaxher i Shtëpisë, katër infermierë dhe pesë ndihmës mjekësorë.

Raport i MKPT-së për vizitën në pikën e kalimit kufitar në Aeroportin “Adem Jashari”

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit (MKPT) ka realizuar vizitë në pikën e kalimit kufitar në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë.

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të huajve, të cilët, bazuar në Ligjin për të Huajt në Republikën së Kosovës dhe në ligjet tjera relevante, nuk mund të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës, e që janë subjekt i kthimit në vendet nga kanë ardhur apo mbahen përkohësisht në hapësirat e mbajtjes në pikën hyrëse të aeroportit.

Grupi monitorues është përbërë nga udhëheqësja e MKPT-së, këshilltari ligjor për parandalim të torturës, mjeku, psikologu, punëtori social dhe dy ekspertë të Këshillit të Evropës, në cilësinë e vëzhguesve.

Raport i MKPT-së për vizitën në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë

MKPT-ja, më 6 shkurt 2019, vizitoi Qendrën Korrektuese në Smrekonicë (QKS). QKS-ja është institucion korrektues i tipit të hapur ku dërgohen të dënuarit me dënime deri në dy vjet burgim dhe i nënshtrohen regjimit të hapur. Kapaciteti zyrtar i QKS-së është për 200 persona, ndërsa në kohën e vizitës ishin të akomoduar 135 të dënuar. Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të dënuarve, i shërbimeve shëndetësore të cilat ofrohen për të dënuarit, si dhe i kushteve të akomodimit në pajtim me standardet vendore dhe ato ndërkombëtare për mbrojtjen e personave të privuar nga liria.

Raport i MKPT-së për vizitën në Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan

Bazuar në këtë mandatin e dhënë, MKPT-ja, më 23 dhe më 24 janar 2019, e vizitoi Qendrën Korrektuese Edukuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan (QKFM). Përveç kësaj, edhe përgjatë vitit, MKPT-ja ka realizuar edhe vizita *ad-hoc* në QKFM.

QKFM-ja në Lipjan është institucion i tipit gjysmë të hapur, i vetmi në Republikën e Kosovës, ku janë të vendosur disa kategori të burgosurish, si: të miturit me masë edukative, të miturit e dënuar, të miturit e paraburgosur, femrat e dënuara, femrat e paraburgosura dhe femrat e mitura. Gjatë vizitës, MKPT-ja u njoftua nga drejtori i Qendrës Korrektuese në Lipjan se kapaciteti i QKFM-së është për 138 persona, ndërsa gjatë vizitës nga MKPT-ja, aty ishin të vendosur gjithsej 77 të burgosur të të gjitha kategorive.

Qëllimi i kësaj vizite ishte monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të mëparshme të MKPT-së, të cilat u ishin dërguar autoriteteve kompetente nëpërmjet raportit me rekomandime. Përveç kësaj gjatë vizitës u trajtua çështja e procedurave të pranimit të femrave madhore dhe të miturve, njoftimi me të drejtat e tyre, trajtimi, kushtet e akomodimit, regjimi, kujdesi shëndetësor, incidentet ndërmjet të burgosurve, aktivitetet në dispozicion, kontaktet me botën e jashtme, procedurat e parashtrimit të ankesave dhe masat disiplinore, të cilat mund t’u shqiptohen sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe Kodit nr. 03/L-193 të Drejtësisë për të Mitur.

Raport i MKPT-së lidhur me vizitën në Qendrën Korrektuese në Dubravë

Bazuar në mandatin e dhënë, MKPT-ja, nga data 27 shkurt 2019 deri më 1 mars 2019, e ka vizituar Qendrën Korrektuese në Dubravë (QKD).

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të MKPT-së, të cilat u ishin dërguar autoriteteve kompetente përmes Raportit me rekomandime për vizitën në QKD, e cila ishte realizuar nga data 20 deri më 22 mars 2018, si dhe monitorimi i respektimit të të drejtave të personave të dënuar, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Gjatë vizitës është trajtuar edhe çështja e procedurave të pranimit, njohja e të burgosurve me të drejtat e tyre, trajtimi, kushtet e akomodimit, regjimi, kujdesi shëndetësor, raportet ndërmjet të të burgosurve, kontaktet me botën e jashtme, procedurat e parashtrimit të ankesave dhe masat disiplinore, të cilat mund t'u shqiptohen sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe mënyra e ekzekutimit të tyre.

Raport i MKPT-së lidhur me vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë

MKPT-ja, më 12 mars 2019, vizitoi Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë (QPM). Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave të njeriut për të burgosurit e vendosur në QPM, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Në QPM pranohen të paraburgosurit dhe të dënuarit me dënime nën 20 vjet. Të burgosurit janë të nacionaliteteve të ndryshme dhe janë të vendosur në dy kate. Sipas drejtorit të QPM-së, kapaciteti i kësaj qendre është 77 persona. Në kohën kur MKPT-ja e vizitoi QPM-së, ishin të akomoduar 10 të paraburgosur dhe 37 të dënuar. Gjatë vizitës u trajtua edhe çështja e procedurave të pranimit, njohja e të burgosurve me të drejtat e tyre, trajtimi, kushtet e vendosjes, regjimi, kujdesi shëndetësor, raportet ndërmjet të burgosurve, kontaktet me botën e jashtme, procedurat e parashtrimit të ankesave dhe masat disiplinore, të cilat mund t'u shqiptohen sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP), si dhe mënyra e ekzekutimit të tyre.

Raport i MKPT-së lidhur me vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prizren

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit, më 20 maj 2019, e ka vizituar Qendrën e Paraburgimit në Prizren (QPP). MKPT-ja mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, si dhe institucionet psikiatrike dhe ato të kujdesit social.

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve; si dhe zbatimi i

rekomandimeve të MKPT-së të dërguara autoriteteve kompetente përmes raportit me rekomandime për vizitën e mëhershme.

Raport i MKPT-së lidhur me vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit, më 29 maj 2019, e ka vizituar Qendrën e Paraburgimit në Lipjan (QPL). Në QPL, përveç të paraburgosurve, vendosen edhe një numër i vogël i të dënuarve. Gjatë vizitës së MKPT-së në QPL ishin të akomoduar 89 të paraburgosur (68 të paraburgosur dhe 21 të dënuar). Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve. MKPT-ja, gjatë vizitës në QPL, intervistoi një numër të konsiderueshëm të burgosurish dhe nuk mori asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike të ushtruar nga zyrtarët korrektues apo për sjellje të autoriteteve të burgut, të cilat do të përbënin shkelje të dinjitetit të të burgosurve. Përveç kësaj, MKPT-ja vërejti se ekziston një klimë pozitive e marrëdhënieve dhe komunikim i mirë interaktiv ndërmjet të dënuarve dhe zyrtarëve korrektues. Sa u përket çështjeve të tjera, si: kushtet e akomodimit, ushqimi, kujdesi shëndetësorë etj., më gjerësisht i gjeni në përmbledhjen e të gjitha raporteve të Avokatit të Popullit.

Raport i MKPT-së lidhur me vizitën në Qendrën Edukativo - Korrektuese në Lipjan

MKPT-ja, më 2 korrik 2019, e vizitoi Qendrën Edukativo - Korrektuese në Lipjan (QEKL). MKPT-ja vërejti se Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve, të cilëve u është hequr liria, përcaktojnë se duhet të themelohen ambiente të hapura paraburgimi për të miturit. Ambientet e hapura të paraburgimit janë pa masa sigurie, ose me masa sigurie minimale. Numri i të ndaluarve në këto ambiente paraburgimi duhet të jetë sa më i vogël, brenda mundësive. QEKL-ja zbaton shkallën e mesme dhe të ulët të sigurisë dhe të kontrollit, aq sa është e nevojshme për mbrojtjen e të miturve nga shkaktimi i vetëdëmtimeve apo shkaktimin e dëmit ndaj stafit apo të tjerëve. Kapaciteti i QEKL-së është 40 shtretër, ndërsa gjatë vizitës së realizuar nga MKPT-ja ishin të vendosur 15 të mitur të gjinisë mashkullore me masë edukuese. Qëllimi i masës edukative është që të kontribuojë në rehabilitimin dhe në zhvillimin adekuat të kryerësit, i cili është i mitur, duke ofruar mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje, duke siguruar edukim dhe aftësim profesional, duke zhvilluar përgjegjësinë e tij personale dhe kështu duke ndaluar sjelljen recidiviste.

Sipas Rendit Shtëpiak të QEKL, organizimi i brendshëm ndërtimor dhe programatik i QEKL-së synon përmbushjen e qëllimit rehabilitues për të miturit, duke pasur parasysh të drejtën e të miturit për privatësi, stimulim shqisor, mundësi për shoqërim me të miturit e tjerë, edukim dhe arsimim të përgjithshëm dhe profesional, kujdes shëndetësor të duhur, ushqim sipas nevojave për moshën, pjesëmarrje në aktivitete sportive, argëtuese dhe kulturore.

Vizita kishte për qëllim vlerësimin e respektimit të të drejtave të personave të mitur, të cilët gjenden në këtë qendër, të cilat parashihen me Kodin e Drejtësisë për të Mitur, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria, si dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të MKPT-së, të cilat ky mekanizëm ua ka dërguar autoriteteve kompetente përmes raportit me rekomandime vitin paraprak.

Raport i MKPT-së lidhur me vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit, më 11 shtator 2019, e vizitoi Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë (QPP). Në QPP, përveç të paraburgosurve, vendosen edhe një numër i vogël i të dënuarve. Kapaciteti i Qendrës është për 300 persona. Gjatë vizitës që realizoi MKPT-ja në QPP, ishin të vendosur 103 të paraburgosur dhe 25 të dënuar. Vizita kishte për qëllim vlerësimin e përgjithshëm të respektimit të të drejtave të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve.

Gjatë vizitës që realizoi MKPT-ja në QPP, personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, realizoi qasje të papenguar në të gjitha vendet e vizituara dhe iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën, si dhe iu mundësuan intervistat me personat e dënuar dhe me persona të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues dhe pa praninë e personelit shëndetësor.

Raport i MKPT-së lidhur me vizitën në Burgun e Sigurisë së Lartë

MKPT-ja, më 10 dhe më 16 korrik 2019, vizitoi Burgun e Sigurisë së Lartë (BSL). Qëllimi i kësaj vizite ishte shqyrtimi i progresit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së të adresuara nëpërmjet Raportit me rekomandime, pas vizitave të mëhershme në BSL, si dhe respektimi i të drejtave të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP), me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Në BSL akomodohen të burgosurit me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë. Kapaciteti zyrtar i BSL-së është për 390 të burgosur. Gjatë vizitës së realizuar nga MKPT-ja, aty ishin të akomoduar 153 të burgosur, prej tyre 24 të paraburgosur. Në BSL akomodohen të burgosurit e përkatësive të ndryshme etnike.

Gjatë vizitës personeli i shërbimit korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa realizoi qasje në të gjitha vendet e vizituara. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën, si dhe iu mundësua intervistimi i të burgosurve, pa praninë e zyrtarëve korrektues.

Letër rekomandimet

Letër rekomandimi për rastin ex officio nr. 67/2019

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 4, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka zhvilluar hetime sipas detyrës zyrtare lidhur me mungesën e harmonizimit të dispozitave kalimtare, përkatësisht të nenit 140 me nenin 141 të Kodit nr. 06/L-006 të Drejtësisë për të Mitur, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr. 17/18 tetor 2018, Prishtinë, duke ardhur në përfundimin se është e nevojshme ndërmarrja e veprimeve përkatëse për ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave kalimtare dhe përfundimtare të Kodit.

Sipas nenit 141 të Kodit, Kodi hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në GZRK, ndërsa do të fillojë të zbatohet gjashtë (6) muaj nga dita e hyrjes në fuqi. Ndërsa sipas nenit 140 të Kodit, me hyrjen në fuqi të Kodit pushon të vlejë Kodi nr. 03/L-193. Rrjedhimisht, pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në GZRK pushojnë se aplikuari dispozitat e Kodit nr. 03/L-193, me përjashtim të rasteve të përcaktuara me dispozitat e neneve 135, 136, 137 dhe 138. Kjo gjendje përbën shqetësim për Avokatin e Popullit, e cila duhet adresuar në mënyrë adekuate.

Për këto arsye, Avokati i Popullit, në pajtim me të lartcekurat, konstaton: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare të Kodit nuk i përmbushin standardet e hartimit të akteve normative, gjë që është në kundërshtim me të drejtat e njeriut, me sigurinë juridike dhe me sundimin e ligjit, përkatësisht nenet 136 dhe 141, krijojnë një situatë të pamundësisë për t'i zbatuar dispozitat penale të drejtësisë për të mitur.

Letër rekomandimi për rastin ex officio nr. 133/2019

Me rastin e vizitës në komunitetin kroat në fshatin Janjevë, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit kanë pranuar ankesa në lidhje me sigurinë e qytetarëve dhe të pronave të tyre, për shkak të grabitjeve dhe plaçkitjeve të shpeshta që po ndodhin viteve të fundit në Janjevë dhe, sipas pohimeve të tyre krejt kjo për shkak të mungesës së një angazhim konkret të autoriteteve përgjegjëse në drejtim të luftimit të kësaj dukurie. Nisur nga kjo, Avokati i Popullit, në bazë edhe të nenit 16, paragrafët 4 dhe 7, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka hapur hetime sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) lidhur me sigurinë e qytetarëve kroatë dhe pronave të tyre në fshatin Janjevë të komunës së Lipjanit.

Avokati i Popullit ia rikujton Policisë së Kosovës detyrimet Kushtetuese dhe obligimet ligjore që kanë të bëjnë me punën e policisë dhe sigurimin e një numri të mjaftueshëm të zyrtarëve të saj nëpër stacione e nënstacione në të cilat është e domosdoshme të rritet personeli, për shkak të përkeqësimit të sigurisë, sigurisë së qytetarëve dhe të pronave të tyre nga rritja e numrit të krimeve të kryera dhe i rekomandoi policisë që të veprojë në përputhje me kompetencat e dhëna me ligj, duke synuar rritjen e numrit të zyrtarëve policorë në fshatin Janjevë, në mënyrë që të arrijnë të përgjigjen në mënyrë adekuate ndaj raportimeve për kryerësit e veprave penale ose të punojë në parandalimin e tyre.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 839/2018

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-125 për Qasje në Dokumente Publike, më 15 nëntor 2018, e ka pranuar ankesën e B. B. parashtruar kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK), për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike, përkatësisht për qasje në dosjen e tij, si kandidat në procedurën e rekrutimit për gjyqtar.

Avokati i Popullit në këtë rast konstatoi se refuzimi i kërkesës së ankuesit për qasje në dosjen e tij si kandidat në procedurën e rekrutimit për gjyqtar ia mohon ankuesit të drejtën për qasje në dokumente publike, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutë dhe me ligj.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 818/2018

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka pranuar ankesë kundër Odës së Mjekëve të Kosovës për faktin se me Vendim nr. 270/2018 për Caktimin e Sistemit të Taksave Administrative është vendosur që “Taksa administrative për inicimin e procedurës disiplinore ndaj mjekëve të jetë në shumën 30 € (tridhjetë euro)”. Për më shumë, ankuesi pretendon se një vendim i tillë shkel të drejtat e njeriut, ngase detyrimi për pagimin e taksës bëhet pengesë për pacientët që të paraqesin ankesë kur konsiderojnë se u janë shkelur të drejtat nga personeli mjekësor.

Avokati i Popullit pohon se iniciimi i procedurës disiplinore ndaj institucionit shëndetësor është procedurë administrative, e cila mund të rregullohet me rregulla të brendshme, mirëpo ato rregulla duhet të jenë në harmoni të plotë me dispozitat e përgjithshme ligjore

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 706/2018

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, si dhe me nenin 10 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Komunës së Graçanicës, për mosdorëzimin e dokumentit të kërkuar në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

Në këtë rast, Avokati i Popullit theksoi se mosshqyrtimi i kërkesës së ankuesit nga Komuna e Graçanicës është në kundërshtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe po ashtu në kundërshtim edhe me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ose me parimin e administrimit të hapur, siç përcaktohet në nenin 9, paragrafi 1, ku thuhet: “*Autoritetet publike duhet të veprojnë në mënyrë transparente.*” Përveç kësaj, Komuna e Graçanicës dështoi t’i përmbushë obligimet që dalin nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe nga Ligji për Avokatin e Popullit, sipas të cilit të gjitha autoritetet publike janë të detyruara t’u përgjigjen kërkesave të Avokatit të Popullit për kryerjen e një hetimi dhe të ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 522/2018

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, si dhe me nenin 10 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA). Ankuesi pohon se i është drejtuar AKA-së me dy kërkesa. Kërkesa e parë ka të bëjë me heqjen e njoftimit publik për vendimet e nxjerra në Mbledhjen e 58 të Këshillin Shtetëror të Cilësisë (KShC); dhe kërkesa e dytë ka të bëjë me kërkesën për qasje në dokumente publike, përkatësisht në Procesverbalin e Mbledhjes së 58 të KShC-së, për të cilat ai nuk ka pranuar përgjigje.

Lidhur me këtë çështje, përkatësisht kërkesën e parë të ankuesit, Avokati i Popullit konsideron se AKA-ja është dashur të veprojë në pajtim me dispozitat ligjore të LPPA-së dhe ankuesit t’i përgjigjet në kërkesën e parashtruar, pa paragjykuar përmbajtjen e saj. Ndërsa, sa i përket kërkesës së dytë të ankuesit, Avokati i Popullit konsideron se qasja në dokumentin e kërkuar mund të trajtohet në pajtim me nenin 11, paragrafi 2, të LQDP-së dhe me nenin 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, të LMDhP-së.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 562/2017

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), për shkak të mospërgjigjes brenda afatit ligjor në ankesën e parashtruar kundër vendimit të Komisionit Komunal të Komunës së Prishtinës për dhënien në shfrytëzim me qira joprofitabile nga familjet e kategorisë sociale të njëjësive banesore që janë në pronësi të komunës.

Avokati i Popullit nxjerr përfundimin se dështimi i MMPH-së për ta zhvilluar procedurën administrative brenda afateve ligjore dhe në frymën e respektimit të parimit të efikasitetit në procedurë, ka reflektuar drejtpërdrejt në cenimin e së drejtës së palës për shfrytëzimin efektiv të mjeteve juridike të garantuara me ligj dhe me standarde ndërkombëtare.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 888/2017

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën e një qytetareje parashtruar kundër Komunës së Prishtinës përkitazi me mos vlerësimin profesional të fëmijës me aftësi të kufizuara, çështjen e mospagimit të asistentit personal për mësimnxënie dhe sigurimin e transportit.

Avokati i Popullit konstaton se Komuna e Prishtinës ka dështuar t'i ndërmarrë veprimet përkatëse për vlerësimin profesional të fëmijës me aftësi të kufizuara, gjë që përbën shkelje të të drejtave të njeriut, në rastin konkret të të drejtave të fëmijëve, përkatësisht shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të standardeve ndërkombëtare dhe të legjisllacionit të lartpërmendur.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 30/2019

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën e parashtruar ndaj Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", i cili pas përmbylljes së konkursit dhe të procedurave tjera lidhur me konkursin me të cilin ankuesi është përzgjedhur si asistent i angazhuar në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, Senati i Universitetit, përmes Vendimit nr. Prot. 1564, i datës 5 nëntor 2018, ka vendosur që nënshkrimi i kontratës me ankuesin të shtyhet deri pas pranimit të opinionit nga Agjencia Kundër Korrupsionit lidhur me mundësinë e ekzistimit të konfliktit të interesit në rastin konkret.

Avokati i Popullit konsideron se konstatimi i AKK-së, në të cilin thuhet se ndryshimi i listës së angazhimit është bërë qëllimisht dhe vetëm sa për t'iu shmangur ndalesës në rregullore, është në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 8, si dhe me nenin 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, ku rregullohen veprimet që zyrtarët duhet t'i ndërmarrin për shmangien dhe parandalimin e konfliktit të interesit.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se punësimi dhe avancimi në universitetet publike në Republikën e Kosovës duhet të bëhet për të gjithë në kushte të barabarta, duke e respektuar plotësisht parimin kushtetues të barazisë dhe qasjen e barabartë në shërbimet publike. Në konkurse duhen respektuar kriteret e përcaktuara, kualifikimet e kërkuara, aftësitë e punës së kandidatit që aplikon për punë. Në të gjitha rastet e punësimit apo të avancimit, nuk do të duhej të ndodhte trajtimi preferencial për arsye të lidhjeve familjare ose të ngjashme, ashtu siç nuk do të duhej që për të njëjtat arsye të ketë trajtim më të pafavorshëm apo përjashtues.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 245/2019

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën lidhur me mungesën e kushteve për shkollim, përkatësisht mosofrimin e kujdestarisë/asistencës 24 orëshe në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim (QBMK) “Xheladin Deda” në Pejë për fëmijën e tij me aftësi të kufizuara të shumëfishta.

Avokati i Popullit konstaton se shërbimet nuk ofrohen në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore, gjë që përbën shkelje të të drejtave të njeriut, në rastin konkret të të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, të vendosur në këtë qendër, përkatësisht shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të standardeve ndërkombëtare dhe të legjislacionit të lartpërmendur dhe rekomandon që të ofrohet shërbim 24 orësh për fëmijët e vendosur në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim “Xheladin Deda” në Pejë.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 591/2018

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën kundër Komunës së Kaçanikut, gjegjësisht kundër Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë, për shkak të moszbatimit të Vendimit (nr. 794/09) të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, datë 21 prill 2009, dhe të Aktvendimit (E. nr. 65/19) të Gjykatës Themelore në Ferizaj, datë 26 shkurt 2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHC), me Vendimin nr. 794/09, i datës 21 prill 2009, kishte obliguar drejtorin e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës dhe shefin për Administratë dhe Personel në Komunën e Kaçanikut që ta kthenin ankuesen në vendin e punës dhe t’ia bënin kompensimin e të ardhurave personale në mënyrë retroaktive.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se çështja e së drejtës nga marrëdhënia e punës, nisur nga rëndësia që ka për të gjitha organet vendimmarrëse do të duhej trajtuar si çështje me prioritet. Kjo do duhej të vlente edhe për Komunën e Kaçanikut – Drejtorinë për Arsim dhe Kulturë, e cila në mënyrë të vazhdueshme e ka prolonguar zbatimin e Vendimit (nr. 794/09) përmbartimor të KPMSHC-së së Kosovës, i datës 21 prill 2009, duke shpallur konkursin, anuluar dhe rishpallur për njëmbëdhjetë herë radhazi.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 699/2018

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën kundër punës së Odës së Përmbartuesve Privat të Kosovës. Ankesa e parashtruar ka të bëjë me detyrimin për pagesën e shërbimeve të përkthimit të dokumenteve zyrtare nga gjuha shqipe në gjuhën serbe, të cilën përmbartuesi në Prizren ia ka ngarkuar ankueses dhe babait të saj gjatë procedurës së ekzekutimit të aktgjykimit të gjykatës.

Avokati i Popullit nxjerr përfundimin se Oda e Përmbartuesve Privat të Kosovës, si dhe përmbartuesi i ngarkuar me këtë lëndë, kanë dështuar ta zbatojnë legjislacionin pozitiv, për shkak se ankuesi është ngarkuar me pagimin e përkthimit të dokumentacionit zyrtar me rastin e përmbartimit të aktgjykimit gjyqësor, përkundër detyrimit ligjor ndaj përmbartuesit që, me rastin e përmbartimit, parashtruesit të ankesës t’ia dorëzojë të gjithë dokumentacionin përkatës në një gjuhë zyrtare të cilën ai e kupton, në rastin konkret në gjuhën serbe, pa e ngarkuar me pagimin për shërbimin e përkthimit.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 235/2019

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) dhe kundër Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), përkitazi me mos lirim nga pagesa të personave të verbër në dalje të objektit të QKUK-së dhe të ShSKUK-së në Prishtinë. Ankuesja pretendon se, në dalje të QKUK-së dhe të ShSKUK-së, personit zyrtar i është prezantuar librezja e verbërisë e lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), mirëpo ai e ka kërkuar udhëzimin që personi i është nënshtruar kontrolleve mjekësore, ndërsa ka refuzuar që ta pranonte çdo dokument tjetër, duke u shprehur: *“Edhe krahët me t ‘dalë pa pagu nuk dilni prej QKUK-së.”*

Avokati i Popullit konstaton se detyrimi nga zyrtarët e angazhuar tek hyrje-daljet e objektit të QKUK-së dhe të ShSKUK-së që personat e verbër të paguajnë shumën e përcaktuar të të hollave përbën veprim të kundërligjshëm dhe kjo praktikë duhet menjëherë të ndalohet në QKUK dhe ShSKUK, si dhe në të gjitha objektet e tjera të institucioneve publike, në rast se ndodh një gjë e tillë.

Gjithashtu, Avokati i Popullit konstaton se kriteri i përcaktuar në Rregulloren Nr. 116 për Shfrytëzimin e Parkingut në Hapësirat e QKUK-së dhe të ShSKUK-së, që, me qëllim të lirit nga pagesa, personat me nevoja të veçanta, përfshirë personat e verbër, mes tjerash, duhet ta tregojnë në dalje *raportin e mjekut i protokolluar në ditën që lirohet*, përbën shkelje të Ligjit nr. 04/L-092 për Personat e Verbër.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 29/2019

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, më 8 janar 2019, e ka pranuar ankesën e parashtruar kundër Telekomit të Kosovës (TK), për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike.

Avokati i Popullit thekson se, duke pasur parasysh rolin e mediave dhe të publikut në një shoqëri demokratike dhe duke pasur parasysh se të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që në një shoqëri të hapur dhe demokratike të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi, Avokati i Popullit konsideron se kërkesa e ankueses për qasjen në dokumentet publike, si e tillë, ka bazë në Ligjin nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike dhe rekomandon që në pajtim me legjislacionin në fuqi t’i ofrohet ankueses qasje në dokumentet e kërkuara.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 9/2019

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) lidhur me Udhëzimin Administrativ MAPL nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna (UA nr. 2014/01). Sipas pretendimeve të ankuesit, dispozitat e UA nr. 2014/01 nuk janë në harmoni me dispozitat kushtetuese, konkretisht me nenin 62 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe, si rezultat i kësaj, atyre po u mohohet e drejta e përfaqësimit e garantuar me Kushtetutë.

Avokati i Popullit ka vërejtur mospërputhje në mes gjuhës shqipe dhe gjuhës serbe në të njëjtin version edhe në Udhëzimin Administrativ MAPL nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna, përkatësisht neni 4, paragrafët 1 dhe 3. Me këtë rast tërheq vëmendjen për domosdoshmërinë e ndërmarrjes së veprimeve konkrete lidhur me harmonizimin gjuhësor të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe Udhëzimit Administrativ MAPL nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna, në mënyrë që përcaktimet e mësipërme ta kenë të njëjtin kuptim në të dy versionet gjuhësore.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 60/2019

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër policisë kufitare të Republikës së Kosovës në pikë-kalimin kufitar Merdare, për shkak të moslejimit të transportimit të udhëtarëve në emër të kompanisë ShPK “Adio”, e cila ka linjë të rregullt qarkullimi.

Avokati i Popullit rikujton se Policia e Kosovës, në veçanti policia kufitare, është e obliguar ta respektojë njoftimin zyrtar dhe njoftimin të cilin Ministria e Infrastrukturës ua ka dërguar përmes postës elektronike autoriteteve të policisë kufitare për të gjitha linjat që kanë pasur leje valide deri në fund të vitit 2017, në mesin e të cilave është edhe kompania për të cilën ankuesi i transporton udhëtarët, që edhe më tej ta ketë miratimin që t’i transportojë pasagjerët derisa të gjendet ndonjë zgjidhje më e përhershme.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 260/2019

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike. Ajo nëpërmjet postës elektronike ka parashtruar kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, përkatësisht për qasje në të dhënat si në vijim: *A ka Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale buxhet për marketing në medie online dhe media sociale, cilat janë mediet dhe rrjetet sociale ku shpenzohet buxheti dhe për çfarë periudhe janë lidhur kontratat.* Këto të dhëna i ka kërkuar për vitin 2017 dhe 2018.

Avokati i Popullit vëren se mostrajtimi nga MPMS-ja i kërkesës së ankueses, përveçse është në kundërshtim me LQDP-në, bie ndesh edhe me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht me parimin e administratës së hapur, i përcaktuar me nenin 9, paragrafi 1: *“Organet publike duhet të veprojnë me transparencë.”* Për më tepër, mungesa e një vendimi në formën e përcaktuar me ligj tërheq me vete edhe mungesën e njoftimit të palës për të drejtën në ankesë, gjë që paraqet edhe shkelje të së drejtës në përdorim të mjeteve juridike.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 265/2019

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), më 20 mars 2019, e ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ), për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike. Ankuesja nëpërmjet postës elektronike ka parashtruar

kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, përkatësisht për qasje në të dhënat si në vijim: *A ka Ministria e Punëve të Jashtme buxhet për marketing në medie online dhe media sociale, cilat janë mediet dhe rrjetet sociale ku shpenzohet buxheti dhe për çfarë periudhe janë lidhur kontratat.* Këto të dhëna i ka kërkuar për vitin 2017 dhe 2018.

Avokati i Popullit vëren se mostrajtimi nga MPJ-ja i kërkesës së ankueses, përveçse është në kundërshtim me LQDP-së, bie ndesh edhe me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht me parimin e administratës së hapur, i përcaktuar me nenin 9, paragrafi 1: *“Organet publike duhet të veprojnë me transparencë.”* Për më tepër, mungesa e një vendimi në formën e përcaktuar me ligj tërheq më vete edhe mungesën e njoftimit të palës për të drejtën në ankesë, gjë që paraqet edhe shkelje të së drejtës në përdorim të mjeteve juridike.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 412/2019

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Policisë së Kosovës (PK), përkitazi me përfshirjen e të dhënave të tij personale në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK) në vitin 2005 dhe mosfshirjen e të dhënave të tij personale nga SIPK-u deri në vitin 2018. Ankuesi pohoi se atë gabimisht e kishin përfshirë në këtë regjistër dhe se asnjëherë nuk ishte informuar lidhur me këtë rast, për të cilin ishte paraqitur kallëzim penal nga Stacioni Policor në Gjilan.

Bazuar në faktet e rastit në fjalë dhe dokumentet e prezantuara, duke qenë se ankuesi ka figuruar si i dyshuar në SIPK që nga viti 2005 deri në vitin 2018, edhe pse kallëzimi penal i Policisë, i datës 20 korrik 2005, bazuar në të cilin të dhënat personale të ankuesit ishin futur në SIPK si person i dyshuar, është hedhur poshtë nga Prokuroria me Aktvendimin PPP. Nr. 118/2005, i datës 10 shkurt 2009, Avokati i Popullit konstaton se ka pasur shkelje të dispozitave ligjore sa i përket ruajtjes dhe fshirjes së të dhënave nga PK-ja, si dhe cenim të parimit të sigurisë juridike, i cili është baza e shtetit të së drejtës dhe siguron besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit përmes veprimeve të organeve administrative, parim ky i cili ndër tjerash konsiston në saktësinë, qartësinë dhe qëndrueshmërinë në tërësi të të gjithë rendit juridik të një shteti.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 203/2019

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQPD), ka trajtuar ankesën parashtruar kundër Komunës së Fushë Kosovës, për shkak të pamundësisë për qasje në dokumente publike. Ankuesi i është drejtuar Drejtorisë për Planifikim Urban (DPU) e Komunës së Fushë Kosovës, me kërkesë për qasje në procesverbalin mbi kontrollimin teknik të objektit investues në bazë të të cilit është nxjerrë Aktvendim 06. nr.300, i datës 23.10.2014; si dhe në projektin kryesor dhe projektin bazë (bodrum) sipas Lejes urbanistike 06.nr.233, e datës 19.7.2012, dhe Lejen ndërtimore nr. 06/235, e datës 25.7.2012.

Avokati i Popullit vlerëson se përjashtimet e së drejtës për qasje në dokumente janë të përcaktuara me LQDP-së. Ndërsa informacionet mund të kufizohen vetëm për qëllime të mbrojtjes së interesave legjitime publike, të jetës ose të interesave të tjera legjitime private, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, dhe konstaton se Komuna e Fushë Kosovës ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve lidhur me

mundësimin, përkatësisht lejimin për qasje në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar të ankuesit, e cila e drejtë është e sanksionuar me akte vendore si dhe me instrumente ndërkombëtare.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 164/2015

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, për shkak të zvarritjes së procedurës penale në lëndën P.nr. 10/2013.

Ankuesi është ankuar për dështimin e gjyqësorit për të garantuar një proces të rregullt, të drejtë, brenda afatit të arsyeshëm ligjor dhe shkeljen e së drejtën për mjete efektive juridike, e paraparë me nenet 31 dhe 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenet 6 dhe 13 të KEDNj-së, si dhe me nenin 5, paragrafi 2, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Avokati i Popullit vlerëson se janë shkelur të drejta e ankuesit për procedurë të rregullt dhe brenda afatit të arsyeshëm kur merret për bazë fakti se procedura ka zgjatur më shumë se 6 vjet.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 290/2019

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, për shkak të përgjigjes së pjesshme në kërkesën për qasje në dokumente publike/informacion.

Avokati i Popullit konstaton se në rastin e ankueses Ministria e Infrastrukturës ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin e qasjes në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar nga ankuesja, gjë që është e sanksionuar me akte vendore si dhe me instrumente ndërkombëtare. Avokati i Popullit konstaton po ashtu se Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, përveçse ka dështuar t'i përmbushte obligimet që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 41 dhe neni 132, paragrafi 3), po ashtu ka dështuar t'i përmbushte obligimet që burojnë nga Ligji për Avokatin e Popullit (neni 25), në bazë të të cilit, të gjitha autoritetet kanë për obligim t'i përgjigjen Avokatit të Popullit në kërkesat e tij për zhvillimin e hetimeve, si dhe t'i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 448/2019

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike ka trajtuar ankesën e organizatës joqeveritare "ADMOVERE", parashtruar kundër Këshillit Prokurorial të Kosovës.

OJQ-ja në fjalë nëpërmjet postës elektronike i është drejtuar KPK-së me kërkesë për qasje në dokumente publike/të dhëna statistikore për secilin vit, që nga paslufta, për stafin akademik të UP-së. Megjithatë, deri në ditën kur ka paraqitur ankesë në IAP, OJQ "ADMOVERE" nuk ka marrë përgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike.

Avokati i Popullit konsideron se interesi i informimit të publikut për mënyrën se si administrohen rastet nga sistemi i drejtësisë, ku të dyshuar, të akuzuar apo të dënuar janë profesorët e Universitetit të

Prishtinës, është thelbësor në drejtim të promovimit dhe të forcimit të demokracisë dhe të funksionimit të mirë të sistemit të drejtësisë. Rol të rëndësishëm në këtë aspekt kanë edhe shoqëria civile dhe mediat.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 256/2019

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, ka trajtuar ankesën e Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN), parashtruar kundër Komunës së Podujevës, për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike dhe atë për qasje në faturat e drekave dhe të darkave zyrtare të Komunës së Podujevës, për periudhën dhjetor 2017- gusht 2018.

Avokati i Popullit, në rastin në fjalë, konstaton se Komuna e Podujevës ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve pozitive lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin e qasjes në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar, e drejtë kjo që garantohet me instrumente ndërkombëtare dhe me akte vendore.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 363/2019

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, e ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme, për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike. Ankuesja ka paraqitur kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, përkatësisht për qasje në: *Emrat e personave të shpallur Konsuj Nderi jashtë Republikës së Kosovës; Emrat e personave të shpallur Konsuj nderi në Republikën e Kosovës; Kopjet e dosjes mbi CV e Konsujve të nderit që ushtrojnë aktivitetin e tyre në emër të Republikës së Kosovës; Cilat kanë qenë kriteret që MPJ ka vendosur në shpalljen e personave Konsuj Nderi? Cilët kanë qenë personat apo edhe shtetet që kanë bërë propozimin për shpalljen nga MPJ e Republikës së Kosovës për Konsuj Nderi?*

Avokati i Popullit konstaton se, në rastin e ankueses, Ministria e Punëve të Jashtme ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve pozitive lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin e qasjes në dokumente publike sipas kërkesës së parashtruar të ankueses, e drejtë kjo e garantuar me instrumente ndërkombëtare dhe me akte vendore.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 275/2019

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, e ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Komunës së Skenderajt, për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike. Ankuesja nëpërmjet postës elektronike ka parashtruar kërkesë për qasje në faturat e drekave dhe darkave zyrtare të Komunës së Skenderajt, për periudhën dhjetor 2017 - gusht 2018.

Avokati i Popullit në rastin në fjalë konstaton se Komuna e Skenderajt ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve pozitive lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin për qasje në dokumente publike sipas kërkesës së parashtruar të ankueses, e cila e drejtë është e sanksionuar me akte vendore si dhe me instrumente ndërkombëtare. Qëllim i miradministrimit të organeve të administratës publike, ndër të

tjera, duhet të jetë edhe krijimi i praktikave të mira, duke promovuar një kulturë administrative të harmonizuar dhe me fokus të qytetarët, e cila mëson nga bashkëveprimi me qytetarët dhe nga shoqëria civile.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 496/2019

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, e ka trajtuar ankesën e parashtruar Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ), për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike. Ankuesi, më 24 prill dhe më 5 qershor 2019, nëpërmjet postës elektronike i është drejtuar ministrisë me kërkesë për qasje në dokumentin e fundit të deklasifikuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Po ashtu ankuesi i ka parashtruar edhe pyetjet në vijim: *A është formuar ndonjëherë në MPJ, komision për klasifikim të informacioneve? Sa dokumente janë klasifikuar gjatë vitit 2018? A ka miratuar MPJ lista të dokumenteve të klasifikuara dhe lista të shpërndarjes së tyre? A mund të na konfirmoni se MPJ pranon dokumente të klasifikuara nga ambasadat e saj? Cilat janë nivelet e klasifikimit të dokumenteve të MPJ-së?*

Avokati i Popullit vlerëson se përjashtimet e së drejtës për qasje në dokumente janë të përcaktuara në nenin 17 të LQDP-së. Ndërsa informacionet mund të kufizohen vetëm për qëllime të mbrojtjes së interesave legjitime publike, të jetës ose të interesave të tjera legjitime private, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Për më tepër, mungesa e një vendimi në formën e përcaktuar me ligj tërheq me vete edhe mungesën e njoftimit të palës për të drejtën në ankesë, gjë që paraqet edhe cenim të së drejtës në përdorim të mjeteve juridike.

Avokati i Popullit konstaton se, në rastin e ankuesit, MPJ-ja ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve pozitive lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin e qasjes në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar nga ankuesi, gjë që është e sanksionuar me akte vendore si dhe me instrumente ndërkombëtare.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 337/2019

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, e ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), për qasje të kufizuar në dokumente publike.

Në bazë të informatave që Avokati i Popullit i ka në dispozicion, ankuesi ka aplikuar në konkursin e datës 25 janar 2019, i shpallur nga KPK-ja për pozitën: Zyrtar për mbrojtje të viktimave, Zyra për mbrojtje dhe ndihmë të viktimave në Mitrovicë. Pas njoftimit për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm, ankuesi, më 14 mars 2019, ka paraqitur kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, përkatësisht *për qasje në testin me shkrim, në procesverbalin e intervistës verbale dhe në pikët e kandidatëve të suksesshëm*. Ankuesi është ftuar në zyrat e KPK-së dhe i është lejuar qasja në testin e tij me shkrim, por nuk i është dhënë kopja e testit, ndërsa nuk i është lejuar qasja në procesverbalin e intervistës së tij, e as në pikët totale të kandidatëve të përzgjedhur në listën e ngushtë të konkursit në fjalë.

Avokati i Popullit konstaton se, meqenëse kërkesa e ankuesit ka të bëjë me të dhënat e tij, KPK-ja është dashur ta ketë parasysh edhe Ligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përkatësisht nenin 11, me të cilin përcaktohen informimi transparent, komunikimi dhe modalitetet për ushtrimin e të drejtave të subjektit të të dhënave; si dhe nenin 14, me të cilin përcaktohet e drejta për qasje nga subjekti i të dhënave.

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 877/2019

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Shkollës së Mesme të Lartë (ShML) të Agrobiznesit dhe të Teknologjisë “Zenel Hajdini” në Ferizaj, përkitazi me shqiptimin e masës disiplinore suspendimit nga shkolla për një muaj.

Ankuesi është nxënë i klasës X, i cili ka pohuar se drejtori i shkollës “Zenel Hajdini”, me vendimin e datës 29 tetor 2019, ia ka shqiptuar masën disiplinore *suspendim nga shkolla për 1 muaj*, me obligim që ai të transferohet në një shkollë tjetër, mirëpo atë nuk po e pranojnë në asnjë shkollë në cilësi të nxënësit për ndjekjen e mësimin për periudhën 1 mujore.

Avokati i Popullit konstaton se Vendimi me nr. 905:/03 për masën disiplinor suspendim nga shkolla 1 muaj, i datës 29.10.2019, i shkel të drejtat dhe liritë e njeriut për faktin se është në kundërshtim me parimet bazë të funksionimit të shtetit demokratik, siç është parimi i ligjshmërisë, parimi kushtetues i sundimit të ligjit dhe parimi i sigurisë juridike, sepse nxjerrja e një vendimi të tillë nuk ka bazë ligjore. Ligji nr. 2002/2 për Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë dhe Udhëzimi Administrativ Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta, numër: 6/2010, janë të shfuqizuara dhe si të tilla nuk mund të prodhojnë efekte juridike.

Letër rekomandimi për vizitat nga MKPT-ja nëpër stacionet policore

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit ripërsërit rekomandimin që të kryhen rinovimet e nevojshme në Qendrën e Mbjajtjes në Deçan sa më shpejt që të jetë e mundur; që të kryhen rinovimet e nevojshme në Qendrën e Mbjajtjes të Stacionit Policor në Pejë; të instalohen, aty ku mungojnë, sistemet e thirrjeve nëpër të gjitha qelitë e stacioneve policore ku ka dhoma të mbajtjes; të ndaluarit të furnizohen me mjete higjienike si dhe të rinovohet apo të gjendet ndonjë zgjidhje tjetër për Stacionin Policor në Fushë Kosovë.

Letër rekomandimi për vizitën e MKPT-së në Qendrën Korrektuese në Dubravë

Me qëllim të vlerësimit të progresit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së, të dërguara përmes raportit me rekomandime, i datës 28 qershor 2018, MKPT-ja realizoi vizitë në Qendrën e Korrektuese në Dubravë.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit ripërsërit rekomandimin që: të miratohet legjislacioni sekondar për luftimin e korrupsionit, siç parashihet me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale; të furnizohet kuzhina me pajisje adekuate sipas vlerësimit konkret; personeli që punon në kuzhinë të furnizohet me uniforma pune; të burgosurit të furnizohen me dollapë për vendosjen e gjësendeve të tyre; të rriten angazhimet jashtë qelisë për të paraburgosurit, brenda mundësive të QKD-së dhe në pajtim me legjislacionin relevant në fuqi; të funksionalizohet

njësia ekonomike; të angazhohet personeli i nevojshëm korrektues, sipas vlerësimit të nevojave; të shtohet numri i punëtorëve socialë, bazuar në numrin e të burgosurve në QKD; të bëhen rinovimet e nevojshme në Pavijonin numër 5 dhe në pavijonin e spitalit në QKD.

Letër rekomandimi për vizitën e MKPT-së në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan

Me qëllim të vlerësimit të progresit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së, të dërguara përmes raportit me rekomandime, i datës 27 mars 2018, MKPT-ja realizoi vizitë në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit ripërsërit rekomandimin që: të sigurohen më shumë aktivitete kulturore, sportive dhe programe për rehabilitim dhe për risocializim të të burgosurve; të asfaltohet pjesa e rrugës së paasfaltuar, e cila gjatë stinës së dimrit dhe në kushte të reshjeve atmosferike mund të paraqesë vështirësi serioze për kryerjen e punës së QPGj-së, në pajtim me LESP-në; të rritet numri i punëtorëve socialë bazuar në numrin e të burgosurve; të evitohen mangësitë teknike për funksionimin e kamerave të sigurisë; të funksionalizohet ashensori në pjesën ku ofrohen shërbimet mjekësore.

Letër rekomandimi për vizitën nga MKPT-ja në Qendrën e Paraburgimit në Pejë

Me qëllim të vlerësimit të progresit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së, të dërguara përmes raportit me rekomandime, i datës 22 nëntor 2018, MKPT-ja realizoi vizitë në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit ripërsërit rekomandimin që: të krijohen kushte dhe hapësirë adekuate të punës për personelin mjekësor; kushtet e akomodimit, përderisa kjo qendër është në përdorim, të jenë në pajtim me standardet minimale të përcaktuara me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale; me standardet e KPT-së dhe me standardet e tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve; të bëhen përpjekje që të rriten angazhimet jashtë qelisë për të paraburgosurit.

Opinionet e Avokatit të Popullit

Opinion nr. 67/2019 lidhur me Kodin e Drejtësisë për të Mitur

Gjatë analizimit të Kodit të Drejtësisë për të Mitur është vërejtur se pjesa e “Dispozitave kalimtare dhe përfundimtare” (pjesa e gjashtë), ka kundërthënë ndërmjet dispozitave, të cilat përcaktojnë shfuqizimin e Kodit të vjetër 2010 në raport me hyrjen në fuqi dhe zbatimin e Kodit të ri. Kështu, neni 140, me titull “Pushim i vlefshmërisë së Kodit ekzistues” i KDM 2018, përcakton: “*Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi pushon të vlej Kodi nr.03/L-193 i Drejtësisë për të Mitur (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 78/ 20.08.2010”)*”; ndërsa në nenin 141 (*Hyrja në fuqi dhe fillimi i zbatimit të Kodit*) përcaktohet: “*Ky Kod hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa fillon të zbatohet gjashtë (6) muaj nga dita e hyrjes në fuqi.*”

Pikërisht dispozita e nenit 141 ka krijuar një praktikë legislative të pazakontë, duke përcaktuar afate të ndryshme sa i takon hyrjes në fuqi të KDM 2018 dhe fillimit të zbatimit të tij, me ç’ rast është krijuar një rrethanë që një periudhë kohore (6 muaj) të mos jenë efektive të zbatueshme dispozitat e asnjërit prej kodeve! Një gjendje e tillë faktike krijon pasojën që të ketë zbrazëti juridike për një fushë me rëndësi të posaçme, siç është trajtimi i të miturve si kryes të veprave penale, përkatësisht në lidhje me fushëveprimtarinë që është rregulluar me Kodin e vjetër 2010 dhe me KDM 2018.

Opinion nr.744/2019 për sigurimin e qasjes në informim për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar të dëgjimit

Në emisionet e ndryshme në kanalet e ndryshme televizive në Kosovë, me rastin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nuk është vërejtur të jenë angazhuar interpretë të certifikuar në *Gjuhën e Shenjave*²⁷⁸, si gjuhë amtare e personave të shurdhër, me qëllim që edhe kjo kategori, që përdorin këtë gjuhë, të informohen rreth programeve politike, me qëllim të vlerësimit të ofertës më të mirë politike për votim të kandidatëve për deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit konstaton se mosdhënia e mundësisë në të kuptuarit të kësaj gjuhe për këtë kategori të personave me aftësi të kufizuar vlerësohet si diskriminim mbi bazë të aftësisë së kufizuar. Ky konstatim i Avokatit të Popullit gjen bazën edhe në Ligjin nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili është në fuqi.

Mendimet juridike në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae)

Mendim Juridik në cilësinë e mikut të gjykatës lidhur me padinë e ankuesve E. Sh. dhe B. E.

Ky mendim juridik i Avokati i Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës ka për qëllim ta argumentojë bazën ligjore dhe të ofrojë një analizë ligjore përkitazi me rastin e bazuar në ankesën individuale të ankuesve lidhur me veprimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe

²⁷⁸ Sipas Rregullores (QRK) nr. 15/2014 për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës, neni 3, par. 1.7, “*Gjuha e shenjave*” – nënkupton *Gjuhën e shenjave e cila ka rregullat e saj gramatikore, strukturën e fjalisë dhe nuancat kulturore.*

të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, që ka të bëjë me mosofrimin e mundësive të garantuara ligjore dhe kushtetuese për mjete juridike efektive brenda një afati të arsyeshëm kohor për rastin e largimit nga puna të ankuesve nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Avokati i Popullit, në bazë të dëshmimeve të paraqitura dhe fakteve të mbledhura, si dhe ligjeve relevante, konstaton se ankesat e ankuesve janë të arsyeshme dhe ka pasur shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Mendim Juridik në cilësinë e mikut të gjykatës lidhur me rastin e S. S. dhe N. D.

Avokati i Popullit, në zbatim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, përmes këtij Mendimi Juridik, ka për qëllim të ofrojë ndihmën juridike në funksion të mbrojtjes së të drejtave të ankuesve në procedurë penale. Konkretisht, ky Mendim Juridik ka të bëjë me të drejtën e ankuesve që lënda e tyre të kthehet në rigjykim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, siç është vendosur për rastin e Z. S. nga Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin PLM.KZZ.nr.223/2017, i datës 11 qershor 2018.

Avokati i Popullit konstaton se Gjykata Supreme e Kosovës do të duhej t'i merrte parasysh konstatimet e Gjykatës Kushtetuese, e po ashtu do të duhej ta merrte parasysh edhe praktikën e vet gjyqësore, lidhur me rastin PML. KZZ nr. 223/2017, i dt. 11 qershor 2018, me të cilin kishte vendosur lidhur me përbërjen e trupit gjykues dhe kthimin në rigjykim të çështjes në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

Mendim Juridik në cilësinë e mikut të gjykatës në lidhje me padinë C.nr.3381/2018

Ky Mendim Juridik, në cilësinë e mikut të gjykatës, përqendrohet në sqarimin e bazës ligjore përkitazi me ankesën e V. K. A. përkitazi me diskriminimin mbi baza gjinore si dhe trajtimin e pabarabartë në procedurat e konkursit të brendshëm për pozita udhëheqëse në Doganën e Kosovës. Ky Mendim Juridik i Avokatit të Popullit i ofrohet Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Avokati i Popullit nxjerr përfundimin se Vendimi (Nr.05.6.1) i Doganës së Kosovës, i protokolluar me nr. 392, i datës 2 gusht 2018, me të cilin është formuar Komisionin për intervistimin dhe vlerësimin e kandidatëve të paraqitur në bazë të konkursit të brendshëm, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, si dhe me nenin 6, par. 8, të Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

Avokati i Popullit gjithashtu konstaton se Dogana e Kosovës gjatë procesit të rekrutimit dhe vlerësimit të kandidatëve, si dhe Ministria e Financave gjatë shqyrtimit të ankesës së ankuseses, nuk e kanë konsideruar epërsinë e Ligjit për Barazi Gjinore si lex specialis, ndaj legjislacionit doganor si lex generalis, prandaj në këtë rast nuk është respektuar parimi Lex specialis derogat legi gjenerali.

Mendim Juridik në cilësinë e mikut të gjykatës në lidhje me pretendimet për të drejtën për trajtim të barabartë

Ky Mendim Juridik, në cilësinë e mikut të gjykatës, përqendrohet në sqarimin e bazës dhe analizës ligjore përkitazi me ankesën e Këshillit Grevist, i cili përfaqëson Stafin e Shërbyesve Civilë të punësuar në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, përkitazi me pretendimet e tyre për të drejtën për trajtim të barabartë, të dinjitetshëm dhe mosdiskriminues në punë.

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2017, ka marrë Vendimin nr.04/20 për rritje të pagave që, si rrjedhojë, përveç stafit politik, përfituan në mënyrë seleksionuese edhe një pjesë e stafit të shërbimit civil në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Ankuesit pretendojnë se ky vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës nuk e ka marrë në konsideratë bazën ligjore në fuqi, e cila rregullon punën dhe funksionimin e administratës shtetërore, konkretisht shërbimin civil, duke qenë në kundërshtim me Ligjin për Shërbimin Civil që është në fuqi, me Ligjin për Pagat e Nëpunësve Civilë, me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Zyrës së Kryeministrit, me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi etj.

Avokati i Popullit vlerëson se Vendimi nr. 04/20, i datës 20 dhjetor 2017, i nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, është vendim seleksionues, i cili krijon pabarazi si dhe paraqet shkelje të nenit 24, paragrafët 1 dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Mendim Juridik në cilësinë e mikut të gjykatës në lidhje me ankesën e E. B.

Ky Mendim Juridik në cilësinë e mikut të gjykatës fokusohet në shpjegimin e procedurave ligjore në aspektin e kufirit të moshës si kriter për punësimin e parashtuesit të ankesës në pozitën e asistentit për një grup lëndësh në Fakultetin e Shkencave Matematikore-Natyrore - FShMN, nëpërmjet konkursit të shpallur nga Universiteti “Hasan Prishtina” në Prishtinë, kur në bazë të Vendimit të Senatit të Universitetit të Prishtinës, nr. 3/434, i datës 16 dhjetor 2013, me rekomandimin e Komisionit Recensues, paditësi nuk është zgjedhur për asistent, me arsyetimin se ai nuk e plotësoi kushtin juridik – moshën. Opinionin fokusohet vetëm në çështjen lidhur me pretendimet e ankuesit që kanë të bëjnë me diskriminimin, përkatësisht se dispozita e kontestuar e Statutit të UP-së, gjegjësisht neni 178, pika 1.2, e shkel të drejtën e tij kushtetuese dhe është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe në thelb është diskriminues.

Avokati i Popullit në asnjë rrethanë nuk e komenton dhe as synon të ndërhyjë në çështjen e vendosjes së rasteve nga Gjykata duke e respektuar plotësisht diskrecionin e gjykatës për interpretim dhe vendimmarrje. Avokati i Popullit synon vetëm të vë në dijeni Gjykatën me qëndrimin e tij në raport me çështjen që është objekt trajtimi, tanimë të artikuluar në Letër rekomandimin e datës 30 gusht 2010, si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, nr. 1242/2010, i datës 9 dhjetor 2013.

Avokati i Popullit vëren se kufizimi i moshës i paraparë sipas Statutit të UP-së - vendimi i Senatit të UP-së përbën akt diskriminues. Kjo praktikë e UP-së është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë si dhe me parimin e sigurisë juridike.

Bazuar në ato që u thanë më lart, Avokati i Popullit, në cilësinë e mikut të gjykatës e njoftoi Gjykatën me qëndrimin e tij në lidhje me këtë çështje, duke shpresuar që në këtë mënyrë i kontribuon qartësimin të kësaj situatë.

Kërkesat për Masë të Përkohshme

Kërkesë e Avokatit të Popullit drejtuar GjThP-Departamentit për Çështje Administrative, që ta shtyjë ekzekutimin e dhunshëm të Vendimit nr.01/10-01/2019A

Avokati i Popullit ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, përkritazi me Vendimin nr.01/10-01/2019A të Inspektoratit të Punës dhe Opinionit nr.1810/2018 të Avokatit të Popullit, të datës 23 gusht 2018, drejtuar Rektorit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” si dhe ministrit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë (MASHT), lidhur me konkursin publik nr.1/173, i datës 27 prill 2018, për pozitën e punës *asistent për grup lëndësh në Katedrën Penale në Fakultetin Juridik të Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”*, në lidhje me pikën II (f), që përcakton: *“Kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit duhet të sjellin edhe vendimin për nostrifikim (barasvlerën) e diplomës përkatëse (bachelor, master, magjistraturë, doktoraturë). Nuk do të merret në konsideratë dëshmia e aplikimit për nostrifikim”*.

Padia ngrihet për shkak se Inspektorati i Punës, me Vendimin nr. 01/10-01/2019A, i datës 23 janar 2019, pa e vërtetuar drejt gjendjen faktike, ka bërë shkelje të nenit 132 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 1, paragrafët 1 dhe 2, të nenit 3, paragrafi 2, të nenit 16, paragrafët 4 dhe 15, si dhe të nenit 25, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, të nenit 9, paragrafët 1, 2.3 dhe 2.7, si dhe të nenit 12, paragrafi 2, të Ligjit nr. 05/L/021 për Mbrojtje nga Diskriminimi. Gjithashtu, me këtë vendim Inspektorati i Punës ka shkelur edhe nenin 4, paragrafi 2, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.

Avokati i Popullit, në pajtim me nenet 132 dhe 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenin 18, paragrafi 5, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, me nenin 9, paragrafi 2.3, me nenin 12, paragrafi 2, të Ligjit 05/L/021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, si dhe me neni 22, paragrafi 2 dhe paragrafi 6, të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, kërkon që Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, të shtyjë ekzekutimin e dhunshëm të Vendimit nr.01/10-01/2019A, i datës 23 janar 2019, deri në marrjen e një vendimi gjyqësor lidhur me padinë për konflikt administrativ.

Kërkesë e Avokatit të Popullit drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e disa paragrafëve të neneve të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë

Avokati i Popullit nëpërmjet kësaj kërkesë i propozon Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 32 (paragrafi 1), të nenit 76 (paragrafi 2) dhe të nenit 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, me pretendimin se nenet në fjalë janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, respektivisht në kundërshtim me: a) nenin 5 (para. 1) të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe.”*; dhe b) nenin 46 (par. 1 dhe par. 3) të Kushtetutës, i cili përcakton: *“E drejta e pronës është e garantuar.” dhe “Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona.”*

Duke u bazuar në themelësinë e kërkesës, për faktin se palë të ndryshme mund të pësojnë dëme të riparueshme në rast të zbatimit të dispozitave kontestuese, si dhe për faktin se zbatimi i dispozitave të tilla do ta cenonte interesin publik, Avokati i Popullit, nëpërmjet kësaj kërkesë i propozon Gjykatës

Kushtetuese masën e përkohshme për pezullimin e menjëhershëm të këtyre dispozitave të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, deri në vendimin përfundimtar të kësaj gjykate.

Kërkesë e Avokatit të Popullit drejtuar Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor lidhur me çështjen e operimit të hidrocentraleve në vend

Në bazë të pretendimeve të ankuesve dhe informatave të tjera që i ka Avokati i Popullit, çështja e operimit të hidrocentraleve në Deçan dhe në Shtërpcë është duke u përcjellë me shumë paqartësi, si për shkak të mungesës së transparencës së institucioneve përgjegjëse për ligjshmërinë e operimit, e po ashtu edhe për shkak të mangësive lidhur me procesin e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje.

Derisa në publik është duke u zhvilluar një debat i gjerë dhe gjithëpërfshirës lidhur me këtë çështje, institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur asnjëherë të jenë mjaftueshëm të qarta lidhur me ligjshmërinë e operimit të hidrocentraleve dhe veprimet e tyre kanë vazhduar të ngelin të zbehta në drejtim të zgjidhjes së çështjes, përderisa reagimet dhe pakënaqësitë e qytetarëve dhe të shoqërisë civile janë në rritje. Të gjitha përpjekjet e deritanishme të organeve për ta adresuar problemin dhe pakënaqësitë e qytetarëve janë duke u treguar si mjete joefektive për zgjidhjen e problemit.

Duke vërejtur se në rastin konkret kemi të bëjmë me ndikimin në mjedis dhe në ujëra, Avokati i Popullit, bazuar në Ligjin nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, qëllimi i të cilit është mbrojtja e resurseve ujore nga ndotja, nga tej shfrytëzimi dhe nga keqpërdorimi, i cili përcakton në mënyrë të qartë se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore nga fusha e resurseve ujore, përfshirë edhe ligjet tjera nga fusha e mjedisit jetësor, vlerëson se Ministria është organi kompetent i cili duhet të japë sqarime të qarta lidhur me këtë çështje.

Avokati i Popullit, duke konsideruar se situata mund të ketë pasoja të pariparueshme në mjedis, kërkon Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që t'i pezullojë aktivitetet e hidrocentraleve në Deçan dhe në Shtërpcë deri në dhënien e sqarimit për ligjshmërinë e operimit të hidrocentraleve në fjalë, si dhe sqarimet për kompetencat mes autoriteteve përgjegjëse.

Kërkesë e Avokatit të Popullit drejtuar GjThP-së në lidhje me listat e kandidatëve të subjekteve politike për Zgjedhjet e Parakohshme 2019

Çështjen e barazisë gjinore e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me legjislacionin vendor dhe me instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës, Avokati i Popullit e ka trajtuar dhe e ka ngritur në nivelin e instancave më të larta, në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në sistemin gjyqësor të vendit, përmes Raportit me rekomandime në lidhje me tri parimet e përgjithshme për interpretimin e akteve normative dhe zbatimin e këtyre parimeve në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përkatësisht të respektimit të barazisë gjinore.

Një nga shembujt e zbatimit të parimeve interpretuese të ligjit ka të bëjë me raportin ndërmjet Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore dhe Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me kërkesat e tyre përkatëse për përfaqësim gjinor mes përfaqësuesve të zgjedhur.

Cilit ligj duhet t'i jepet përparësi në rregullimin e kësaj çështjeje - Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme apo Ligjit për Barazi Gjinore? Në këtë rast, dy prej parimeve interpretuese janë relevante. Që të dyja i japin përparësi Ligjit për Barazi Gjinore.

Për sa i përket parimit *lex specialis*, në fillim mund të duket e paqartë se cili ligj duhet konsideruar i posaçëm dhe cili i përgjithshëm, mund të duket se secili ligj rregullon një fushë të ndryshme specifike, prandaj asnjëri nuk gëzon përparësi në raport me tjetrin.

Mirëpo, sipas logjikës së GjEDNj-së në rastin *Kudla kundër Polonisë* ([GC], Aplikimi nr. 30210/96, GjEDNj, 26 tetor 2000, § 1460 është Ligji për Barazi Gjinore ai që duhet konsideruar si ligj i posaçëm. Siç u pa më sipër, GjEDNj-ja konsideron se, në shumicën e rasteve, neni 6, par. 1, është *lex specialis* në raport me nenin 13, sepse: “*Mbrojtjet e ofruara prej nenit 6, par. 1, të cilat përfshijnë rangun e plotë të procedurës gjyqësore, janë më të rrepta sesa ato të nenit 13 dhe i gëlltisnin ato*” (Kudla, § 146; theks i shtuar).

Sipas së njëjtës logjikë, kërkesa më e rreptë e Ligjit për Barazi Gjinore, që përfaqësimi i secilës gjini të jetë 50%, mund të konsiderohet *lex specialis* në raport me kërkesën më të ulët të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili kërkon vetëm përfaqësim prej 30% të secilës gjini. Prandaj, sipas parimit *lex specialis*, kërkesa më e rreptë e Ligjit për Barazi Gjinore gëzon përparësi në raport me atë më pak të rreptë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Nisur nga kjo dhe argumentimit më të detajuar në padinë e parashtruar, Avokati i Popullit të kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë aprovimin e masës së përkohshme në procesin zgjedhor, duke kërkuar nga i padituri rishikimin e listave të partive politike, të jenë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Barazinë Gjinore respektivisht neni 6, paragrafi 8 dhe nenin 14.

Kërkesë e Avokatit të Popullit drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin dhe pezullimin e disa dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë

Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë e ngarkon Qeverinë e Republikës së Kosovës me kompetenca për administrimin e çështjes së punësimit të zyrtarëve publikë, duke përfshirë këtu edhe zyrtarët publikë në institucionet e pavarura. Institucionet e pavarura përcaktohen me Kapitullin XII të Kushtetutës, ndërsa nenet 132-135 përcaktojnë Avokatin e Popullit si një ndër pesë institucionet e pavarura në Republikën e Kosovës.

Veshja e Qeverisë së Republikës së Kosovës me kompetenca për punësimin e zyrtarëve publikë në institucionet e pavarura, duke e përfshirë këtu edhe Institucionin e Avokatit të Popullit, a paraqet shkelje të: Pavarësisë së institucioneve të pavarura, të përcaktuara me Kapitullin XII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht pavarësisë së Avokatit të Popullit sipas nenit 132, par. 2, të Kushtetutës.

Kjo nuk është hera e parë që Qeveria e Republikës së Kosovës, duke nxjerrë ligje dhe akte nënligjore, cenon pavarësinë kushtetuese të Institucionit të Avokatit të Popullit. Tri vjet më parë, Qeveria /Ministria e Administratës Publike kishte nxjerrë Qarkoren Administrative nr. 01/2016, e cila kishte kufizuar pavarësinë e të punësuarve të institucionit e për të cilën Avokati i Popullit e kishte ngritur

çështjen në Gjykatën Kushtetuese, e cila kishte vendosur në përputhje me kërkesën e Avokatit të Popullit në Aktgjykimin KO73/16.

Në bazë të argumenteve të shtjelluar gjerësisht në kërkesë, Avokati i Popullit kërkon nga Gjykata të vendosë masë të përkohshme për pezullimin e menjëhershëm të dispozitave të kontestuara, përkatësisht të neneve 2 (paragrafi 3), 5 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, paragrafi 2), 10 (paragrafët 1 dhe 2), 11, 14 (paragrafi 5), 15 (paragrafët 4 dhe 6), 17 (paragrafi 7), 31 (paragrafi 3), 32 (paragrafi 5), 33 (paragrafi 5), 34 (paragrafi 16), 35 (paragrafi 6), 37 (paragrafi 5), 38 (paragrafi 7), 39 (paragrafi 11), 40 (paragrafi 12), 41 (paragrafi 6), 42 (paragrafët 10 dhe 11), 43 (paragrafi 13), 44 (paragrafi 4), 48 (paragrafi 9), 49 (paragrafi 6), 52 (paragrafi 7), 54 (paragrafi 6), 67 (paragrafi 11), 68, (paragrafi 8), 70 (paragrafi 8), 71 (paragrafi 8), 75, 80 (paragrafi 4), 83 (paragrafi 18) dhe neni 85 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë.

Kërkesë e Avokatit të Popullit drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin si dhe për pezullimin e Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik

Ligji nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, mes tjerash, e përcakton sistemin e pagave dhe të shpërblimeve për zyrtarët publikë, të cilët paguhen nga buxheti i shtetit; dhe rregullat për përcaktimin e pagave të punonjësve të ndërmarrjeve publike në Kosovë. Ligji nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik e autorizon Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës për nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Çështjet e ngritura që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë e Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, janë si në vijim: nëse Ligji për Pagat në Sektorin Publik cenon parimin e ndarjes së pushteteve, kontrollit e balancimit mes tyre; nëse me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik është arritur të sigurohet garancia kushtetuese që ka të bëjë me barazinë para ligjit, përkatësisht nëse ligji në fjalë ka arritur të sigurojë pagë të barabartë për punë të barabartë; nëse Ligji për Pagat në Sektorin Publik cenon të drejtën e pronës të subjekteve në sektorin publik.

Avokati i Popullit konsideron se Gjykata Kushtetuese duhet ta japë një vlerësim lidhur me çështjet si në vijim: Nëse parimi i ndarjes së pushteteve dhe garancia kushtetuese, që ka të bëjë me barazinë para ligjit, është arritur me Ligjin e kontestuar dhe me Shtojcën 1 të tij; Nëse Ligji i kontestuar duhet t'i përfshijë ndërmarrjet publike, të cilat ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës dhe nëse përfshirja e tyre në Ligjin e kontestuar e cenon Kushtetutën, përkatësisht parimin e ekonomisë së tregut të lirë, i shprehur në nenin 10 dhe në nenin 119 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të reflektuar në Ligjin nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike; Nëse Ligji i kontestuar duhet t'i trajtojë me kujdes punonjësit e institucioneve, të organeve dhe të autoriteteve të një rëndësie të veçantë dhe punonjësit në sektorin publik për specializimin e të cilëve është investuar.

VII. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNJ), të themeluara në pajtueshmëri me Parimet e Parisit, të cilat janë kriteret minimale që duhet t'i ketë një institucion për të drejtat e njeriut që të konsiderohet kredibil, i pavarur dhe efektiv në arenën ndërkombëtare, kanë rol shumë të rëndësishëm, përveç të tjerash, edhe në mbikëqyrjen e zbatimit efektiv të obligimeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që burojnë nga mekanizmat dhe dokumentet ndërkombëtare, të cilat janë pjesë e sistemit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

Vitin e kaluar, me rastin e 25-vjetorit të miratimit të Parimeve të Parisit, znj. Dunja Mijatović, Komisionarja e Lartë për të Drejtat e Njeriut e Këshillit të Evropës, në deklaratën e saj tregoi për rëndësinë e IKDNJ-ve në sistemin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, kurse këtë vit është bërë edhe më shumë punë në këtë aspekt. Më 15 mars 2019, Komisioni i Venedikut miratoi “*Parimet për Mbrojtjen dhe Promovimin e Institucioneve të Ombudsmanëve*”, të referuara si (“Parimet e Venedikut”)²⁷⁹, të cilat përfaqësojnë një përmbledhje të standardeve të njohura ndërkombëtare për Institucionet e Ombudsmanëve dhe janë ekuivalente me Parimet e Parisit. Ato do të luajnë rol kyç në mbrojtjen e institucioneve ekzistuese të Ombudsmanëve të cilat përballen me kërcënime të ndryshme të ushtrimit të pavarur të mandatit, ofrojnë udhëzime rreth funksionimit dhe përmirësimit të punës së tyre dhe gjithashtu shërbejnë si bazë për krijimin e institucioneve të reja të Ombudsmanëve, në shtetet në të cilat nuk janë krijuar ende.

Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës, si institucion i pavarur kushtetues për të drejtat e njeriut, është i përkushtuar që të veprojë si urë lidhëse në shkëmbimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, por gjithashtu të përgatisë kapacitetet e tij, që në një të ardhme kur Republika e Kosovës të anëtarësohet në Kombet e Bashkuara dhe Këshillin e Evropës, të jetë në gjendje të marrë përsipër obligimet e veta në kuadër të sistemit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke e ditur rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërveprimit me organizata dhe rrjete të ndryshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ka marrë pjesë në një sërë takimesh, të cilat janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Data
1.	Roli i IKDNJ-ve në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në zonat e pakontrolluara nga qeveria Bruksel, Belgjikë	13-14 shkurt 2019
2.	Konferenca për 20-vjetorin e themelimit të Ombudsmanit të Greqisë Athinë, Greqi	20-22 shkurt 2019
3.	Punëtori për shqyrtimin e projektligjit për të mbrotjen e fëmijëve Durrës, Shqipëri	23-25 shkurt 2019

²⁷⁹ 25 Parimet e Venedikut për Institucionet e Ombudsmanëve, Komisioni i Venedikut, [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)005-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)005-e)

4.	Takimi vjetor i GANHRI 2019 Gjenevë, Zvicër	4-7 mars 2019
5.	Punëtori për dhunën me bazë gjinore dhe qasjen e barabartë në drejtësi Sarajevë, Bosnje	4-5 mars 2019
6.	Forumi i Gjashtë Rajonal për Sundimin e Ligjit për Evropën Juglindore Dubrovnik, Kroaci	23 mars 2019
7.	Punëtori lidhur me të drejtat ekonomike dhe sociale në situatat (post) konflikt Mostar, Bosnje	25-27 mars 2019
8.	Forumi i 12-të Evropian për të drejtat e fëmijëve Bruksel, Belgjikë	2-3 prill 2019
9.	Takimi i 6-të i Këshillit të Evropës-FRA-ENNHRI-EQUINET për Platformën Operacionale for Barazinë e Romeve Bratisllavë, Sllovaki	14-15 maj 2019
10.	Takim i Komitetit për çështje politike dhe demokraci i Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës lidhur me situatën në Kosovë dhe rolin e Këshillit të Evropës Strasbourg, Francë	11 prill 2019
11.	Takimi i dytë trepalësh i institucioneve për të drejtat e njeriut të Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë dhe Kosovës Tetovë, Maqedoni	18-19 prill 2019
12.	Takimi i Grupit Punues për Azil dhe Migrim të ENNHRI Zagreb, Kroaci	25-26 prill 2019
13.	Takimi i Grupit Punues për Komunikim Bruksel, Belgjikë	21-22 maj 2019
14.	Trajnimi lidhur me “Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve” Hagë, Holandë	15-24 maj 2019
15.	Akademia e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut Venedik, Itali	3-7 qershor 2019
16.	Takimi i Rrjetit të Mekanizmave Kombëtar për Parandalimin e Torturës në Evropën Juglindore	10-12 qershor 2019
17.	Takimi përcjellës i ENNHRI lidhur me rolin dhe përgjegjësitë e IKDNJ-ve në Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në zonat e pakontrolluara, të pa njohura në territoret në konflikt	11-12 qershor 2019

	Bruksel, Belgjikë	
18.	Konferenca Ndërkombëtare për Eleminimin e Dhunës ndaj Fëmijëve Sofie, Bulgari	27-29 qershor 2019
19.	Trajnimi “Ndalimi dhe denimet alternative” Hagë, Holandë	5-12 shtator 2019
20.	Takimi i dytë i Rrjetit të MKPT-ve të Evropës Juglindore Shkup, Maqedoni	2-3 tetor 2019
21.	Vizitë studimore në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut Strasburg, Francë	8-9 tetor 2019
22.	Lansimi i projektit “Lehtësimi horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë-Faza II” Shkup, Maqedoni	9 tetor 2019
23.	Vizitë studimore në Bordin e Ombudsmanëve të Austrisë Vjenë, Austri	14-18 tetor 2019
24.	Takimi tematik i Rrjetit të Ombudsmanëve të Evropës Juglindore për të drejtat e fëmijëve me temën: “Të drejtat e fëmijëve migrantë” Tiranë, Shqipëri	17 tetor 2019
25.	Konferenca Rajonale “Dinamikat e Popullsisë, Kapitali Njerëzor dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm, në Evropën Juglindore” Sarajevë, Bosnje	21-22 tetor 2019
26.	Takimi vjetor dhe Asambleja e Përgjithshme e Rrjetit Evropian për Trupat e Barazisë (EQUINET) Bruksel, Belgjikë	23 tetor 2019
27.	Konferenca e 11-të Ndërkombëtare e Ombudsmanëve të Forcave të Armatosura Sarajevë, Bosnje	27-29 tetor 2019
28.	Punëtorja “Roli i IKDNj-ve në ndërtimin e paqes” Zagreb, Kroaci	29-31 tetor 2019
29.	Konferenca Rajonale e Mekanizmave të Barazisë Podgoricë, Mali i Zi	28-29 tetor 2019
30.	Takimi i Tretë Regjional ndërmjet Avokatëve të Popullit dhe Komisionarëve për Mbrojtje nga Diskriminimi nga rajoni	31 tetor- 1 nëntor 2019

	Vlorë, Shqipëri	
31.	Konferencëna e Projektit Spider Web, "Projekt Strategjik për të rritur zbulimin dhe detektimin e krimeve mjedisore në Ballkanin Perëndimor" Zagreb, Kroaci	12-13 nëntor 2019
32.	Takimi i Asamblesë së Përgjithshme dhe Konferencës Vjetore të ENNHRI Bruksel, Belgjikë	13-14 nëntor 2019
33.	Konferenca e Dytë Ndërkombëtare e Ombudsmanëve Stamboll, Turqi	18-19 nëntor 2019
34.	Vizitë studimore në Zyrën e Komisionarit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut lidhur me krijimin e indikatorëve për të drejtat e njeriut Gjenevë, Zvicër	20-22 nëntor 2019
35.	Konferenca ndërkombëtare "Fëmijët dhe të rinjtë në rrezik" Podgoricë, Mali i Zi	10-11 dhjetor 2019
36.	Konferenca "Liria pa urrejtje – Përshtatshmëria e lirisë së shprehjes me të drejta të tjera" Tiranë, Shqipëri	20 dhjetor 2019

Tabela: Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare

Bashkëpunimi me homologë dhe me organizata të tjera ndërkombëtare

Bashkëpunimi me homologë dhe me organizata të tjera ndërkombëtare në Kosovë është një element i rëndësishëm i punës së Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP). Kemi kënaqësinë të raportojmë që edhe këtë vit ky bashkëpunim ka vazhduar të avancohet edhe me tutje dhe është jashtëzakonisht i mirë. Në kuadër të tij janë realizuar një sërë aktivitetesh, të cilat kanë qenë mundësi e mirë e shkëmbimit të informatave dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, në mënyrë që të njëjtat të zbatohen edhe në Kosovë. Këto aktivitete janë të elaboruara më poshtë.

Të qenit anëtar i Rrjetit Evropian të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI) i ka benefitet e veta. Në kuadër të këtij anëtarësimi, Institucioni i Avokatit të Popullit ka përfituar nga pjesëmarrja në një sërë takimesh të realizuara në këtë vit.

Fillimisht përmendim punën që është duke u bërë në kuadër të projektit "*Roli i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut në situatat në konflikt dhe pas konfliktit*", i cili ka për qëllim të ngre vetëdijen për rolin e IKDNj-ve në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, të rrisë solidaritetin dhe bashkëpunimin ndërmjet IKDNj-ve evropiane, e sidomos atyre që veprojnë në zona post-konfliktuale, si dhe të mbështesë punën e tyre në angazhimin me akterë ndërkombëtarë dhe vendorë, duke e përfshirë edhe shoqërinë civile. Në kuadër të aktiviteteve të këtij projekti, më 13-14

shkurt 2019, përfaqësues të nivelit të lartë të IKDNj-ve në Evropë, organizata ndërkombëtare dhe shoqëri civile, u mbledhën bashkë në Bruksel, për të diskutuar për rolin dhe përgjegjësitë e IKDNj-ve në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në zonat e pakontrolluara nga qeveria në rajon. Takimi shërbeu si platformë për shkëmbimin e praktikave lidhur me rolin e IKDNj-ve në punën e tyre në këto kontekste si dhe identifikimin e qasjeve më adekuatë për punën në të ardhmen.

Puna në adresimin e të drejtave të njeriut në rrethana të tilla është sfiduese dhe e ndjeshme. Të drejtat e njeriut të individëve, të cilët jetojnë në zona të pakontrolluara nga qeveria, janë veçanërisht të rrezikuara, duke pasur parasysh mungesën e strukturave të njohura demokratike dhe ndërlidhja e drejtpërdrejtë e tyre me mekanizma ndërkombëtarë të mbrojtjes. Gjithashtu e rëndësishme në këto kontekste janë tensionet aktuale kulturore, etnike, fetare, politike dhe të tjera dhe karakteri i zgjatur i konflikteve që ka ndodhur shpesh në dekadat e fundit.²⁸⁰

Gjatë këtij takimi, z. Hilmi Jashari, Avokat i Popullit i Republikës së Kosovës, tregoi përvojën e institucionit tonë në punën e zyrës ekzistuese rajonale në pjesën veriore të Mitrovicës dhe qasjen në adresimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe ngritjen e besimit të komuniteteve të ndryshme që jetojnë atje në Institucionin e Avokatit të Popullit. Ai deklaroi: *“Ngritja e numrit të ankesave të pranuar nga kjo pjesë e Kosovës, është indikator matës i besimit të këtyre komuniteteve në punën tonë”*.

Kurse, më 11-12 qershor, ENNHRI organizoi edhe një takim pasues me të njëjtën temë, i cili u fokusua në identifikimin e mënyrave konkrete se si IKDNj-të evropiane mund t’i përmirësojnë të drejtat e njeriut në zonat jashtë kontrollit të shtetit për shkak të konfliktit.

Në kuadër të projektit të njëjtë, më 25-27 mars 2019, u mbajt një punëtori lidhur me të drejtat ekonomike dhe sociale në situatat në (pas) konflikt, në të cilën u diskutua lidhur me konfliktin dhe ndikimin e tij në deprivimin e njerëzve nga dinjiteti i tyre, një situatë e cila mund të zgjasë me vite. Shkelja e të drejtave ekonomike dhe sociale mund të jetë edhe shkak edhe pasojë e konfliktit. Në rrethana të tilla, monitorimi, dokumentimi dhe raportimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut bëhet një mënyrë e rëndësishme përmes së cilës IKDNj-të mund të ndikojnë në ndryshimet afatshkurta dhe afatgjata të gjendjes.

Po ashtu, më 29-31 tetor, në Zagreb u mbajt një punëtori lidhur me rolin e IKDNj-ve në ndërtimin e paqes, e cila kishte për qëllim t’i adresonte qasjet konceptuale në ndërtimin e paqes, ndërlidhjet e tyre me të drejtat e njeriut dhe ndikimet praktike në angazhimin e IKDNj-ve në punën e tyre në këtë kontekst. Në takim u tha: *“IKDNJ-të mund të bëhen shumë të rëndësishme në arkitekturën për ndërtimin e paqes. Ato punojnë në promovimin dhe mbrojtjen e dinjitetit të njeriut në shoqëritë që janë të ndikuara nga kujtimet e ngjarjeve të këqija që kanë përjetuar. Me statusin e tyre të pavarur, IKDNJ bëhen ura të pjesëve dhe niveleve të ndryshme të shoqërisë, duke i bërë ato partnere unike në procesin e ndërtimit të paqes.”*²⁸¹

²⁸⁰IKDNj-të evropiane dhe akterë të tjerë takohen për të diskutuar promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në zonat e pakontrolluara nga qeveria, ENNHRI, 18.02.2019, <http://ennhri.org/news-and-blog/european-nhris-and-other-actors-meet-to-discuss-the-promotion-and-protection-of-human-rights-in-non-government-controlled-areas/>

²⁸¹Punëtorja në Zagreb eksploron rolin e IKDNj-ve në ndërtimin e paqes, ENNHRI, 19 nëntor 2019, <http://ennhri.org/news-and-blog/workshop-in-zagreb-explores-the-role-of-nhris-in-peacebuilding/>

Në vazhden e aktiviteteve me ENNHRI përmendim edhe Akademinë e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, e cila u organizua në bashkëpunim me Zyrën e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (ODIHR), mbajtur më 3-7 qershor 2019, në Venedik të Italisë. Këtë vit ajo u fokusua në rolin e IKDNj-ve në zbatimin efektiv të të drejtave ekonomike dhe sociale. Në të morën pjesë 26 pjesëmarrës, në mesin e të cilëve edhe një përfaqësues nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës.

Gjithashtu, më 13-14 nëntor 2019, u mbajt edhe Asambleja e Përgjithshme dhe Konferenca Vjetore e ENNHRI-it, e cila këtë vit u fokusua në realizimin e të drejtave ekonomike dhe sociale në Evropë dhe roli i IKDNj-ve në këtë drejtim. Në kuadër të këtij takimi, IAP-ja kontribuoi edhe më një praktikë të mirë të punës sonë me fokus në realizimin e së drejtës në shëndet dhe mbrojtje sociale.

Ndër ngjarjet më të rëndësishme këtë vit ishte edhe pjesëmarrja e Avokatit të Popullit, z. Jashari, në takimin e Komitetit për Çështje Politike dhe Demokraci i Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës lidhur me situatën në Kosovë dhe rolin e Këshillit të Evropës, i cili u mbajt më datën 11 prill 2019. Në këtë takim, z. Jashari prezantoi gjendjen reale të të drejtave të njeriut në Kosovë, të arriturat, sfidat dhe mundësitë për avancimin e tyre në të ardhmen. Gjithashtu foli për të drejtat e komuniteteve në Kosovë dhe kornizën e mirë ligjore që ekziston për realizimin e të drejtave të tyre. Të arriturat që u përmenden gjatë këtij takimi, ndër të tjera, spikati: mbajtjen e debatit të parë parlamentar lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, vendimin i kryeministrit për themelimin e grupit ndërministror për të drejtat e njeriut, bazuar në rekomandimin e Avokatit të Popullit, ngritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit për 29 % në krahasim me vitin paraprak, ngritjen e numrit të rasteve të hetuara sipas detyrës zyrtare (ex officio), ngritjen progresive të numrit të ankesave të adresuara nga minoritetet, vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit si më të besuarin në vend dhe rajon nga Barometri për Ballkanin, gjithashtu cilësimi i njëjtë nga Komisioni Evropian në raportin e progresit për vendin, zbatimin e të gjitha masave në kuadër të Planit të Veprimit për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit etj. Kurse si sfida, z. Jashari përmendi mungesën e mekanizmave ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut, siç është mosanëtarësimi i Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës dhe rrjedhimisht pamundësia për t'iu drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mungesa e mekanizmave të tjerë të kontrollit të konventave të ndryshme ndërkombëtare, për shkak të barrierave politike, e gjithashtu edhe mungesa e mjeteve efektive juridike në rastet e zvarritjeve të procedurave gjyqësore.

Është me rëndësi të përmendet edhe pjesëmarrja në Takimin Vjetor dhe Konferencën e Aleancës Botërore për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut - GANHRI (nga e cila bëhet shqyrtimi i pajtueshmërisë së IKDNj-ve me Parimet e Parisit), i cili u mbajt në Gjenevë, më datat 4-6 mars 2019, i fokusuar në temën: “Sigurimi i zbatimit të bazuar në të drejtat e njeriut dhe përgjigjes gjinore, përcjellja dhe rishikimi i Kompaktit Global për Migracionin: Roli i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut”. Meqë Republika e Kosovës ende nuk është anëtarësuar në Kombet e Bashkuara, Institucioni i Avokatit të Popullit e ka të kufizuar mundësinë për të qenë pjesë e kësaj organizate të rëndësishme ndërkombëtare, por ka vite që merr pjesë në aktivitetet dhe takimet e saj si anëtar vëzhgues.

Në kuadër të bashkëpunimit që kemi me Zyrën e Komisionarit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, më datat 20-22 nëntor 2019, dy përfaqësues të IAP-së ishin për një vizitë studimore në Gjenevë, e cila kishte si fokus operacionalizimin e qasjes të bazuar në të drejta të njeriut ndaj të dhënave dhe indikatorëve në Kosovë. Në këtë vizitë, pjesë e delegacionit ishin edhe përfaqësues të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, me të cilët pritet që të nënshkruhet një memorandum bashkëpunimi për krijimin e indikatorëve matës për të drejtat e njeriut në Kosovë.

Këtë vit një vizitë tjetër studimore u mbajt në Austri, prej datës 13-18 tetor 2019. Nikoqir i kësaj vizite ishte Bordi i Ombudsmanëve të Austrisë, me të cilët kemi një bashkëpunim shumë të mirë dhe të cilët në vazhdimësi kanë qenë të gatshëm të na ndihmojnë me ndarjen e përvojës së shkëlqyer që kanë në punën e tyre, për ç' gjë i jemi mirënjohës. Ata e udhëheqin edhe Institutin Ndërkombëtar të Ombudsmanëve, në të cilin IAP-ja është anëtare me të drejta të plota.

Në periudhën raportuese, përkatësisht, më 25 prill 2019, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit mes Komisionit Kombëtar Zviceran për Parandalim të Torturës dhe Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili ka për qëllim monitorimin e përbashkët të operacioneve të kthimit me forcë ndërmjet Zvicrës dhe Kosovës. Kjo marrëveshje është e një rëndësie të veçantë për të dy institucionet, është marrëveshja e parë ndërkombëtare e kësaj natyre për të dy institucionet, si për Komisionin Kombëtar Zviceran për Parandalimin e Torturës dhe po ashtu edhe për Institucionin e Avokatit të Popullit, në kuadër të të cilit është Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës për Kosovë. Përmes këtij memorandum, palët ranë dakord që të bashkëpunojnë për së afërmi dhe të konsultohen me njëra-tjetrën në çështje të interesit të përbashkët me qëllim të arritjes së qëllimit të përbashkët, që të sigurohen që të kthyerit janë trajtuar mirë nga policia zvicerane gjatë operacionit të kthimit dhe që ata të trajtohen mirë në mënyrë humane që nga momenti i dorëzimit tek autoritetet policore të Republikës së Kosovës në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

Ndërsa kur jemi tek bashkëpunimi me institucione homologe nga rajoni, përmendim tri takime rajonale të realizuara ndërmjet Institucioneve të Ombudsmanëve dhe Komisionarëve për Mbrojtje nga Diskriminimi, të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. I pari u mbajt në muajin janar në Prizren, i dyti në muajin prill në Tetovë dhe i treti në muajin nëntor në Vlorë, si rezultat i të cilave u nënshkrua edhe një memorandum i bashkëpunimit, përmes të cilit palët nënshkruese ranë dakord të fokusohen në çështjet e mëposhtme:

1. Në takimet e organizuara nga vendet e Ballkanit, të kërkohet që gjuha shqipe të jetë gjuhë zyrtare e takimit, kurse në takime të tjera më gjerë, të vepohet sipas rastit dhe varësisht nga niveli.
2. Të krijohen kushte për shkëmbimin e ekspertëve në nivel institucionesh, me qëllim të ndarjes së përvojave në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe luftimin e diskriminimit dhe pabarazisë.
3. Shkëmbimi i rregullt i opinionëve dhe raporteve të interesit të ndërsjellë.
4. Të shfrytëzohet mandati i Avokatëve për kryerjen e shërbimeve të mira për shtetasit e huaj (që i përkasin të tri shteteve fqinje të përfshira me këtë memorandum bashkëpunimi), të cilët mund të jenë viktimat të shkeljeve nga autoritetet e shteteve respektive dhe që kanë probleme me realizimin e të drejtave të tyre në vendet ku jetojnë.

5. Në funksionimin e vazhdueshëm të një platforme diskutimi dhe këshillimi, për çështje të interesit të përbashkët.

Avokati i Popullit vazhdoi të jetë prezent për të dhënë kontribut edhe në disa takime të tjera rajonale. Ndër të tjera, vlen të përmendet që me ftesë të homologut nga Mali i Zi, ai mori pjesë në Konferencën Rajonale të Mekanizmave të Barazisë, e mbajtur në Podgoricë, më datat 31 tetor - 1 nëntor 2019, në të cilën z. Jashari kontribuoi me propozime konkrete se në çka mund të fokusohen Mekanizmat e Barazisë në rajon, për të përmirësuar punën e tyre, siç janë çështjet më poshtë:

- 1) Përdorimi i mjeteve të teknologjisë informative në krijimin e një platforme të publikimit të vendimeve dhe opinioneve të Mekanizmave të Barazisë.
- 2) Bashkëpunimi në nivelin teknik-shkëmbimi i ekspertëve ndërmjet institucioneve.
- 3) Solidariteti ndërmjet Mekanizmave të Barazisë - mbështetja e njëri-tjetrit në raste të kërcënimeve në punën e tyre respektive.
- 4) Qasje ligjore kreative - diskutimi lidhur me vështirësitë në të cilat hasën Mekanizmat e Barazisë dhe krijimi i standardeve të unifikuara për lehtësimin e punës së përditshme, p.sh. Mekanizmat e Barazisë punojnë së bashku me gjykatat në përcaktimin e vijës ndarëse ndërmjet lirisë së shprehjes dhe krimeve të urrejtjes.

Bashkëpunim i mirë ekziston edhe me institucione të tjera homologe në rajon dhe më gjerë, me të cilat Institucioni i Avokatit të Popullit i Republikës së Kosovës është në komunikim të përhershëm për çështje të interesit të përbashkët.

Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare

Anëtarësimi i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNj) në mekanizma dhe rrjete ndërkombëtare shërben për të avancuar marrëdhëniet dinamike që duhet të ekzistojnë ndërmjet tyre dhe sistemit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Duke u nisur nga kjo, edhe këtë vit, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ka vazhduar të punojë në drejtim të anëtarësimit në rrjete dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare

Duke qenë se me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, IAP-ja u mandatua si organ i barazisë, pas një pune të madhe në konsolidimin e Departamentit për Mbrojtje nga Diskriminimi, më datën 1 shkurt 2019, IAP-ja dërgoi kërkesë formale për anëtarësim në Rrjetin Evropian të Organeve të Barazisë (EQUINET). Pas kësaj kërkesë pasuan edhe një sërë komunikimesh formale për rishikimin e mandatit të IAP dhe përmbushjes së kriterëve për t'u anëtarësuar në këtë rrjet dhe me datën 23 tetor 2019, para anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të EQUINET, Avokati i Popullit z. Hilmi Jashari ka prezantuar kërkesën e Institucionit të Avokatit të Popullit për të qenë anëtar me të drejta të plota në Rrjetin Evropian të Organeve të Barazisë (EQUINET).

Me këtë rast, z. Jashari theksoi se Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës funksionon në përputhje me Statutin e EQUINET dhe kriteret e paracaktuara dhe së këndejmi plotëson kushtet e kërkuara për të qenë anëtar, krahas institucioneve të tjera të barazisë, anëtare të këtij rrjeti.

Përkundër kundërshtimit formal nga ana e Serbisë, respektivisht notës së protestës nga ana e Komisionarit për Mbrojtjen e Barazisë në Serbi, si dhe lobimit paraprak nga ana e tyre, me shumicë votash, anëtarët e EQUINET votuan për anëtarësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës në këtë rrjet.

Anëtarësimi i Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës në Rrjetin Evropian të Organeve të Barazisë (EQUINET) është një sukses tjetër i radhës për këtë institucion dhe i shtohet listës së anëtarësimeve në strukturat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Më poshtë në paraqitje tabelore është evidentuar gjendja momentale e anëtarësimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në mekanizma ndërkombëtarë:

Nr.	Rrjeti/Mekanizmi	Viti i anëtarësimit
1.	Instituti Evropian i Ombudsmanëve (EOI)	2002
2.	Rrjeti i Ombudsmanëve për Fëmijë i Evropës Juglindore (CRONSEE)	2009
3.	Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve (IOI) ²⁸²	2012
4.	Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI) ²⁸³	2013
5.	Asociacionin e Ombudsmanëve dhe Ndërmjetësve të Frankofonisë (AOMF) ²⁸⁴	2015
6.	Asociacioni i Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM)	2016
7.	Rrjeti i Ombudsmanëve për Ambientin dhe të Drejtat e Njeriut ²⁸⁵	2017
8.	Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë (EQUINET) ²⁸⁶	2019

IAP-ja gjithashtu ftohet dhe merr pjesë edhe në aktivitete të disa mekanizmave dhe rrjeteve të tjera, në të cilat, për shkak të barrierave politike, është vetëm anëtare vëzhguese në:

- Aleanca Botërore për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut - GANHRI (nga e cila bëhet shqyrtimi i pajtueshmërisë së IKDNj-ve me Parimet e Parisit);
- Rrjeti Evropian i Ombudspersonëve për Fëmijë - ENOC
- Rrjeti i Mekanizmave Kombëtar për Parandalimin e Torturës të Evropës Juglindore - SEE NPM (në kuadër të të cilit IAP-ja merr pjesë në takime të ndryshme që kanë për qëllim bashkëpunimin, promovimin dhe shkëmbimin e përvojës, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave të privuar nga liria).

²⁸²Për më shumë informata rreth Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve, vizitoni këtë ueb-faqe: www.theioi.org

²⁸³Për më shumë informata rreth Rrjetit Evropian të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, vizitoni këtë ueb-faqe: www.ennhri.org

²⁸⁴Për më shumë informata rreth Institutit Evropian të Ombudsmanëve, vizitoni këtë ueb-faqe: <http://www.aomf-ombudsmans-francophonie.org/>

²⁸⁵Ky rrjet është themeluar në vitin 2017 dhe është nënshkruar nga këto shtete: Bosnja, Kroacia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia dhe Sllovenia.

²⁸⁶Për më shumë informata rreth Rrjetit Evropian të Organeve të Barazisë (EQUINET), vizitoni këtë ueb-faqe: <https://equineteurope.org/>

Raportimi në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë

IAP çdo vit pranon pyetësor të tematikave të ndryshme nga organizata ndërkombëtare për të raportuar për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Edhe këtë vit janë dërguar pesë pyetësor të cilët janë të listuar në tabelën e mëposhtme.

Data	Tema e raportit/hulumtimit	Organizata/institucionit të cilit i është dërguar raporti
1 shkurt 2019	Raport lidhur me gjendjen e të zhdukurve në Kosovë	Grupi Punues i Kombeve të Bashkuara për të Zhdukurit me Forcë
27 shkurt 2019	Raport lidhur me gjendjen e personave të pastrehë në Kosovë	Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI)
27 shkurt 2019	Raport lidhur me gjendjen e realizimit të të drejtave ekonomike dhe sociale në Kosovë	Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI)
18 prill 2019	Raport lidhur me qasjen në kujdes shëndetësor të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas në Kosovë	Agjencia Belge për Azil
2 maj 2019	Raport lidhur me Gratë, Paqen dhe Sigurinë	Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara
28 gusht 2019	Raport lidhur me gjendjen e të dënuarve dhe të burgosurve në Kosovë	Ambasada Amerikane në Kosovë
29 gusht 2019	Raport lidhur me gjendjen e personave me aftësi të kufizuara intelektuale	Këshilli Zviceran për Refugjatë

Tabela: Lista e raporteve të dërguara në organizata ndërkombëtare

VIII. Komunikimi me publikun dhe me mediat

Gjatë vitit 2019, Institucioni i Avokatit të Popullit ka thelluar edhe më shumë bashkëpunimin me mediat dhe si rrjedhojë ka plasuar me kohë informacione të dobishme për publikun e gjerë. IAP-ja konsideron se komunikimi dhe informimi janë shtylla kryesore të llogaridhënies dhe transparencës kundrejt publikut.

Gjatë tërë këtij viti, Avokati i Popullit, e po ashtu edhe zëvendësit e tij, kanë folur për çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut, siç janë: mbrojtja nga diskriminimi, barazia gjinore, miradministrimi, mjedisi, dhuna në familje, e tema të tjera që bien në mandatin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit.

Të gjitha këto tema janë përçuar me kujdes tek publiku kosovar përmes intervistave, prononcimeve, debateve dhe konferencave për shtyp. Siç do të paraqitet më poshtë në tabelën numër 3, IAP-ja ka pasur punë me media të shkruara, radio e televizione dhe natyrisht mediat online kanë një mbulueshmëri më të madhe të aktiviteteve të institucionit. Avokati i Popullit ka dhënë intervista edhe për media në gjuhët e tjera, si ato serbe, boshnjake dhe turke, e po ashtu aktivitetet e IAP-së janë mbuluar edhe nga mediat e rajonit.

Vlen të theksohet se marrëdhënia reciproke me mediat ka sjellë rezultate në punën e IAP-së. Gjatë vitit 2019, Avokati i Popullit ka nisur 29 raste sipas detyrës zyrtare (Ex officio), duke u bazuar në artikujt e mediave vendore.

Tabela 1: Rastet e hapura Ex. Officio nga raportimet e mediave

Raste të hapura Ex. Officio nga raportimet e mediave	29
Portali “Gazeta Express“	6
Gazeta “Koha Ditore“	6
Portali “Klan Kosova“	3
Portali “Indeksonline“	2
Portali “Kallxo.com“	2
Të tjera	10

Në anën tjetër, klima e besueshmërisë ndaj IAP-së është krijuar përmes punës së institucionit, duke ofruar informacione të besueshme dhe të sakta për publikun.

Institucioni ka organizuar disa konferenca të mbajtura në institucion dhe ka prezantuar raporte dhe rekomandime drejtuar institucioneve dhe organeve përkatëse dhe kështu mbulueshmëria mediale ka qenë e kënaqshme. Zyra për marrëdhënie me publikun ka përcjellë komunikatat për media për të pasur reagime të duhura në funksion të miradministrimit.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka promovuar punën dhe aktivitete e saj, duke përdorur edhe mjete të tjera alternative të komunikimit, si Facebook, duke krijuar kështu një rrjetëzim më efikas në prezantimin e informacioneve drejtpërdrejt me publikun.

Megjithatë, një rol tjetër të rëndësishëm në thellimin e bashkëpunimit me media ka luajtur marrëdhënia korrekte me gazetarë nga Zyra për marrëdhënie me publikun, por edhe e Avokatit të Popullit si dhe bashkëpunëtorëve të tij.

Zyra për marrëdhënie me publikun ka vazhduar të rrisë kontaktin dhe informimin e vazhdueshëm dhe proaktiv me qytetarët, me qëllim të ngritjes së vetëdijes përkitazi me të drejtat dhe liritë e garantuara në Republikën e Kosovës, si dhe për rolin e mandatin që ka Avokati i Popullit.

Janë publikuar 43 raporte, prej tyre, 20 raporte për rastet, 11 raporte Ex-Officio dhe 12 raporte të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT). Pasqyra e tyre në statistika sipas muajve duket si në tabelën 2:

Tabela 2: 43 raporte të publikuara në ueb-faqen zyrtare, sipas muajve

2019	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Raportet e rasteve	-	1	1	4	4	-	1	-	-	1	5	3	20
Raportet Ex officio	-	-	-	1	2	2	2	-	-	-	-	4	11
Raportet e MKPT-së	-	-	-	2	3	2	-	3	-	-	2	-	12

Këto raporte janë publikuar në ueb-faqen zyrtare të IAP-së, të përcjella me informatë përmbledhëse. Më tej, raportet dhe informatat janë përcjellë tek mediat dhe janë shpërndarë po ashtu përmes faqes zyrtare dhe profilit të IAP-së në rrjetin social Facebook.

Po ashtu, në periudhën raportuese 1 janar – 31 dhjetor 2019, nëpërmjet ueb-faqes zyrtare të IAP-së, si dhe nëpërmjet postës elektronike dhe faqes së profilit të IAP-së në rrjetin social Facebook, janë shpërndarë edhe informata e njoftime të tjera lidhur me aktivitete dhe angazhime të Avokatit të Popullit. Numri i përgjithshëm i tyre arrin në 66. Të shpërndara në numra, sipas muajve, duken si në tabelën 2.

Tabela 3: 66 informata/deklarata/njoftime të publikuara në ueb-faqe, sipas muajve

2019	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
	2	1	8	8	10	7	4	3	6	3	6	8
TOTALI	66											

Edhe në këtë vit, Avokati i Popullit ka pasur prezencë të theksuar nëpër media në lidhje me aktivitetet dhe raportet e numërta që institucioni i ka bërë. Tabela 3 liston shpërndarjen e paraqitjeve mediale sipas medimeve, bazuar në kërkesa të mediave dhe gazetarëve për prononcime, intervista, emisione, debate e të tjera. Avokati i Popullit dhe bashkëpunëtorët e tij kanë pasur mbi 100 paraqitje mediale.

Tabela 4: Lajmet të ndryshme të publikuar dhe të emituar në medie, sipas medimeve

IAP në medie-lajme			
Agjencia e Lajmeve Kosovapress	28	Portali Arberesh.com	26
BIRN/Kallxo.com	36	Periskopi	20
Ekonomia Online	26	Telegrafi	19
Gazeta Bota Sot	6	Insajderi	19
Gazeta Epoka e Re	12	Indeksonline	15
Gazeta Koha Ditore	14	Koha.net	44
Gazeta Kosova Sot	6	Kosova-sot.info	11
Gazeta Zeri	10	Zeri.info	26
Gazetaexpress.com	17	Bota sot	15
Gazeta Metro.net	15	Rtklive.com	37
RTK 1	14	Lajmi.net	12
RTK 2	9	Fakteplus.net	34
KTV	15	Gazeta Blic	18
TV 21	9	Frontonline.net	26
Klan Tv	20	Gazeta Tribuna	16
TV Dukagjini	13	Faks.al	3
TV 7	12	Kosova Today	2
RTV Puls	5	Zhurnal.mk	7
RTV Gracanica	3	Time Ballkan	3

TV Most	4	Radio Evropa e Lirë	1
Radio Kontakt Plus	1	Radio Kosova	3
RTV Kim Radio	2	Kosovapost.net	1

Avokati i Popullit, në fund të vitit, në një konferencë të veçantë për media, prezantoi të dhënat preliminare të statistikave dhe punës së bërë përgjatë vitit 2019.

Zyra për marrëdhënie me publikun dhe mediat po ashtu menaxhon procesin e pranimi të kërkesave për qasje në dokumente publike (QDP) që i drejtohen IAP-së, si dhe procedimin e përgjigjeve të institucioneve tek palët.

Gjatë vitit 2019, Avokati i Popullit ka pranuar 4 kërkesa për qasje në dokumente publike dhe për të gjithat ka ofruar përgjigje pozitive. Lidhur me kërkesat e zgjidhura pozitivisht, palëve u janë dorëzuar dokumentet e kërkuara, në pajtim me kërkesat (në format fizik, në format elektronik, por herë-herë edhe në të dyja format).

IX. Financimi

IAP-ja është institucion i pavarur, i cili financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës. Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit: “IAP e përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe ia dërgon për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës”.²⁸⁷ Po sipas kësaj dispozite ligjore, IAP-së i sigurohet buxhet i nevojshëm shtesë edhe për rastet e shtimit të obligimeve dhe kompetencave me këtë ligj dhe me ligjet e tjera, respektivisht edhe me burime shtesë përkatëse dhe adekuate financiare dhe njerëzore.²⁸⁸ Kurse gjatë vitit 2019, IAP-ja ka pasur mbështetje të madhe nga donatorët e ndryshëm.

Financimi i IAP-së nga Buxheti i Republikës së Kosovës

IAP-ja, bazuar në procesin ligjor për përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesës së rregullt buxhetore, ka parashtruar kërkesën e vet buxhetore për vitin 2019 në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe në Ministrinë e Financave.

Kërkesa buxhetore për vitin 2019 nga ana e Avokatit të Popullit është përgatitur mbi bazën e planit të punës dhe të aktiviteteve të planifikuara për realizim gjatë vitit 2019. Buxheti i IAP-së për vitin 2019 është ndarë në masën monetare prej 1.373.753.99 €, i cili ka qenë i destinuar për këto kategori buxhetore si në vijim:

- a) Paga dhe mëditje në shumën prej 990.900.99 €.
- b) Mallra dhe Shërbime në shumën prej 309.353.00 €.
- c) Shpenzime komunale në shumën prej 25.500.00 €.
- d) Shpenzime Kapitale në shumën prej 48.000.00 €.

Pasqyrimin e buxhetit të IAP-së për vitin 2019, sipas kërkesës buxhetore, të buxhetit fillestar, të shpenzimeve buxhetore si dhe të kursimeve buxhetore, do ta paraqesim në formën tabelore mbi bazën e dhënave të përgjithshme sipas kategorive ekonomike buxhetore. Kurse raportimi financiar i detajuar dhe për vitin buxhetor 2019, për të gjitha kategoritë ekonomike buxhetore dhe nënkategoritë e veçanta ekonomike buxhetore, do të hartohet veçmas dhe do t’i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës mbi bazën e formularit të unifikuar për raportime financiare nga institucionet e pavarura, ashtu siç kërkohet nga ana e Komisionit për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Republikës së Kosovës.²⁸⁹

Në paraqitjen tabelore në vijim pasqyrohet buxheti i IAP-së për vitin 2019, duke e pasqyruar: *Kërkesën buxhetore, buxhetin fillestar sipas Ligjit për Buxhetin e vitit 2019, deklarin e kursimeve buxhetore nga IAP dhe shkurtimet buxhetore me vendim të Qeverisë të Republikës të Kosovës dhe buxhetin final për vitin 2019.*

Tabela 1: Buxheti i IAP-së sipas Kërkesës buxhetore të Ligjit të buxhetit, të deklarin të kursimeve buxhetore nga IAP-ja dhe me shkurtimet buxhetore me vendim të Qeverisë dhe buxhetin final për vitin 2019.

²⁸⁷ Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 35, paragrafi 3.

²⁸⁸ Po aty.

²⁸⁹ Raporti financiar i detajuar për buxhetin e IAP-së do t’i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas formularit unik për raportime financiare.

<i>Kategoria Ekonomike</i>	Kërkesa buxhetore	Buxheti i ndarë për vitin 2019	Deklarimi i kursimeve nga IAP	Shkurtimi buxhetit me vendim të Qeverisë	Buxheti Final 2019
Paga dhe mëditje	1.058.332.00	990.900.99	50.000.00	17.160.80	923.740.19
Mallra dhe shërbime	309.353.00	309.353.00	75.000.00	0.00	234.353.00
Shpenzime komunale	25.500.00	25.500.00	17.000.00	0.00	8.500.00
Shpenzimet kapitale	66.000.00	48.000.00	0.00	0.00	48.000.00
Gjithsej buxheti	1.459.185.00	1.373.753.99	142.000.00	17.160.80	1.214.593.19

Planifikimi i buxhetit, shpenzimi i buxhetit dhe deklarimi i kursimeve buxhetore për vitin 2019 është realizuar sipas nevojave të planfikuar dhe destinacionit të përcaktuar për plotësimin e nevojave dhe të aktiviteteve të punës së IAP-së, të cilat kanë qenë me interes të sigurimit të ushtrimit të mandatit, të mbarëvajtjes së punës dhe funksionimit të IAP-së. Kurse nuk ka munguar monitorimi dhe kontrolli i brendshëm në shfrytëzimin ekonomik dhe efikas të buxhetit.

Për vitin 2019, sipas procedurave ligjore, IAP-ja ka bërë edhe deklarimin e kursimeve buxhetore në muajin tetor 2019 në shumën totale 142.000.00 €. Mirëpo, me propozim nga Ministria e Financave (MF) dhe me vendim të Qeverisë të Republikës të Kosovës, në muajin dhjetor 2019, është bërë harmonizimi dhe shkurtimi i buxhetit të IAP-së nëpër kategoritë e ndryshme buxhetore në masën monetare prej 17.160.80 €.

Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2019

Buxheti IAP-së për vitin buxhetor 2019 është realizuar në nivelin prej 92.56 %, në raport me buxhetin final të fundvitit. Në tabelën vijuese e paraqesim gjendjen e buxhetit final në raport me shpenzimet buxhetore për vitin 2019. Paraqitja tabelore e të dhënave buxhetore është sipas kategorive ekonomike dhe sipas shpenzimeve të shprehura në përqindje.

Tabela 2: Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2019

Nr.	Kategoritë ekonomike	Buxheti Final për 2019	Buxheti i shpenzuar	Mjete të lira	Realizimi në %
1.	Paga dhe mëditje	923.740.19	923.740.19	0.00	100.00
2.	Mallra dhe shërbime	234.353.00	195.230.89	39.122.11	83.31

3.	Shpenzime komunale	8.500.00	5.262.96	3.237.04	61.92
4.	Shpenzime kapitale	48.000.00	0.00	48.000.00	0.00
Gjithsej		1.214.593.19	1.124.234.04	90.359.15	92.56

Donacioni - financimi direkt i IAP-së

Gjatë vitit 2019, IAP-ja ka pasur donacion nga Këshilli i Evropës, i cili ka qenë i destinuar për financimin dhe angazhimin e katër (4) këshilltarëve të jashtëm ligjorë, me qëllim të ushtrimit të mandatit nga Avokati i Popullit, pas hyrjes në fuqi të Pakos Ligjore për të drejtat e njeriut. Masa monetare e këtij donacioni ka qenë në shumë prej 19.194.47 €.

X. Statistikat

Përmbledhja statistikore e ankesave dhe e rasteve për vitin 2019

Nga 1 janari 2019 deri më 31 dhjetor 2019, në selinë e IAP-së në Prishtinë dhe në zyrat rajonale janë parashtruar 2014 ankesa dhe kërkesa për këshillë apo ndihmë juridike, nga qytetarët e Kosovës.

Numri më i madh i rasteve të hetuara nga IAP-ja, gjatë periudhës raportuese, kanë qenë kryesisht përkitazi me: *të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën për mjete juridike, të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, e drejta e qasjes në dokumente publike, mbrojtjen e pronës etj.*

Në tabelat e mëposhtme, në mënyrë të hollësishme, paraqitet numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura dhe rasteve të hetuara, numri i rasteve të hetuara sipas detyrës zyrtare, përkatësia etnike e ankuesve, gjinia e ankuesve, numri i rasteve të zgjidhura, autoritetet përgjegjëse kundër të cilave janë drejtuar ankesat, numri i raporteve me rekomandime dhe letër rekomandimeve për rastet e hetuara etj.

Tabela 1: Ankesat e paraqitura në IAP gjatë vitit 2019

	Numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura në IAP	2014
	Numri i personave të përfshirë në ankesat e paraqitura	9468
Përkatësia etnike e ankuesve		
	Shqiptarë	1810
	Serbë	91
	Boshnjakë	28
	Ashkali	24
	Romë	21
	Egjiptas	20
	Turq	12
	Të tjerë	8
Gjinia e ankuesve të paraqitur në Institucionin e Avokatit të Popullit		
	Meshkuj	1464
	Femra	550
Autoritetet përgjegjëse ndaj të cilave janë drejtuar ankesat (një ankesë mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse).		
	Gjykatat	620
	Ministritë	532

Komunat	270
Policia	128
Prokuroritë shtetërore	84
Person privatë	84
Ndërrmarjet publike	59
Kompanitë private	39
Agjencia Kosovare e Privatizimit	24
Autoritetet e huaja	17
Agjencia Kosovare e Pronës	4
Të tjera	288

Tabela 2: Ankesat e shpallura të papranueshme gjatë vitit 2019

Numri i ankesave të shpallura si të papranueshme	1037
Baza ligjore e papranueshmërisë së ankesave bazuar në Ligjin për Avokatin e Popullit	
Mosshfrytëzim i mjeteve juridike - neni 22, pika 1.4	361
S'ka shkelje, keqadministrim - neni 22, pika 1.1	249
Në shfrytëzim të mjeteve juridike - neni 22, pika 1.3	191
Jashtë juridiksionit - neni 21, pika 1.3.1	176
Mosinteresim, dështim i palës - neni 22, pika 1.2	48
E parashtruar pas afatit ligjor - neni 21, pika 1.3.2	8
Ankesë anonime - neni 21, pika 1.3.3	4

Tabela 3: Ankesat që janë në pritje për shqyrtim gjatë vitit 2019

Ankesat në pritje për shqyrtim	34
---------------------------------------	----

Tabela 4: Rastet e hapura për hetim në IAP gjatë vitit 2019

Rastet e hapura për hetim nga ankesat e paraqitura nga qytetarët	943
Rastet e hapura sipas detyrës zyrtare (Ex. Officio)	54
Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në rastet e hetuara	

	Shqiptarë	828
	Serbë	68
	Egjiptas	13
	Boshnjakë	12
	Turq	9
	Romë	8
	Ashkali	2
	Goranë	2
	Të tjerë	1
Gjinia e ankuesve bazuar në rastet e hetuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit		
	Meshkuj	681
	Femra	262
Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP-ja (një rast mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)		
	Gjykatat	335
	Ministritë	264
	Komunat	138
	Policia	60
	Prokuroritë shtetërore	47
	Ndërmarrjet publike	22
	Kompanitë private	12
	Agjencia Kosovare e Privatizimit	11
	Person privatë	8
	Agjencia Kosovare e Pronës	1
	Autoritetet e huaja	2
	Të tjera	159

Tabela 5: Lënda e rasteve të hetuara bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë (një rast mund të përfshijë më shumë se një shkelje të të drejtave të garantuara)

	E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	316
--	---	-----

E drejta për mjete juridike	205
E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit	180
Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	115
E drejta e qasjes në dokumente publike	99
Mbrojtja e pronës	80
Të drejtat e fëmijës	71
Barazia para ligjit	58
Të drejtat e të akuzuarit	36
E drejta për arsimin	34
Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues	28
Përgjegjësia për mjedisin jetësor	14
E drejta e martesës dhe familjes	12
E drejta për jetën	11
Dinjiteti i njeriut	11
Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes	8
Liria e lëvizjes	7
E drejta e privatësisë	4
Raste për ndërmjetësim	2
Mbrojtja gjyqësore e të drejtave	2
Liria e artit dhe e shkencës	2
Liria e mediave	2
Konfesionet fetare	2
E drejta e lirisë dhe sigurisë	1
Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore	1
Liria e asociimit	1
E drejta e integritetit personal	1
Liria e shprehjes	1
Liria e besimit, ndërgjegjjes dhe e fesë	1
Parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale	1

Tabela 6: Numri i përgjithshëm i rasteve të mbyllura nga IAP-ja gjatë vitit 2019 (jo vetëm rastet e vitit 2019, por edhe rastet e regjistruara më herët e të mbyllura gjatë këtij viti)

	Numri i përgjithshëm i rasteve të mbyllura	849
Baza ligjore e mbylljes së rasteve bazuar në Ligjin për Avokatin e Popullit		
	Të zgjidhur pozitivisht, në pajtim me kërkesën e ankuesit - neni 21, pika 1.5	345
	Të papranueshme, s'ka shkelje, keqadministrim - neni 22, pika 1.1	162
	Të papranueshme, në shfrytëzim të mjeteve juridike - neni 22, pika 1.3	138
	Të mbyllura me raport – neni 24.3	101
	Të papranueshme, mosshfrytëzim i mjeteve juridike - neni 22, pika 1.4	58
	Të mbyllura për mosinteresim të ankuesit, dështim i palës - neni 22, pika 1.2	36
	Të papranueshme, jashtë juridiksionit - neni 21, pika 1.3.1	9

Tabela 7: Raportet me rekomandime, Opinionet dhe Kërkesat për masë të përkohshme nga IAP-ja

	Raporte për rastet e hetuara (nga ankesat e qytetarëve)	20
	Raporte për rastet e hetuara <i>ex officio</i>	11
	Raportet e MKPT-së	12
	Letra me rekomandime	33
	<i>Rekomandime në Raportet dhe letrat me rekomandime</i>	225
	Kërkesë për masë të përkohshme	6
	Amicus Curiae	5
	Opinione	2

Tabela 8: Implementimi i rekomandimeve të nxjerra në raportet dhe në letër rekomandimet për rastet e hetuara nga IAP-ja gjatë vitit 2019

Autoriteti përgjegjës	Rekomandime të implementuara	Rekomandime të paimplementuara	Në pritje për implementim
Ministria e Drejtësisë	16	4	34
Ministria e Shëndetësisë	4	0	4
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	5	2	24

Ministria e Punëve të Brendshme	3	0	11
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	0	1	8
Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit	0	0	3
Ministria e Financave	0	1	0
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	2	0	1
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1	0	2
Ministria e Punëve të Jashtme	0	0	6
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	4	0	1
Qeveria e Kosovës	0	1	3
Kuvendi i Kosovës	1	0	2
Gjykata Themelore në Prishtinë	1	0	3
Gjykata Themelore në Mitrovicë	0	0	1
Prokuroria e Shtetit	0	0	2
Prokuroria Themelore në Prishtinë	0	0	2
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1	1	1
Policia e Kosovës	3	1	12
Telekomi i Kosovës	0	0	1
Universiteti i Prishtinës	1	0	0
Universiteti i Mitrovicës	0	0	1
Komuna e Prishtinës	0	0	2
Komuna e Ferizajt	0	0	3
Komuna e Podujevës	0	0	3
Komuna e Skenderajt	0	0	2
Komuna e Gjilanit	0	0	6
Komuna e Fushë Kosovës	0	0	3
Komuna e Kaçanikut	1	0	0

Komuna e Graçanicës	2	0	1
Komuna e Junikut	0	0	1
Komuna e Parteshit	0	0	1
Komuna e Mamushës	0	0	1
Komuna e Kllokotit	0	0	1
Komisioni i Pavarur për Media	0	0	1
Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	0	0	1
Agjencia Kadastrale e Kosovës	0	0	1
Shoqata e të Verbërve të Kosovës	1	0	0
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë	0	0	1
KEDS	1	0	0
Inspektorati Shëndetësor	2	0	1
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	2	0	0
Këshilli Prokurorial i Kosovës	0	0	4
Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave	1	0	0
Ngrohtorja e Qytetit, “Termokos”	0	0	2
Zyra e Rregullatorit për Energji	1	0	0
Oda e Përmbaruësve Privatë	0	1	0
Oda e Mjekëve të Kosovës	1	0	1
Agjencia Kosovare për Akreditim	1	0	0
Totali	55	12	158

Paraqitja grafike e statistikave 1 janar 2019 - 31 dhjetor 2019




Figura 1: Shqyrtimi i ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit 2019




Figura 2: Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në ankesat e paraqitura në IAP




Figura 3: Gjinia e qytetarëve bazuar në ankesat e paraqitura në IAP




Figura 4: Autoritetet përgjegjëse të ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit 2019




Figura 5: Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në rastet e hapura për hetim




Figura 6: Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP-ja




Figura 7: Lëndët e rasteve të hetuara, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë




Figura 8: Rastet e mbyllura nga IAP-ja gjatë vitit 2019 (jo vetëm rastet e vitit 2019, por edhe rastet e regjistruara më herët e të mbyllura gjatë këtij viti)




Figura 9: Implementimi i rekomandimeve të nxjerra në raportet dhe në letër rekomandimet për rastet e hetuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit

Statistikat për treguesin 7 të Kontratës së Reformës Sektoriale për Reformën e Administratës Publike²⁹⁰

Më 7 dhjetor 2017, mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian u nënshkrua Marrëveshja Financiare për Instrumentin për Asistencën e Para-Anëtarësimit - IPA 2016, pjesa e dytë, për Reformën e Administratës Publike. Kontributi maksimal i Bashkimit Evropian në këtë marrëveshje është në vlerë prej 25,000,000.00 EUR.

Objektivi i përgjithshëm i kësaj marrëveshjeje: *“Synon përkrahjen e procesit të reformës së administratës në Kosovë me qëllim të rritjes së llogaridhënies, transparencës dhe efektivitetit të administratës publike, me fokus më të madh në nevojat e qytetarëve dhe bizneseve. Ky program synon të ndihmojë qeverinë e Kosovës në zbatimin e pakos strategjike të reformës së administratës publike e miratuar në vitin 2015 e fokusuar veçanërisht në përmirësimin e llogaridhënies së administratës, harmonizimin e zhvillimit dhe koordinimit të politikave, në prezantimin e menaxhimit modern të burimeve njerëzore dhe modernizimin e shërbimeve publike të orientuar drejt konsumatorit. Programi gjithashtu do të fuqizoj kapacitetet administrative të nevojshme për zhvillimin dhe zbatimin e acquis të BE-së”*.²⁹¹

Vlen të theksohet se, me qëllim të rritjes së nivelit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, kjo çështje është përfshirë në po këtë marrëveshje, përmes treguesit (indiktorit) nr. 7, i cili

²⁹⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15707>


²⁹¹ Marrëveshja Financiare për IPA 2016 - pjesa e dytë, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe BE, fq. 18.

parashikon që deri në vitin 2020, zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga institucionet e nivelit qendror të arrijë jo më pak se 60 %. Ndërsa, kujtojmë se në vitin 2016, sa u përket rekomandimeve të adresuara institucioneve të nivelit qendror, zbatimi i tyre ka qene në shkallën 16 %. Kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi më 15 dhjetor 2017.

Më poshtë do t'i paraqesim të arriturat mbi zbatimin e treguesit nr. 7.2.1 dhe 7.2.2 për vitin 2019, nëpërjet statistikave:

Treguesi 7.2.1 kërkon që të paktën 90% e institucioneve të qeverisë qendrore, të cilave Avokati i Popullit u ka adresuar rekomandime në periudhën ndërmjet 1 janarit dhe 30 nëntorit 2019, janë përgjigjur me një letër brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.

Avokati i Popullit, gjatë periudhës 1 janar deri më 30 nëntor 2019, ka adresuar 109 rekomandime institucioneve të nivelit qendror²⁹², nga të cilat, vetëm për 36 rekomandime ka pranuar përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar me nenin 25 dhe 28 të Ligjit nr. 5/L-019 për Avokatin e Popullit.²⁹³ Me këtë konkludohet se shkalla e zbatimit për treguesin 7.2.1 është mjaft e ulët, sepse Avokati i Popullit, gjatë periudhës së përcaktuar, ka pranuar përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh vetëm për 33% të rekomandimeve të adresuara institucioneve të nivelit qendror. Prandaj, sipas këtyre të dhënave, treguesi 7.2.1 nuk është përmbushur.²⁹⁴




²⁹² Institucionet e nivelit qendror të përcaktuara me treguesin 7 të Marrëveshjes Financiare mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian; Kjo marrëveshje mund të gjindet në gazetën zyrtare nën linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15707>

²⁹³ <https://www.oik-rks.org/2018/08/20/ligji-per-avokatin-e-popullit-nr-051-019/> qasur më 13/02/2019

²⁹⁴ Metoda e kalkulimit për treguesin 7.1.1 është bërë sipas formulës: $X = \frac{\text{numri i rekomandimeve me përgjigje nga institucionet e nivelit qendror të pranuar nga Avokati i Popullit brenda afatit ligjor}}{\text{numri total i rekomandimeve të Avkatit të Popullit adresuar institucioneve të nivelit qendror gjatë periudhës së përcaktuar}} \times 100$.

Treguesi 7.2.2 kërkon që të paktën 50% e të gjitha rekomandimeve drejtuar institucioneve të qeverisë qendrore, të lëshuara në vitet 2018 dhe 2019, në të cilat institucionet e qeverisjes qendrore janë përgjigjur pozitivisht, janë zbatuar.

Avokati i Popullit, gjatë periudhës 1 janar 2018 deri më 31 dhjetor 2019, gjithsej ka adresuar 313 rekomandime institucioneve të nivelit qendror²⁹⁵ (në vitin 2018 janë adresuar 151 rekomandime, ndërsa gjatë vitit 2019 janë adresuar 162 rekomandime), nga të cilat 107 rekomandime janë zbatuar. Ndërsa në rekomandimet e adresuara gjatë së njëjtës periudhë dhe për të cilat kemi pranuar përgjigje pozitive apo përgjigje me synim pozitiv mbi zbatimin e rekomandimeve, kemi 182 rekomandime, nga të cilat janë zbatuar 99 prej tyre, apo shkalla e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, sipas indikatorit 7.2.2 ka arritur në 54%.²⁹⁶



²⁹⁵ Institucionet e nivelit qendror të përcaktuara sipas listës në metodologjinë e treguesit 7 (7.1.1 dhe 7.1.2) të Marrëveshjes Financiare mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian; Kjo marrëveshje mund të gjindet në gazetën zyrtare nën linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15707>

²⁹⁶ Metoda e kalkulimit është bërë sipas formulës së përcaktuar me treguesin 7.1.2: $X = \frac{\text{numri i rekomandimeve të adresuara institucioneve të nivelit qendror gjatë periudhës së përcaktuar, për të cilat institucionet përgjegjëse kanë kthyer përgjigje me synim pozitiv mbi zbatimin e rekomandimeve, janë implementuar}}{\text{numri total të rekomandimeve të adresuara institucioneve të nivelit qendror gjatë periudhës së përcaktuar për të cilat institucionet përgjegjëse kanë kthyer përgjigje me synim pozitiv mbi zbatimin e rekomandimeve}} \times 100$.